

6654|P<sup>D1</sup>

# Thema

**murteza LUZHA**

**gani BOBI**

**ružica PETROVIĆ**

**shkëlzen MALEIQI**

**zhan-pol SARTËR**

**herbert MARKUZE**

**fehmi AGANI**

**asllan PUSHKA**

**drago DURIĆ**

**sherif MALOKU**

**xhafer XHAFERI**

THE  
HISTORICAL  
SKETCH

OF THE  
CITY OF NEW YORK.

BY JAMES FENIMORE COOPER.

IN THREE VOLUMES.

THE FIRST VOLUME.

NEW YORK,  
1828.

PRINTED FOR THE AUTHOR BY  
J. & A. BROWN,

10, CHURCH-SQUARE,  
NEW YORK.

PRICE, \$1.50.  
THE SECOND VOLUME.

NEW YORK,  
1829.

PRINTED FOR THE AUTHOR BY  
J. & A. BROWN,

10, CHURCH-SQUARE,  
NEW YORK.

PRICE, \$1.50.  
THE THIRD VOLUME.

NEW YORK,  
1830.

PRINTED FOR THE AUTHOR BY  
J. & A. BROWN,

10, CHURCH-SQUARE,  
NEW YORK.

PRICE, \$1.50.

THE AUTHOR,  
JAMES FENIMORE COOPER,  
PREFACES

THESE VOLUMES WITH THE FOLLOWING  
INTRODUCTORY WORDS.

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

"THE HISTORY OF NEW YORK IS THE  
HISTORY OF AMERICA."

THEMA

REVISTË E SHOQATËS SË  
FILOZOFËVE DHE SOCIOLOGËVE  
TË KSA KOSOVËS

ČASOPIS DRUŠTVA FILOZOFA  
I SOCIOLOGA SAP KOSOVA

- PËRMBAJTJA — SADRŽAJ**
- ARTIKUJ — ČLANCI**
- Murteza Luzha:** Dialogët e Platonit
- Gani Bobi:** Kultura si introspekcion  
**Ružica Petrović:** Marksizam i revolucija
- TRIBUNA — TRIBINA**
- Shkëlzen Maliqi:** Nacionalizmu treba vaditi kvadratni koren
- TEKSTE TË ZGJEDHURA —  
IZABRANI TEKSTOVI**
- Zhan-Pol Sartë:** Socializmi që erdhi nga të ftohtët  
**Herbert Markuze:** Kultura në shoqërinë njëdimensionale
- HULUMTIME — ISTRAŽIVANJA**
- Fehmi Agani:** Burokracia, Marks i e Veberi
- Asllan Pushka:** Niveli i koncentrimit ekonomik dhe populativ në KSA të Kosovës
- KATALOGU I »THEMËS« —  
KATALOG »THEME«**
- Drago Đurić:** Peri Anderson: »Razmatranja o zapadnom marksizmu«
- Sherif Maloku:** Hivzi Islami: »Fshati i Kosovës«
- Xhafer Xhaferi:** Ernest Bloch: »Tezat e Marksit mbi Fojerbahun«
- Xhafer Xhaferi:** Muhamedin Kulashi: »Kah metafilozofia«

- THEMA
- REVIEW OF THE SOCIETY  
OF PHILOSOPHY AND  
SOCIOLOGY OF THE  
SAP KOSOVA
- CONTENTS**
- 1 ARTICLES
- 3 **Murteza Luzha:** The dialogues of Plato
- 13 **Gani Bobi:** Culture as introspection
- 29 **Ružica Petrović:** Marxism and revolution
- 37 TRIBUNE
- 39 **Shkëlzen Maliqi:** The Square Root of Nationalism
- 49 SELECTED TEXTS
- 51 **Jean-Paul Sartre:** Socialism coming from the cold
- 83 **Herbert Marcuse:** Culture in unidimensional Society
- 95 RESEARCH
- 97 **Fehmi Agana:** Burocracy, Marx and Weber
- 127 **Asllan Pushka:** The Level of Economic and Populative Concentration in SAP of Kosova
- 139 THE CATALOGUE OF »THEMA«
- 141 **Drago Đurić:** Pery Anderson: »West Marxism«
- 149 **Sherif Maloku:** Hivzi Islami: »The Village of Kosova«
- 155 **Xhafer Xhaferi:** Ernst Bloch: »Marx's Theses on Feuerbach«
- 163 **Xhafer Xhaferi:** Muhamedin Kullashi: »Towards Metaphilosophy«

EKZEMPLARI I DETYRUEŠHĚM  
OBAVEZNI PRIMERAK

ARTIKUJ  
ČLANCI



murteza  
luzha

---

**DIALOGËT  
E PLATONIT**

I

**P**latoni, filozofi i shquar grek, stilisti më i spikatur heLEN dHE njëri nga mendimtarët antikë më aktualë në epokën tonë, la pas vete mbi tridhjetë dialogë dhe trembëdhjet letra (sa janë ruajtur!).<sup>1)</sup> Këto vepra, Platoni i shkroi për një shtresë të gjere lexuesish, në formë bisede pro e contra të theksuar, të gjallë dhe me përsëritje të argumenteve më të rëndësishme.

Në dialogët e tij, Platoni vazhdimisht theksoi se filozofia nuk mund të mësohet pa përpjekje dhe mundime të caktuara, ngase edhe vetë shqyrtimi i problemeve filozofike kërkon formë të thelluar të të menduarit dhe përjetim të njëmendët të të gjitha çështjeve filozofike për të cilat meditohet. Të shkruash për filozofinë dhe për problemet e saj nuk është aspak lehtë, thotë Platoni, aq më parë kur dihet se fjalët nuk janë gjithmonë adekuate me ndjenjën që mund të kemi lidhur me ndonjë problem filozofik. Andaj, nga filozofi, në veprat e tij, kërkohet të ruajë ecurinë e zhvillimit dhe të zgjidhjes së çështjeve të shtruara dhe këtë, sipas bindjes së thellë të filozofit të madh grek, mund ta sen-

<sup>1)</sup> Nga tërë veprimitaria krijuese e Platonit, në gjuhën shqipe është përkthyer deri sot (më sa di unë) vetëm *Apologja e Sokratit* nga profesor Spiro Konda (botuar në vazhdim në revistën »Hylli i drithës« (1939—1940) dhe *Kritoni* ose Detyra e ka njeriu për atdhe (1939—1942) dhe më vonë si libri magjistrali i tull: *Platoni — Kritoni e Apologja e Sokratit*, Shkodër, Shyp shkronja »A. Gj. Fishta«, 1941. Aty-këtu, herë-herë nëpër revista dhe periodikun tjeter shqip hasim edhe fragmente të vogla nga ndonjë dialog tjeter të Platonit.

Nr. inv. 6657/P  
Inv. br. 1254/190



dërtojmë vetëm nëpermjet dialogëve. Vetëm në dialogë ekziston mundësia e ndërnimit të tezave e antitezave si dhe arritja e caktuar e zgjidhjes së problemeve të ndryshme filozofike e të tjera. Pikerisht për shkak të kësaj bindjeje të thellë, Platon i shkroi të gjitha veprat filozofike të tij (përveç *Apologjisë së Sokratit*) në formë dialogu, në të cilat, kuptohet, janë të pranishme përherë jo vetëm përbajtjet e caktuara filozofike, por edhe stili i shkëlqyeshëm dhe forma e lartë letrare dhe artistike e të shprehurit.

Në dialogët e tij, Platon përdori dialektikën si shkathësi nëpermjet të cilës shtrohen pyetjet e ndryshme dhe jepen përgjigjet e caktuara, me qëllim të zgjidhjes së drejtë dhe të saktë të çështjeve të ndryshme filozofike. Andaj, në kryeveprën e tij »*Shteti*«, Platon thotë se dialektika njerëzit i bën të aftë për të shtruar pyetje dhe për të dhënë përgjigje, ndërsa në dialogun »*Kratili*« shton se dialektikan konsideroi njeriun i cili është i aftë të pyesë dhe të përgjigjet. Në këtë drejtim Platon ishte adhurues i madh i të menduarit dialektik, përherë theksonte se për gjithçka duhet të mendohet në mënyrë dialektike dhe se për të dalluar të vërtetën nga gjenjeshtra duhet të hulumtohen edhe njera, dhe tjetra. Natyrisht, dialektika e Platonit nuk është objektive, ngase ai formuloi vetëm problemet e dialektikës subjektive, përkatësisht të metodës dialektike të hulumtimit. Për Platonin, dialektika gjithashu është një mënyrë e veçantë e shkathësisë së të folurit dhe si e tillë kjo ndryshon nga forma e të shkruarit. Nga ana tjetër, forma e dialogut për Platonin është zbatim praktik i kësaj mënyre të kuptimit të dialektikës. Me këtë, kuptohet, Platon nuk e reduktoi dialektikën vetëm në ndonjë metodë të diskutimit, ngase dialektika në kuptimin platonian ka domethënien edhe të teorisë së njohjes mbishqisore. Se Platon një mend mendoi kështu, këtë më së miri e vërteton përkufizimi i tij i dialektikës si teori logjike në dialogun »*Fedari*«, në të cilin, duke shpjeguar arsyet e aplikimit të kësaj forme të komunikimit për të paraqitur pikëpamjet filozofike të tij, ndërsa të tjera shkroi:

»Fjala e shkruar i përngjan fotografisë. Fotografia të duket e gjallë, por nese e pyet diçka, atëherë ajo me dinjitet hesht. Kështu është edhe me fjalen e shkruar: të duket se ajo flet thuajse diçka kupton; mirëpo, nese megjithëkëtë e pyet me dëshirë që të marrësh vesh diçka nga ajo që pohon, gjithmonë të thotë të njejtën gje. Ndërsa, kur botohet, brend gjithkaj dhe kështu arrin tek ata që e kuptojnë dhe tek ata për të cilët nuk është. Kurse, kur ndokush e keqtrajton dhe e ryn pa të drejtë, gjithnjë i nevojitet ndihma e

babait: sepse vetë as nuk mund të mbrohet as t'i ndihmojë vetes. Tjetërsoj është motra e saj, fjala e gjallë, ngase kjo me dituri shënohet në shpirtin e atij që mëson dhe di të mbrohet vetë e di të flasë dhe të heshtë ndaj ataj që nevojitet. E këtillé është fjala e gjallë dhe shpirtërore, ndërsa fjala e shkruar mund të karakterizohet si hije e saj. Njeriu i urtë shkruan vetëm për shkak të lojës ose për shkak të grumbullimit të kujtimeve të pleqërisë së harruar, edhe për vete, edhe për çdo njeri tjeter që shkon pas gjurmës së njejtë<sup>2)</sup>.)

Si shihet nga mendimi i ciktuar, Platoni vërtetë adhuronte fjalën e gjallë dhe dialektike dhe e konsideronte plotësisht parësore në krahasim me fjalën e shkruar. Vetëm fjala e gjallë ka forcë magjike për t'i bindur bashkëbiseduesit, për t'i komunikuar pikëpamjet e caktuara dhe për t'i mbrojtur mendimet e drejta. Vetëm dialogët mundësojnë këmbimin e vërtetë të mendimeve dhe mënyrën parimore të bisedimeve. Me fjalë të tjera, Platoni në veprat e tij i dha përparësi fjalës së gjallë dhe bisedave ndërmjet individëve dhe këtë e bëri ngase ishte thellësish i bindur se vetëm nëpërmjet dialogut ndërmjet njerëzve filozofia arrin qëllimet e veta. Nga ana tjeter, kjo bindje e thellë e tij e bëri Platonin mjeshtër të vërtet të thurjes së dialogëve dhe nga ky aspekt veprat e tij edhe sot të pushtojnë me bukurimë e rrallë artistike dhe shkaktojnë kënaqësi dhe përjetim të njëmendë estetik. Me dialogët e tij, Platoni, pra, u bë filozofi i pari që njëmend ngriti formën dialoge të trajtimit të problemeve të ndryshme filozofike në shkallën më të lartë artistike dhe përmes saj gjeti mënyrën më të përsosur të shprehjes së pikëpamjeve të tij për çështjet e ndryshme të kohës së tij. Në përmjet krahasimit, që është pa dyshim forma më e bukur dhe më e shpeshtë e dialogëve të tij, Platoni shprehu dhe formuloi krejt atë që mendonte dhe sÿnonte, shqyrtoi shumë probleme esenciale jo vetëm të jetës reale të përditshme, por edhe çështje të ndryshme gnoseologjike, metafizike, etike e të tjera. Në dialogët e tij, të pasur me teza dhe antiteza, që mundësojnë trajtimin e gjithanshëm të problemeve dhe evitojnë rrezikun e konkluzioneve të forcuara dhe të ngutshme, Platoni gjithashu paraqiti në mënyrë tejet plastike portretin e shumë personaliteteve të shquara të kohës së tij dhe në mënyrë të veçantë portretin e Sokratit si filozof të vërtetë. Për këto dhe shumë vlera të tjera origjinale, dialogët e Platonit janë të pasur me kualitete

<sup>2)</sup> Cituar sipas Parathënies së Milosh Gjuriqit me rastin e botimit të tretë të Apologjisë së Sokratit, Kritonit dhe Fedonit në gjuhën serbokroate, BIGZ, Beograd 1976, f. 21.

të shkëlqyeshme gnosologjike dhe estetike dhe nga ky aspekt me të drejtë konsiderohen vepra me vlerë të lartë teorike dhe artistike. Veçori të rralla dhe të jash-tëzakonshme të dialogëve të Platonit, që duhet theksuar posaçërisht janë pa dyshim, stili elegant dhe poetik, të menduarit filozofik që përshkohet nga një diskutim shumë i gjallë dhe i pasur nga aspekti i konfrontimit të mendimeve, frymëzimi i thellë krijues dhe forma e përsosur e të shprehurit filozofik. Nga ky aspekt, Platon i ishte dhe mbeti mjeshtër i pashoq i dialogut dhe njëri nga krijuesit më të mëdhenj të prozës artistike dhe të mrekullueshme. Me këtë rast nuk duhet harruar as adhurimin e pakufijshëm të Platonit ndaj mësuesit të tij Sokratit, nëpërmjet të cilit paraqiti tërë filozofinë e tij. Sokrati është oratori dhe interpretuesi kryesor i pikëpamjeve filozofike të Platonit.

Në dialogët e Platonit, Sokrati është personaliteti kryesor dhe në pjesën më të madhe të tyre ai e udhëheq bisedën. Përashtim bëjnë vetëm dialogët *Sofisti*, *Shtetari*, *Timeu* dhe *Kritia*, ku Sokrati vetëm merr pjesë dhe *Ligjet* ku ai nuk paraqitet fare. Duke bërë mësuesin e tij figurë qëndrore të dialogëve të tij, Platon i nëpërmjet personalitetit të Sokratit paraqiti një figurë jash-tëzakonisht të gjallë dhe të fuqishme, të urtë dhe modeste. Sokrati, si dihet, kurrë nuk fliste për veten dhe ishte i tërhequr dhe i përbajtj. Edhe pse ishte i mençur, ai kurrë nuk e konsideroi veten njeri të jash-tëzakonshëm dhe asnjëherë nuk glorifikoi personalitetin e tij. Mirëpo, Sokrati me gjithë modestinë e rrallë të tij ishte mendimtar i shquar dhe filozof i madh, i cili gjatë gjithë jetës u angazhua për humanizimin e njeriut. Tërë jetën e tij ia kushtoi bashkëatdhatarëve të vet, duke i këshilluar dhe tërhequr vërejtjen atëherë kur paraqitej nevoja. Vazhdimi i insistoi në diturinë e cila mund ti nënshtrohet qëllimeve praktike dhe të zbatohet në praktikë, në jetën e secilit individ dhe në marrëdhëni i ndërmjet njerëzve. Mendonte se dituria mund ta nxitë aktivitetin e njeriut dhe se mendimi mund të realizohet, respektivisht të shndërrohet në veprim praktik. Andaj, besimi në forcën morale të mendjes përbën thelbin e idealizmit etik të Sokratit.

Duke u mbështetur në mendimet e Sokratit, Platon i më vonë në dialogët e shumtë krijoi idealin e tij të mënyrës filozofike të jetës, që njëherësh është edhe boshti kryesor i tërë mendimit filozofik të tij, i cili lindi nga vetëdija kritike dhe problemi i diturisë, nga jetët e praktika përkatëse, kuptohet në bazë të teorisë së paraqitur. Për zgjidhjen e problemit të hulumtimit filozofik, theksoni Platon, e rendësishme është bindja subjektive mbi botën dhe jo mënyra e ekzistimit të saj.

Materialiteti i botës, shton ai, nuk e ka në vete esencën e vërtetë të tij, andaj as nuk mund të bëhet objekt i vërtetë i filozofimit. Vetëm realiteti ideal mund të bëhet objekt i diturisë dhe i të menduarit njërežor.

## II

Nëse u besojmë fjalëve të Arsitotelit se »nuk është ar çdo gjë që shkroi Platon«, atëherë me siguri është shumë vështirë të provohet saktësisht cilat vepra janë dialogë të Platonit dhe cilat të shitësve të veprave të tij, si ishte edhe Hermodori, i cili konsideronte dialogë të Platonit edhe veprat e autorëve të ndryshëm. Si pas studimit të dr. Milosh N. Gjuriqit.<sup>3)</sup> në kuadrin e Corpus Platonicum, vepra të Platonit konsiderohen dyzët e gjashtë vepra të ruajtura, *Mbrojtja e Sokratit*, dyzët e një dialogë, përbledhja prej trembëdhjetë letrave, *Definicinet, Klasifikimet dhe Epigramet* (1—32). Ndërkaq, nga Corpori në fjalë, qëmoti u hoqën shtatë dialogë joautentikë (*Aksioku, Alkioni, Demodoku, Erik-siu, Sizifi, Mbi virtytin, Mbi padrejtësinë bashkë me Definicinet, Klasifikimet dhe Epigramet*). Nga ana tjeter, tre ose katër dialogë, herë-herë, përbënë një tërësi për nga përbajtja, si ndodh bie fjala me dialogët *Teeteti, Sofisti, Shtetari, Filozofi* (ky i fundit nuk u shkrua) ose *Shteti, Timeu, Kritia, Hermokrati* (edhe ky i fundit nuk u shkrua). Mirëpo, si kemi shkruar në Parathënien për *Shtetin e Platonit*,<sup>4)</sup> në bazë të studimit të deritashëm të të gjitha punimeve autentike të Platonit, të gjitha veprat filozofike të themeluesit të idealizmit objektiv ndahen në katër grupe, që përputhen plotësisht me periudhat e zhvillimit filozofik të mendimtarit të madh antik. Në fund nuk duhet ta harrojmë as faktin se secilit titull të dialogëve të Platonit, Trasili u shtoi edhe titullin që tregon përbajtjen e tyre siç ndodh me dialogët *Georgissi* ose *Mbi retorikën, Laheti* ose *Mbi trimërinë, Parmenidi* ose *Mbi idetë* e tjera.

Në periudhën e parë të krijimtarisë filozofike të tij, të cilës i takon edhe vepra *Apologja e Sokratit*, Platon kishte pikëpamje të ngjashme me Sokratin dhe merrej kryesisht me hulumtimin konceptual të etikës. Kjo njëherësh tregon se për njerezit e asaj kohe parësore ishte njohja e themeltë e nocioneve kryesore të etikës. Shembull markant për këtë orientim filozofik të Platonit në periudhën e parë të zhvillimit filozofik të tij është, pa dyshim »*Protagora*«, që është dialogu më i rëndësishëm

<sup>3)</sup> Shih: Platon, *Obrana Sokratova, Kriton, Fedon*, BIGZ, Beograd, 1976, f. 17.

<sup>4)</sup> Shih: Ploni, *Shteti*, Rilindja, Prishtinë 1980, f. 14—15.

për studimin e nocioneve etike. Në këtë fazë të zhvillimit të tij Platon, gjithashtu, njësoj si mësuesi i tij Sokrati, thekson se për njerëzit dhe për jetën e tyre të përditshme shumë e rëndësishme është njohja e nocioneve etike ngase edhe virtuti është i mundur vetëm në saje të diturisë.

*Apologjia* ose *Mbrojtja e Sokratit* hyn në radhën e veprave më të bukura të Platonit dhe është shkruar në formë të një proze që, si thonë shumë studiues të filozofisë platoniane, është më e bukur se poezia. Andaj, leximi i kësaj mbrojtjeje të thjeshtë por tejet të gjuimshme të Sokratit para gjyqit popullor të Athinës paraqet për lexuesin një përfjetim të vërtetë artistik. Këtë mbrojtje, Sokrati e bëri në vitin 399 para e. r. në ditën e seancës së gjyqit para komisionit të gjykatesve (heliastëve) të cilet temotetet i zgjedhnin me short. Sipas veprimit gjyqësor, *Apologjia* ndahet në tri pjesë. Në pjesën e parë, që njëherësh është pjesa më e madhe e *Apologjisë* së Sokratit, paraqitet mbrojtja lidhur me dy padite që i bëhen Sokratit. Është njëfarë Sokrati i ndyrë, thuhet në padi, që studion tokën dhe qielin dhe që mëson sesi gjëja më e keqe mund të paraqitet si më e mirë. Sokrati gjithashtu gabon sepse çoroditë rrininë dhe nuk u beson perëndive të cilave u beson shteti dhe në vend të tyre fut perëndi të reja. Në seancën gjyqësore, Sokrati u mbrojt lehtë nga pjesa e parë e padisë, ngase kurrrë nuk u mor me gjëra dhe me fenomene të tokës dhe të qellit. Gabojnë dhe ngatërrohen të gjithë ata që mua me padisin për këto gjëra me të cilat u mor Anaksagora. Mua gjithashtu më ngatërrojnë me sofistët se gjëja po mësoj të tjerët sesi gjëja e keqe dhe e pavërtetë mund të paraqitet si e vërtetë dhe e drejtë. Pjesa e dyte e padisë kundër Sokratit që e paraqesin Meleti, Aniti dhe Likoni është shumë e rëndë. Nga tre akuzuesit Sokrati përmend veçanërisht Anitin, i cili ishte kryesor i procesin gjyqësor kundër tij. Këtë e vërteton edhe Platonit në dialogun e tij »*Menoni*«, në të cilin Aniti paraqitet kundërshtar i përbetuar i sofistëve dhe i mësuesve të mençurisë. Si thotë dr. Branislav Petronijeviqi në *Parathënien* e tij për *Apologjinë*,<sup>5)</sup> Sokrati, para se tu përgjigjet akuza e kësaj pjesë të padisë, flet për gjenezen e padisë së parë. Pyetjes se kush është më i mençuri nga njerëzit e gjallë, profecia në Delfi u përgjegj se ky njeri është Sokrati. Unë thotë Sokrati desha të vërtetoi dome-thënien e këtij pohimi të hyjnise dhe për të kuptuar mençurinë e tyre, studiova shtetarët, poetët, zejtarët

<sup>5)</sup> Shih: Platon, *Obrana Sokratova i Kriton*, Izdanje francusko-srpske knjižare A. M. Popovića, Beograd 1930, str. 5—7.

dhe oratorët. Në bazë të kësaj, unë konkludova se jam më i mençuri ndër këta, të cilët nga ana e tyre përfytyrojnë se dinë edhe atë që nuk dinë, kurse unë jam koshient se kurrgjë nuk di. Pikerisht ky hulumtim, shton Sokrati, nxiti urejtjet e të tjerëve dhe në këtë mënyrë fitova shumë armiq. Andaj, poetët për hakmarrës të tyre zgjodhën Meletin, shtetarët dhe zejtarët Anit-in kurse oratorët Likonin.

Në mbrojtjen e tij gjatë procesit gjyqësor, Sokrati në mënyrë të veçantë përgjigjet lidhur me dy pikat e para të padisë, me të cilat akuzohet se po prish rinnë. Në bazë të çfare argumenteve e mbështet akuzën e tij Meleti, pyet Sokrati dhe shton se për këtë nuk ekzistojnë kurrfarë të dhëناsh serioze dhe të argumentuara. Edhe sikur të bëja diçka të ngjashme, unë këtë do ta bëja pa qëllim. Së këtejmi, për këtë unë do të meritoja ndonjë këshillë apo vërejtje dhe kurrsesi akuza dhe dënim. Lidhur me padinë se po i mohon perënditë, Sokrati me përgjigjet e tij është më pak bindës. Mirpo, meqë gjatë procesit, nepromjet pyetjeve e detyron Meletin të pohojë se Sokrati gjëja nuk u beson fare perëndive, ai me sukses arrin ta mposhitë edhe këtë akuzë të paargumentuar të Meletit. Në fund, pas kryerjes së procedurës gjyqësore, gjyqtarët marrin vendim dhe e shpallin Sokratin fajtor. Sipas ligjit të atëherëshëm athinas, Sokrati kishte të drejtë të propozonte vetë dënimin. Mirépo, edhe pse u përpoq, pas tërheqjes së sérishme të gjykatësve, Sokrati dënohet me vdekje, duke pranuar këtë vendim në mënyrë të qetë, ndonëse nuk pajtohej me të. Fjalët e fundit të Sokratit ishin këto:

»Por, ju lutem edhe për këtë: kur të rriten bijtë e mi, i mundoni o burra, duke i mërzitur ashtu sikur ju kam mërzitur unë juve në qoftë se ju duket se do të përkujdesen më tëpër për pasuri ose për diçka tjetër sesa për virtyt. Dhe në qoftë se mendojnë se janë diçka e nuk janë asgjë, i qortoni sikurse ju kam qortuar unë juve në qoftë se nuk përkujdesen për atë që duhet dhe në qoftë se mendojnë se janë diçka, e nuk vlejnë kurrgjë. Dhe në qoftë se veproni kështu, atëherë e përjetoj nga ju drejtësinë e plotë, edhe unë vetë, edhe djemtë e mi.

Por tash është koha të shkoj unë në vdekje, kurse ju në jetë. E cili nga ne shkon drejt shpëtimit më të mirë, këtë nuk e di askush pos perëndisë«.

»Kritoni« është vepra e dytë e Platonit që i ofrohet lexuesit në gjuhën shqipe, në botim të »Rilindjes« së Prishtinës. Pas vdekjes së Sokratit, gjatë qëndrimit në Megarë, Platon vazhdoi të shkruante vepra në të cilat është i dukshëm ndikimi i idealizmit etik të mësuesit të

tij. Në këtë periudhë të zhvillimit filozofik të tij, përveç »*Apologjisë së Sokratit*«, Platon shkroi edhe dialogun »*Kritoni*«, i cili i përkushtohet lavdërimit të Sokratit, të cilin si theksuam më sipër e dënoi demokracia athinase. Ky dialog i Platonit hyn në radhën e veprave të hershme të Platonit dhe sikurse *Ijoni*, *Apologjia*, *Hipiu i vogël*, *Laheti*, *Trasimaku*, *Harmidi*, *Eutifroni* dhe *Lisidi*, u shkrua kryesisht nën influencën e Sokratit, dialog në të cilin paraqitet jeta e Sokratit dhe bëhet përcaktimi platonian i nocioneve etike.

Dialogu »*Fedoni*« i takon periudhës së pjekurisë së plotë të Platonit dhe bën pjesë në grupin e tretë të vepgrave të tij. Në këtë vepër të shkëlqyeshme, në të cilën kritikohet ashpër periudha kozmologjike e filozofisë dhe sidomos Anaksagora dhe mësimi determinist i tij, Platon përpinqet të provojë pavdeksinë e shpirtit dhe paraqet disa vërtetime për këtë, duke u nisur nga disa supozime. Së pari, thuhet në këtë dialog, shpirti dinte për idetë edhe para se të vendosej në trup; pra, shpirti ka edhe një ekzistence të mëparshme, kështu që ajo që ekzistojë para nesh, medoemos do të ekzistojë edhe pas nesh. Prandaj, kjo nuk mund të zhduket ngase si mund të lindë jeta po të zhdukej çdo gjë. Duke u nisur pikërisht nga ky fakt, thotë Plaroni, shpirti duhet të jetë i pavdekshëm.

Sikurse në »*Shtetin*« dhe në disa vepra të tjera, Platon edhe në dialogun »*Fedoni*« përqëndrohet në nocionin e të mirës, duke konsideruar atë shkak të fundit të gjithçkafit dhe për njohjen e së cilës nevojitet dituria më e lartë. Nga ana tjetër, Platon në fillim u impresionua shumë nga vizioni hyjnor i botës dhe ky preokuptim i tij është tejet i jartë të dialogun »*Fedoni*«. Për këtë shkak ndoshta Platoni në këtë dialog është më tepër se në asnje vepër tjetër i preokupuar me problemin e vdekjes dhe mendimi i tij nga ky aspekt është shumë larg realitetit dhe jetës së përditshme. Përveç kësaj, nga filozofia Platon kërkon të ndihmojë pa kur sim për pastrimin e shpirtit nga trupi dhe insiston përgatitjen e njeriut për jetë të amshueshme pas vdekjes. Prandaj, filozofi me dëshire e pranon vdekjen, ndërsa filozofi i vërtetë edhe e rregullon jetën në atë mënyrë që të jetë afér vdekjes. Në këtë mënyrë, me gjithë paraqitjen e disa pikëpamjeve të tjera që nuk përpunohen me këto të »*Fedonit*«, Platon prapëseprapë asnjëherë nuk hoqi dore nga ideja themelore e tij, aq shumë e theksuar në këtë dialog se më mirë është të jesh i vdekur, sesa i gjallë dhe se jeta e vërtetë është pengesë dhe kufizim, kurse vdekja manifestim i njëmendtë i jetës. Në këtë dialog Platon, përveç tjerash, shkroi hollësisht edhe për teorinë sensualiste të njohjes. Pyetjes që e paraqet

Simiu lidhur me rëndësinë që kanë shqisat për njohjen e së vërtetës, Sokrati i përgjigjet dhe konfirmon se shpirti, për shkak të kontaktit me të vërtetën, duhet plotësisht të veçohet nga trupi dhe terisa të jetë së bashku me trupin ky medoemos të shpie në iluzion në përpjekjet e tij për çdo observim. Andaj, për hir të njohjes të së vërtetës, duhet braktisur krejtësisht shqisat dhe ndijimet dhe në vend të tyre duhet të zbatohet vetëm mendimin e kulluar, i cili ekskluzivisht është i aftë ti vërej idetë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në dialogun »*Fedoni*«, Platoni shqyrtoi edhe çështje të tjera, të paraqitura herë-herë në formë tejet të errët dhe të zymtë duke theksuar se trupi është varrë dhe burg i shpirtit; se filozofët nuk synojnë asgjë tjetër veçse të vdesin dhe të jenë të vdekshëm (*Phaed.* 62 B, 64 A; respektivisht se duhet të jetojnë, veprojnë për t'u çliruar nga trupi si burim i vazhdueshëm i sëmundjeve dhe i mjerimit, i epsheve, i frikës dhe i figurave të llojlojshme iluzore. Andaj, përfundon Platoni, detyra e tyre është të çlironhen nga trupi dhe filozofët me dëshirë vdesin ngase pas vdekjes i pret e vërteta e njëmendtë.

### III

Duke shfletuar me kujdes të gjithë dialogët e Platonit, duke përfshirë këtu edhe tri veprat e shqipëruara: »*Apologjinë e Sokratit*«, »*Kritonin*« dhe »*Fedonin*«, njeriu nuk mund ti shmanget përshtypjes kryesore se Platoni në to na ofron një idealizim të realitetit dhe një porosi të përhershme se idealet njerëzore nuk duhet kërkuar në formën ekzistuese shoqërore të manifestimit të disa parimeve, por në nocionet ideale, të cilat janë normë e përgjithshme për të gjithë njerëzit. Andaj, qëllimi kryesor i filozofisë është njohja e gjithanshme e këtyre nocioneve ideale.

Shumë studiues modern të filozofisë së tij konfirmojnë se Platoni është filozofi më i madh antik grek, e disa prej tyre edhe filozofi më i madh i të gjitha epokave dhe njëri nga personalitetet më të shquara të mendimit filozofik, i cili ndikoi fuqishëm në shumë filozofë dhe mendimtarë të mëvonshëm. Me admirim të vecantë për Platonin shkruan edhe disa autorë që nuk pajtohen me disa pikëpamje të tij, duke reduktuar madje tërë krijimtarinë folozofike të traditës në dialogët e tij.<sup>6)</sup> Mirëpo, disa autorë të tjere, si Karl Poperi, shk-

<sup>6)</sup> Shih: Leon Brunschvicg, *L'Actualité des Problèmes platoniciens*, Paris, 1937.



ruan me indinjatë të thellë kundër Platonit dhe filozofisë së tij, duke e quajtur mësuesin e Aristotelit si krijues ideor të totalitarizmit.

Pavarësisht nga vlerësimet kontradiktore dhe kontraversat ekzistuese lidhur me dialogët e Platonit dhe filozofinë e tij në tërësi, për të cilën kemi shkruar hollësisht me rastin e botimit të »Shtetit« të tij në gjuhën shqipe, ai është dhe mbetet poet i njëmendtë i fjalës së shkruar dhe mjeshtër i rrallë i dialogëve. Ishte krijues i vërtetë i të shkruarit artistik dhe i stilit të bukur të meditimit filozofik, që mori fuqitë prej botës së ideve. Platon kishte në vete diçka demoniane dhe kjo atë njëmend e bëri mendimtar gjenial dhe filozof të vërtetë. »Si filozof, poet dhe reformator«, thotë Julius Shtenceli, njëri nga studiuesit më të njojur të filozofisë platoniane, »Platon synoi vetëm një: të bëhet Homer i ri dhe me veprën e tij ta zëvendësonte veprën e Homerit.?) Andaj, dialogët e tij edhe sot tingellojnë më bukurinë e mahnitur dhe si të tillë kurrë nuk humbin shkëlqimin e jashtëzakonshëm të tyre.

---

Shih: Julius Stenzel, *Platon der Erzieher*, Leipzig, 1928.

**gani  
bobi**

---

## **KULTURA SI INTROSPEKSION**

**H**eterogeniteti gjithnjë e më i thelluar shoqëror i shqiptarëve midis dy luftërave botërore po e desistematizonte edhe homogenitetin kulturor të tyre: dalin kërkesa për tipe të ndryshme kulturash, për orientime të reja kulturore. Është vështirë, të mos themi e pamundshme, të bëhet një klasifikim i qartë i këtyre orientimeve për shumë arsy (sidomos pse orientime të qarta as dhe që kishte), mirëpo kërkesat që shtroheshin në shtypin dhe në periodikun shqiptar të kohës mund të grupohen sipas disa tipeve kulturore. Kah kultura introspektive, ose kah tipi faustian i kulturës do t'i quajmë kërkesat e »neoshqiptarëve« për »neoshqiptarizmë«, ose për »shqiptarizmë oksidentale« që afishoheshin aq shumë në revistat dhe në botimet e tjera të viteve 30. »Neoshqiptarizma« u detyrohet kryesisht Branko Merxhanit dhe Vangjel Koçës, të cilët, jo vetëm që krijuan këtë fjalë, por dhe u përpoqën të bënин prej saj një koncept-bazë të kulturës dhe të shoqërisë shqiptare, i cili »elaborohej« në variante të ndryshme më së shumti në gazeten »Demokratia« të Gjirokastrës, si dhe në revistat »Neoshqiptarizma«, »Illyria«, »Minerva«, »Përpjekja Shqiptare« etj., që dilnin në Tiranë. C'kérkonin »neoshqiptarët« me »neoshqiptarizmën« e tyre?

Që të përgjigjemi në këtë pyetje, më parë të shohim se ç'mendonin vettë »neoshqiptarët« për përpjekjet dhe angazhimin e tyre në drejtim të »neoshqiptarizmës«. Njëri nga ata do të thotë shprehimisht: »Përpjekja jonë në periodën e jetës shqiptare që po kalojmë është një mundim i kotë, sepse mungon rrathi që t'a

kuptojë dhe të vihet nënë flamurin e saj<sup>1</sup>. Ky auto-dekurajim nuk është fare pa kurajo, sepse »kjo nuk do të thotë se njeriu s'duhet të përpinqet që të përgatit udhën për një tjeter periodë jete më të lartë dhe me kuptim më të gjërë<sup>2</sup>. Aq më parë pse »idea s'mund të triumfojë me një herë, po më parë duhet të shkojë nëpër disa fazë gjer sa të arrijë në fazën që të kuptohet, të çmohet të ndjeket dhe të mbretërojë në mëndjet dhe shpirtërat e të gjithëvet<sup>3</sup>. Në ç'fazë ishte »idea neoshqiptare«? Ajo, sipas Vangjo Nirvanës (Vangjel Kocës —G.B.), ishte »në fazën e parë të predikimit«, në »një fazë donkishoteske«, siç i thoshte më pastaj ai. Ç'dëshirohej të arrihej përmes kësaj »ideje-përpjekjeje«? Përmes kësaj »idealisme theoreike« të »shpirtërave që s'kuptohen« dëshirohej të arrihej »shpëtimi« nga »konvencionalizma dhe urtësia meskine«, të »krijohet« shqiptari pikërisht »si Don-Kishoti«, si Don Kishoti po, por jo »si një figure qesharake siç pandehet përgjithësisht«, veç si një hero që »përpinqet për një gjë të bukur, të drejtë, kundër çdo konvencion, poshtërie, egoisme dhe vulgariteti«; pikërisht »si Pear Gynt-i ibsenian«, i cili »përpinqet të gjejë e t'a zaptojë vetëhen«, pikërisht si »Fausti; si Ahasveri« që »ecën e ecën (...) për të zbuluar e zaptuar botën që i mungon dhe për të mbushur zbrasësirën që ndjen brenda në vetëhen e tij<sup>4</sup>.

Kërkosat për vetëkërkim, për vetëzbulim, për vetëzotërim, kundër çdo »konvencionalizmi e urtësie meskine«, janë, ç'është e vërteta, qëllimi kryesor i kulturës së tipit faustian, të cilin »neoshqiptarët« duan ta projektojnë »mbi të nesërmen shqiptare«, ku pasi të jetë bërë »ajo që psikologja e quan introspection«, mund të krijohet një »histori e re«, histori »në kuptimin e gjere e të thelle të fjalës«. Si mund të krijohet kjo histori e re, e gjere dhe e thelle? Si mund të krijohen shqiptarët që e kërkojnë, e zbulojnë dhe e zoterojnë veten? Këto pyetje marrin një përgjigje të prerë: përmes një »luftë morale«, të zhvilluar »jashtë botës politike dhe jashtë botës materiale« — thotë Vangjo Nirvana.<sup>5</sup>

Sikur të mos na ishte tërhequr vërejtja në një vend tjeter se »ne nuk i përdorim fjalët me kuptimin e tyre të rrugavet« dhe se gjithë ai që nuk ka njohje mbi »methodhologjinë e shkencave sociologjike mund të mos na kuptojë fare« dhe të bjerë »viktimë e një shpiegimi

<sup>1</sup> Vangjo Nirvana, *Përpjekja jonë*, Illyria, 17 Qershori 1934, fq. 2.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty.

paradoksal që nuk ka asnje lidhje dhe asnje afrim me rrjedhën e iderave tonë,<sup>6</sup> mbase do të ishim bërë edhe ne »pa asnje bazë kulture, pa shkollë dhe pa edukatë« dhe do t'i sulmonim »neoshqiptarët« »duke (i) akuzuar si lojtare fjalësh«.<sup>7</sup> Vërejtja e tërhequr na detyron ta mbajmë durimin e të kërkojmë »kuptimin« e »luftës morale jashtë botës politike e jashtë botës materiale«.

Udha na çon te motoja e *Përpjekjes shqiptare*: »politikë s'ka — vetëm kulturë«, e vënë që në numrin 1 të revistës për t'u shpjeguar »gjëre e gjatë në numrin 2 të saj dallimi që bëjnë themeluesit e *Përpjekjes* midis nocioneve *politikë e kulturë*. Para se t'u përgjigjet pyetjeve që i shtron vetë Branko Merxhani (»C'ndryshim ka midis nocioneve të Politikës dhe të Kulturës? C'është Politika? C'është Kultura? C'do me thënë të merresh me Kulturë pa bërë Politikë«), ai hap një, si e quan »paranthezë të vogël filozofike« me qëllim që »të na përgatise pak mendjen« për »përgjegjet e kuptuarshme« që zotohet t'i jape! Brenda kësaj »parantheze« Branko Merxhani fut, në një anë Niçen, duke na bërë me dije se për filozofin gjerman »fuqia lëvizëse e jetës është Der Will zur Macht — Vullneti i Pushtetit«, që do të thotë se »aq individi sa edhe Shoqëria kanë si qëllim të qenies së tyre të marrin nën sundim dhe nën influencën e vet çdo gjë, çdo çfaqje, çdo manifestim, që ka të bëjë me jetën njerëzore« dhe, në anën tjetër, si »të kundërt« me Niçen, vë filozofin frëng Alfred Fuije, i cili »si fuqi lëvizëve të jetës pranon Vullnetin e Konsciencës = Volonte de Conscience«.<sup>8</sup> Dallimi midis politikës dhe kulturës, sipas Merxhanit, nis pikërisht me pyetjen: »Kush vallë nga këta dy Filozofë ka të drejtë — Filozofi i Pushtetit, apo ai i Konsciencës?«. Kësaj pyetjeje i përgjigjet vetë Branko Merxhani, natyrisht, »duke u dhënë të drejtë« që të dy këtyre filozofëve, sepse edhe Nietzsche edhe Fouillée nuk bëjnë gjë tjeter veç se çfaqin një *Realitet Shoqëror* që e ndjejnjë« dhe se »përgjithsojnë gjykimin si-cilido simbas sistemit filozofik të vet«!<sup>9</sup>) Me kaq përfundon »parantheza e vogël filozofike« e Branko Merxhanit që kishte për qëllim të na »përgatise pak mendjen« dhe të na bënte me dije se ai dhe ata (»neoshqiptarët«) nuk përdorin »fjalësokaku«, por nocione, bile »(notion frengjisht; Begrift gjermanisht)«, kuptimin e të cilavet, thoshin ata, shqipja nuk e njeh.<sup>10</sup>

Përgjigjet »e kuptuarshme« të Branko Merxhanit po dalin pa kuptim, ashtu sikundër nuk po shihet kuptimi edhe i »paranthezës filozofike« të tij. Nëse me këtë

<sup>6</sup> Khs: *Përpjekja shqiptare*, 2 / 1936, fq. 65.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Po aty fq. 66—67.

<sup>9</sup> Po aty, f. 67.

<sup>10</sup> Po aty, f. 65.

parantezë është dashur të thuhet se politika është Der Will zur Macht, kurse kultura është Volonté de Conscience, atëherë më parë do të duhej shtruar disa pyetje që kanë të bëjnë, jo vetëm me »natyrën e përkthimit« të nocioneve që u përmendën më sipër. A është Der Will zur Macht e Niçes »Vullnet i Pushtetit«, si »qëllim për të marre çdo gjë nën sundim«, apo »diçka« më shumë se kjo? Mos Volonté de Conscience e Fuijesë është pak më tjeter se përpjekje (e individit dhe e shoqërise) që të marrin në dorë(?) çdo qenie të jetës dhe ta futin brenda në qarkun e 'percepcionit' të tyre? Dhe, së fundi, a janë fare »të kundërtë« dhe që e përashtojnë njëra — tjetrën Der Will zur Macht e Niçes dhe Volonté de Conscience e Fuijesë?

Pyetjet e parashtruara mbisin jashtë »paranthezes-së vogël filozofike« të Branko Merxhanit, prandaj të shohim si ai »e zhvillon« më tutje distingun mes kulturës dhe politikës. Pasi na tregon se çdo shoqëri shfaq dy farë »vullnetesh sociale« (»e para është Kultura, e dyta është Politika«), autori ynë na thotë shprehimi: »Kultura përbledh të gjitha përpjekjet theoreike dhe përshtypjet spiritualiste ose materialiste të një shoqërie<sup>11</sup>. Ky »përkufizim« i kulturës, nëse nuk mund të kritikohet për ndarjen »metafizike« midis kulturës materiale dhe kulturës shpirtërore, sepse »kultura përbledh (...) përshtypjet(?) spiritualiste ose materialiste«(<sup>12</sup>), atëherë mund të thuhet se nuk është gjithaq qartë. Porse, »qartësia« vjen më pastaj: »Puna e kulturës është, në parim, një punë mendimi, që ecën kryesisht drejt zbulimit të së Vërtetës«, ndryshe nga »puna« e politikës që »përmban dhe përbledh të gjitha mundimet praktike që bën një grup shoqëror brenda roku llimeve të historisë së vet«.<sup>13</sup> Me fjalë të tjera, politika »ecën drejt për drejtë për në Fuqi dhe për në Pushtet«, kurse kultura »kufizohet në gjurmimin dhe në përhapjen e së Vërtetës«.<sup>14</sup> Dhe, edhe më »qartë«: »Politikë, d.m.th. sundim. Dhe asgjë tjeter!« Ndërsa, kulturë, d.m.th. »zbulim i së Vërtetës«.<sup>15</sup> Rrjedhimisht nga kjo Der Will zur Macht është vullnet për Fuqi=Pushtet=Politikë= »sundim dhe asgjë tjeter!« A mund të thuhet tashti se »neoshqiptarët i lexuan me ëndje filozofët dhe sociologët borgjezë«, siç pohon Viron Koka,<sup>16</sup> apo mbështet më saktë të thuhet se ata nuk arriten t'i lexonin këta filozofë e këta sociologë?

<sup>11</sup> Po aty, f. 67.

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Khs: Viron Koka, *Kritikë pikëpamjeve reaksionare të neoshqiptarizmës*, Studime Historike, 2 / 1969, fq. 143—146.

Në bëlbëzimet e para filozofike e sociologjike në gjuhën shqipe e nga autorë shqiptarë, nuk duhet të jetë shumë e çuditshme pse Niçea na del »filozof i pushtetit«, përkatesisht, pse nocioni i tij *vullneti përfuqi* reduktohet e trivializohet si *vullnet pëtë nënshtruar*. Do të ishte kërkesë tepër e madhe për autorin tonë të kërkojmë nga ai Niçen autentik, të interpretuar dhe »të rikonstruktuar« pa i shtrëmbëruar dhe pa i degraduar idetë dhe koncepcionet filozofike të tij. Një Niçë i tillë rrallë se mund »të gjendej« në kohën e Branko Merxhanit, e edhe gjithandej ku nuk flitej shqipja. Niçen po e »vënин« në shërbim të fashizmit, prandaj edhe *fugia* e tij si *mbifuqi* (mehr Macht, mehr Kraft) po dominonte, për të mos thënë se ishte e vëtmja në interpretimet e këtij filozofi. Koncepcionet e tjera të *fuqisë* se Niçes nuk vërehen nga autori ynë: as *fuqia* si *thjesht fuqi*, e aq më pak *fuqia* si *krijimtari*, si *aftësi* dhe *mundësi pëtë përjetuar* dhe *pëtë jetuar*, *pëtë dashur e pëtë sjellë* në jetë të *renë*; *pëtë krijuar e pëtë dhuruar*, *pëtë t'u befasuar* me të papritura.<sup>16</sup>

Nëse Niçea e Fuije citohen nga autori ynë për të na »përgatitur pak mendjen«, Karl Manhajmi dhe vepra e tij *Ideologja dhe utopia* përmenden, pos për të na bëre me dije se ky »sociolog i madh« paska kritikuar »frazën e famëshme të Marx-it« (»nuk është ndërgjegjja e njeriut që cakton qenien e tij, është qenia shoqërore që cakton ndërgjegjen e njeriut«), edhe për të na thënë se (1) »Ndërgjegjja jone mvaret nga rrethanat shoqërore brënda në të cilat vërtitemi dhe jetojmë«, (2) »ajo që ngjan me rrethanat shoqërore, ngjan edhe me ndërgjegjet e njerëzvet« dhe (3) »çdo ndërgjegje që nuk u përgjigjet rrethanavet shoqërore, brenda të cilavet zhvillohet, është një ndërgjegje false«.<sup>17</sup> Një kushtëzim kaq i njëtrajtshëm shoqëror i vetëdijes mbas mund t'i atribuoitet edhe Manhajmit dhe mbas mund të qepet edhe me fjalë të tij, meqë *qenia shoqërore*, edhe pse zë vendin qëndror në sociologjinë e njoħjes, e edhe në veprat e tjera të Manhajmit, ka mbetur nocion ende i papërkufizuar, më shumë rrjedhojë kombinimesh elektike të teorive nga më të ndryshmet sesa sintezë origjinale e këtij autori. Përkrye kësaj vetë Manhajmi është ngritur disa herë kundër vulgarizimit të raportit: *qenia shoqërore — vetëdija shoqërore*, duke theksuar se ky raport është shumë më i thellë sesa e ka parë kritika tradicionale e ideologjisë, mirépo, ç'është e vërteta, vështirë është të hetohet ndonjë ndryshim i

<sup>16</sup> Khs: Gajo Petrović, *Filozofija i revolucija*, Naprijed — Zagreb, 1973, ff. 143—6.

<sup>17</sup> Branko Merxhani, *Politika dhe kultura, Përpjekja shqiptare*, 2 / 1936, ff. 65—66.

madh (kualitativ) midis kritikës tradicionale të ideologjisë dhe asaj të Manhajmit. Marrëdhënia midis qenies shoqërore dhe vetëdijes shoqërore, sipas këtij autorit, supozon që »(a) kushtet shoqërore përcaktojnë edhe strukturën bazë logjike-kategoriale të vetëdijes, e jo vetëm disa përbajtje të saj, e pastaj (b) nga përcaktimi total shoqëror i vetëdijes pason përfundimi mbi partikularitetin e domosdoshëm të vetëdijes dhe të menduarit të secilit grup shoqëror, ngase ato në tërësinë e caktuar shoqërore e historike zënë pozitë të vëçantë«.<sup>18</sup> Është konstatuar me të drejtë se ky »universalizim i nacionit të ideologjisë totale në mënyrë kritike është orientuar kundër pikëpamjes së Marksit që në secilën epokë historike në të menduarit e klasave revolucionare shprehet vetëdija historikisht më adekuatë«, ashtu sikundër është parë me luciditet se »dallimi« midis pikëpamjeve të Marksit dhe të Manhajmit mbi ideologjinë është se ky i fundit identifikon kushtëzimin shoqëror të mendimit me falsitetin ideologjik të tij.<sup>19</sup>

Nuk ishte qëllimi ynë »ta mbrojmë«, si tha Branko Merxhani, »frazën e famshme« të Marksit nga kritika e Manhajmit, por deshëm të theksojmë se autorit i *Ideologjisë dhe utopisë* citohet pa kriter, e aq më pak me ndonjë qëndrim kritik nga drejtori i *Përpjekjes shqiptare*. Pikëpamjet e Manhajmit dhe nacionet e tij simplifikohen dhe zëvendësohen njëri për tjetrin nga autorit ynë: atë që Manhajmi e quan »inteligjencë«, Branko Merxhani në mënyrë të vulgarizuar do ta quaje »kulturë«. Mirëpo kjo »kulturë« e Merxhanit, »e veçuar në përbajtje« dhe »e ndarë në qëllime« nga politika, vetëm verbalisht është »shesh i lirisë«, sepse duhet të jetë sa më larg dhe nuk duhet »të trazohet« fare me politikën, në mënyrë që të mos bëhet »sklave« e saj dhe të mos e humbë »kuptimin e qenies së vet«,<sup>20</sup> ndryshe nga »inteligjenca« e Manhajmit, e cila, po kështu, duhet të qëndrojë jashtë jetës shoqërore, e posaçërisht jashtë jetës politike, të rrije pezull (*sozial freischwebende Intelligenz*<sup>21</sup>) me qëllim që t'i analizojë pa anime e në mënyrë kritike ngjarjet shoqërore e politike dhe me qëllim që të ndikojë nga jashtë në to. Të merresh me politikë për Merxhanin do të thotë të merresh me »hiç gjë«, »të flesh tërë ditën duke zënë miza«, meqë

<sup>18</sup> Khs: Vojin Milić, *Sociologija saznanja izmedu istorizma i marksizma*, parathënie në: Karl Manhajm, *Ideologija i utopija*, Nolit — Beograd, 1978, f. XXV.

<sup>19</sup> Po aty, ff. XXV—XXVI; khs. edhe: Fehmi Agani, *Ideologja dhe camera obscura e ideologjizmit*, Thema, 1 / 1984, ff. 121 — 136.

<sup>20</sup> Branko Merxhani, p. i.c., ff. 68—69.

<sup>21</sup> Karl Manhajm, *Ideologija i utopija*, Nolit — Beograd, 1978, f. 152 e tutje.

»brenda kaosit të sotshëm të oshëtimave politike të botës zëri i ynë është si një *vox clamantis in deserto*.<sup>22</sup> Po pér të njëjtin Merxhan dhe po në të njëtin artikull »politikani përpinqet të qërojë jetën shoqërore nga zakonet e këqija, nga veset dhe në vendin e tyre të vendosë të mirat. Prandaj politikani ka nevojë të domosdoshme të vëré në dorë fuqinë e sundimit dhe të zotërojë pa asnje kufizim të gjitha zotësitë vepronjëse të një vendi« (nënvizimi ynë).<sup>23</sup> Si mund të jetë tashti kultura »shesh i lirisë« ku »nuk mund të hyjnë në punë as shtypjet, as frikësimet, as dhe çfarëdo urdhri zyrtar, por ku »gjurmohet« dhe »përhapet« e vërteta? Athua konfuzioni dhe kundërthëniet janë garancë e së vërtetës, apo, mbas, mohim i saj? Mos, vallë, »lëmi i mendimit« është përzierje idesh e konceptesh pa një qëndrim dhe qëllim të caktuar apo mbas aftësi e eliminimit të inkonsekruencave dhe të konfuziteteve pér t'u arritur e vërteta? Sa mund të jetë i lire mendimi nëse »nuk guxon« të merret »me hiç gjë«, të mendojë pér politikën? Këso pyetjesh nuk ia shtron vetes Branko Merxhani. Përkundrazi, në një vend tjeter do të jetë »më i qartë« kur kërkon »bashkërenditjen« e aksioneve të »njerezve të mendimit« me »njerezit e veprimit« (intelektualët me qeveritarët — G. B.), duke thënë shprehimisht: »Monarkia përbën bazën e lirisë sone politike dhe vetëm mbi themelet e fuqisë dhe të sundimit të saj do të jetë e mundur të zhvillohet dhe të konsolidohet evoluta normale e qenies shtetërore të kombit. Domethënë me monarkinë filloj periudha e pozitivismës sone shtetërore, periudha e një aktiviteti konstruktiv, e cila ka pér qëllim të fundit normalizimin dhe modernizimin e organizmës së brëndshme të shtetit«.<sup>24</sup> A mund të shpjegohen ky qëndrim apologjet dhe këto konstruksione të zbrazëta, kinse teorike, si rrjedhojë e pozitës së papercaktuar shoqërore dhe e pasigurisë së intelektualit shqiptar të viteve 30; si pasojë e mungesës së qëllimit të përbashkët të shoqërisë shqiptare? Sado që pyetja implikon një përgjigje pozitive, mendojmë se nuk mund të jepet që tashti një përgjigje e këtillë. Drejt kësaj përgjigjeje, po ndalemi te një shkrim tjeter i Branko Merxhanit, tashti te artikulli i tij *Tradita dhe idea kombëtare*, botuar në *Illyria* të 17 dhjetorit të vitit 1935.

Shkrimi i Merxhanit nis me pyetjen: »ç'rol lozin Tradita dhe Historia në formimin e Jetës Kombëtare?« dhe përfundon me konstatimin se »varja dhe skllavë-

<sup>22</sup> Branko Merxhani, p. i c. f. 70.

<sup>23</sup> Po aty, f. 68.

<sup>24</sup> *Vullneti*, 28 nentor 1929, f. 3.

<sup>25</sup> *Illyria*, 17 Dhetuer 1935, f. 5.

rimi në kërkimet e traditave, është armiku më i madh i çdo çapi çlironjës përpara«.<sup>26</sup> Brenda pyetjes nisëse dhe konstatimit sosës të këtij shkrimi »qarkullojnë« ide dhe pikëpamje që e kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe që vështirë qëndrojnë brenda një titulli të përbashkët. Megjithëkëtë, kritika e traditës e Branko Merxhanit është e vendosur: »Nuk shërbehet idea kombëtare kur ndjejmë nevojën të bindemi në një tok urdhëra të pa-arsyeshme, primitive dhe antishoqërore të traditave«.<sup>27</sup> Për së dyti: »Kombet e sotme u krijuan pikërisht sepse kanë dashur të largohen nga traditat e tyre«.<sup>28</sup> Për së treti, me fjalë të Dyrkemit: »Sa forcohetjeta kombëtare, kaq dobesohet tradita«.<sup>29</sup> Sa shihet nga shkrimi i autorit tonë tradita dhe kombi janë dy anë të ndara mes vete. Këto dy nocione e përjashtojnë njëri-tjetrin: aty ku ruhet tradita, nuk krijohet kombi; dhe, anasjelltas, aty ku zhvillohet kombi, zhduket tradita. Duke dashur ta theksojë raportin suprimues midis traditës dhe kombit, Branko Merxhani, »mbështet« shkrimin e tij në disa fjalë të zhveshura nga konteksti i përgjithshëm i veprave *Etude de Moral* të Rauh-it dhe *De la division du travail social* të Durkhiem-it.

Nëse trivializimi i traditës në »fuqi përtimi«, në »urdhër të pa-arsyeshëm«, »primitiv« e »antishoqëror«, në nocion »të kundërt« me kombin, mund të shpjegohet si reagim i »neoshqiptarëve« ndaj pozicionit të theksuar tradicionalist që kishin marrë një grup intelektualësh shqiptarë të tubuar kryesisht rrëth revistave »Leka« dhe »Hylli i Dritës«, një reduktim i këtillë i traditës në atë që më së shpeshti quhet »traditë negative« me qëllim që të kritikohet ajo, nuk paraqet ndonjë përpjekje serioze të »neoshqiptarëve« për t'i kontribuar mendimit kritik për traditën, atij mendimi që synon të depërtojë në esencën e dukurisë për ta parë atë me të gjitha mungesat, dobesitë e kufizimet e saja, me të gjitha mundësitë dhe perspektivat zhvillimore që ka ajo. »Neoshqiptarët« duke e parë traditën vetëm si »urdhër të pa-arsyeshëm« e »antishoqëror«, nuk arriten ta shihnin atë edhe si kusht të domosdoshëm të krijimit të vlerave të reja; nuk arriten ta shohin në emër të traditës, jo vetëm insistimin për të, por edhe kundërshtimin ndaj saj — aktin e seleksionimit (ç'është »e mirë« e ç'është »e keqe« nga tradita) në saje të përvetësimit të një tradite të caktuar dhe, së këndejmi, nuk arriten të shohin se tradita dhe kombi, sado që ndërsjell-

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

tazi gërshtetohen, mohohen, suprimohen, tejkalohen, me gjithatë gjallerohen dhe realisht veprojnë si momente konsitutive të një terësie.

Qëndrimi hiperkritik dhe përcmues ndaj traditës dhe përgjithësisht ndaj kulturës kombëtare i »neoshqiptarëve« duhet të shihet më tepër si një reagim i paartikular i tyre: nuk dëshironin të bëheshin ata që ishin, nuk donin të bëheshin qenie sociale-mendore-emotive e ngjashme me kushtet dhe rrëthanat e jetës së tyre. Këto kushte e rrëthana nuk kanë pikur nga qelli për të mbetur të pandryshuara sot e tërë mot: »Jeta kombëtare shqiptare e sotme nuk është përfundim i një tok traditave dhe ndjenjave, që çlironen nga çdofarë kritike e ndryshimi. Mbase është përfundimi i një shkence shkatërronjëse, i një mendjeje vepronjëse, që kërkon të gjejë gjithnjë më të drejtën, më të fismen, më të mbaruarën«.<sup>30</sup> Kriteri kryesor i »neoshqiptarëve« përpërkufizimin e kulturës kombëtare të tyre nuk ishte *ajo që është, por ajo që duhet të bëhet* dhe kjo që *duhet të bëhet* nuk mund të bëhet në mënyrë stihike e sporadike, por përmes proceseve transkulturative të organizuarra dhe të planifikuara që nënkuuptojnë »përpunimin e realitetit shoqëror« duke njojur më parë »ligjet e lëvizjeve dhe të determinizmave shoqërore«, si dhe duke marrë parasysh dëshirën dhe vetëdijen e pjesëtarëve të grupeve shoqërore për ndryshimin pozitiv të vlerave sociokulturore të tyre: »Që të kuptojmë më mirë — mirë nevojat e popullit tonë dhe që të përgatitim planet më të mira për një *Reformë kombëtare të vërtetë*, me parë nga çdo gjë mëndjen t'oni duhet t'i kthejmë nga populli dhe të gjejmë shkaqet pse ka mbetur mbrapa«,<sup>31</sup> sepse »Një Komb nis t'a ndjejë e t'a drejtojë vetëhen, vetëm ahene kur nis të mendojë fatin e tij: Një *Popull* bëhet *Komb* vetëm kur arrin një shkallë të lartë ndërgjegjëje (vetëdijeje — G. B.) dhe kur *frymën kritike të mendjes* së tij e kthen nga fuqitë e natyrshme dhe instruktive në të cilat ishte skllavëruara gjér dje«.<sup>32</sup> Kjo shkallë e vetëdijes supozon kërkimin e vazhdueshëm e kreativ të vërvetes që nuk mund të gjendet vetëm *brenda rrëthanave, kushteve, institucioneve e mënyrave ekzistuese* të të jetuarit, por përtëj këtij »realiteti« ekzistues. Identiteti kombëtar i shqiptarëve, me fjalë të tjera, duhet të vendoset, të krijohet, të formësohet parreshtur. »Shqiptarizma«, sipas »neoshqiptarëve«, duhet të dalë nga »struktura e veçantë« e shoqërisë shqiptare dhe duhet të krijohet si »shqiptarizmë, jo letraro-romantike, por radikal-demokrate«.<sup>33</sup> Që të mos themi edhe njëherë

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Branko Merxhani, p. i c., fq. 68.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Khs: *Përpjekja shqiptare*, 3 / 1936, fq. 172 — 180.

Problem diferencijacije ne može se postavljati kao jednostrana obaveza. Samo oni koji neće da razumeju složenu prirodu kosovskih konflikata, ili iz njih hoće da profitiraju rizičnim ulaganjima prema načelu »što gore — to bolje!«, nastoje da obavežu samo Albance ignorisuci ostale aktere kosovske drame. U vladajućem ideoološkom diskursu uopšte se ne uzima u obzir složenost odnosa, društveni milje sukoba u kojem po-stoji akcija i reakcija, i u kojem je teško ustanoviti, bar ne u ovom konkretnom slučaju, *ko je prvi počeo*, jer je početak tamo negde u maglenoj prošlosti. A u tom diskursu nam se kaže, i traži se od nas da to bez prigovora prihvativimo, kako su Albanci ti koji su prvi počeli, pa i kontinuirano nastavili sve do naših dana, kada se odigravaju možda i završne scene jedne viševkovne tragedije srpskog naroda. Prema logici stvari, ta je tvrdnja neodrživa. Kako sam već ranije naglasio, ovakav jednostrani pristup problemu može imati samo rasističko utemeljenje u tezi da su Albanci po prirodi agresivan i šovinistički nastrojen narod.

Kritičari mi stavljaju i ovu primedbu: ja, tobož, ne razlikujem agresivni i delatni albanski šovinizam, od verbalnog i salonskog sprskog šovinizma. U prvom slučaju radi se o aktima neposrednog nasilja nad pripadnicima drugih naroda, u drugom slučaju o brbljanju sa tribina. Naravno, ja sam spreman da se složim sa Vučelićem da to nisu šovinizmi iste specifične težine, i ne insistiram na njihovoj punoj nivelizaciji i sravnjivanju. Međutim, ja se s njim ne mogu složiti u potpunosti oko klasifikacije ovih šovinizama po nacionalnoj pripadnosti. Niti je albanski šovinizam toliko ogrezao u prljaviu praksu, niti je srpski samo u svilenim rukavicama. I ovde opet, moram da ukažem na jednostranost vladajućeg diskursa. Naime, klijučne teme ovog prinudnog diskursa nisu još uvek dovoljno argumentirana da bi se uzimali za očigledne pokazne i dokazne sudeove. Mnoga pitanja su tu otvorena, ali se snjima manipuliše kao da sasvim pouzdano znamo kakav je njihov karakter. Tvrdi se naime da se na Kosovu odvija otvoreni genocid, da su tu dopuštena diluvijalna bezakonja i izvljavanja najniže vrste. Kaže se: postoje bezbrojni primeri ubistava, nasi-

lja, silovanja, skrnavljenja grobova itd. Ali, ako bismo te primere divljaštva uzeli da nabrajamo pojedinačno, ispostavilo bi se da njihov broj nije nipošto mnogo veći od sličnih »divljaštava« u drugim našim civilizovanim sredinama (recimo, silovanja na Kosovu ima manje nego u nekom većem gradu u Jugoslaviji), a i njihova šovinistička motivacija vrlo je često nesigurna. I kada bismo od nekog ko se poziva na te brojne zločine Albanača nad Srbima i Crnogorcima pozvali da nabroji sve zločine za koje zna, bilo bi to, uveren sam, prilično neugodno pitanje za takvog sabesednika, jer bi on, u najboljem slučaju, mogao da navede recimo dvadesetinu slučajeva o kojima je pisala štampa. Ali, tu je važnija generalizacija od stvarnog broja poznatih slučajeva. *Slučajevi* su postali objekt neviđenih manipulacija. Klasičan je već postao slučaj Đorđa Martinovića. On se u ovom ideoološkom diskursu uzima kao jedan od glavnih dokaza teze o divljačkom i ničim ograničenom izvljavanju albanskih šovinista koji mogu, kao u turska vremena, činiti ama baš sve nad nezaštićenim srpskim i crnogorskim življem (na slici Mice Popovića prikazan je nesretni Martinović kao martir sa srednjovekovnih ikona, dok se rulja Albanaca priprema da ga nataknje na flašu *u prisustvu vlasti!*) dočim je pravno, pa i moralno, slučaj još uvek otvoren! Ja ne mogu znati da li se Martinović sam povredio, kako glasi izveštaj istražnih organa, ili se nad njim izvljavalo dvoje Albanaca, kako je on najpre tvrdio, pa je prema nekim porekao, da bi sada pod paskom advokata to ponovo tvrdio. U ovom slučaju, valja sa indignacijom odbiti pre svega političku manipulaciju štampe. Štampa je ta koja se izvljava nad nesretnom sudbinom Martinovića! I ovde se, u prvom redu, treba gnušati postupka štampe, a tek potom dolazi na red osuda nepoznatog izvršioca (ili izvršilaca) dela, makar da je to i sam Martinović.

Naravno, da ne bude nesporazuma, ja neću ovim da tvrdim kako na Kosovu nema šovinizma i izvljavanja, niti da problem iseljavanja Srba i Crnogoraca nije problem. Slažem se da su to veliki problemi. Ali, baš zato što su oni tako veliki i osetljivi, valjalo bih da ih proučavamo u svim njihovim uzrocima, izbegavajući svaku vrstu jednostranosti. Zašto bi se alibi-govorom proglašavao svaki pokušaj prevladavanja jednostranog diskursa koji kosovsku krizu hoće da objasni samo jednim uzrokom, albanskom iridentom. Kada Vučelić zahteva da se načini razlika između prljavo-praktičnog i otmeno-salonskog nacionalizma, on previда to da je u ovom našem konkretnom slučaju, upravo taj salonski nacionalizam do te mere predimenzionirao prisustvo i moć albanskog nacionalizma da se situacija na Kosovu prikazuje kao njegova potpuna pobeda. Albanski nacionalizam i

šovinizam postaju ovde jedina kosovska realnost a svi se Albanci maltene proglašavaju ako ne za otvorene iridentiste, a ono za njene potajne simpatizere.

To su eto, razlozi zbog kojih sam ja ubedjen da se borba protiv albanskog nacionalizma u »policijском« i svakom drugom smislu može uspešno voditi samo ako se uporedo sasecaju krila i drugim, revanšističkim nacionalizmima, u prvom redu onom srpskom. Ja to nazivam *vadenjem kvadratnog korena nacionalizama*. Napadajući srpski nacionalizam, oličen u »Knjizi o Kosovu«, ja sam ujedno vadio i kvadratni koren albanskog nacionalizma kojeg su kritičari, a takvih je danas mnogo, dovoljno već razobličili i u njegovim motivima i načinima manifestovanja. Ponešto sam i sam doprineo tom razobličavanju (vidi npr. »Fjala« br. 7/1986), i uglavnom se slažem sa tim kritikama. Jedino što bih kritičarima zamerio jeste to što mnogi među njima pišu u hitnju i prema šablonima reagovanja za političko-propagandne svrhe, gde se ispušta iz vida da su pojave u stvarnosti mnogo složenije, protivurečnije, međuzavisnije.

Na kraju, ne mogu a da ne spomenem jednu recenicu iz pisma koje sam nedavno dobio od prijatelja iz Beograda, a koja glasi »Mene više uopšte ne interesuje ko je prvi počeo; mnogo me više interesuje ko će prvi da prestane«. To je, mislim, jedina konstruktivna osnova za pružanje otpora svima onima koji rade na produživanju konflikta između srpskog i albanskog naroda.



---

TEKSTE TË ZGJEDHURA  
IZABRANI TEKSTOVI



**zhan-pol  
sartër**

**SOCIALIZMI  
QË ERDHI  
NGA TË FTOHTËT\***

Këta zëra u ngritën midis viteve 1966 dhe muajëve të parë të vitit 1968; një agim i turpshëm i ndriçonte Karpitatet sllovake, luginën e Moravës, majet e Bohemisë; edhe pak kohë dhe do t'i shihnim këta njëritë në dritën e diellit, të fshehur para syve tanë me re të dendura që kur ua dorëzuam nacistëve për t'i fituar dymbëdhjetë muaj paqe.

Ai agim nuk ishte mëngjes, nuk ishte i hareshëm: prej atëherë, socializmi ra sërisht në natën e gjatë të mesjetës së vet. Më kujtohet se q'më thoshin, kah vitet 1960, miqtë e mi sovjetikë: »Durim, ndoshta kjo do të shkojë ngadale, por të shihni: procesi është i pakthyeshëm«, dhe ndonjehërë kam përshtypje se asgjë nuk ishte e pakthyeshme përvëç degradimit të patundshëm dhe të vahzdueshëm të socializmit sovjetik. Mbesin këta zëra, sllovakë dhe çekë, tufa frymësh të prera, ende të ngrrohta dhe të gjallë, të përgjënjeshtruarë por të pamohuara. Nuk mund t'i dëgjosh këta zëra pa sëkëlldi: ata flasin për një të kaluar të tmerrshme e groteske, ata na thonë se ajo është varrosur përgjithmonë ndërsa e kaluara, e ringjallur, bëhet sërisht e tashmja e pandërrerë e Çekoslllovakisë; ato paralajmërojnë me maturi një ardhmëri më të mirë të cilën një erë e madhe, pas pak, e fiku si një qiri; je i prirur t'i krahasosh me dritat që na vijnë nga yjet e vdekura, aq më tepër kur ato kane qenë, para se vendi të jetë zhytur sërisht në heshtje, bartëse të një mesazhi që nuk na drejtohej neve. Megjithëkëtë, sot duhet t'i dëgjojmë ata zëra; këtu përpinqem të shpjegoj përsë ata na përkasin.

\* Punim nga libri »Situatat« që së shpejti del në gjuhën shqipe në botimin e »Rilindjes«.

Tremëdhjetë takime, katërmëdhjetë dëshmi, apo, nëse doni, katërmëdhjetë rrëfime. Sepse rrëfimi, në kuptimin në të cilin e merr Rusoja, është rreptësisht e kundërtë e autokritikës. Ata që flasin këtu, romansierë, dramaturgë, poetë, eseistë — është madje edhe një filozof — duken të shtendosur, të matur, rrallë herë brutalë, shpesh ironikë; sado që janë të kapluar nga zemërimi revolucionar, ata nuk e shfaqin atë. Ata më pak po-hojnë e më shumë pyesin, e pyesin veten. Përveç kësaj, ata dallohen plotësisht mes vete. Disa janë bij punëtorësh, fshatarësh, arsimtarësh, babai i Jiri Muhës ishte piktor, babai i Kunderës muzikant, Vaclav Haveli doli nga gjiri i borgjezisë së lartë të paraluftës. Disa janë çekë, disa moravas e disa të tjerë sllovakë. Novomeski i pati shtatëdhjetë e dy vjet kur u zhvilluan këto biseda; më i riu, i cili atëherë i kishte tridhjetë e dy vjet, do të mund të ishte djali i tij. Novomeski e kishte parë lindjen dhe rënien e Republikës së Parë Çekosllovake; ai kishte qenë, në Sllovakia, njëri prej tre udhëheqësve të Kryengritjes; ministër, pas luftës, ai ka kontribuar që vendi i tij të bëhet çfarë është bëre, gjë që nuk e pengoi që, pak më vonë, si shumë të tjerë, të dënohet me burgim. Haveli i kishte dy vjet kur u nënshkrua kapitulimi i Çekosllovakisë në Mynih, e pesëmbëdhjetë vjet kur filluan proceset. Midis tyre, njerez të pjekur, të radhitur. Tre breza, prej të cilëve i pari është fati i të tretit, ndërsa i treti bëhet me dëshire gjykatës i dy të parëve; brezi i dytë, viktimitë dhe bashkëfajtor, është i tërhequr me afinitete të pamohueshme edhe kah njëri edhe kah tjetri e njëherazi është dëbuar prej tyre me antagonizma të qarta. E këtillé është përbajtja e kësaj vepre: intelektualët shikojnë rrëth tyre, në vete dhe pyesin vetëm: »Çka ka ndodhur vallë?«

Frikesohem se këto fjalë të fundit mund t'i dësh-projnë disa lexues: »Intelektualë? Kjo kastë manadri-nësh s'ka të drejtë të flasë në emër të popullit. Ç'është e vërteta, ata me kujdes kanë hequr dorë të flasin në emër të popullit: si qytetarë të Çekosllovakisë ata u flasin bashkëqytetarëve të vet. Juve aspak. E bashkëbise-duesit e tyre të vërtetë duket se janë treguar më pak të vrenjtur sesa ju sepse vite të tëra kultura e kishte marrë, siç thotë Limi (Liehm), detyrën e politikës. Shkaku qëndron aty se me gjithë divergjencat e tyre, kundërshtitë e tyre, përmes nyancave të tyre, luhatjeve të tyre dhe llojshmërisë së tyre, mund të rikonstituohet hollesisht një ligjërata e përbashkët për njëzet e pesë vjet të historisë çekosllovake. Këtë ligjërata — ashtu si e kam kuptuar unë — do të doja këtu t'ua rrëfeja para se t'u qaseni dëshmive në veçantine e tyre.

»Çka ka ndodhur?«

Novomeski, i pari i cili ia bën vetes këtë pyetje, drejtobet menjëherë kah thelbi: fatkeqësia e tashme e kombit çekoslovak del nga fakti se e ka përvetësuar një ske-më të gatshme të socializmit. Në saje të pozitës që kishte ai më së miri mund të na flasë për vitet e para të pasluftës: më 1945 askush nuk dëshironte ta restauronte Republikën e Parë. Ajo kishte rënë *para* okupacionit: në Mynih. Fajtor për kapitulim, për këta të rinj të zemëruar, nuk ishin vetëm aleatët e tyre, por, në radhë të parë, borgjezia e tyre kombëtare. Humanizmi i Beneshit ishte vetëm një maskë prej alci: ai ishte bërë pluhur. Prapa saj nuk kishte ftyvrë njerezore, qoftë madje edhe të pamëshirshme: dhëmbëza të një mekanizmi. Prova: pse populli i bashkuar nuk u ngrit, më 1938, kundër *diktaturit gjerman*? Do të ishte e kotë? Kryengritja do të shuhej me gjak? Ndoshta. Por ndoshta edhe kryengritja do t'i detyronte Aleatët ta revidonin politikën e tyre. Sidom që të jetë, rezistenca më shumë do të viente sesa pasiviteti. Po, ky pasivitet, prej nga vinte? Pa dyshim prej marrëdhënieve në prodhim, do të thotë prej institucioneve borgjeze: industrializimi i lartë i vendit i zhvillon-te forcat »masifikuese« të cilat i përçanin punëtorët dhe svnonin ta shndërronin secilin prej tyre në një molekulë të veçuar; sundimi i profitit, i cili është nië send, ua impononte njerezve shpërndarjen dhe inercionin e sendeve. Krvengritësit, kur erdhën në pushtet, pas çlirimt, ishin të vendosur që të mos lejojnë të kthehet ajo shogëri e pafujqisë. Socializmi, për ta, ishte së pari viçi i artë i përbysur, integrimi i të gjithëve në një kolektivitet *njerëzor*, të drejtat e plota qytetare për të gjithë, e drejta e barabartë e të gjithëve që të marrin pjesë në udhëheqjen ekonomike, sociale e politike të vendit; do të arrihej *nxehtësisht* ai unitet kombëtar i cili nuk kishte mundur të arrihej atëherë kur rrëthanat e kërkonis këtë, duke e vënë fatin e të gjithëve në duart e të gjithëve, gjë e cila mund të realizohej vetëm mbi një bazë: mbi shogërorizimin e mjeteve të prodhimit.

Nuk janë aq të rëndësishme arsyet që e nxisin një popull të shkojë në socializëm: kryesorja është oë ai ta ndërtojë atë, me vetë duart e veta. »E vërteta, shkruan Hegeli, *krijohet*.« Ky është edhe parim i psikoanalizës: do të ishte e kotë apo e dëmshme sikur supozonin dicka që vështirë është e mundshme, t'i njihnim fshehtësitet e pacientit, t'i a zbulonim atij, t'ia shfaqnim të vërtetën e tij si një goditje me çomangë të rëndë mbi kokë: përkundrazi, më mirë është që ky vete ta kërkojë atë dhe ta ndryshojë veten përmes këtij kërkimi, në atë mënvritë ai do ta zbulojë atëherë kur do të jetë në gjendje t'i bëjë ballë asaj. Ajo që vlen për individin, në këtë rast, vlen për lëvizjet e mëdha kolektive: proletariati duhet të emancipohet në saje të vetë mjeteve të veta, t'i farkojë armët

e veta dhe vetëdijen e vet të klasës në luftën e përditshme, në mënyrë që ta marrë pushtetin atëherë kur do të jetë në gjendje ta ushtrojë atë. Kjo nuk ndodhi në BRSS: është fakt se bëhesh socialist duke e krijuar socializmin, sa në saje të forcave që i përdor për t'i vendosur strukturat e reja dhe për t'i shkatëruar të vjetrat, jashtë vetes dhe në vete, aq edhe me lojën e institucioneve të ndërtuara. Këtë e thoshte Lenini, duke i përcaktuar njerezit sovjetikë, të pasigurt, të përshkuar me ideo-ologji të regjimit të vjetër dhe shumica prej tyre analfabetë: shoqëria e re duhet të ndërtohet *me ta* dhe *përmes tyre*. Pikërisht këtë e synonin revolucionarët në Bohemi dhe në Sllovenski: të ndryshohen duke e ndryshuar botën, të krijohen në saje të ndërtimit të durrueshëm dhe të vendosur të socializmit *të tyre*, socialistë *të formuar*. Sot, do ta shihni këtë në libër, shumica prej tyre e quajnë Jaltën »një Mynih tjetër«. Atëherë, përplot miradie për BRSS, i cili porsa i kishte çliruar, të mahnitur me fitoren e tij të cilën e shikonin si një ngadhënjim të një shoqërie të çliruar mbi një fuqi të madhe kapitaliste, të së Mirës mbi të Keqen, ata dëshironin të mbeteshin brenda zonës së ndikimit sovjetik dhe as që u shkonte në mend ta mohonin hegemoninë e »vëllait të madh«. Ata dëshironin ta shfrytëzonin përvojën e tij dhe këshillat e tij por vetë ta bëjnë punën, duke u nisur prej problemeve të tyre, prej situatës së tyre të veçantë, prej burimeve të tyre dhe prej kultures së tyre: ky vend i vogël me dy kombe, me zhvillim të lartë industrial, njëqind herë i pushtuar, i robëruar, nuk kishte model për të kopjuar; përmes gabimeve të tejkaluara, të devijimeve të koriguara, të shtrembërimeve të përmirësuara, duhej që ai ta zbulonte rrugën e vet — siç iu desht Kubës ta bënte këtë, pesëmbëdhjetë vjet më vonë — për të mundur, një ditë, ta njihte veten në veprën e vet.

E kursyen nga ky mund. Secila prej Dy Fuqive të Mëdha kontribuoi në këtë drejtim: pas Jaltës, plani Marshall. Vazhdimi është i njojur. Më 1948 komunistët e morën pushtetin e vëllai i madh ia dhuroi vëllait të vet të vogël një socializëm të parafabrikuar. Në BRSS, këtë socializëm e kishin përpunuar disi, më shumë keq se sa mirë. Ai së paku përbante një përgjigje — në vitet e para — ndaj vështirësive të një vendi të madh ende bujqësor, sadoqë kishte filluar të industrializohet, pa borgjezi dhe, pas luftës qytetare dhe masakrimeve të saj, gati pa proletariat; blloku i vendeve kapitaliste atij ia impononte autarkinë, do të thotë e detyronte ta sakrifikonte klasën fshatare në prodhimin e mjetave produhuase. Meqë klasa punëtore mungonte dhe s'mund ta ushtronë diktaturën e vet, Partia qe e shtrënguar që ta ushtronë atë në vend të saj, apo, thënë më mirë, në vend të një klase punëtore të ardhshme. Është e njojur tron-

ditja e jashtëzakonshme demografike e cila ishte mjet dhe rrjedhoje e akumulimit socialist. Për ta rindërtuar sektorin sekundar, morën, si gjithkund, prej sektorit primar por shpejtësia e metamorfozës ishte e tillë që Partisë iu desht ta farkëtonte klasën e re punëtore duke i formësuar fshatarët që i nevojiteshin industrisë: këta njerëz të transformuar nuk kishin kurrfarë traditash të proletariatit të vjetër revolucionar; zatën, s'kishin prej nga t'i merrnin ato. U desht të bëhej një akulturim i shpejtësuar me manipulime të ndryshme: kundër mbeturinave të qëndrueshme të ideologjive të vjetra, që përbën shpresën e parë e cila pretendonte të është natyra dhe spontaniteti, deshën të krijonin një natyrë të dytë e cila do ta ndrydhte të parën duke i kushtëzuar reflekset dhe duke i mbushur kujtesat me një zhavor maksimash minimarksiste që ia sigurojnë mendimit të masave stabilitetin, peshën dhe inercionin e kërkuar. E shtyrë nga domosdositë e koniunkturës, Partia, larg asaj që ta *shprehë* vetëdijen e punëtorëve, qe shtrënguar që ta *prodhojë* atë; duke qenë, e vëtmja forcë reale në këtë vend shumë të madh e të shthurur, ajo e pa veten të detyruar që të akumulonte fuqi: në vend që t'i kontribuonte shuarjes së shtetit në saje të pavaresisë së tij kritike, ajo e forcoi atë duke u identifikuar me të, por, menjehershë, u infektua nga skleroza administrative; meqë përbënte shumicën e anëtarëve në të gjitha kuvendet e zgjedhura, ky aparat vigan ishte gjysmë i paralizuar nga gjithëfuqia e vet: në gjithëpraninë dhe në vetminë e vet, ai nuk mund ta *shihte* veten. E gjithë kjo në fillim nuk ishte veçse një mjet për t'u bërë ballë rreziqeve që kërcënohen, veçse një devijim i rrezikshëm — Lenini ishte i vetëdijshëm për këtë — por i përkohshëm dhe pa dyshim i korrigjueshëm, deri në çastin kur burokracia, prodhim i paevitueshëm i akumulimit të funksioneve, e shndërrroi këtë aparat në një sistem definitiv. Shoqëria sovjetike strukturohet pak nga pak rrëth këtij boshti kurrizor dhe bëhet për një gjysmë-shekulli ajo që është sot. Këtë histori, të gjithë e njohin; e kotoj është të pyesim këtu a kanë mundur të vejnë punët ndryshe. Një gjë është e sigurt: në BRSS marrëdhëniet në prodhim janë *ndërtuar* nën presionin e një nevoie vitale: të prodhohet me çdo kusht; së paku ky qëllim i *imponohej* një vendi gati krejtësisht bujqësor i cili porsa e kishte bërë shoqërorizimin e mjeteve të prodhimit; elektrifikasi mi i gëlltiti sovjetët: ai pjesërisht pati sukses, pikërisht aq sa ishte i domosdoshëm në atë vend, në atë koniunkturë.

Ndërkaq, Çekoslovakia e kishte tejkualuar fazën e akumulimit fillestar dhe u gjend shumë e hutuar benda socializmit që ia imponuan me aq gjentilesë: ajo nuk kishte nevojë ta zhvillonte industrinë e rendë sepse ajo

i nxirrte resurset e veta, para luftës prej industrisë përpunuese; sa i takon autarkisë — këto masa të dhunshme të cilat BRSS në fillim ia imponoi vetes nën presionë,<sup>1</sup> ky komb i vogël që jetonte prej këmbimeve me botën e jashtme, duke eksportuar prodhime të konsumit, duke importuar pajisje të ndryshme, nuk kishte kurrfarë arsyje dhe, përkundër pasurive të nëntokës së vet, s'kishte kurrfarë mjeti për ta realizuar atë: e lidhur me zonën socialiste, mjaftonte t'i ndërronte klientët e vet.<sup>2</sup> Zgjerimi i prodhimit të saj, e sidomos përblysja absurde e objektivave të tij prioritare, e solli shumë shpejt në situatë që të *prodhonte pér të prodhuar*, në vend se, përkundrazi, t'i riorganizonte industritë ekzistuese në pajtim me nevojat e popullit, me kërkuesat e *drejta* të klientëve të vet të rinj dhe të kërkonte para së gjithash, ta përmirësonë produktivitetin e vet. Nëse identifikimi i Partisë dhe i shtetit ka mundur të jetë apo të duket i domosdoshëm »në rrrethana fatale«<sup>3</sup> pér t'i mbajtur nën kontroll rrjedhat demografike në një vend bujqësor në industrializëm e sipër, çfarë kuptimi kishte ai pér një komb prej katërmëdhjetë milione banorësh, një pjesë e konsiderueshme e të cilat e përbente një proletariat të ruajtur që kishte arritur gjatë Republikës së Parë, përmes luftërave të tij, dështimeve të tij, vetë pafuqisë së tij, një vetëdije të pamohueshme të klasës dhe tradita të forta punëtore? Çekoslovakia ka mundur të jetë fuqia e parë pér ta realizuar kalimin prej një ekonomie të kapitalizmit të përparuar kah një ekonomi socialiste, duke u ofruar kështu proletarëve të Perëndimit, nëse jo një model, së paku një mishërim të ardhmërisë së tyre revolucionare; asgjë nuk i mungonte: as veglat e as njerezit; nëse ishte e mundur qeverisja punëtore, atëherë ajo mund të realizohej në Pragë dhe në Bratislavë. Fatkeqësisht, në Moskë, manipulatorët, të manipuluar nga vetë manipulimet e veta, madje as që mund ta kuptonin atë socializëm: ata e imponuan *sistemin*. Ky model i importuar, i paadaptuar, pa baza reale, por i përkrahur nga jashtë në saje të përgjërimit të vëllait të madh, u paraqit pra si një idol, do të thotë si një tëresi e fiksuar e kërkueseve të pakushtëzuara, të padiskutueshme, të padiskutuara, të pashpjegueshme, të pashpjeguara. Punëtoret cekoslovakë ishin liruar prej sundimit të profitit vetëm sa pér të rënë nën sundimin e prodhimit të fetishizuar. Një gozhdë e shtyn tjetrën: »Sendi në pushtet« i Republikës së vjetër u dëbua dhe u zëvendësua nga një Sendi tjeter, tjetërsimi me një tjetësim tjeter. Posa

<sup>1</sup> Dhe ngase i kishte mjetet e jetesës brenda teritorit të vet.

<sup>2</sup> Këtë gjë ajo, madje, e bëri duke u lidhur me BRSS në vend të Gjermanisë, por në kushte që dihen.

<sup>3</sup> Roza Luksemburgu.

u vu n̄ l̄evizje makina e r̄endē, n̄ fillim ngadalē e m̄e vonē gjithnjē m̄e shpejt, ajo i shpartalloi strukturat dhe e shkatérroi vendin.

Pēr kētē socializēm tē imponuar mund tē thuhet, sigurisht, se u bē nga Çekēt dhe Sllovakēt, apo, m̄e mirē, pērmes tyre. Halli qēndron aty se ai nuk i socializoi fare; tē merremi vesh: njerēzit e 45-shit ishin revolucionarē tē bindur dhe shumica e tyre mbeti e tille, por sistemi ua ndaloi ta bēnin vetē pērvojēn e ndērtimit socialist: pēr t'i ndryshuar duhej tē merreshin ashtu si ishin; ai i mori ashtu si nuk ishin. Nē vend qē tē paraqitet si njē problematikē e hapur qē kērkon njēkohësicht njē transformim racional dhe njē pērbysje tē vazhdueshme tē ideve, shkurt, njē kushtëzim reciprok dhe dialektik tē *praxisit* dhe tē teorisë, ai u imponua pērnjéherë, me njē mendjemadhësi tē pabesueshme, si njē dhuratë e nurshme e Providences, njē socializēm pa lot, me fjalë tē tjera pa revolucion dhe pa edhe mē tē voglin kontestim: de-tyrat ishin tē pērkufizuara, mjaftonte qē ato tē kryheshin; dituria ishte e myllur, kērkohej qē ajo vētēm tē mēsohej pērmendësh. Nē rrrethana tē tilla nuk duhet tē habitemi fare kur njerēzit e brezit tē parë, ata qē militonin nē radhët PKÇ para luftës dhe qē bēnë rezistencë gjatë okupacionit, u kthehen pas 1956, siç thotë Novomeski, idealeve tē tyre tē vitit 1920: meqë nuk mundën asgjë tē ndertonin, ata nuk u ndryshuan me asgjë; tē shtypur, tē fshehur nga gurët e parullave, kujtimet e vjetra dhe shpresat e rinise së tyre mbetën tē paprekura; aq mē tepér qē kēto, pēr shumicën, mbetën si strehim i heshtur kundër ligjëratës zyrtare. Fatkeqësia e tyre qēndron nē faktin se asaj kujtese, sado e gjallë qē i duket, i vjen era myk: sa ide e marré t'i pērjetosh njëzet vjetët e tua atëherë kur i ke mbushur tē gjashtëdhjetatë. Nē mēnyrë tē njejtë dhe pēr arsyë tē njejtë mbeti i paprekur edhe tradita kolektive. Katërmbehdhjetë dëshmitarët tanë janë formalë: familjet, Kisha, traditat lokale apo kombëtare, rrymat e tē menduarit, ideologjitet, e tērë trashëgimia — e cila do tē tejkalohej dhe do tē ndryshohej nga një socializēm nē formim e sipér — u ruajt nēn rendin e vendosur apo u pērforcua: nē Bérno, Jan Skaceli cek rritjen e ndikimit tē katolicizmit, tē tjerët theksojnë se relacionet midis Bohemisë dhe Sllovakisë, pērherë ngapak tē tendosura, larg asaj qē tē pērmirësohen, gjë e cila do tē duhej tē arrihej, ndoshta, nē gjirin e një ndermarrje tē madhe tē pērbashkët, nuk kanë pushuar tē degradohen. Nëse megjithatë doket e vjetra e kanë ruajtur vitalitetin e vet nēn petkun e gjysmëlegalitetit, nga kjo nuk do tē duhej tē nxirrej pērfundimi se marrëdhëniet njerëzore nuk janë ndryshuar fare nga regjimi i ri: prej vitit 1948 deri mē 1956, ato

janë keqesuar çdo ditë: raporte të rreme të prodhimit u vëndosën në varësi nga një ekonomi e deformuar dhe nga sendësimi i pushtetit.

Të konstatojmë njëherë, se sistemi, në çastin kur i ftonte qytetarët të punonin në çështjet e përbashkëta njëherazi i privonte nga çfarëdo pjesëmarrjeje reale në këtë ndërmarrje kombëtare. Unë nuk pretendoj madje, këtu, të flas për qeverisjen punëtore, e as për një kontroll të ushtruar nga kuvendet rregullisht të zgjedhura: sistemi, siç kemi parë, është alergjik ndaj këtyre hoveve majtiste. E kam parasysh atë rrjedhojë të paevitueshme që del nga socializmi i importuar: depolitizimi i rrufeshëm dhe i rrënjosor i një vendi, të cilin okupacioni dhe rezistenca e kishin politizuar thellesisht. Lidhur me këtë pikë të gjithë dëshmitarët tanë pajtohen. Sendi, natyri shët, nuk mundi të funksiononte pa njerez; ai rekrutoi njerez-sende, kokëgomarrë që i shndërroi në kokëtulla; ata u bënë të xhindosur të pushtetit, burokrate të hierarkizuar nga të cilët secili komandonte në emër të një tjetri, të eprorit të vet, ky tjetri në emër të një tjetri e më i larti në emër të vetë sendit. Ky është i paaftë, përkah esenca, të përshtatet apo të përparojë: ndryshimi më i vogël mund ta thyejë atë; ai pra s'ka kurrfarë nevoje t'i përtérijë kuadrot e veta, apo, të themi më mirë ai ka nevojë të mos i përtérijë; posa zhduket një burokrat atë e zëvendëson një tjeter i cili i përngjet si një vëlla dhe që nuk është aspak më i ri se ai. »Sistemi« ruan dhe ruhet, nuk ka qëllim tjeter veçse ta përjetësojë ekzistimin e vët; për këtë arsyе ai është i prirur që të prodhojë një gerontokraci sepse pleqtë janë zakonisht konservatorë. Rrjedhimisht, »brezi i parë«, i cili e importoi sistemin, u kujdes që ta mënjanonte brezin e dytë prej të gjitha posteve kyçë: »Ne ishim, thotë një dëshmitar katërdhjetëvjeçar, dofin të përjetshëm«. Ndërkakq Kundera thotë: »Brezi im është përçarë thellesisht: disa kanë vendosur të emigrojnë, të tjerët të heshtin, disa janë përshtatur dhe më në fund ata që kanë vendosur të zhvillojnë një farë veprimtarie opozitare legale dhe konstruktive. Megjithatë, asnjë prej këtyre qëndrimeve nuk ishte mjaft dinjitoz... Emigrimi nuk dha fryte; emigrimi i brendshëm venitet në vetmi dhe pasuqi; opozita, derisa vazhdonte të publikoj, ishte doemos e shtrënguar të ishte jokonsekuente dhe të bënte kompromise; sa u përket atyre që janë shtruar... ata s'janë gjë tjeter veçse të vdekure... Pakënaqësia e të gjithëve me vveteten është ai moment i hidhur i përbashkët i një përvoje të njejt i tërë një brezi... i cili madje nuk ndien më nevojë që të mbrohet kur e sulmojnë të rinjtë e sotëm«. I pasuqishëm dhe i kompromituar, i dëbuar prej të vjetërve nga punët publike, i sulmuar prej të rinjve pse, megjithatë, mjaft ka marrë pjesë në to, i tillë

është brezi i »ndërmjetësve«; por prapë, këta dëshmonë rrallë herë të ashper ndaj brezit të parë: pas konsatimit të një dështimi të plotë që i zhgënjeu thellësisht, ata shtojnë ndonjëherë me mëshirë të përshkuar me dhembshuri: »Ata kanë aq pak rast të veprojnë mbi çkadoçoftë«. Sa i takon rinisë agresive e cila i fyen ndonjëherë — shumë më rrallë sesa pohojnë ata, — ata frikësohen prej saj dhe frikësohen për të: ajo është, na shpjegojnë ata, skeptike dhe cinike sepse ka përshtypje se nuk mund të bëjë asgjë prej gjëje. Meqenëse është ngritur në injorancë, në kohën e degradimit të dijes, ata frikësohen se ajo mund të ketë fat edhe më të keq se të tyrin: asaj do t'i dhimbset Republika e Parë, sepse nuk e ka përjetuar kalbjen e saj e mandej, progresivisht, do të integrohet nga regjimi dhe — meqë duhet jetuar, — ajo do ta përjetësojë atë edhe pa e ditur këtë. Ja këto ia parashikonte brezit të ri brezi i mesëm, para dimrit 1967—68. Ky brez kishte të drejtë lidhur me një pikë: ky brez i tretë i refuzonte me tmerr dhe gërdi socializmin e parafabrikuar që ia imponuan si fat të tij. Ky refuzim mbeti i parëndësishëm, sepse, deri më 1967, ky brez nuk pati mundësi të ndikonte mbi asgjë. Mirëpo ata nuk e kanë kuptuar një gjë — përveç ndoshta Jan Skacelit — se do të mjaftonte një ditë një hapje, një çfarëdo mundësie për të ndërmarrë një aksion të përbashkët, në mënyrë që ai cinizëm i pafuqisë të shndërrrohej në kërkësë revolucionare dhe që kjo rini »absurdiste« të bëhej, në sytë e të gjithëve, brezi i Jan Palla-hut. Qështë e vërteta, për të procesi i mineralizimit të njeriut porsa kishte filluar.

Mbi natyrën e këtij procesi, Kosiku dhe Kundera na japid informata të çmueshme, që janë aq më instruktive ngase e shikojnë atë nga pikëvështrime të ndryshme. Esenciale është se Sendi, me ndërmjetësimin e shërbëtorëve të vet, e mendonte njeriun dhe, natyrisht, e kuptonte atë si një send. Jo si një subjekt të historisë por, doemos, si objektin e saj. I verbër dhe i shurdhë për dimensionet e mirëfillta njerëzore, ai e reduktonte njeriun në një sistem mekanik: jo vetëm në teori por edhe në praktikën e përditshme. »Nuk është fjala aty, thotë Kosiku, për një ide mbi njeriun e përkufizuar me vetëdije por për figurën e tij ashtu si e supozon sistemi, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, ashtu si, ai e formëson në nivelin e masave sepse ai ka nevojë pikërisht për qytetarë të tillë«. Ajo që e cilëson *homo birokratikusin* është një tërësi e veçorive negative. Ai nuk qesh: »Përgjegjësit e merrnin të qeshurit si të papëlqyeshmë për pozitën e tyre«. Në të vërtetë, ata ishin çmësuar të qeshnin. E nëse ndonjëri, përkundër natyrës së vet të institucionalizuar, ia lejonte vetes t'ia plaste gjat, ai rrezikonte shumë dhe e kompromitonë rrëthin

e vet, siç e provoi këtë belaja — për të cilën rrëfen Limi — dy shkaxhi të rinj që kishin menduar se mund të tallen me Nezvalin pa u ndëshkuar; duket se pikërisht ai episod grotesk i shërbue Kunderës si temë e *Shakasë*. Është e ndaluar të *kesh dëshire* për të qeshur. Urdhëresë e qartë që del rreptësisht nga premisat: të qeshurit konteston; pra, kur revolucioni konservon, të qeshurit është kundërrevolucionar. As »njeriu zyrtar«, po të flasim si Kosiku, nuk vdes »sepse ideologjia nuk e pranon vdekjen«. Dhe me arsyen: një robot nuk jeton, prandaj ai nuk mund të vdesë: kur prishet e riparojnë ose e flakin në hedhurina. »Në njëfarë mënyre, shton Kosiku, ai nuk ka trup«. Kjo merret vesh: sistemi ka dhëmbëza të mekanizmit, rripa të transmisionit por nuk ka organe dhe ata që »mendojnë« në vend të tij dhe në dobi të tij nuk kanë sy për t'i parë organizmat, këto njësi të integrimit antiburokratik të cilat do të mund ta kuptonin veten si qëllim sikur t'u kushtohej atyre shumë kujdes. Filozofi çek shton se *njeriu burokratik* nuk e njeh »as groteskën, as tragjikën, as absurdin« ngase këto kategori ekzistenciale nuk kanë raporte të qarta me prodhimin dhe, rrjedhimisht, nuk kanë realitet: ato janë mirazhe mjegulllore të kultivuara me borgjezitë gëndërruese të Perëndimit. Për të përfunduar: »Ai nuk ka vetëdije dhe nuk ka nevojë për të«. Ç'dreq do të bënte me të, zatën: rrugët janë të rrahura, detyrat janë të përgatitura, do t'i kushtezojnë reflekset e tij me metoda të sprovuara, duke perfshire aty edhe refleksin cerebral që e quajnë në mënyrë të pasaktë të menduar. Ky objekt i mrekullueshëm, i jashtëm ndaj vetes dhe i lëvizur nga forcat e jashtme, shpjegohet kryepëkut me mekanikën pavloviane: ai është tejet i manipulueshëm dhe mund të shfrytëzohet deri në pikën e fundit. »Njerëzit, thotë Kosiku, nuk lindin megjithatë arrivistë, të kufizuar, dogmatikë, të mbyllur ndaj të menduarit, të pandieshëm, të prirur që në çdo çast t'i kaplojë demoralizimi. Vetë sistemi i do të tillë dhe i bën të tillë, sepse pa ta nuk mund të funksionojë«. Njerëzit e sistemit, si produkte të prodhimit të fetishizuar, për nga esenca janë të dyshimtë; madje, në mënyrë të dyfishtë: njëherazi pse janë të sendësuar dhe pse asnjëherë nuk janë plotësisht të sendësuar. Duke qenë robotë ata janë të përdorshëm, pra janë tradhtarë potenciale: meqenëse pushteti di t'i gjejë levat e tyre të komandimit, përsë edhe agjentët e huaj nuk do t'i zbulonin ato? Dhe si ta dimë, në këtë rast, se kush i tërheq fijet e marionetës? Mirépo, aq sa mineralizimi nuk është i plotë — e ai nuk është kurrë i plotë, këto minerale dykëmbëshe janë njërez që e jetojnë njerëzisht mineralizimin e tyre — vetë ekzistanca e tyre është një rrezik për regjinimin: të qeshësh, të qash, të vdesësh, madje edhe të tështiesh, do

të thotë të dëshmosh për një spontanitet të dëmshëm e ndoshta edhe me origjinë borgjeze. Të jetosh, fundja, do të thotë të kontestosh: nëse jo faktikisht, së paku parimisht. Prandaj duhet përgjuar. Nga ky përgjim regjimi nxjerr dobi të dyfishtë: së pari, duke mos pa sur qëllim tjetër veç vetes dhe, në mungesë të kontrollit e të ndërmjetësimeve dhe meqë, si viktimë e pushtetit të vet të pakufishëm, as nuk mund ta njohë veten e as ta marrë me mend se bën ta kritikojnë, ai e shtron parimin se duhet dyshuar në njerëzit e jo në institucionet; pra atij i përgjigjet që te ato kafshë-makina të paraqitet ndonjëherë kafsha mbrapa makinerisë: animaliteti është e Keqja, rezidumi i pareduktueshëm i një vargu të mijëvjeçarëve të kaluar; kritika nuk e zbulon kurrë të metën e sistemit por vesin e thellë të atij që e ka bërë atë, ai vullnet i lirë i cili, herët a vonë, e shtyn njeriun të bëjë mëkate, së paku në mendje, kundër ndërtimit të socializmit. Mirëpo, sidomos parimi i korruptimit të vazhdueshëm të *homo burokratikusit* i ka dvë përparësi të pamohueshme: e arsyeton përdorimin e praktikave makiaveliane: të blejsh apo të terrorizosh; ai ia bën të mundshme Sendit, në rast nevoje, që t'i likidojë vetë ministrat: kur makina kërcellen, ai i eliminon disa përgjegjës e nuk i hyn riparimit të makinës i cili, veç kësaj, do të ishte i kote. Ata udhëheqës janë tradhtarë që i janë shitur armikut: motori punonë mirë, *dëshlimet* e tij të pashpjegueshme shkaktoheshin thjesht nga përpjekjet e atyre që donin ta sabotonin. Me një fjale, Sendi është i detyruar t'i përdorë njerëzit por ai nuk ka besim në ta, i përbuz dhe i urren: njësoj si zotëria skllervit e vet apo padroni punëtorët e vet; ai vepron në atë mënyrë që mosbesimi, përbuzja dheurrejtja t'i percaktojnë, kryesisht, marrëdhënët e njerezve ndërmjet vato dhe të secilit me vetveten.

Mbetet të shihet se a do t'ia dale në krye ai. Dëshmitarët tanë përgjigjen se po. Së paku në disa raste dhe deri në një masë të caktuar. Po kush vihet në shërbim të Sendit? Të shiturit, frikacakët, ambiciozët? Përkundrazi, më të mirët: komunistët më të sinqertë, më besnikë, më të ndërgjegjshëm. Kundera na shpjegon shkakun e kësaj dukurie. Vizioni mekanicist i njeriut, siç duket se mendon Kosiku, nuk është bazë e socializmit burokratik, por është prodhim i tij, apo, po të doni, ideologji e tij. Revolucioni i vitit 1917 sillte në vete shpresat të mëdha, optimizmi marksist ishte i pëershkuar aty me èndrrat e vjetra të vitit 1848, me idealet romantike, me egalitarizmin e Babefit, me utopitë që kishin origjinë krishtere. Duke u imponuar »socializmi shkencor« nuk i zhduki këto vjetërsira humaniste: ai u paraqit si trashëgimtar dhe realizator i këtyre synimeve idealiste por të thella: shtrohej çështja e clirimtë të punëtorëve

nga prangat e tyre, e suprimimit te shfrytëzimit, e zëvendësimit te diktatures së profitit, në të cilën njerezit janë prodhime të prodhimeve të veta, çështja e shoqërisë së lirë pa klasa ku ata janë prodhime të vetvetes. Kur Partia e burokratizuar u identifikua me shtetin, ato parime, ato ideale, ato objektiva të mëdha me këtë nuk u zhdukën; përkundrazi: zëdhënësit e pushtetit shpesh i përkujtonin ato në fjalimet e tyre, në kohën kur shumë moskovitë ishin mësuar të rrinin pa gjurmë tërë natën, duke i mbyllur sytë vetëm në mëngjes, pasi siguroheshin se kishte kaluar koha e qumështorit. Natyrish, sistemi burokratik që moti e kishte krijuar ideologjinë e vet. Por kjo kurrë nuk ishte eksplikite; e pranishme gjithkund në veprime, forma e saj e ndryshueshme hetohej në disa pika të ligjëratisë zyrtare: atë e maskonin me një ideologji tjeter, me ideologjinë e shpallur *ad usum pulli*, një humanizëm i zbehtë marksian: kjo i bëri çekët dhe sllovakët e rinj që të humbasin. Më 1945 ata ranë në grackë, të galvanizuar me fjale. A s'është përtu çuditur që Vaculikut, njëri nga akuzuesit më të ashper të sistemit, hyri plot entuziazëm në Parti — në moshen njëzetvjeçare — i nxitur nga broshura e Stalinit: *Mbi materializmin dialektik dhe historik?* Mu përkëtë arsyen Kundera theksion, pa dashur ta krahasonët shoqërinë gjermane me shoqërinë sovjetike, se hitlerizmi, në një aspekt, ishte më pak i rrezikshëm se ajo që ai e quan stalinizëm. Me të parin, së paku, puna ishte e qartë: ai fliste haptas dhe qartas; rrallë herë botëkuptimi maniheist ishte më i arsyetuar. Mirëpo, »stalinizmi« ishte diçka krejt tjeter, humbisje në të: në të ishin dy anë të referencës, dy botëkuptime, dy ideologji, dy mendje, njëra dialektike, tjera mekaniciste: ua përsëritnin atë formulë të neveritshme të Gorkit: »Njeri, sa madhërishtë tingëllon kjo« ndërsa funksionarët vendosnin t'i dërgonin njerezit — shëndetligë përkah natyra — nëpër burgje. Kjo i hutonte. Dukej se ideja socialiste ishte çmendur. Kjo nuk kishte ndodhur por shërbëtorët e Sëndit, pa fije cinizmi, kërkonin prej bashkatdhetarëve të tyre dhe prej vetvetes që ta pranonin sistemin në emër të socializmit humanist; ata e paraqitnin — ndoshta singjerisht — njeriun e ardhmiërisë si caku është lartë të një ndërmarrjeje të guximshme dhe të madhërishtë në emër të së cilës paraardhësi i tij, njeriu i sotëm, duhej të lejonte që ta trajtojnë dhe ta trajtojë veten si një send dhe si fajtor. Ky nuk ishte plotësisht gabim i tyre; truri i tyre vuante nga një sëmundje që zakonisht e ka vendin në fshikë: ai e kishte gurin. Por të gjithë ata që, në saje të besnikërisë ndaj parimeve të socializmit, u orvatën ta shikojnë vetën me sytë e tyre prej meduze, pësuan një përdredhje të përgjithshme të të menduarit. Kështu shpjegohen paradokset aparente të cilat Kun-

dera i numëron me hidhërim: »Në art, doktrina zyrtare ishte realizmi. Por ishte e ndaluar të flisje, për realitetin. Kultit të rinise i thurnin publikisht lavdi por na pengonin ta gëzönim rinine tonë. Në ato kohëra të pamëshirshme në ekrane mund të shihnim vetëm takimet e turpshme të dashuruarve skofiarë e të shtangur. Prej nesh kërkonin që ta shfaqnim gjithkund gëzimin tonë por edhe për shfaqjen më të vogël të haresë na kercënoheshin me dëname. Ai ndoshta do ta kishte shpje-guar më mirë atë situate sikur të kishte shkruar: *në emër të realizmit* na ndalonin ta paraqisnim realitetin; *në emër të kultit të rinise*, na pengonin të jemi të rinj; *në emër të gëzimit socialist*, e shuanin harenë. Ana më e keqe ishte se ajo dredhi e trashë i bënte edhe vetë ata bashkëfajtorë: përderisa ende besonin në socializmin burokratik — së paku si në rrugën e pamiradishme dhe të vështirë që shpie në socializmin e vërtetë, — ata njerez e kanë përdorur mendjen e tyre të gjallë dhe dialektike në justifikimin e sundimit të mëndjes së ngurtësuar, gjë që i shpinte doemos në pranimin e dënimit të parës nga e dyta. Të bindur nga propaganda se, siç thoshte Miraboja: »Ruga e cila shpie prej të Keqes kah e Mira është më e keqe se sa vetë e Keqja«, ata në fillim pajtoheshin me të Keqen, ngase në të shihnin të vëtmin mjet për ta arritur të Mirën e po ashtu edhe pse ishin të shtyrë nga ajo që njëri prej tyre e ka quajtur »demon i pajtimit«, ata e shihnin në të vëtë të Mirën ndërsa të Keqen e zbulonin në vëtë rezistencat e tyre ndaj ngurtësimit. Çimentoja u hynte përmes syve, përmes veshëve e ata i shikonin kundershtimet e arsyes së tyre të shëndoshë si rezidum të një ideologjie borgjeze e cila i shkëpuste nga populli. Të gjithë dëshmitarët katërdhjetëvjeçarë e pranojnë këtë këtu: ata ndienin nevojë ta débonin, që më parë çdo sprovë kritike, nga frika që ajo të mos shfaqte ringjalljen e individualizmit. Ata tregojnë se me çfarë kujdesi e strehonin në skajin më të fshetur të kujdëses së tyre habinë më të vogël, një sëkëlldi të pérjetuar befas, sesi përpinqeshin të mos i shihnin ato gjëra që do të mund t'i skandalizonin. Çështë e vërteta, rreziku ishte shumë i madh: do të kishte mjaftuar një dyshim për ta vënë në dyshim të tërë sistemin e pastaj ata ishin të sigurt për këtë, kontestimi do t'i hudhte në një vetmi të padenjë: duke qenë se ishin lindur, në kohën e Republikës I, ata mbanin gjurmë të pashtyeshme të një kulture të cilën duhej ta hedhën me çdo kusht në mënyrë që ta arrinin pajtimin me masat. Në fakt, ligjëratë e Sendit paraqitej si vëtë mendimi i klasës punëtore, e kjo ishte e qartë ngase Sendi e ushtron te diktaturën në emër të proletariatit ngase ishte vëtëdija e saj. Zatën, askush nuk i mendonte me të vërtetë deklaratat e Sendit sepse ato ishin *diçka*

*që nuk mendohej* (l'impensable). Por, atëherë, çdokush i merrte ato si shprehje adekuate të frysës objektive dhe, duke pritur që t'i kuptonte, i mësonte përmendësh dhe i vendoste, si ikona misterioze, në tempullin e vet të vogël të brëndshëm. Të gjithë, punëtorë, fshatarë intelektuale, nuk ishin të vetëdijshëm se janë bërë viktima të një tjeterësimi dhe të një atomizimi të ri; të gjithë, duke ia veshur vetes subjektivizmin, donin ta shkatërronin veçimin molekular, të gjenin unitetin e zjarrtë të aksionit revolucionar, në të cilin çdonjëri ballafaqohet me çdonjërin jo si një tjeter por si *i njëjtë* dhe askush nuk guxonë ta vëronte se për ta hequr anomalinë e vet të dyshimtë prej tij nuk kërkohej gjë tjeter veçse të bëhej *tjetër nga vetvetja* që të bashkohej me të tjerët dhe ngase çdonjëri prej tyre provonte të bëhej tjeter nga vetja. Këta njerëz të serializuar nuk komunikon midis tyre veçse përmes *Tjetrit nga njeriu*. (*l'Autre que l'homme*). Kështu, ata zhyteshin edhe më thellë në vetmi pikërisht në saje të përpjekjeve që i bënин për t'i ikur asaj dhe ushqenin mosbesim njëri ndaj tjetrit po në atë masë sa çdonjëri ushqente mosbesim ndaj vetyves. Limi e ka përshkruar shumë mirë, mu në këtë libër, tundimin e fundit dhe histerik, që është përfundim logjik i tërë procesit: të vihet në gjunjë për të besuar dhe për ta zëvendësuar — *credo quia absurdum\** — arsyen me besim. Kjo do të thotë se nën sundimin e prodhimit të fetishizuar, çdo njeri real e sheh veten, në koekzistencën e tij 'të thjeshtë të përditshme, si një pengesë në ndërtimin e socializmit dhe nuk mund t'i ikën krimit të të jetuarit ndryshe veçse duke e suprimuar vëton tërësisht.

Kjo është, natyrisht, një rrjedhojë ekstreme: ndërkakq, shumë punëtorë pushuan fë interesoeshin për çështjen publike, i kaploj nata, topitja. Për t'i shpërblyer që e pranuan atë gjendje, të gjithëve u dhanë tituj: të gjithë u bënë funksionarë. Një pjesë mjaft të madhe të intelektualëve, përkundrazi, e kaploj tërbimi i vete-shkatërrimit; duhet të pranohet se atyre u shkon përdore kjo punë: si në demokracitë borgjeze ashtu edhe në ato popullore, këta specialistë të univerzales shpesh janë të ngarkuar me veçantinë e tyre. Mirëpo, mazohizmi i intelektualëve të Perëndimit, siç e vëren këtë Kundëra, nuk është fare i rrezikshëm: askush nuk ia vë veshin. Në vendet socialiste intelektualët i shikojnë me sy të keq e pushteti është çdoherë i gatshëm t'u dalë në ndihmë që ta shkatërrojnë vetveten. Në Çekosllovaki, posa u bënин edhe vërejtjen më të vogël, ata nxíttonin ta fajesonin vetveten, duke e përdorur arsyen e vet vëtëm sa për ta përpunuar akuzën absurde derisa ajo bë-

---

\* Besoj pse është absurde (përkth.)

hej e pranueshme, derisa e përpunonin veten që ta pranonin atë. Veç kësaj, në Parti, zyrtarët më të mirë — shumica e të cilëve nuk ishin intelektuale — poashtrë e përpunonin veten; në saje të besnikërisë. Vetëm në këtë dritë mund të kuptoohen pranimet gjatë proceseve të viteve pesëdhjetë. Natyrisht, ato pranime bëheshin vetëm kur procesi i vetëshkatërrimit arrinte pikën ekstreme: nuk ishte më fjala që të përpunoheshin heshtazi fajet e veshura për t'ua dhëne një dukje vërtetësie e hetuesit kishin autorizim që me kërcënime, me goditje, me pagjumësinë e shkaktuar dhe me mjeshtëri të tjera t'i zbusin aftësitë kritike të të akuzuarve në mënyrë që këta ta pranonin *atë që është e papranueshme në akuzë*. Përqindja e dështimeve të këtyre proceseve ishte fare e vogël, ngase njriu çekosllovak kishte qenë përgatitur qëmoti të pranonte: duke qenë thelbësisht i dyshimtë për udhëheqësit, përfqinjtë e vet, përvetven, separatist, përkundër vullnetit të tij e nga vetë fakti i ekzistencës së tij molekulare, fajtor potencial në rastin më të mirë, në rastin më të keq kriminel megjithëse intimisht nuk e di ku qëndron krimi i tij, besnik, përkundër të gjithave, ndaj Partisë e cila e shtypet, ai e pranonte »fajin«, porsa këtë e kërkonin prej tij, nga se shpresonte se kështu merr fund sëkëlldia e tij e padurueshme. Madje edhe nëse e ruante sigurinë intime se nuk i ka bërë gabimet që ia vishnin, ai i pranonte ato në saje të prirjes përvetëdënim. Kështu disa njerëz anksiozë, të munduar nga ndjenja e fajit, origjinën e së cilës nuk e dinin, vjedhin me qëllim që t'i kapin dhe në burg e gjejnë prehjen: duke i dënuar për një delikt të vogël. Shoqëria dënon, në fakt, gabimin e tyre original; ata e paguajnë me këtë gabimin. Përmë tepër: Goldshtykeri (Goldstüker) tregon këtu se e ka lexuar, pasi ka dalë nga burgu, librin e një psikanalisti i cili e shpjegonte pranimin si një »identifikim me agresorin« dhe shton se, sipas përvojës së tij personale, ky interpretim nuk është shumë larg të vërtetës. Agresori është Partia, arsyaja e ekzistimit të tij, ajo që e përjashton dhe ngrihë përballë tij si një mur i pakapercyeshëm dhe në çdo mospranim të tij i përgjigjet me zërin e policit: »S'ka të vërtetë tjetër përvëç tonës.« Kur e Vërteta dëshiron ta mbajnë përm Murin kinez, si mund t'i kundërvësh asaj (»Atë ditë nuk isha në Pragë; kurre nuk e kam parë Slanskin«) bindje të brishta subjektive? Më mirë do të jetë që fatkeqi të pajtohet në vete me Partinë duke u identifikuar me Atë dhe me policët që e përfaqësojnë Atë, duke e pranuar përbuzjen dhe urrejtjen që këta ia shprehin në emër të Asaj nëse arrinë ta shikojë vëten me sy meduze të Gorgonës në pushtet, ai do ta zhdukë atë »gjë« të papërshtatshme e të mjerë që e ndante prej saj: jetën e vet. Fajtor! Çfare

marramendjeje! E kaplon qetësia, topitja, vdekja. Lidlur me këtë çështje, më duhet t'ia shtoj tregimit të Goldshtykerit një dëshmi për vërtetësinë e së cilës garantoj vetë. Në një vend tjeter të demokracisë populllore, me rastin e një serie tjeter të proceseve gjyqësore, një ish-partizane, që më vonë zuri poste të larta, e hodhën në burg duke e paditur për spiunazh: gjëja se ajo kishte punuar për Inteligjenc Servisin; gjëja se gjatë luftës për çlirim, burri i saj e kishte demaskuar por ajo kishte arritur t'ia kurdiste atij një grackë në të cilën ai kishte vdekur. Pas hetimeve disajavëshe ajo e pranoi në tërësi akuzën dhe gjyqi, i indinjuar, dënoi me burgim të përfjetshëm. Pas ca kohe, miqtë e saj morën vesh se më nuk e mundonin, se pak fliste me të burgosurit e tjere dhe se dukej e qetësuar. Ky proces gjyqësor ishte kurdisur aq keq sa askush nuk i besoi: kur pushteti bëri ndërrimin e personelit të vet, gruaja e re u lirua dhe u rehabilitua. Ajo u zhduk, por morën vesh se fshihej te kushërinjtë e vet. I pari i cili, në saje të lutjes së kushërinjve të saj, e hapi derën me forcë, e gjeti të mbledhur kruspull në një divan, të heshtur. Ai i foli gjatë pa arritur të marrë prej saj ndonjë përgjigje, e kur më në fund e hapi gojën ajo i tha me një zë të ankthshëm vetëm këto fjalë: »Ç'keni ju të gjithë? Unë jam fajtore!« Atë që e dënuara nuk kishte mundur ta përballonte, nuk ishin as torturat, as rënia e saj, as burgosja, por thjesht rehabilitimi i saj. Siç shihet, të menduarit e mineralizuar mund të ofrojë prehje: e vendosin si një rrashë varri në një koke të shqetësuar, ajo mbetet aty, e rëndë, inerte, »qetësuese«, duke i ndrydhur dyshimet, duke i kufizuar lëvizjet spontane të jetës në një gumëzhimë të parëndësishme insektesh. Edhe pa arritur deri në atë pikë, pranimi i përket vetë logjikës së sistemit, madje mund të thuhet se ai është caku i tij: së pari sepse Sendi, duke mos pasur as arsyë e as mendje, nuk kërkon fare të mendosh për atë që e thuash, por vetëm ta thuash atë publikisht. Pastaj, ngase në socializmin e importuar i cili pretendon t'i bindë punëtoret çekë të vitit 1950 se ata, fundja, nuk janë asgjë tjeter, veçse fshatarë ruse të vitit 1920, e vërteta përkufizohet si një rrrenë e institucionalizuar. Ata të cilët me sinqueritet e vendosën sistemin apo që e bindën veten se i përgjigjej Çekoslovakisë duhej të vinin, herët e vonë, në situatë që të rrejnë plot dëshpërim pa besuar në rrrenë e tyre në mënyrë që t'i afrohen asaj që e dinin si të Vërtetë.

Gruan e re e nxorën nga gjendja në të cilën kishte rrënë në saje të disa goditjeve elektrike. Kjo metodë ngapak staliniane bëhet e përshtatshme kur përdoret për destalinizimin e trurit. Duke qenë më pak të së-murë, katërmëbëdhjetë dëshmitarëve tanë u mjaftoi ve-

tëm një goditje elektrike: »Raporti — që i vishej — Hrushçovit», siç thoshte asokohe *L'Humanité*-ja. Në fakt, raporti kishte të përbashkët me mjekësinë e vrazhdë e cila e shëroi të pafajshmen — përkundër — saj se ishte rrufe dhe asgjë më shumë. Ai raport nuk e përbante asnje ide,asnje analizë, madje asnje përpjekje të interpretimit. Një »histori plot zhurmë e furi, e treguar nga një i marre«. Të merremi vesh: ketu nuk vihet në dyshim inteligjenca e Hrushçovit; thjesht ai fliste në emër të sistemit: makina ishte e mirë, shërbyesi i saj kryesor nuk ishte fare i mirë; fatmirësisht, ai sabotues e kishte liruar botën nga prania e vet, tash e tutje çdo gjë sërisht do të funksiononte mirë. Shkurt, personeli i ri e mënjanonte një të vdekur që ishte bërë pengesë, sikundër që personeli i vjetër i kishte eliminuar të gjallët. Ishte e vërtetë, megjithatë, se Stalini kishte urdhëruar të bëhen masakra, e kishte shndërruar vendin e revolucionit socialist në një shtet policor; ai ishte vërtet i bindur se Bashkimi Sovjetik nuk mund të mbërrinte në komunizëm pa kaluar nëpër socializmin e kampeve të përqëndrimit. Mirépo, siç e vëren saktësisht këtë njëri nga dëshmitarët, kur pushteti e sheh të udhës që ta thotë të vërtetën, ai këtë e bën sepse nuk ka gjetur rrenë më të mirë. Pernjëherë, ajo e vërtetë, duke kaluar nëpër gojët zyrtare, bëhet një rrenë e mbështetur në fakte. Stalini ishte njeri i keq? Le të jetë. Por si ndodhi që shoqëria sovjetike e ngriti në fron dhe e mbajti gjatë një qerek shekulli? Të shqetësuarve, personeli i ri u hodhi këto fjalë »kulti i personalitetit«: le të kënaqen me atë formulë burokratike, shembull tipik i *asaj që nuk mendohet* (*l'impensable*). Çekët dhe sllovakët kishin përshtypje se u kishte rënë mbi kokë një gur i madh për ndërtim dhe se ai u thye duke i copëtuar të gjitha idolet. Ky duhej të ishte, sic më duket, një zgjim i rëndë. Zgjim? Kjo fjalë padyshim nuk është e saktë sepse, siç shkruan njëri prej tyre, nuk pati ndonjë befasi të madhe: kishin përshtypje se atë që ua thoshin ato ditë e kishin ditur qëmoti. Vec tjerash, larg asaj që ta rizbulonin botën e zgjimit dhe të drithës, çdo gjë u dukej joreale: ata që morën pjesë në proceset e rehabilitimit dolën prej tyre thellësisht të habitur: i rehabilitonin të vdekurit me të njëjtat fjalë, më të njëjtat ligjërata që kishin shërbye dikur për t'i dënuar. Natyrisht, të jetosh më nuk ishte krim. Mirépo, kjo *ndihej* e nuk mund të provohej: rrena e institucionalizuar mbetej atypari. Inerte, e paprekur. Si dëshmitarë të një shembjeje të madhe e të largët, ata ndienin se diçka ishte kalbur në mbretërinë sovjetike; megjithatë ata mësonin nga burime të autorizuara se, te ata, modeli i importuar nga BRSS kurre nuk kishte funksionuar më mirë. Në fakt, makina funksiononte si du-

hej. Çdo gjë kishte ndryshuar, asgjë nuk kishte ndryshuar. Hrushçovi qart e bëri me dije këtë atëherë kur populli hungarez deshi në një kohë të papërshtatshme t'i nxirrte rrjedhimet e Kongresit XX. Natyrisht, çekoslllovakët nuk i besonin më rrenës së institucionalizuar, por ata frikësosheshin shumë se nuk do të besojnë më në asgjë. Ata kishin jetuar deri atëherë në atë siç e quan njeri prej tyre, »mjegullinë socialiste«; tash kur ajo braktisej sadopak ata kishin mundësi t'i vlerësonin dëmet: ekonomia, e rrënuar, kërcënëhej ta shkatërronte shoqërinë; fabrikat, të vjetruara, prodhonin, pa i përfillur fare kërkuesat reale të koniunkturës, produkte të cilësisë së dobët, niveli i aftësive teknike e profesionale binte dita më ditë, »njohuritë humaniste zvogëlohen në mënyrë të pandalshme«;<sup>4</sup> vendi, thjesht, nuk e njihte veten, meqë rrëna zyrtare dhe gjenjeshtrat statistikore e kishin rrënuar dijen e vjetër dhe i kishin ndalur prerasi hulumtimet dhe kërkimet socio-ekonomike mbi realitetin e tij. Po të mos na shkojë mendja, sidomos, se e njihnin dhe e fshihnin të vërtetë: e vërteta, thjesht, nuk ekzistonte dhe askush nuk kishte mjetet pér ta vendosur atë. Rinia, pa fije dyshimi, ishte në gjendjen më të vështirë: »Dituria e të rinjve është fragmentare, e autorizuar, e shthurur, shkolla e mesme është e paaftë që t'u japë nxënësve një pikëpamje të tërësishme mbi çkado, duke përfshire këtu edhe historinë tone kombëtare; sa i takon historisë universale, më mirë të mos e zëmë nëgoje; varfëria pedagogjike, në këtë lëndë, është dëshpëruese.<sup>5</sup> Dëshmitarët tanë u gjettën në një vend të panjohur, në një planetë të panjohur, midis Lindjes sekrete dhe Perëndimit të ndaluar. Ata parandjenin se ligjërata komike dhe tragjike mbi »krimet e Stalinit« do të mund të bëhej e vërtetë po të integrohej në një analizë marksiste të shoqërisë sovjetike. Po si mund ta ruanin besimin në marksizmin përderisa Sendi në pushtet nuk pushonte ta paraqiste atë si ideologji të veten? Nëse ishte rrënë zyrtare, si mund të ishte ajo, njëherazi, edhe e vërtet? E nëse ishin dy marksizma, një i pavërtetë e një i vërtetë, si do të arrinin ata, që ishin produkte të të pavërtetit, ta njihnin të vërtetin? Ata hetuan atëherë se mbi atë tokë të panjohur, indigenët më të panjohur ishin ata vetë. E dimë nga historia se kur gjyqtarët e pyetën, më 1795, anëtarin e Konventës Zhozef Lë Bonin lidhur me arsyet e politikës së tij represive në Pa-dë-Kale (Pas-de-Calais), ai u përgjigj disi i habitur: »Nuk po kuptoj... cdo gjë ndodhi aq shpejt...« Në Çekosllovaki asgjë nuk shkonte aq shpejt prej vitit 1948 deri në vitin 1956, por kishte,

<sup>4</sup> Kundera.

<sup>5</sup> Goldshtykeri.

padyshim, — lodhje, adaptim, pajtim me fatin, mungesë të imagjinatës, voluntarizëm të iluzionit — një duke vërtetësie e zyrtë e të pavërtetës, një normalitet i anormales një jetë e përditshme që s'mund të durohej, e të gjitha këto të mbuluar me mjegull. Prej mjegullës së shpërndarë kishin mbetur vetëm disa shtresa të shkëputura që zvariteshin nëpër lugine e këta njerez të zhgënjyer thoshin me vete, edhe ata: nuk po kuptoj. Kush ishin pra ata që kishin përjetuar atë që nuk mund të përjetohet, që e kishin duruar atë që nuk mund të durohet, që e kishin marrë shkatrrimin e ekonomisë së 'tyre si ndërtim të ekonomisë socialiste, që kishin hequr dore nga arsyaja për t'u mbështetur në besim në emër të socializmit shkencor dhe, më në fund, që i kishin pranuar gabimet dhe krimet që nuk i kishin bëre? 'Ata nuk mund ta kujtonin jetën e tyre të kaluar, ta masin »peshën e gjërave të bëra e të thëna«, t'i evokon kujtimet më intime pa rënë në atë gjendje të trallisjes së lehte të cilën Frojdi e quan *estrangement*. Reagimet e tyre në fillim ishin shumë të ndryshme. Gërditje, turp, zemërim, përbuzje. Kundera e zgjodhi humorin e zi. »Kam lindur me 1 prill, gjë që nuk është pa rrjedhoja në rrafshin metafizik«. Dhe po ashtu: »Njerëzit e brezit tim nuk i kanë mirë punët me veten. Unë nuk e dua veten shumë«. Ajo që ai e quan »zbatica e stalinizmit« e ka shpënë deri në skepticizmin absolut: »Stalinizmi ishte mbështetur mbi ideale të larta, por, gradualisht, i kishte shndërruar në të kundërtën e tyre, dashurinë ndaj njerezimit në egërsi ndaj njerezve, dashurinë ndaj të vërtetës në sistem të spiunimit... Në librin tim të parë, në kohën kur stalinizmi kishte marrë hov të madh, qeshë orvatur të reagoja duke u mbështetur në një humanizëm total... Mirépo, posa erdhi zbatica... unë ia bëra vetes këtë pyetje: Në fakt, përse do të duhej t'i duash njerezit? Kur dëgjoj sot të flitet përfafajsinë e fëmijës, për vëtmohimin e nënës së tij, për detyrën e shenjtë që të rritemi e të shtohemi, vërej se e njoh këtë këngë: kam kaluar nëpër këto sprova«. Ky lirik e braktis poezinë në mënyrë që t'i ripërvetësojë kategoritë e humbura: të qeshurit, grotesken; ai do ta shkruaje *Shakanë*, dhe, me këtë titull, ai nuk dëshiron të shënojë vetëm mahinë e pafajshme të heroinit, por tërësinë e një sistemi ku një shaka pa pasoja e shpie doemos autorin e saj në kampin e përqendrimit. Vaclav Haveli, ndërkaq, e zbulon njëherazi absurditetin e botës dhe absurditetin e vvetvesë: duke rrjedhë nga një familje borgjeze, si fëmijë i të pasurve e ndiente veten keq, që nga fëmijëria e hershme, në mesin e fëmijëve të varfér, e, nga kjo, e ndiente veten edhe pa rrënje, në ajër; pas luftës ishte viktimi e dis-

kriminimit, objekt i të cilit ishin hebrenjtë dhe fëmijët e borgjezëve, i kishte të ndaluara shumë profesionë si dhe studimet në universitetet; me ngulmë të madh kërkoi më kot, vite të tëra, autorizimin që t'i vijojë ligjëratat e dramaturgjisë në Fakultetin e Pragës, të cilin më në fund ia dhanë por vetëm kur që afirmuar si autor dramatik. Ai, megjithatë, e ndiente veten të huaj ndaj Sendit në pushtet. Ndoshta, diç më pak se të tjerët: shumica prej tyre kërkonin të integrohen brenda sistemit, ndërkaq ai e dinte se kjo është e pamundshme për të, ngase nuk e donin. Si rrjedhojë e kësaj situate doli shumë shpejt prirja e tij që ta ndiente veten absurd në një botë absurde. »Zbulimet« e vitit 1956 vetëm e rritën edhe më shumë atë tëhuajsim prandaj mu për këtë shkak kanë mundur ta krahasonjnë teatrin e tij me atë të »absurdistëve« perëndimore.<sup>6</sup>

Shkurt, si atëherë që kur e kanë ndier veten jo realë në një shoqëri joreale dhe ceremoniale e të trish-tueshme, si viktima, dëshmitarë apo bashkëfajtorë të një farse monumentale dhe të ankthshme, si atëherë kur valviten, si marioneta absurde, në një mjedis të strukturuar nga një absurditet i thelle në atë mënyrë që çdo orvatje për t'iu adaptuar asaj situate apo për ta ndryshuar atë ishte, që nga fillimi, i absurdizuar, njerëzit që flasin këtu, të gjithë, kanë vuajtur në vitet e para pas Kongresit XX nga ajo që psikiatrit e quajnë si krizë të identitetit. Ata nuk ishin të vetmit që e ndienin këtë krizë — ngase masat i kaplonte një sëkëlldi e rëndë dhe e heshtur — por padyshim ishim më të goditurit. C'të bësh? Ta vrashësh veten apo të provosh të jetosh. Në saje të disa aluzioneve të cilat lexuesi do t'i gjejë në këto biseda, hetohet se disa e zgjodhën mundësinë e parë; të tjerët deshën ta përdorin të drejtën e të jetuarit të cilën, para do kohe, ua kishin pranuar zyrtarisht. Këta nuk kishin zgjidhje: të jetojsh, do të thoshte së pari të shkëputesh nga një depersonalizim i cili kërcenohej të bëhej alibi, ta njohësh veten, ta rizbulosh veten në mënyrë që ta riformosh veten. E si mund ta kuptionin ata vete historinë e tyre pa e kërkuar aty ku ishte, në pesëdhjetë vjetet e fundit të historisë së tyre kombëtare? Midis aventurës së tyre të veçantë dhe aventurës së madhe të popullit cekoslovak, ekzistonte një reciprocitet i perspektivave: në situatën tejet të vështirë në të cilën ata gjendeshin, pa kategori e pa koncepte për ta menduar realitetin, për ta menduar *veten*, ata kuptuan se çdonjëra prej atyre

<sup>6</sup> Pjesët e tij, megjithatë, kanë një dallim prej atyre: ato kanë një përbajtje politike që nuk mund t'u ikën bashkatdhetarëve të tij. Në pjesën *Një raport që u përket* ai ka theksuar qartë se asgjë nuk mund të ndryshojetë derisa sistemi të mbetet si është dhe derisa ta sekretojë burokracinë e vet.

dy historive mund tē ndriçohej vetēm nē saje tē tjetrës. Subjekтивizëm? Jo, por modesti. Ata duhej o tē vdisnin o ta gjenin tē vërtetët. Jo atë tē sistemit: ata ende nuk ishën armatosur aq sa ta sulmonin atë, kjo do tē bëhej më vonë. Té vërtetët e jetës së tyre, tē tē gjitha jetërave çeka e sllovake, nē realitetin e tyre tē vrazhdë, pa pasur asgjë nē duar, asgjë nē xhepa, duke hequr dorë nga cfaredo interpretimi ideologjik: ata duhej t'u ktheshin fakteve, njëherë fakteve tē errësuara, tē shtrembëruara, para tē cilave, siç thoshte Novotni pa tē keq, s'do tē duhej tē përluleshin me servilizëm.<sup>7</sup> Është meritë shumë e madhe e këtyre njerezve që, brenda rrëmujës së përgjithshme, ngadale e me ngulm, ndërmorën publikisht, përkundër censurës dhe kërcenimeve tē pushtetit, atë hulumtim edipian. Mu këtu mund tē shihet se si Jaroslav Putik e braktisi gazetarinë dhe iu kushtua letërsisë: më parë, padyshim duke dashur tē evitonë që t'i vinte në dyshim sintezat e mëdha tē stalinizmit, ai zhytej në faktet e jashtme ashtu si i jepnin mjetet e informimit në tërë botën, fryte tē maskuara, nē Lindje, nga plogështia pedante e aparatit, nē Perëndim, nga një »objektivizëm« tinzar. »Nevoja pér tē shkruar gjëra që më përkasin, që ta shpreh vërtet veten, më lindi vetëm pas vitit 1956. Sikurse lufta, edhe ai vit la gjurmë te njerëzit. Në mënyrë tē vrazhdë. Sa më takon mua... unë kisha hetuar mjaft gjëra dhe i bëja vetes pyetje tē ndryshme. Megjithatë, ai vit shkaktoi... tronditje vendimtare. Atëherë e kuptova qartë se nuk po e bëja atë që vërtetë doja ta bëjë. Ai donte tē shkruaja pér ta njojur veten dhe, siç thonë shumica e romansierëve që flasin këtu, pér »t'i njojur njerëzit, pér t'i zbuluar nē »dimensionet e tyre ekzistenciale«. Kosiku thotë se prej viteve 1956 deri më 1958 kultura çeka u polarizua rreth çështjeve ekzistenciale dhe pikërisht pyetja »Çështë njeriu?« u bë emërtues i përbashkët. Nuk ishte fjala, mos kini frikë, që ta harnojnë një humanizëm. Sa u takon humanizmave, ata i kishin pas njojur dy: atë tē Beneshit dhe atë tē Stalinit. Që tē dytë, siç thotë shumë mirë njeri nga déshmitarët tanë, »ua fshehnni njeriun«. Që tē dytë ishin bëre copë-copë: askujt nuk i shkonte në mend t'i mblidhë copat e tyre. Ndërmarrja ngashnjyese dhe e vështirë së cilës i hyjnë, ishte e vëtmja ndërmarrje e mundshme, e vëtmja e domosdoshme: t'u qasen njerëzve pa paragjykime filantropike. Prandaj, nga ky pikëshikim, pyetja tē cilën e shtroi Kundera, është shenjë e një radikalizmi tē shëndo-shë: përsë do tē duhej dashur njerëzit? Po; përsë? Për-

<sup>7</sup> Ide kjo që, shikuar në tërësi, është mjaft e drejtë dhe duket se i kundërvihet *Realpolitikës*, por e cila, në atë gojë, do tē thoshte në fakt se faktet s'duhet tē merren parasysh atëherë kur janë në kundërshtim me vendimet e përgjegjësve.

gjigjja do tē dihet një ditē apo ndoshta kurrē. Pēr një kohē kjo nuk ishte aq e rēndēsishme. Skepticizmi i Kunderës nuk shpie, natyrisht, nē konformizēm por as nē dëshpērim; ky autor na thotë shtruuar se skepticizmi pēr tē paraqet rilindjen e tē menduarit: »Skepticizmi nuk e zhduk botën, ai e shndërron atë nē pyetje«. Duke pērfetuar nga tēhuajsimi i vet, ata duan qē asgjē tē mos mbahet e vetékuptueshme, qē asnijë e vërtetë tē mos jetë e padyshimtë. Pēr ta sikurse pēr Platonin, tē çuditurit është burim i filozofisë dhe, pēr një kohë ata duan tē qëndrojnë aty. Nē vend tē pohimeve tē pushtetit qē kanë trajtēn e përgjigjeve qē u paraprijnë pyetjeve dhe e pengojnë shtruarjen e tyre: tē menduarit nuk do tē lirohet nga gurët gëlqerorë qē e lëndojnë apo e shtrembërojnë, por duke i shpërbërë nē një problematikë. Kjo gjë nuk e pengon kërkimin por, përkundrazi, e nxit atë, ia para-shtron atij detyrat dhe kufijtë e përkohshëm. Vaclav Havel, nē prill tē vitit 1968, parashëh »një art social me tonalitet thellësisht realist« i cili do ta paraqiste »individin nē kontekstin e tij shoqëror, me jetën e tij private, me familjen e tij, fëmijët e tij, me kushtet e tij materiale. Tē gjitha këto do tē vihen nē rend dite po tē jetë e mundur një ditë tē thuhet si qëndron vërtetë puna e tyre... Na pret një realizëm i ri social dhe jo vetëm kjo, por, pikërisht nē roman, një orientim i ri kah hulumtimi psikologjik, kah gjurmimet me sondë nē fushat e pahulumtuara.<sup>8</sup> Goldshtykeri nuk thotë gjë tjeter — e Marksit e kishte thënë këtë para tij (edhe Frojdi) — kur, pēr tē vënë nē pah se hulumtimi i këtyre Edipave tē rinj dëshiron tē jetë shterrues, pohon: »Është e pamundur tē paraqitet realiteti i thellë përmes shfaqjeve tē saj tē si-përfaqshme.«

Ky zell do t'i bëjë tē buzëqeshin shumë lexues përendimore: sepse ne tē botës »së lirë« e kemi kaluar kaherë atë shkallë! Ka shumë kohë që jemi ushtruar hollesisht nē njobjen refleksive, nē metapsikologji, nē analizë. Është e vërtetë: ne kemi një mënyrë tjeter pēr ta injoruar veten e ne flasim më me dëshire pēr komplekset tona sesa sa pēr kushtet materiale apo pēr kontekstin socio-profesional nē tē cilin jemi tē ngérthyer dhe ne na pëlqen më shumë tē pyetemi pēr komponentën tonë homoseksuale sesa pēr Historinë e cila na ka krijuar dhe tē cilën e kemi krijuar; edhe ne jemi viktima e bashkëfajtorë tē tjetersimit, sendëzimit, mistifikimit, edhe ne po fundosemi nën »peshën e gjërave tē bëra e tē thëna«, tē gënjeshtrave tē pranuara e tē përhapura pa besuar shumë nē to: por ne nuk duam ta dimë këtë. U pë-

<sup>8</sup> Mund tē vërehet këtu se arti pēr tē cilin Haveli bën fjale s'ka asgjë tē përbashkët me »absurdizmin« e tij tē mëparshëm: ai shpresonte asokohe

ngajmë somnanbulëve që shëtisin mbi ullukë duke ëndërruar në koqet e tyre në vend se t'i shikojnë sesi ecin. Natyrisht, edhe çekët duhet t'i rimendojnë këto probleme të cilat ua kishte fshehur turpi i tepëruar i viteve pesëdhjetë.<sup>9</sup> Por, siç i thoshte njëri prej tyre Limit: »Çfarë fati sikur të mos kishim të merreshim me punë të tjera!« Ata duhet ta thonë të tërën apo të zhduken: ata i shtrojnë *nxehtësisht* e konkretisht pyetjet të cilat ne i shtrojmë ftohtë e në rrafshin abstrakt, dhe i shtrojnë njehherazi njëmijë pyetje të tjera për të cilat kurrë nuk do të na shkonte në mend t'i shtrojmë; se ata ende nuk e njojin mirë veten kjo del nga fakti se përvoja e tyre është shumë e pasur: nevojitet kohë për ta sistematizuar atë.

Kjo nuk është e vëtmja arsy. Më kujtohet biseda që pata me një shkrimtar të Amerikës latine — kjo ishte në vitin 1960, ai ishte i lodhur, më shumë lucid sesa i dëshpëruar, ai luftonte ende; e dija se jeta e tij ishte e mbushur me luftëra, me fitore dhe me disfata, e kishte qenë i syrgjynosur e i burgosur, se shokët e kishin përashtuar nga partia e pastaj e kishin kthyer sërisht në radhët e saj dhe se gjatë kësaj lufte të pandërpërre u kishte mbetur besnik idealeve të veta por ishte çliruar nga iluzionet. »Për këtë histori, i thashë, për historinë tuaj, do të duhej të shkruani«. E tundi kohën në shenjë mohimi — kjo ishte hera e vetme që e shfaqi hidhërimin: »Ne komunistët, ne nuk kemi histori«. E kuptova se autobiografia për të cilën porsa më kishte folur, e tija apo e ndonjërit nga shokët e tij, aty apo gjetiu, kishte pak gjasa të tille në dritë. S'ka histori, jo. S'ka kujtesë. Partia e ka edhe njerën edhe tjetrën, por të falsifikuara. Ai që e shkruan nga jashtë historinë e PK, në saje të dokumenteve e dëshmive, mund të jetë i penguar nga paragjykimet e veta, sido që të jetë i mungon një përvojë e pazëvendësueshme; nëse ka dalë nga partia, shkrimin e tij mund ta pengojë zemërimi e hidhërimi; ai që e shkruan atë histori nga brenda, nëse është në pajtim me përgjegjësit, bëhet historiograf zyrtar, apo i shikon çështjet sipas politikës së ditës. Në çka mund të mbështetet një militant i cili do të donte ta kuptonte jetën e vet, nëse organizata në të cilën bën pjesë dhe e cila e ka prodhuar, jo vetëm se parimisht e dekurajon këtë lloj ndërmarrjesh subjektiviste por, në rastin më të mirë, do ta shtyjë që për vetveten të japë dëshmi të rreme? C'ka ka ai? Ka kujtime të rindërtuara, të fishkura apo të shlyera nga një varg autokritikash, ose të tjera që janë të gjalla por të parëndësishme apo të pakuptueshme. Si t'i kujtohet, pas aq shumë kthesash të pranuara, drejtimi

<sup>9</sup> Shumica prej tyre, në biseda, e cekin shtruar psikanalizën si rrugë që shpie kah »realiteti i thellë«.

të cilin pat besuar se e ka marrë në fillim, si ta dijë ku shkon tashti? E cili anëtar i Partisë mund të pohojë se çelësi, të cilin e përdor për interpretimin e aksioneve të saj, do të jetë po ai edhe pas një viti? Vetëmashtrimet arrijnë të krijojnë një dimension të fshehur, sikurse te ai sovjetiku për të cilin miqtë e tij më thoshin: ai i ka dymbëdhjetë kate të sinqeritetit, ju keni arritur vetëm te kati i katërt. Të tillët heshtin; të tjerët ia kanë dhënë dy herë jetën partisë së vet: ata shpesh e kanë atë në rrezik në saje të urdhrit të partisë dhe, nga dita në ditë, për hir të disiplinës, e kanë lënë atë prapa vetes të mbulohet me rërë, nëpër duna ku edhe era më e vogël mjaf-ton për t'i fshire hapat e tyre.

Shumica e çekëve e sllovakëve që flasin këtu janë anëtarë të PKÇ. Edhe ata ia kanë kushtuar jetën entuziazmit dhe e kanë harruar atë gjatë disa vjetëve. Megjithëkëtë, pikërisht ata sot e ndërmarrin, në këto biseda, në romane, në njëqind ese të tjera,<sup>10</sup> ringjalljen e jetës, ndërmarrje kjo që dukej e pamundshme në vitet gjashëtëdhjetë dhe e cila edhe sot ballafaqohet me të njëjtat vështirësi. Për këtë arsye, ata duhet të shkojnë hap pas hapi, t'i thyejnë të gjitha rezistencat e tyre të brendshme, t'i vështrojnë gjurmët gati të padukshme, t'i ngrejnë guret e varrezave për të parë se ç'është varrosur brenda. E sidomos, e tërë çështja është aty — të gjejnë *pikën e ndricimit*. Për fat të mirë, kuitimet e tyre ende janë të gjalla: në vitin 1956, »mjegullia socialiste« i kishte bërë vetëm tetë vjet moshë. Referati i Hrushçovit, sado absurd që të ketë qenë, ua jep »goditjen e fundit« e cila ua bën të mundshme të flasin si duhet për veteven e për Partinë ata nuk do të orvaten fare ta mbiflutojnë këtë trup të madh, pjese përbërse e të cilit ishin: ai ishte spirancë e tyre; megjithëse i kishin pësuar veprimet e sistemit, ata e dinin po ashtu se vetë e kishin bërë atë — sado që ai ishte i parafabrikuar, është dashur së paku që ta vendosin atë — dhe se vetë lufta të cilën e bënин të gjithë për t'i kufizuar disa skajshmëri të tij ishte vetëm një mënyrë e caktuar e pranimit të tij. Ata do të flasin për të, pra, *nga brenda*, ngase ende janë në të dhe me një solidarësi të pamohueshme — pa e dënuar atë asnjëherë me urrejtje e zemërim, pa u orvatur të hiqen si të pafajshëm, — por do të distancohen prej tij *brenda* në saje të mospërputhjes së shkaktuar nga *tëhuajësimi* i cili përnjëherë nxjerr në shesh praktika aq rutinore sa ata i kanë kryer pa i hetuar. Thua jse nuk mund ta ripërvetësonin jetën e tyre, pikërisht në emër të vetë konstanteve që duhej të zbuloheshin, të be-

<sup>10</sup> Nga ky pikëshikim nuk njoh asgjë të menduar aq mirë, aq të fortë e aq lucide sa dëshminë e mrekullueshme të Londonit: *Pranimi*.

snikërive të rikthyera, veçse me një kritikë të brendshme të Partisë, e as ta mohonin rolin e Partisë veçse me një mohim radikal të vjetvetes, pa i bërë çështje veprimet e tyre dhe rrjedhimet e këtyre, për lëshimet, dëshirimet e kompromisët e tyre. Ajo që mund të duket si një rreth magjik, duke i lexuar këto biseda, është në fakt një lëvizje dialektike e cila do të duhej t'ua bënte të mundshme të gjithë lexuesve të tyre, si dhe vetë atyre, ta gjejnë të vërtetën e tyre të humbur, atë totalitet konkret, përherë të detotalizuar, të kundërthënsëm, problematik, të hapët, të papërfunduar, e megjithatë një, nga i cili duhet të niset çdo hulumtim teorik, nga i cili është nisur marksizmi me Marksin, për t'u nisur sërisht, pas tij, me Leninin, me Roza Luksemburgun, me Gramshin, por për të mos u rikthyerasnijëherë më, më vonë.

Mbi çka mund të mbështeteshin ata që ta ruanin *distancimin* i cili është i domosdoshëm për ta bërë hulumtimin? Përgjigja është e qartë: mbi kulturën e tyre kombëtare. A mjafton kjo arsyе për t'ua veshur nacionalizmin, siç veproi garda e vjetër e stalinistëve të mu-mifikuar? Jo: lexojini dhe do të shihni. Është faj i tyre nëse batica e pseudomarksizmit, duke u tërhequr, ua ka zbuluar faktin se tradita e tyre historike mbetej e par-prekur meqenëse nuk ishte përpunuar e nuk ishte tejkaluar kah një socializëm i vërtetë dhe nëse ata vërejnë se mbështetja e tyre në historinë e tyre, sado e pamjatueshme që të jetë, përkohësisht është më e dobishme për ta kuptuar të tashmen e tyre sesa konceptet e zbrazëta, përdorimin e të cilave ua kishin imponuar? Mirëpo, ata pajtohen se vetë këto të dhëna më vonë duhet t'i nënshtronen një interpretimi marksist. Por, për t'u bërë ballë problemeve më të ngutshme, ata e shohin të arsyeshme të nisen nga faktet e thjeshta e të njohura: konfiguracioni i trollit, situata gjeopolitike e vendit, vogëlsia e tij e cila i bëri Boheminë e Sllovakinë fushëbe-teja të fqinjëve të tyre, aneksioni nga ana e Perandorisë austro-hungareze e cila, dikur, i ka »rikatolicizuar« me dhunë ashtu siç orvaten sot t'i »ristalinizojnë«, të gjitha këto janë aq hipoteka mbi ardhmërinë e tyre sa edhe shpjegime mbi të tashmen e tyre. Kundër okupatorëve, cfarëdo që të kenë qenë ata, dhe armatave të tyre të rënda e të pamposhtshme, të dy popujtë kanë luf-tuar përherë në saje të riafirmimit të vazhdueshëm të mëvetësise së tyre kulturore. »Çekët, thotë Limi, janë i vetmi popull i Evropës i cili e ka kaluar pjesën më të madhe të shekullit XVII dhe tërë shekullin XVIII pa e pasur një aristokraci kombëtare, e cila atëherë ishte zakonisht bartëse e arsimimit, e kulturës dhe e politikës. Për shkak të gjermanizimit dhe të rikatolicizimit të dhunshëm... politika çake u lind si një përpjekje e domosdoshme e ringjalljes së gjuhës e të qytetërimit kombë-

tar... në atë mënyrë që uniteti i ngushtë i kulturës dhe i politikës paraqitet këtu, qëmoti, si një unitet organik« Në kohën e stalinizmit, problemet janë të tjera, por armët e çekëve mbeten të njëjtë: kundër socializmit i cili vjen nga të ftohit, ta afirmojnë personalitetin e tyre kulturor. Ta mbrojnë kulturën kombëtare, jo për ta konseruar ashtu si është, por për të ndërtuar nga ajo socializmin i cili do ta ndryshojë atë duke e ruajtur njehërazi vulën e saj. Ja se ç'rizbulojnë intelektualët çekë në vitet gjashtëdhjetë; ja se çka u ndihmon më mirë ta gjejnë vendin e tyre në këtë planetë: ata nuk paskan qenë, siç mendonin, të panjohur ndër të panjohurit; ajo që i kishte shtyrë të mendonin ashtu ishte gjendja e atomizuar në të cilën i solli sundimi i Sendit; për ta shfronësuar pa u zhytur në »subjektivizëm«, duhej që secili ta gjente te secili fqi i vet të afërmë e vet, do të thotë si prodhim të së njejtës histori kulturore. Lufta do të jetë e vështirë dhe përfundimi i saj nuk është i sigurt: ata e dinë se »jetojnë në shekullin e integrimit të tërësive më të ngushta brenda atyre më të gjera«; njëri prej tyre madje deklaron se »procesi i integrimit kërcënohen shumë që t'i përfshijë (për t'u dhënë fund dhe për një afat më të shkurtër a më të gjatë) të gjitha kombet e vogla...« Ç'të bëhet në këtë rast? Ata nuk e dinë: qëkurse e kanë mbyllur katekizmin e tyre, ata duan të mos jenë më të sigurt në asgjë. Tërë ajo që e dinë është se, në momentin e pikërishtëm, lufta e Çekoslovakisë për autonominë e saj kulturore hyn në suazë të një lufte më të gjerrë të cilën shumë kombe, të mëdha a të vogla, e bëjnë kundër politikës së blloqeve dhe për paqe.

I pasigurt, tashmë i përqarë nga konfliktet e brendshme, pushteti e pa të arsyeshme që t'i zbuste shtrëngimet: nga frika se angazhimi i ri i njerëzve të kulturës të mos i shpinte që ta braktisin »realizmin socialist« për ta përvetësuar »realizmin kritik« — që të dy këto »koncepte« të pamendueshme, Mirépo, shërbëtorët e Sendit reagojnë ndaj rreziqeve që u kërcënohen vetëm nëse e gjejnë përkufizimin e tyre në katalogun që ua kanë shpérndarë, — ai ia hapë derën dezangazhimit: nëse nuk keni mundësi ta shprehni besimin tuaj në sistem, ju lejojnë të flisni për të mos thënë asgjë. Shumë vonë: ata që flasin këtu — dhe shumë të tjerë që këta i përfaqësojnë — e refuzuan këtë tolerance; Goldshtykeri thotë bukur: »Nacionet e realizmit dhe të jorealizmit e fshehin problemin e vërtetë, e ky është: deri ku mund të shkojë te ne angazhimi i artistit kur është fjala për shpjegimin e kushteve të jetës të krijuara historikisht nga faktorët shoqërorë në këto vitet e fundit? Për ta nuk ishte fjala që ta kërkonin kthimin e liberalizmit borgjez, por, meqenëse e vërteta është revolucionare, të kërkojnë të drejtën revolucionare për ta thënë të vërtetën.

Udhëheqësit madje as që arrinin ta kuptonin këtë kërkesë: për ta e vërteta tashmë ishte thënë, tërë bota e dinte përmendësh e detyrë e artistit ishte vetëm që ta përsériste. Dialog i të shurdhërvë. Por, përnjëherë ndodhi që masat u ndezën: ajo që, në fillim, ka mund të duket si brengë e një kaste profesionistësh të privilegjuar u bë kërkesë e pasionuar e tërë një populli. Këtu duhet të shpjegohet se në ç'mënyrë u realizua atje ajo që ne nuk patëm sukses ta bënim, një muaj më vonë, unitetin e intelektualëve me klasën punëtore.

Në vitet e gjashtëdhjeta situata ekonomike bëhet gjithnjë më shqetësuese: midis ekonomistëve, Kasandrat nuk mungojnë. Klithmat e tyre alarmuese nuk arrijnë te publiku i gjere. Çdo gjë ndodh brenda Partisë e madje edhe brenda aparatit shtetëror: kjo do të thotë se lufta për rimëkëmbjen e makinës gërshetohet me luftrën për pushtet. Në shtresat udhëheqëse ashpërsohet konflikti ndërmjet burokratëve të vjetër dhe atyre të rinj. Të parët, që Limi i quan »amatore«, e arsyetojnë jokompetencën e vet universale me parimin stalinian të autonomisë së politikes; të dytët i takojnë, gati të gjithë, brezit të »trashëgimtarëve të përjetshëm të froni«; pa e bërë çështje sistemin; ata e theksojnë epërsinë së paku koniunkturale të ekonomisë.<sup>11</sup> Shkurt, reformistë. Natyra e pushtetit nuk është kontestuar: pushtetmbajtësit e legjitimojnë autoritetin e tyre me parullën e vjetër të intensifikimit të luftës së klasave; ata që e kërkojnë atë, të rinjtë, e mbështesin kërkesën mbi aftësitë e veta dhe mbi domosdonë urgjente të rregullimit të ekonomisë — këta reformistë autoritarë nuk e vërejnë se në çfarë kundërthënie kanë rënë atçherë kur e mbështesin parimin e pandryshuar të autonomisë së politikës mbi kërkesat imediate të bazës ekonomike. Ata do ta rrënojnë nga lart fetishizmin e prodhimit, do t'ua përshtasin këtë resurseve dhe nevojave të vendit dhe do ta nënshtrojnë, në një masë të caktuar, nën kontrollin e konsumit. Konflikti i këtyre dy despotizmave, njëri obskurantist e tjetri i arsimuar, i bën që të dytë të kthehen kah klasa punëtore: ajo do të arbitrojë.

Në fillim dukej se ajo u vu në anën e udhëheqësisë së vjetër: të depolitizuar nga rutina e zymtë në të cilën i kishin detyruar të vendoseshin, shumë prej punëtoreve shqetësohen nga ndonjë ndryshim i cili mund t'ua rrëzikojë sigurinë e punësisë. Për t'i përfëtuar, klani tjetër

<sup>11</sup> Është për t'u çuditur sesi udhëheqësit e R.D.Gj, të gjithë së bashku, i kanë neutralizuar konfliktet në krye dhe i kanë dhënë një nxitje të hovshme ekonomisë së Gjermanisë Lindore duke ua shtrirë mundësinë teknokratëve që të marrin pjesë në pushtet. Nga kjo doli si rrjedhojë se sundimi i tyre mbi masat është më i rreptë sesa në vendet e tjera socialiste.

duhet t'u japë, edhe atyre, një kontroll të caktuar mbi prodhimin dhe t'u premtojë një »ligj për ndërmarrjen socialiste«. Shkurt, reforma e planifikuar sjell, *ipso facto*, një *liberalizim* të caktuar të regjimit: flitet për decentralizimin, vetëqeverisjen. *Flitet* për këtë: mirëpo, të ekzistojë sistemi, këto fjalë nuk kanë ndonjë kuptim; vetëqeverisja mbetet vetëm fjalë e zbrazët kur pushtetin politik e mban në duart e veta një grup i privilegjuar i cili mbështetet mbi një organizatë të centralizuar. Do të jetë meritë e intelektualëve sllovakë që u shfrytëzua paraliza e pushtetit, të bllokuar nga kundërthëniet e tij të brendshme, për t'i nxitur punëtorët që t'ua kundërvenë propozimeve të liberalizmit reformist kërkesën revolucionare të një *demokratizimi socialist*. Ç'është e vërteta, askush, as prej atyre e as prej këtyre, nuk pati ide të qartë për atë që po ndodhte. Intelektualët, të ngashnjyer nga reformizmi, me artikujt e tyre donin të kontribuonin, para së gjithash, që masat që të viheshin në anën e reformatorëve. Mirëpo, shkrimet e tyre — ato që janë në këtë libër dhe shumë të tjera, — si rezultat i një meditimi i cili kishte filluar në vitin 1956, kishin pesë e vlerë shumë më të madhe sesa ua merrte mendja edhe vetë atyre: duke e kërkuar dhe duke e thënë të vërtetën, ata e zhvishnin sistemin dhe ua vënин në pah fakin lexuesve, duke e ndriçuar përvojën e cila është karakteristike pér çdokënd, se për popullin çekoslovak nuk shtrohej fare çështja që t'u japid fund »gabimeve« të regjimit por që ta shkatërronin tërë sistemin. Proseset, pranimet, sëmundja e të menduarit, gjenjeshtra e institucionalizuar, atomizimi, mosbesimi i përgjithshëm, jo, të gjitha këto nuk ishin gabime: këto ishin rrjedhime të paevitueshme të socializmit të parafabrikuar; kurrfarë përmirësimi, kurrfarë arnimi nuk do të mund t'i mënajnonte dhe, çfarëdo garniture që të jetë në pushtet, përkundër vullnetit të saj, ajo do të gurëzohet apo do të thërmohet po ashtu, përveç nëse çekët e sllovakët, të gjithë së bashku, të mos ngrireshin me çekanë për ta goditur makinën dhe të mos i binin pa pushuar, përdërsa ajo të mos rrënohej tërësisht. Ata e kuptuan qartë përbajtjen e vërtetë të të menduarit të tyre, kah fundi i vitit 67, kur për shkaq të shkrimeve të tyre patën ndërin të sulmoheshin ashpër nga një pushtet i lodhur: një kohë të gjatë me gojë të myllur — papritmazi — ata panë sesi idetë e tyre zbritën në rrugë, rinia studentore — ky brez në të cilin dyshonin aq fort — i kishte përvetësuar dhe i ngrihte lart si flamuj. Fitorja e reformizmit, në janar të vitit 1966, nuk ishte tashmë fitore e tyre, përkundër aleancës së përkohshme të masave dhe të teknokracisë: triumfi i tyre i vërtetë erdhë pak më vonë, atëherë kur klasa punëtore, e zgjuar nga topitja në të cilën kishte rënë, e shtroi sërisht, pa qenë në fillim plo-

tësish e vetëdijshme për këtë, kërkësën e vet të vjetër maksimaliste, të vëtmen që vërtet buron prej saj: pushteti në duar të sovjeteve. Diskutohej në të gjitha ndërmarrjet, aty mësohej demokracia e drejtëpërdrejtë; në disa fabrika punëtorët nuk pritën madje as që të votohet ligji për ta përjashtuar drejtorin dhe për ta vendosur zëvendësin e tij të zgjedhur nën kontrollin e një këshilli punëtorësh: udhëheqësit e rinx, meqë rrjedha e ngjarjeve i kishte tejkaluar, u detyruan ta ripunojnë projektin e tyre të ligjit për t'i marrë parasyshë vlimet popullore; shumë vonë: bëhej e qartë se procesi i demokratizimit nuk do të ndalej. Intelektualët panë se kjo lëvizje e madhe popullore përmban radikalizimin e mendimit të tyre dhe, përnjëherë, duke qenë edhe vetë të radikalizuar, por pa armiqësi ndaj garnitures së re në pushtet, e intensifikuan luftën e tyre kundër sistemit. Kurrë shtypi e radioja nuk qenë kurrë më të lira sesa në Çekosllovaki gjatë pranëverës së vitit 1968. Por ajo që na habit neve të Perëndimit është fakti se luftën e intelektualëve për lirinë e plotë të fjalës e të informatës e përkrahën punëtorët që e kuptuan shumë shpejtë se e drejta e informimit të plotë ishte pjesë përbërse e kërkësave të tyre themelore. Mbi këtë bazë u lidh bashkimi i punëtorëve dhe i njerëzve të kulturës.<sup>12</sup> Kjo gjë shpreh mjaft qartë se në ç'masë dallojmë nga ato tonat problemet e një demokracie popullore. Punëtorët franezë nuk do të hedheshin në grevë sikur qeveria jonë ta kufizonte lirinë e shtypit e, në situatën e tashme, mund t'i kuptojmë: pushteti rrallë herë ka nevojë t'ua myllë gojën gazetave, këtë punë e bën profiti. Punëtorët e lexojnë *le Parisien libéré* (*Parisienin e çliruar*) pa besuar në asnjë fjalë të kësaj gazete dhe duke menduar se çështjet e shtypit do ta gjejnë zgjidhjen e tyre me suprimimin e pastër e të thjeshtë të profitit. Ata e dinë ndoshta se censura ekziston në BRSS apo në Poloni, por kjo nuk i shqetëson fare: atje — siç ua kanë shpjeguar — proletariati e ushtron diktaturën e vet: do të ishte një krim të tolerohet, në emër të parimeve abstrakte, e veç kësaj borgjeze, që gazetat kundërrevolucionare të ngulin

<sup>12</sup> Kv bashkim ende ekzistonte kur u ktheva në Pragë në nëntor të vitit 1969. Studentët i kishin pushtuar disa fakultete për të protestuar kundër rivendosjes efektive të censurës. Megjithëkëtë, ende kishte mundësi që të shfaqej deri diku lirisht mendimi për okupatorin dhe unë munda të them, duke u përgjigjur në pyetjen e një studenti, në një sallë të mbushur plotë se e konsideroja intervenimin e të pesëve si një krim lufte; ata kërkonin lirinë e informimit brenda perspektivës së kërkësës maksimale për të cilën fola më lartë. Qeveria, pa ndonjë vendosmëri, e shqyrtonë mundësinë që të ndërmerrte masa kur punëtorët e disa fabrikave të rendësishme çëke u dhane fund luhatjeve të saj duke e bërë të ditur se do të hedheshin menjëherë në grevë nëse do t'i preknin studentët

këmbë për ta helmuar ajrin me gënjeshtat e tyre. Ndërkëq, më 1968, pas njëzet vjetesh të stalinizmit, punëtorët çekë e sllovakë i shikonin punët ndryshe; edhe ata, në fillim, kishin qenë të ngopur me gënjeshtra; deri në ç'masë, këtë nuk e kishin ditur asnjëherë më parë, e më vonë filluan ta mësonin: diktatura e proletariatit ishte diktaturë e një partie që kishte humbur çdo kontakt me masat; sa i takon luftës së klasave, si kanë mundur të besojnë ata se ajo ishte intensifikuar me përparimin e socializmit: ata e vërenin mirë se, qëkur e kishin vendosur, vetëm kishte pësuar regres? Për ta as censura nuk ishte më pak e keqe, ngase gënjeshtra e censuronte të vërtetën. Përkundrazi, aq sa bëheshin të vetëdijshëm për kërkesën e tyre maksimaliste, e vërteta e plotë, si dije teorike e praktike, bëhej për ta nevojë e thellë: për shkak të arsyes së thjeshtë se pushteti punëtor s'mund të ushtrohet madje as në vendet e punës nëse nuk është i informuar vazhdimi, në të gjitha nivelet. Kjo kërkesë, u muar vesh, nuk kishte të bënte vetëm me difuzionin e përditshëm të lajmëve të vendit e të botës së jashtme përmes mediumeve masive; ajo kërkesë e merrte kuptimin e vet të vërtetë gjatë thellimit për ta orientuar, për ta korrigjuar, për ta kontrolluar prodhimin, për t'i vendosur aktivitetet e tyre në kontekstin e vendit e të botës, për ta ruajtur, me gjithë largësinë, kontaktin e vazhdueshëm mes vete, punëtorët çekë e sllovakë kérkonin një pjesëmarrje të plotë në jetën shkençore e kulturore të kombit. Kjo kërkesë, e cila, në pranverën e Pragës, porsa kishte filluar të vetëdijësohej, do të kishte shkaktuar, herët a vonë, një revolucion të kulturës e të arsimit. Kështu, në gjun e një lëvizjeje të gjere revolucionare, punëtorët e intelektualët ishin njëri për tjeterin, në saje të reciprocitetit, faktor permanent i radikalizmit: këta e kuptionin se mund ta përbushin funksionin e tyre — kërkimin e të vërtetës — vetëm në një shoqëri socialiste në të cilën të gjithë marrin pjesë në pushtet; ata, të pasionuar nga polemikat që zhvilloheshin nëpër gazeta, e kuptionin se nuk mund ta realizojnë socializmin pa e thyer monopolin e dijes (i cili ekziston si në Lindje poashtu edhe në Perëndim) dhe pa e siguruar difuzionin më të gjërë të së vërtetës, e cila, duke qenë në mënyrë të pandashme teorike dhe praktike, e gjente zhvillimin e vet të plotë brenda unitit dialektik të këtyre dy postulateve. S'ka dyshim se të gjithë bartësit e këtij procesi ishin larg asaj që të dinë nse ku shkonin dhe ç'bënin. Mirëpo, po ashtu nuk mund të dyshohet se ata orvateshin *ta realizonin socialistin* duke e shkatërruar sistemin dhe duke vendosur marrëdhëniet të reja në prodhim. Garnitura në pushtet, sado që e tejkaluar nga ngjarjet, ishte lucide, e kuptoi situatën, gjë për të cilën dëshmon edhe projekti i tur-

pshëm i »revidimit të statuteve të »Partisë« i botuar në *Rude Pravo*, më 19 gusht 1968, i cili e ndalonte kumullimin e funksioneve publike në Parti dhe në Shtet.<sup>13</sup> Goditjen e parë, me çekan e cila duhej ta shkatërronte makinen, ishte e detyruar ta jepëte vëtë burokraci.

Përfundimi është i njohur: ky socializëm porsa kishte filluar te lindte kur e shoi kundërrevolucioni. Këtë c përsërit edhe *Pravda* dhe unë pajtohem plotesisht me gazetat sovjetike, përvç lidhur me një çështje të vogël të pikave themelore: forcat kundërrevolucionare nuk erdhën nga Perëndimi; nuk është imperializmi perendimor, së paku këtë herë, ai që e shtypi lëvizjen e demokratizimit dhe që e rivendosi me presion e dhunë sundimin e Sendit. Udhëheqësit e BRSS u tmerruan kur panë sesi filloj të lindte socializmi dhe i dërguan tanket në Pragë për ta mbetur. Sistemi u shpëtua në çastin e fundit, një ekip tjeter, shpejtazi i vendosur në pushtet, e vazhdoi ekzistencën e gjenjeshtës së institucionalizuar duke e përshëndetur publikisht intervenimin sovjetik. Asgjë nuk ka ndryshuar, përvç se socializmi i imponej, duke u bërë shtypës, është demaskuar: ligjërimi zyrtar dëgjohet brenda heshtjes së katërmëdhjetë milionë njerëzve të cilët nuk i besojnë mëasnje fjale të tij, ata nga kreu i pushtetit që e përsërisin atë ligjërim, janë po aq të vëtmuar sa edhe kolaboracionistët gjatë okupacionit gjerman, ata e dinë se rrejnë, se Sendi është armik i njeriut, por rrena i ka kapluar dhe nuk do t'i lëshojë më; ftesa që u është drejtuar qytetarëve për ta denoncuar njéri-tjetrin del nga vëtë logjika e sistemit: për ta vazhduar ekzistimin e vet ai kërkon që secili të dyshoje nga tjetri, të dyshoje në vete; mirépo mosbesimi në vete ka marrë fund; pas kongresit XX dhe agresionit të vitit 1968, nuk do të arrijnë më të shkaktojnë mosbesim në vete te çekët e sllovakët: mbetet mundësia që secilin, edhe përkundër dëshirës së vet, ta bëjnë një denoncues potencial, pra një të dyshimtë në sytë e vetes dhe në sytë e fqinjëve të vet. Me gjithë disa masa të kota të kujdesit, të pesë pushtuesit nuk u brengosën fort që ta fshehnin karakterin thjesht *konservator* të intervenimit të tyre. Borgjezia jonë perëndimore nuk u mashtrua lidhur me këtë: hyrja e tankeve në Pragë ia hoqi shqetësimet: pse, të mos i jepte fund një lufte të ftohtë dhe të lidhte me BRSS një Aleancë të Shenjtë e cila do ta mbante rendin gjithkund? Ja në ç'gjendje jemi: letrat janë mbi tavolinë; nuk ka mundësi më për të mashtruar.

<sup>13</sup> Ideja natyrisht nuk ishte e re. E as revizioniste. Ajo është e shtruar qartë në statutin e Partisë sovjetike. Mirépo, unë kam vëré në pah se për çfarë arsyaje ajo, në BRSS, asqë filloj ndonjëherë të realizohej. Ajo që është e rëndësishme, këtu, është vullneti për t'u këthyer në burime, për t'i dhënë jetë një parimi të harruar, për t'i kthyer rolin revolucionar PK.

Megjithatë, ne ende po mashtrohemë: e majta *proteston*, zemërohet, qorton apo »shpreh keqardhje«; *Le Monde* boton shpesh tekste të fryshtëzuara nga një hidhërim i virtytshëm e të përcjella nga një listë e gjatë me nënshkrime në të cilat gjenden çdoherë emra të njëjtë — imi, bie fjala. Le të nënshkruajmë! Le të nënshkruajmë pra! Çdo gjë tjetër është më e mirë se heshtja, e cila mund të merret si pranim. Me kusht që nga ky moralizëm të mos nxjerrim një alibi. Po natyrisht, nuk është fare e mirë ajo që e kanë bënë të Pestit atje! Po sikur ta dini t sa pak e çajnjë ata kokën pér këtë! Madje: sikur të brëngoseshin pér të majtën evropiane, ata më së shumti do të mund të dëshironin që ajo t'i bjere me këmbë tokës dhe t'u bërtasë: Ua! Derisa ne do të mbetemi në suaza të deontologjisë, sistemi përherë do të jetë i qetë: ata janë fajtorë, ata nuk kanë vepruar si socialistë? Kjo ka ndodhur ashtu, ngase ata kanë mundur ta bëjnë këtë: i bëjnë çështje vetëm ata e jo edhe regjimin. Mirëpo, nëse i lexojmë këto biseda dhe nëse përmes tyre e deshifrojmë përvojën çekosllovake, do ta kuptojmë shpejt se udhëheqësit sovjetikë të rekrutuar e të formuar nga sistemi, duke e ushtruar pushtetin në emër të Sendit, nuk mund të vepronin ndryshe nga ajo si vepruan. Duhet kritikuar regjimin, marrëdhëniet në prodhim të cilat e kanë ndërtuar atë dhe të cilat janë përforcuar e ngurtësuar në saje të veprimit të tij: pas muajit gusht të vitit 1968, duhet të braktiset, po ashtu, moralizmi si strehim dhe iluzionin reformist: makina nuk mund të riparohet, popujt duhet ta fusin në dore e ta hedhin poshtë. Forcat revolucionare të Perëndimit e kanë vetëm një mënyrë, sot, pér ta ndihmuar — në afat të gjatë por në mënyrë efikase — Çekosllovakinë; t'i dëgjojmë zërat që flasin pér të, të mbledhin dokumente, t'i rikonstruktojnë ngjarjet, të orvaten t'i analizojnë ato hollësish, përtej koniunkturës, si ngjarje që i shfaqin strukturat e shoqërisë sovjetike, ato të demokrative popullore dhe raportet e këtyre me ato, dhe ta shfrytëzojnë këtë analizë pér ta rimenduar, pa parasu-pozime e qëndrime të prera, të majtën evropiane, objektivat e saj, detyrat e saj, mundësítë e saj, tipet e ndryshme të organizmit të saj, me qëllim që të përgjigjet në pyetjen 'themelore të kësaj kohe: si të bashkohen, t'i shkatërrojnë strukturat e vjetra të gurezuar, çfarë strukturash të reja të prodhojë në mënyrë që revolucioni i ardhshëm të mos lindë një socializëm të tillë.

Parathënie pér librin *Tri breze* të Antoni Limit bo-toi Gallimard, Paris, 1970.

U përkthye nga *Situation IX*, Gallimard  
Paris, 1972.

Përktheu: Muhamedin Kullashi

**herbert  
markuze**

---

**ARTI NË  
SHOQËRINË  
NJËDIMENSIONALE**

**Q**e të prezantohem në njëfarë mënyrë, do të dëshiroja të them disa fjalë për atë sesi kam filluar ta ndiej të nevojshme të merrem me fenomenin e artit. Tërë kohën do ta përdor nacionin »art« në kuptim të përgjithshëm, që përfshin letërsinë, muzikën, dhe artet figurative. Analogjikisht me këtë »gjuha« (gjuha e artit, gjuha artistike), ka të bëjë me fotografinë, statujën, zërin dhe fjalën.

Ishte ky njëfarë dëshprimi ose situate e pashpresë. Dëshprim në të kuptuarit se gjuha, e gjithë gjuha e përditshme, veçmas ajo tradicionale disi dukej e vdekur. Më duket e paaftë të shprehë ngjarjet e sotme, arkaike dhe e vjetruar në krahasim me disa të mbërrime dhe me forcën e gjuhës artistike dhe poetike, veçanërisht në kontekstin e protestës kundër kësaj shoqërie, në mesin e rinisë së sotme të panënshtuar dhe kryengritëse. Kur pasqë demonstratat e tyre kundër luftës në Vietnam dhe kur merrja pjesë në to, kur i dëgjoja sesi këndonin këngët e Bob Dylanit, ndieja disi, por kjo është vështirë të definohet, se në të vërtetë kjo është gjuha e vetme revolucionare që na ka mbetur sot.

Mund të duket romantike dhe unë shpesh herë veten e qortoj se ndoshta jam tepër romantik në vlerësimin e fuqisë çliruese, radikale të artit. Më kujtohet deklarata e kahershme, e njohur, mbi kotësinë dhe ndoshta mbi krimin e artit, që thotë: Partenoni nuk e viente gjakun dhe lotët e një robi të vetëm grek. Ndoshta njësoj është e kote deklarata e kundërt se vetëm Partenoni ka arsyetur shoqërinë skllave. Pra, cili prej këtyre dy konstatimeve është i drejtë? Nëse shikoj civilizimin dhe kulturën

Në atë kuptim pikëpamja surrealistë, e tillë çfarë është zhvilluar në atë periudhë, ngre gjuhën poetike në atë shkallë ku kjo bëhet e vëtmja gjuhë e cila nuk i nënshtronhet gjuhës universale të regjimit, »metagjuhë« e negacionit të plotë e cila e transcedon madje edhe vetë aksionin revolucionar. Me fjalë të tjera arti mund të plotësojë rolin e tij imanent revolucionar, vetëm në qoftë se nuk bëhet pjesë e ndonjë regjimi, duke përfshire këtu edhe vetë rendin e vendosur revolucionar. Besoj se këtë në mënyrë më të qartë e tha Benjamin Përet, në deklaratën e tij të vitit 1943: »Sot nuk mund të pranohet se dikush është poet në qoftë se nuk e kundershton botën në të cilën jeton me jokonfornizëm të plotë. Ai u kundërvihet të gjithëve, duke përfshire edhe revolucionarët të cilët hyjnë vetëm në arenën politike, të cilën e ndajnë në atë mënyrë arbitrarisht nga tërësia e lëvizjes kulturore. Revolucionarët e tillë kështu e proklamojnë inferioritetin e kulturës ndaj revolucionit shoqëror«.

Për dallim nga këta surrealistët proklamojmë varësinë e revolucionit shoqëror nga e vërteta e imagjinatës poetike. Megjithëkëtë, kjo pikëpamje është jodialektike, aq sa e redukton në minimum shkallën deri te e cila vete gjuga poetike është infektuar dhe vërsuar nga dyfyrësia e mashtrimi; ajo gjuhë nuk mbetet e pastër. Ndërsa surrealizmi tani sa kohë është mall konsumimi që mund të shitet.

Arti megjithatë vazhdon, me gjith infektimin e robërimin. Gjuga e imagjinatës mbetet gjuhë kryeneçësie, fajësimi, proteste. Duke lexuar artikullin mbi »Betejën e fëmijëve« dhe Bob Dylanin, në revistën Remparts, kam hasur në këto vargje nga poezia e Artur O'Shaughnessyjeva. Në fillim nuk kisha ide kush është ky autor. Më thanë se është në të vërtetë poet i dobët dhe për habinë time, vërejtja se po ajo këngë hollësish shpie në librin e kaltërt të shoqërisë së Johan Birchit. Mua më pëlqejnë ato vargje dhe ky ndoshta tregon sesa pak di unë për artin. Mendoj se ato thonë diçka, madje me rëndesi dhe nuk turprohem t'jua përsëris.

*Një tjeri me një endërr  
do të ngarendë embël dhe kurorë do të marrë;  
tre të tjerë im me një këngë të re  
me forcë do t'ia pushtojnë mbretëritë.*

Përveç veçorive poetike të këtyre vargjeve (së pakut rimohen), ato thjesht janë të pavërteta, të pasakta, nga se janë betejë fëmijësh, që nga mesjeta, me kitarë apo pa të, gjithnjë kanë rënë nën goditjen e mbretërisë, në vend që të ndodhët e kundërtë, siç do të doshironin të thonin këto vargje.

Por, megjithëkëtë, këngët dhe meloditë nuk zhduken, artet nuk zhduken, duket se ato madje marrin frymë dhe rol të ri, respektivisht dëshirojnë që në mënyrë të vetëdijshme të jenë sistematikisht rrënuese, të papërkulura, antiart negativ absurd. Dhe sot në botën ku kuptimi dhe rendi, »pozitivja« duhet të imponohen me të gjitha mjetet e mundshme represive, artet vete marrin qëndrim politik, qëndrim protestues, mohimi, kundërshtimi.

Përbajtja politike e artit mund të dëshmohet si qëllim i tillë. Përbajtja poltikë e artit mund të dëshmohet me po atë qëllim, madje edhe atje ku në vend të formave të rrënimit, të mohimit dhe të pakuptimsise përtrejien format tradicionale, p.sh. në festimin e dashurisë së ligjshme e të lirisë në poezinë franceze të rezistencës — poezi të cilën Péret e injoroi. Duket se sot më shumë se kurdoherë në art po futen elemente të cilat zakonisht konsiderohen te jashtme e të huaja për të dhe se arti në vetvete, në sjelljen dhe në procesin e tij të brendshëm anon kah dimensioni politik, duke mos e lëshuar vte formën artistike. Në atë proces dinamik, dimensioi estetik gjithnjë me pak i ngjet pavarësisë, neutralitetit. Situata historike e artit ndryshon në këtë mënyrë që pastërtia, madje edhe mundësia e artit si art bëhet diskutabile. Artisti detyrohet të formosojë dhe të komunikojë të vërtetën, e cila duket se nuk është në pajtim me formën artistike e as që i përket asaj. Kam thënë se arti sot përgjigjet në krizën shoqërore. Nuk janë në rrezik vetëm aspektet dhe format e caktuara të rendit jetësor, por edhe rendi në tërësi, sikurse edhe shfaqja e nevojave kualitative te ndryshme dhe përbushja e qëllimeve të reja. Duket se lloji esencialisht i ri i qenies njerëzore, duhet të krijojë mesin teknik e natyror, kualitativisht të ri, për të mos vazhduar deri në pambarim epoka e barbarizmit të zhviluar dhe e mizorise.

Kjo do të thot se arti duhet të gjejë gjuhën dhe idetë të cilat mund ta komunikojë këtë domosdoshmëri si të veten. Përndryshe, si do të mund të paramendonim se ndonjëherë do të shfaqen marrëdhënie të reja midis njerëzve dhe sendeve, nëqoftëse njerëzit edhe më tutje krijojnë paraftyrime dhe flasin me gjuhën e shtypjes, të robërimit dhe të mistifikimit. Sistemi i ri i nevojave dhe qëllimeve i takon sferës së përjetimit të mundshëm. Atë mund ta definojmë përmes negacionit të rendit ekzistues respektivisht formës së jetës, sistemit të nevojave dhe të përbushjes së tyre, ku energjia shqisore, qetësuese e instikteve jetësore ngadhënjen mbi ato represive, të dhunshme dhe grabitçare.

Çfarë pra mund të jetë roli i artit në zhvillimin dhe në realizimin e idesë së një bote të tillë? Negacioni i qartë i realitetit ekzistues do të ishte bota »estetike«, në kuptim të dyfishtë që ka të bëjë edhe me sensibilitetin edhe me artin, përkatësisht aftësia për të pranuar mbresat e formës — formës së bukur e të këndshme, si mënyrë e mundshme e të ekzistuarit të njerëzve dhe të sendeve. Besoj se fotografia dhe realizimi imagjinativ i një bote të tillë është fundi i artit, se gjuha e artit flet në një botë të atillë të cilën kurrë nuk mund ta arrijë dhe se e drejta dhe e vërteta e artit kanë qenë të definuara e të vërtetuara në mënyrë ireale, pa prezencën e qëllimit imediat të artit. Me fjalë të tjera arti mund ta realizojë vveten vetëm nëse mbetet iluzor dhe nëse krijon iluzione. Por, sot, për herë të parë në histori, arti po ballafaqohet me mundësinë e mënyrave krejtësisht të reja te realizimit dhe pikërisht këtu, kujtoj, qëndron dome-thënia e situatës së sotme të artit, Pozita e artit në botë po ndryshon dhe sot arti po bëhet faktor potencial i kri-jimit të realitetit të ri. Krahas kësaj, arti do të duhej të abrogohej e të transpedohej në plotësimin e qëllimeve të veta.

Të shpjegoj atë që deshiroi të them, do të dëshiroja së pari të shqyrtoja se në ç'kuptim është arti aftësi njohëse me të vërtetën e vet dhe në ç'kuptim gjuha e artit e gjen të vërtetën e fshehur e të ndrydhur. Do të dëshiroja të konstatojë se arti në instancë të fundit flet me gjuhën e zbulimit.

Arti (në rend të parë, ndonëse jo edhe ekskluzivisht artet figurative), zbulon se ekzistonjë sendet, të cilat nuk janë pjesë të thjeshta te materies me të cilën manipulohet arbitrarisht, por »sendet në vete«, sende të cilat »dëshirojnë« diçka, të cilat durojnë, e të cilat vihen në dispozicion të domenit të formës, përkatësisht sende që janë në vete »të estetikshme«. Kështu arti gjen dhe liron fushën e formës shqisore, pëlqimin shqisor, përkundër perceptimit fiktiv, të shëmtuar e të paformë, i cili zmbraps të vërtetën dhe forcën e sensibilitetit, dimensionin shqisor si dimension erotik.

Po citoj fjalët e njërit nga »formalistët« e mëdhenj rusë, i cili në kohën e revolucionit bolshevik shkruante: »Arti ekziston që të fitohet ndieshmëria e jetës, që të ndihet objekti, që të përjetohet se guri në të vërtetë është gur. Qëllimi i artit është ndieshmëria e objektit si vizion e jo si objekt i njohur. Arti »e bën objektin unik«, mjegullon format e njohura dhe smadhon vësh-tirësinë dhe kohëzgjatjen e vrojtimit. Në art akti i vrojtimit është qëllim i vvetves dhe ai duhet të zgjatet. Arti është mjet përmes të cilit përjetohet zanafilla e objektit. Ajo tashmë ekziston nuk ka kurrfarë rëndësie për artin«.

Së këtejmi, procesi artistik është »çlirim i objektit nga automatizmi i vrojtimit« i cili shtrembëron dhe kufizon atë që sendet janë dhe që mund të jenë.

Prandaj, mund te themi se arti zbulon dhe krijon drejtpërdrejtshmëri të re, e cila shfaqet pasi të jetë shkatërruar e vjetra, kjo drejtpërdrejtshmëri arrihet në procesin e kujtimit: paraftyrimet, nocionet, idetë, të cilat kaherë janë »të njoitura«, në veprën artistike shfaqen dhe verifikohen në mënyrë shqisore.

Duket se arti si njojje dhe si kujtim, bukur shumë, varet nga forca estetike e qetësisë — qetësisë së figurës dhe të statujës, qetësisë që përshkon tragjedinë, qetësisë në të cilën ndihet muzika. Qetësia është medium i komunikimit, ndarje me të njojurin, qetësia jo vetëm në ndonjë vend apo në ndonjë kohë të caktuar për kontplacion, por si dimension i tërë që është prezent, por të cilin nuk e përdorim. Zhurma çdokund përcjell agresivitetin e organizuar. Erosi narcisoid, shkalla e parë e çdo energjie erotike dhe estetike, synon para së gjithash të arrijë qetësimin. Në atë qetësim shqisat mund të vërejnë e të dëgjojnë atë që zmbrapset në punët dhe defrimet e përditshme, atë ku vërtetë mund të shohim, të dëgjojmë dhe të ndiejmë atë çka jemi dhe çka janë sendet.

Konstatimet e përmendura ndoshta do të tregojnë se në çmasë dimensioni estetik është dimension potential i vetë realitetit, e jo vetëm dimension i artit që i është kundërvënë realitetit. Mund të themi gjithashtu se arti përpinqet të realizoje vetveten. Arti mbështetet në ndieshmëri: nevojat biologjike, në mënyrë instiktive sërisht dalin në shesh në forma artistike —ato bëhen të »objektivizuara« në formësimin e realitetit tjetër. »E estetikshmja« është kategori ekzistencionale dhe sociologjike dhe si e tillë nuk ka të bëjë me artin nga jashtë, por i takon artit si art.

Prej këtu, megjithatë, del pyetja: për ç'arsye përbajtja biologjike dhe ekzistenciale e të »estetikshmes« sublimohet në sferën joreale, fiktive te artit e jo në transformimin e realitetit? A ka të vërtetë ndoshta në konstatimin vulgar sipas të cilët, arti, si degë e veçantë e veprimtarisë krijuese, e ndarë nga prodhimi material i shoqërise, ka të bëjë me atë që Marks i quante »parahistori« të njerëzimit, përkatësisht histori të njeriut, para çlirimit të tij në shoqërinë e lirë? A mos ndoshta për këtë, dimensioni i tërësishëm i realitetit ka mbetur »imagjinar«, »iluzor«? Do ta vija veten në sprovë të shtroj pyetjen që ka të bëjë me këtë: A mos ndoshta, sot ka ardhur koha që arti të lirohet nga kufizimet e veta, në art të pastër, në halucinacion? A është koha që të njësohen dimensioni estetik dhe politik, në mënyrë që të përgatitet terreni, në mendime e vepër për transfor-

mimin e shoqërisë në vepër artistike? Dhe a është, ndoshta, historikisht e arsyeshme pikëpamja mbi »fundin e artit«? A nuk e tregojnë te mbërrimet e civilizimit teknologjik mundësinë e transformimit te artit në teknikë, të teknikës në art, në kuptim të plotë të eksperimentimit të kontrolluar me natyrën dhe shoqërinë, në mënyrë që t'i u epet forma estetike, përkatesisht forma e botës harmonike e të qetë?

Duhet të theksohet se »arti politik« është shprehje absurdë, sepse arti vetveti kurrë nuk do ta arrinte atë transformim, por do të mund të lironë të vërejturit dhe sensibilitetin për të cilët ka nveoje. Ndërsa kur do të ndodhë njëherë transformimi shoqëror, arti, forma e imagjinatës, do të mund të udhëhiqte ndërtimin e shoqërisë së re. Dhe për shkak se vlerat estetike janë vlera të jodhunës par excellence, arti si teknologji dhe teknikë do të inkorporonte racionalitetin e ri për krijimin e shoqërisë së lirë, përkatesisht për shfaqjen e mënyrave dhe të qellimeve të reja të vetë progresit teknik.

Këtu, ndërkaq, dëshiroj të tërheq vërejtjen lidhur me atë se çdo përpjekje për të shpjeguar kategoritë estetike, në relacion me aplikimin e tyre në shoqëri, krijimi i mijdisit shoqëror, pothuaj patjetër sjell ndërmend mashtrimin e fushatës për zbukurim apo llahtarit e realizimit sovjetik. Duhet të rikujtojë se realizimi i artit si parim i përtierirjes shoqërore nënkupton ndryshimin shoqëror radikal. Nuk është fjala për zbukurimin e asaj që është, por për riorientimin e plotë të jetës në shoqërinë e re.

Në këtë kontekst kam bërë fjale për aftësinë njoëse të artit që shpreh dhe komunikon mënyrën e caktuar të vrojtimit, të të kuptuarit, madje të shkencës, për aratin i cili paralajmëron të vërtetëtë specifike, e cila aplikohet në realitet. Me fjale të tjera përsëri kam përdorur frazën e njobur vulgare mbi gjasimin e së vërtetës dhe të artit. Ç'kuptim ka definimi tradicional i artit, përmes së bukurës, kur pjesa aq e madhe e arteve, madje e arteve të mëdha, sheshazi nuk janë të bukura në asnje kuptim? A nuk është ndoshta, përgatitja e shpirtit për të vërtetën, vetë e bukura, apo ngashjmëria midis së vërtetës dhe artit duhet të jetë përputhje midis sensibilitetit dhe të të kuptuarit, shqisores dhe racionales? Ndërkëq, atëherë na kujtohet se sensualiteti dhe arësyja, ndjeshjmëria për të bukurën dhe dija, janë të kundertë. Njohja e së vërtetës në të shumtën e rasteve është e dhe mbshme dhe e shëmtuar dhe për këtë arsy e vërteta mund të quhet e bukur vetëm në kuptimin krejtësisht jondijor, si p.sh., kur flitet për bukurinë e zgjidhjes matematikore. Apo ndoshta bukuria duhet të jetë medium shqisor i së vërtetës, e cila përndryshtë është e pakryer,

përkatësisht përputhje midis njeriut dhe natyrës, materies dhe frysës, lirisë dhe kënaqësisë, që do të ishte vërtet fundi i parahistorisë së njeriut.

Hegeli në filozofinë e tij të artit, paramendon gjenden e botës ku natyra inorganike dhe organike, sendet dhe njerëzit bashkëveprojnë në organizmin racional të jetës, ku agresioni ka gjetur qetësim në përputhjen midis së përgjithshmes dhe të veçantës. A nuk është ky, gjithashtu, vizion i shoqërisë si vepër artistike, realizim historik i artit? Përcepcioni i këtillë i artit si ecuri në të krijuar apo udhëheqje duke krijuar shoqërinë, kërkon veprim të ndërsjellë të shkencës, të teknikës dhe të imaginatës, në mënyrë që të formohet dhe të mbahet sistemi i ri jetësor. Kjo është teknika si art, ndërtimi i së bukurës, jo si objekte apo vende të bukura, por si forma të tërësishme të jetës-shoqërisë dhe natyrës. E bukura si formë e një tërësie të tillë, kurrë nuk mund të jetë natyrore, e drejtpërdrejtë, por atë në kuptimin më rigozoz të fjalës e sajnjë dhe e transmetojnë arsyja dhe imagjinata. Për këtë ajo është rezultat i teknikës, por i asaj tekniqe që është e kundërtë e teknologjisë dhe e teknikës, të cilat sot zoterojnë me shoqëritë represive, përkatësisht, e teknikës e cila është çliruar nga forca shkatërruese që njerëzit dhe sendet, frysët dhe materien i përjeton si objekt të thjeshtë copëtimi, bashkimi, riformësimi dhe shpenzimi. Në vend të kësaj, arti-teknika, do t'i çlirojë potencialet e materies që mbrojnë dhe forcojnë jetën, ndërsa me të do të drejtojë parimi i realitetit, i cili në përmasa shoqërore ka nënshtruar energjinë dhunuese, energjinë e instikteve jetësore. Cila veti e së bukurës në përgjithësi mund t'i rezistojë forcës së agresionit instiktiv dhe të zhvillojë sensibilitetin erotik? Duket se e bukura është në gjysmë të rrugës midis qëllimeve të pasublimuara dhe të sublimuara. Ajo nuk i takon impulsit të pasublimuar, por është shprehje shqisore e joshqisores. Ky është, mendoj, definicioni tradicional i së bukurës përmes formës.

Çka arrin në të vërtetë forma? Ajo lidh dhe sjell rregullsi, në mënyrë që ta përfundojë. Ky është fund në kuptimin tekstuall, ngase përcaktohen koordinata të qarta brenda të cilave fuqia e materies qetësohet në kufijtë e përsosmërisë dhe të përbartimit. Materia e formësuar ashtu mund të jetë organike ose inorganike, forma e ftyrës, e jetës, forma e gurit, e tryezës, por gjithashtu edhe forma e veprës artistike. Forma e tillë është e bukur, ngase inkorporon qetësimin e dhunës, të kaosit dhe të forcës. Forma e tillë është rend, madje edhe mbrapsje, por në shërbim të sensibilitetit dhe të haresë.

Në qoftë se, pra, forma në këtë kuptim ka rëndësi për artin dhe nëse e bukura është element me rëndësi i formës në art, do të delte se arti në vetë strukturën e

tij është iluzor, mashtrues dhe vetëvrasës. Arti është iluzor, ngase e paraqet si ekzistues atë që nuk është. Andaj kënaq, siguron kënaqësi surrogate në realitetin e mjetë. Paraftyrimi banal i kënaqësisë surrogate përmban më shumë se kokërrzën e zbrazët të së vërtetës. Këtu nuk flitet për shpirtin e artistit. Kujtoj se vete struktura e artit është përfaqësuese dhe ajo ka formësuar reportin e artit ndaj marrësit, konsumuesit. Pikerisht veprat më autentike dëshmojnë atë përfaqësim objektiv të artit. Arti i madh mund ta robërojë të dhembjen, tmerrin, tërë pikëllimin e vërtetë — të gjitha këto bëhen të bukura dhe mund të sjellin kënaqësi përmes formës artistike. Vetëm në këtë transformim arti mban në jetë dhembjen, lëmérinë dhe pikëllimin, i mban në jetë si të bukura dhe të mjaftueshme për përjetësinë. Kështu katarza, spastrimi vërtet ndodh në artin i cili qetëson pezmin e revoltës dhe të ankesës dhe që negativen e shndërron në afirmative. Aftësia magjike e artistit qetëson tmerrimin dhe gjëzimin dhe e kthen dhembjen në pëlqim e défrim, ndërsa çastin e përkohshëm, në vlerë të përmotshme, të depozituar në thesarin e madh të kulturës që futet nën tokë në kohë lufte, ndërsa del në sipërfaqe në çastin kur mbaron masakri. Arti nuk bën pa atë transformim dhe afirmim. Ai nuk mund ta shkatërrojë katarzën magjike të formës, nuk mund të sublimoje tmerrin e gjëzimin. Fotografia e cila nuk paraqet asgjë ose paraqet vetëm pjesë të diçkafës, ende është fotografi e pakufizuar, edhe pse nuk ka kornizë, mall potencial për treg. As desublimimi këtu nuk do të ndihmonte. Desublimimi i tillë në art do të mund ta heqte dallimin midis metagjuhës së artit dhe gjuhës së zakonshme. Ai mund të depërtojë deri te ndodhitë në dhomën e fjetjes e në banjo dhe me këtë mund të krenohet, ndërkëq, ngurosja përcjellëse kaherë është zbehur dhe gjithashtu është kaparuar dhe kapërdire. Në këtë ose atë mënyrë, në caktimin e pozicioneve, në rimë, në kontrabandën e elementeve transcendentë të së bukurës, forma artistike dëshmohet dhe mohon negacionin. Duket se arti është e thënë të mbetet art, kulturë në botën e tmerrit. Antiarti më i shfrenuar edhe më tutje ndeshet me detyrën e pamundur për të zbuluar, formësuar tmerrin. Më duket se koka e meduzes është simbol adekuat dhe i përhershëm i artit — i tmerrit si bukuri, tmerrit të kapur në formë të këndshme të objektit madhështor.

A është sot tjetëfare pozita e artit? A e ka humbur arti forcën e krijimit të kokës së meduzës e të ballafaqimit me të? Me fjalë të tjera, a e ka humbur ende fuqinë e të ballafaquarit me vvetveten? Dikush ka thënë se pas Oswiecimit është e pamundur të shkruhet poezi. Madhësia e tmerrit sot shtrihet në të gjitha format, madje edhe në ato të paformë.

Ndërkaq, pyes, a e ka penguar ndonjëherë tmerri real krijimin e artit? Skulptura greke dhe artitektura qetësish kanë jetuar së bashku me tmerrin e shoqërisë skllavopronare.

Romanet e mëdha të dashurisë dhe ato aventuristike nga mesjeta janë shfaqur në kohën e krimeve të Albizhanëve dhe të torturave të inkuizitorëve, ndërsa pejzazhet prehëse të impresionistëve kanë bashkëjetuar me realitetin të cilin Zola e paraqiti në »Zherminalin«.

Në qoftë se kjo është e vërtetë, në qoftë se madhësia e tmerrit sot nuk e spjegon këtësinë e artit, a është karakteri totalitar njëdimensional i shoqërisë sone përgjegjës për këtë gjendje të re të artit? Edhe në këtë duhet dyshuar. Elementet e formës artistike gjithnjë kanë qenë edhe elemente të realitetit ekzistues. Ngjyrërat e piktureve dhe materialet e skulptureve janë elemente të botës së përbashkët. Përse sot artisti duket i pafuqishëm të gjejë formën e transformimit e të ndërrimit, në realitetin e shëmtuar dhe shkatërrues?

Përsëri duhet ta drejtojmë vëmendjen në karakterin historik të artit. Arti si i tillë, jo vetëm në stilet dhe në format e tij të nduarnduarshme, është dukuri historike. Sot ndoshta arti e zë historinë dhe historia artin. Ndryshojnë pozita historike dhe roli i artit. Objektivja, realja bëhet fushë e ardhshme e artit, ndërsa arti bëhet teknikë në kuptimin tekstual »praktik« të fjalës — ndrejtje sendesh, e jo fotografim i fotografisë, eksperimentim me potencialin e fjalëve dhe të tingujve, jo shkruarje poezish ose kompozim këngësh. A paralajmërojnë ndoshta këto krijime mundësinë që forma artistike të bëhet »parim i realitetit« — proces në të cilin arti e transcedon veten, në bazë të të mbërrimeve të shkencës dhe të teknologjisë? Në qoftë se mund të bëjmë gjithçka me natyrën dhe me shoqërinë, me njeriun dhe me sendet, pse ato nuk do t'i bënim subjekt objekt në botën e qetësuar, në mesin estetik të padhunë? Për krijimin e një mesi të këtillë natyror dhe shoqëror, ekziston mënyra, ekzistojnë mjetet dhe materiali ku instinktet jetësore të pasublimuara do të ndryshojnë drejtimin e zhvillimit të nevojave dhe të aftësive njerëzore, do të ndryshonin drejtimin e progresit teknik. Ekzistojnë parakushtet që të sajohet e bukura, jo si stoli, jo si sipërfaqe e së shëmtuares, jo si eksponate muzeore, por si shprehje dhe qëllim i njeriut të ri — si nevojë biologjike në sistemin e ri jetësor. Ndërsa në këtë ndrvshim të mundshëm të pozitës dhe rolit të artit, arti që transcendent vetyvet, do të bëhej faktor në përtërirjen e natyrës dhe të shoqërisë, të polosit, do të bëhej faktor politik — jo art politik, jo politikë si art, por art si arkitekturë e shoqërisë së lirë.

Përkundër kësaj mundësie teknike të shoqërisë së lirë, sistemet shoqërore represive, vejnë në lëvizje, në mprojtje të tyre agresivitetin në përmasa të papara. Fuga e tyre e madhe dhe produktiviteti mbyllin rruget që shpien kah çlirimi dhe kah realizimi i artit.

Situata e tashme në art, për mendimin tim, në mënyrën më të qartë është shprehur në konstatimin e Tomas Manit se duhet ta revokojmë simfoninë e dhjetë. Duhet ta revokojmë jo vetëm pse është e gabuar dhe e rreme (nuk mundemi dhe nuk bën të këndojmë odën e gëzimit, madje as si premtim), por për arsyen se ekziston dhe se është e vërtetë në vetvete. Ajo qëndron në botën tonë si arsyetim i »fikcionit«, i cili më nuk mund të arsyetohet.

Ndërkaq, revokimi i veprës artistike do të ishte ve-për e re artistike. Mendoj se Stockhausen gjithsa është e mundur ka bërë revokimin e simfonisë së nëntë. E nëse revokimi i artit të madh nga e kaluara mund të jetë vetëm edhe një vepër artistike, atëherë aty kemi të bëjmë me procesin artistik, ku një formë transformohet në tjetrën, një stil në tjetrin, një fiksion në tjetrin. Por, ndoshta, megjithatë ndodh diçka reale në atë proces. Nëse zhvillimi i vetëdijes dhe i momentit të pavetëdijeshëm na mundeson t'i shohim gjërat që nuk i shohim, ose të cilat nuk bën t'i shohim, të flasim ose dëgjojmë gjuhën që nuk e flasim dhe nuk e dëgjojmë — mandej nëse ai zhvillim sot ndikon në vetë formën artistike — atëherë arti, me gjithë afirmacionin e vet, do të ndikojë si pjesë e forcës çlirimtare në çlirimin e vetëdijes së gjymtuar e të pavetëdijes së gjymtuar, të cilat përforcojnë, përndryshe, sistemin represiv. Mendoj se arti sot e ushton këtë detyrë më me vetëdije sesa më parë. Tjetra nuk varet nga artisti. Realizimi, ndërrimi i njëmendët, që do të çlironte njerëzit dhe sendet, mbetet detyrë e aksionit politik. Artisti aty nuk merr pjesë si artist. Por kjo veprimtari e jashtme sot ndoshta është e lidhur me pozitën e artit — dhe ndoshta, madje me arritjet e artit.

Përktheu: Kadri Metaj  
(Nga »Estetska dimenzija«, »Školska knjiga,  
Zagreb 1981)



---

HULUMTIME  
ISTRAŽIVANJA



**fehmi  
agani**

---

**BUROKRACIA,  
MARKSI  
E VEBERI**

I

*Nga historia e mendimit sociologjik e politik*

Fenomeni i burokracisë s'është i ri. Egjipti i kohës së Perandorise së Re, monarkia e Dioklecianit, shteti bizantin e kisha katolike përmenden si shembuj të shqërive me burokraci të zhvilluar. Weberi, madje, Perandorinë e Re në Egjipt e quan »model historik« për të gjitha burokratitë e mëvonshme. As shtetet e centralizuarë mësjetare, monarkitë e mëdha, nuk do të mund të funksiononin pa një burokraci të caktuar. Megjithëkëtë, jo vetëm termi 'burokraci', i cili mirëfilli dhe tek-stualisht do të thotë 'sundim i zyrës' dhe supozohet të ketë lindur, ose, më mirë, të jetë përdorur për herë të parë më 1745 nga fiziokrati *V. de Gurne*, por edhe burokracia, në kuptim dhe dimensione bashkëkohore, si element dhe faktor i rëndësishëm strukturor shoqëror e politik, me peshë, degezim e shtrirje, me rëndësi e domethënies të sotme është produkt i këtyre shekujve të fundit. Mund të thuhet se shekulli XIX dhe ky yni janë pëkërisht shekuj të përhapjes dhe të fuqizimit të burokracisë, të organizimit burokratik dhe të raporteve burokratike.

Ndër faktoret e shumtë dhe kompleksë që e kushtëzojnë këtë përhapje dhe fuqizim të burokracisë, në radhë të parë mund të përmenden zhvillimi i përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror, kompleksia gjithnjë më e madhe strukturelle dhe funksionale e shoqërisë, zhvillimi i ndarjes së punës dhe i strukturimit të ekonomisë kapitaliste, fuqizimi i shtetit, që është djepi dhe

trolli i vërtetë i organizatës burokratike, degëzimi dhe përhapja enorme e pushtetit shtetor, e kompetencave dhe e ndërhyrjeve të tij, lindja e organizatave dhe e institucioneve të mëdha e komplekse si janë partitë politike, ushtritë moderne etj. Për një shoqëri të zhvilluar dhe komplekse si e sotmja, përfunksionimin e saj në kushte të një heterogeniteti e të kontradiktave të shumta e të thella shoqërore-klasore, ekonomike, politike e të tjera, burokracia dhe organizimi burokratik duken të domosdoshëm.

Edhe zanafilla e teorive për burokracinë është e vjetër. Mendime të para për pushtetin shtetor, për organizimin dhe funksionimin e tij, gjemë te Platonit dhe Aristoteli. Por teoritë për burokracinë, si përpjekje për një studim të thelluar, sistematik e të gjithanshëm të këtij fenomeni janë, po kështu, të këtyre dy shekuve të fundit.

Teoria e parë e burokracisë, që shënon fillimin e teorive moderne për këtë fenomen është teoria e Hegelit, e cila e trajton burokracinë si »frymë të shtetit« e ndërmjetëse midis pushtetit dhe shoqërisë civile. Përgjithsisht, filozofia politike e Hegelit ishte një sintezë enciklopedike e mendimit politik qytetar, që ushtroi ndikim të fuqishëm në të gjitha teoritë politike të mëvonshme. »S'kishte asnjë sistem të madh politik-shkruan E. Kazirer — që t'i rezistonte ndikimit të tij. Të gjitha ideologjite tona bashkëkohore e dëshmojnë forcën dhe qëndrueshmërinë e parimeve, të cilat përfundojnë të parë u shfaqen dhe u mbrojtën në filozofinë e të drejtës dhe në filozofinë e historisë të Hegelit.«<sup>1</sup>) Filozofia politike e Hegelit, e në kuadër të saj edhe filozofia e tij e shtetit, është pjesë përbërëse e sistemit të idealizmit absolut. Fryma universale, në zhvillimin e saj dialektik, duke pasur përfundim qëllim realizimin e lirisë, në fushën e historisë arrin formën e saj më të lartë në shtetin, i cili, si realizim i kësaj fryme, shënon shkallën më të lartë të zhvillimit përgjithësisht. Ideja e lirisë, që është synimi themelor i frymës absolute, mund të realizohet vetëm në shtet dhe nga shteti, prandaj shteti është mendësia më e lartë, qëllimi i fundit i zhvillimit të frymës absolute. Dhe ky shtet s'do të mund të realizonte këtë funksion të lartë pa burokracinë. Për Hegelin shteti është »personifikim i interesit të përgjithshëm, brenda të cilit të gjitha interesat e veçanta i nënshtronë sistemit ligjor. Forma profane e këtij parimi më të lartë është pikërisht burokracia, pa të cilën shteti s'do të mund t'i realizonte qëllimet e veta«.<sup>2</sup>)

<sup>1</sup> Ernest Kazirer, *Miti mbi shtetin*, Beograd, f. 247. svetu», 7—8 / 1979, f. 313.

<sup>2</sup> Mino Vianello, *Organizata dhe ideologjia*, »Marksizam u svetu», 7—8/1979, f. 313.

Teoria e këtillë politike, konceptioni i tillë për shtetin është jo vetëm idealist, por apologjist, madje do të mund të thuhej reaksionar, është një mistifikim dhe absolutizim i së dhënës, racionalizim i së ekzistuarës. Dhe me të drejtë u tha se teoria e shtetit e Hegelit lindi »jo në kopshtet e shkencës, por në plehërishtën e servilitetit«.<sup>3</sup> Megjithëkëtë, gjenialiteti i tij, thellësia dhe depërtimi dialektik bënë që teoritë politike të mëvonshme, madje edhe më të mëdhatë prej tyre, të lindin e të zhvillohen pikërisht në dialog dhe në konfrontim me të.

Nga mesi i shekullit XIX për problemin e burokracisë interesohen mendimtarë liberalë si Tokvili, Xhon Stjuart Milli, Speseri e të tjerrë dhe, nga një tjetër aspekt e në kuadër të koncepcioneve anarkiste edhe Shtirneri, Bakunjini, Prudoni.

Po nga mesi dhe në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në konfrontim me Hegelin, për të cilin burokacia si shtresë e përgjithshme është bartëse e interesit të përgjithshëm dhe si ndërmjetëse midis politikës dhe popullit, luan një rol pozitiv dhe racional, si tejkalim i kësaj dhe i pikëpamjeve të tjera dhe si përgjithësim i përvojave dhe i njojurive të reja, në kuadër të një konceptioni të ri të përgjithshëm teorik dhe metodologjik, që shënon një transformim revolucionar në pikëpamjet dhe njojuritë e përgjithshme për shoqërinë e politikën, në lidhje të ngushtë me teorinë mbi luftën klasore, mbi shtetin, karakterin, karakteristikat, funksionin e tij, lind edhe teoria e re marksiste mbi qenien, thelbin, format e shfaqjes, funksionin, vendin dhe rolin shoqëror dhe karakteristikat sociale-psikologjike të burokracisë, me theksim të qarri të karakterit negativ dhe opresiv të burokracisë dhe të funksionit të saj prej vegle në duar të klasës sunduese.

Në deceniet e para të shekullit tonë lind edhe një teori e madhe për burokracinë, teoria e Veberit, me pretendime që në trajtë të një tipi ideal të shpjegojë në vija të përgjithshme burokracinë, format historike të shfaqjes së saj, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të organizatës burokratike, psikologjinë e burokracisë, ndikimit e saj në jetën shoqërore, në ekonomi dhe në politikë, domethënien e saj për marrëdhëniet njerëzore dhe për njeriun e përfatin e tij.

Përveç këtyre teorive të mëdha të burokracisë të Marksit dhe të Veberit, të njoitura e të pranuara si të këtilla nga ihtarët dhe kundershtarët e tyre, në këtë shekull lindën edhe shumë pikëpamje e konceptione të tjera. Moska e Pareto, Ostrogorski e Robert Mihelsi zhvi-

<sup>3</sup> Cituar sipas: E. Kazirer, *Vepra e cituar*, f. 249.

lluan teoritë e tyre të klasës politike dhe të oligarkizmit dhe të burokratizimit të partive politike.<sup>4</sup> Autore të tjerë (Trelçi etj.) paraqiten procesin e burokratizimit në organizatat fetare.

Zhvillimi shoqëror i fillimit të këtij shekulli që karakterizohet nga lindja e imperializmit, ashpërsimi i kontradiktave klasore dhe i antagonizmave shoqërore e i marrëdhënieve ndërkombe, nga Lufta Botërore e Revolucioni i Tetorit dhe lindja e vendit të parë socialist, shtruan nevojën e rishqyrtimit të pozitës dhe të rolit shoqëror të burokracisë, të aspekteve të reja të kushtëzimit, të ekzistimit dhe të funksionimit të saj. Dhe lindëni pikëpamje e koncepcione të reja për burokracinë, të cilat në thelb nuk shënojnë ndonjë ngritje cilësore të njohurive për këtë fenomen shoqëror e politik. Kur është fjala për pikëpamjet mbi mundësitë, trajtat dhe rrezikun e burokratizimit në socializëm, pikëpamje ndër të cilat shquhen mendimet e Leninit, të Roza Luksemburgut<sup>5</sup> etj., është karakteristike dhe meriton të theksohet fakti që diskutimet për burokracinë dhe burokratizimin ishin të gjalla e jashtezakonisht të frytshme pikërisht në ditët e revolucionit dhe fill pas tij. Përkundrazi, më vonë, kur burokratizimi u bë rrezik i vërtetë dhe kur dominonte në raportet shoqërore e politike, u shua mendimi për burokracinë, nuk lindi ndonjë teori me vlerë për të, as në Bashkimin Sovjetik as në vendet e tjera socialiste, kurse mbështetja në klasikët, përmendja dhe përsëritja e mendimit të tyre, të shumtën bëhet në trajtë frazash konvencionale pa brendi e domethënies reale. Ose, kritika e burokracisë bëhet për mosefikasitetin e saj, shikuar nga aspekti i organizatës burokratike dhe i interesave, i synimeve dhe i efikasitetit që e kërkon ajo. Prandaj, burokracia shihet vetëm si administrizëm, si humbje në shkresurina, ndonëse këto janë një aspekt, por jo kryesor, i fenomenit të burokracisë. Kjo ngushti dhe ky reduktim i fenomenit të burokracisë sikur të donte të dëshmonte mendimin që shpreh Marks, përkundër iluzionit të Hegelit se qytetarët janë të mbrojtur nga shpërdorimet burokratike në saje të kierarkisë së burokracisë, të kontrollit të instancave të ulëta nga të lartat. Por, thotë Marks, »hierarkia ndëshkon funksionarin kur ai mëkaton kundër hierarkisë ose kur bën një mëkat, për të cilin hierarkia nuk ka nevojë, por ajo e merr atë nën mbrojtje sa herë që vetë hierarkia mëkaton nëpërmjet tij«.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Shih punimet: »Teoritë shoqërore të elitarizmit«, »Thema«, 1–2 / 85 dhe »Teoria e oligarkisë e Robert Mihelsit«, »Thema« 4(3) / 85.

<sup>5</sup> Mund të shihet punimi: »Roza Luksemburgu dhe Revolucioni i Tetorit«, Përparimi, 1–2 / 1964.

<sup>6</sup> K. Marks, Reth kritikës së filozofisë hegeliane të së drejtës, Tirane 1979, f. 103.

Ndryshimet në format e organizimit, të pronësise etj., në kapitalizmin bashkëkohor, lidhur me krizën e përgjithshme të tij, u dhanë shkas disa pikëpamjeve të reja për burokracinë, si është pikëpamja e Bernemit mbi »revolucionin menaxherial«, të cilat u shfaqën me mjaft pompë e pretendim, por pa ndonjë rezultat të qëndrueshëm e më vlerë.

Koncepcioni dhe teori të shumta u shfaqën edhe pas Luftës së Dytë Botërore për burokracinë dhe format e ndryshme të ekzistimit e të funksionimit të saj, për aspekte të ndryshme të marrëdhënieve burokratike. Pati dhe ka nga këto koncepcione e teori edhe studime e depërtime të sukseshme në ndriçimin dhe në të kuptuarit e këtij fenomeni kompleks e shumëdimensional, të vjetër dhe njëkohësisht të ri. Të përmendim vetëm Rajt Milsin dhe studimin e tij mbi elitën amerikane. Por ka edhe mjaft përshkrime të cekëta të fenomenit të burokracisë, përsëritje të reduktuara të teorive të përparshme dhe »zbulime« të të diturave. Dhe, është karakteristikë e gati të gjitha teorive të reja që janë parçiale, janë përpjekje për studim të formave të veçanta të burokracisë, të aspekteve të veçanta të saj, pa pretendime për një shpjegim të përgjithshëm e të thelluar të burokracisë.

Një kontribut të rëndësishëm për teorinë e burokracisë, veçanërisht për ndriçimin e këtij fenomeni, të kushtëzimit e të formave të manifestimit të tij në socializëm si dhe për mundësitet e përballimit të burokratizmit e dha mendimi sociologjik e politik jugosllav, që nga Programi i LKJ e deri te vepra e Kardelit. Por edhe këtu vërehet kohëve të fundit një ngecje dhe rënie e dukshme, një margjinalizim i temës së burokracisë, ndonjë studimi i forcës rezistuese dhe përshtatëse të burokracisë edhe në kushte të vetëqeverisjes, i mundësive të deformimit burokratik të vetëqeverisjes do të ishte me vlerë të madhe teorike dhe një ndihmë e rëndësishme për tejkalimin e ngecjeve e të vështirësive të zhvillimit të sotëm shoqëror. Dhe do të ishte një përgjigje për euforinë djathtiste dhe etatiste, unitariste që po ofrohet sot me agresivitet si zgjidhje e vetme e problemeve të këtij vendi e të kësaj shoqërie.

## II

Ekzistojnë mendime dhe vlerësimë të ndryshme të pikëpamjes dhe të teorisë së Marksit për burokracinë e burokratizmin. Nuk janë të rralla reduktimet, minimizimet e edhe injorimet ose nënvlerësimet e saj. Norberto Bobio, për shembull, teorinë e Marksit për burokracinë e redukton në »disa fraza të nxjerra nga veprat e para të Marksit të ri, të cilat ai ua kishte lënë brej-

tësve (minjve) të librit« dhe habitet sesi këto faqe, »padyshim të rrepta dhe aktuale«, mund të ngrihen në shkallë të një teorie »të saktë e të vërtetë« të burokracisë.<sup>7</sup> Ai e mohon të jetë kjo teori e lidhur dhe e mbështetur në teorinë marksiste të shtetit, sepse një teori e këtillë nuk ekziston. Problemi kryesor i çdo teorie politike është se *kush* (njëri, disa, shumica) dhe *si* sundon, thotë Bobio. Marksii dhe Lenini ishin të interesuar, në radhë të parë, për subjektin e sundimit dhe jo për mënyrën e sundimit, që është problem i institucioneve. Prandaj, konkludon ai, teoria e tyre e shtetit është jo e plotë, »teori e vërtetë dhe adekuat marksiste e shtetit nuk ekziston«.<sup>8</sup> Kjo, sipas tij, do të mund të thuhet edhe për teorinë marksiste për burokracinë. R. Nisbeti, duke e përqëndruar kritikën në pikëpamjen e Marksit mbi shuarjen e shtetit, pohon se në konцепцион e Marksit për shtetin dhe për burokracinë gërshtohen »mendimi analistik me shpresën mesiane«, se Marksii pak çante kokën për mundësinë që socializmi të ketë probleme të veta me burokracinë, sepse mendonte që posa të shembej kapitalizmi, do të shuheshin shteti dhe tjetërsimi i politikës. Këtu, në këtë konцепcion, thotë Nisbeti, duhet të kërkohet arsyja përfje edhe sot, në shtet dhe në lëvizjet socialiste (marksiste) mbizotëron të thuash, një indiferencë totale për problemet e burokracisë, të centralizimit e të mekanizmit politik, që janë »preokupimi qendor« i mendimit liberal i këtij shkulli.<sup>9</sup>

Por, sado të duken pjesërisht të arsveshme këto vërejtje dhc sado të mund të përmenden edhe mungesa, jo të pakta e të parëndësishme, të këtij koncepçioni, prapë teoria e Marksit e burokracisë, për nga thellësia e depërtimit në thelbin e këtij fenomeni, për nga të kupuarit e kushtëzimit, të karakterit e të funksionit shoqëror të burokracisë, të qenies së saj, të implikacioneve shoqërore e politike të burokratizimit të marrëdhënieve shoqërore, të natyrës, të karakterit dhe të cilësive psikologjiko-sociale të qëndrimit, të sjelljes, të mentalitetit e të veprimit burokratik, më në fund për nga fundamentimi jo vetëm shoqëror-politik, por edhe teoriko-njohës e metodologjik, për nga inkadrimi i saj në një koncepçion të përgjithshëm sociologjiko-politikologjik dhe për nga lidhja e saj me teoritë si janë ato të klasës dhe të luftës klasore, të shtetit, të politikës dhe të tjetërsimit të saj në kushte të caktuara etj., është

<sup>7</sup> N. Bobbio, *A ekziston doktrina marksiste mbi shtetin, »Marksizam u svetu«* 7–8 / 1976, f. 248 dhe 251.

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> R. A. Nisbeth, *»The sociological tradition«*, London 1971, fq. 139.

*teori qendrore* në kuadër të koncepcioneve të sotme përkëtë fenomen. Dhe do të mund të thuhej se pa këtë teori, e cila ka depërtuar fuqishëm edhe në konceptcionet e tjera, nuk ka shpjegim të kënaqshëm sociologjiko-politik të fenomenit të burokracisë.

Mirëfilli konceptionin e vet të burokracisë Marksie zhvillon — në formë dhe në sferë bukur abstrakte — në konfrontim me mendimin e Hegelit. Më vonë, në *Luftat klasore* dhe në *Tetëmbëdhjetë brymierin*, në letërkëmbim, në *Luftën civile*, në *Kapital* e në vepra të tjera, ku trajton edhe problemin e burokracisë, pikëpamja e Marksit shfaqet më e formuar dhe e konkretizuar, ndonjëse edhe në veprat e para është e thellë dhe inventive.

Në *Kritiken e filozofisë hegeliane të së drejtës*, Marks konfrontohet me pikëpamjet e Hegelit mbi shtetin dhe të drejtën dhe parimit monarkist të Hegelit i kundërvë parimet demokratike e humaniste, sikurse ngrihet edhe kundër vlerësimit që i bën Hegeli burokracisë e funksionit të saj.

Për Hegelin, shoqëria civile ishte fushë e betejës së interesave private, individuale, »e luftës së të gjithëve kundër të gjithëve«, por edhe fushë e ndeshjes së interesave private me »punët e vecanta shoqërore« dhe e ndeshjes së këtyre të dyjave me interesin e përgjithshëm, të mishëruar në shtetin. Shteti shpreh interesin e përgjithshëm, ai përbën »të përgjithshmen që ekziston në vetvete dhe përvete«, kurse për interesat e vecanta përkujdesen *korporatat* e komuneve, të zejeve, të rendeve. Unifikimin e këtyre sferave, realizimin e interesit të përgjithshëm e bën pushteti qeveritar, bashkë me pushtetin gjyqësor e policor, të cilët kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me të vecanten, me shoqërinë civile.<sup>10</sup>

Marks dialekticien pëlqen përcaktimin e shoqërisë civile nga Hegeli si një *bellum omnium contra omnes* dhe mbi të gjitha, thekson si esencial faktin që »Hegeli niset nga ndarja midis „shtetit“ dhe „shoqërisë civile“, midis „interesave të vecanta“ dhe „së përgjithshmes që ekziston në vetvete e përvete“ dhe, në të vërtetë, burokacia mbështetet në këtë ndarje«.<sup>11</sup> Duke e lidhur fenomenin e burokracisë »me karakterin themelor të epokës borgjeze (qytetare) domethënë me kunderthënien në mes të përgjithshmes abstrakte të politikës dhe të partikularizmit social të shoqërisë, që reflektohet me deomos në sferën e politikës« dhe duke e parë burokracinë »si përcjellëse të domosdoshme ose si fenomen të domosdoshëm përcjellës të shtetit „politik“ reprezentativ, si përfaqësuese jo të të përgjithshmes së vërtetë, por iluzore,

<sup>10</sup> K. Marks, *Vepra e cituar*, f. 91.

<sup>11</sup> E njëjtë vepër, f. 92.

të pseudo të përgjithshmes«,<sup>12</sup> Marks konkludon se »Hegeli nuk e ka *zbuluar* natyrën e *pushtetit qeveritar*« dhe se »ajo që thotë Hegeli pér pushtetin qeveritar nuk meriton të quhet analizë filozofike.<sup>13</sup> Hegeli »nuk e sheh fare *përbajtjen* e burokracisë«, thotë Marks, ai jep vetëm disa përkufizime të përgjithshme të organizimit »formal« të saj, kurse, në të vërtete — »*burokracia nuk është veçse »formalizmi i një përbajtjeje që qëndron jashtë vetë asaj»<sup>14</sup> (Nënvizimi im — F. A.)*

Duke vazhduar depërtimin në thelb të fenomenit të burokracisë, në konfrontim me Hegelin, në suaza që i kishte shtruar ai dhe thuajse me terme të tij, po në atë nivel abstraktësie, por duke i tejkaluar këto suaza e njëanësi, Marks, me shprehje të fuqishme e me stil të mprehtë, vazhdon: »Korporatat janë materializmi i burokracisë dhe burokracia është spiritualizmi i korporative... Po ajo frymë që në shoqëri krijon korporatën, në shtet krijon burokracinë...«<sup>15</sup>

Disa herë e thekson Marks se burokracia është formalizmi shtetror, »shteti si formalizëm«. Burokracia, thotë ai, »duhet ta mbrojë përgjithësinë *imagjinare* të interesit të veçantë, frymën korporative, pér të shpëtuar veçantinë *imagjinare* të interesit të përgjithshëm, *frymën e vet...* Fryma e burokracisë është kryekëput frymë e jezuitizmit, fryma e teologjisë. Burokratët janë jezuitët e shtetit, teologët e tij«.<sup>16</sup> Është karakteristikë e burokracisë të ngatërrojë formën dhe përbajtjen, realen dhe formalen, t'i shndërrrojë ato njëren në tjetrën, si dhe të shikojë veten si qëllim të fundit të shtetit, sikur shteti të ishte pér burokracinë. Duke i shndërruar qëllimet e veta »formale« në përbajtje të vetën, ajo bie në konflikt me qëllimet reale. Detyrat shtetërore shndërrohen në detyra burokratike, kurse detyrat burokratike në detyra shtetërore.<sup>17</sup>

Me mprehtësi e karakterizim mjeshtëror, sikur të fliste sot e pér të sotmen, Marks përcakton natyrën, karakterin e karakteristikat sociale-psikologjike të burokracisë. »Fryma e përgjithshme e burokracisë — shkruan Marks — është sekreti, misteri. Këtë sekret e ruan ajo brenda vetës, në saje të hierarkisë, kurse ndaj të tjerëve në saje të mbylljes korporative të saj. »Prandaj fryma e hapur e shtetit, si edhe mendimi shtetëror i duket burokracisë si *tradhti* kundrejt sekretit të saj. Prandaj *autoriteti* është parimi i dijes së saj kurse hyj-

<sup>12</sup> Adolf Bibiq, *Marksizmi, politika, shteti, »Marksizam u svetu«* 778 / 1976, f. VIII—IX.

<sup>13</sup> K. Marks, *Vepra e cituar*, f. 86, 90.

<sup>14</sup> E njëjta vepër, f. 92.

<sup>15</sup> E njëjta vepër, 92.

<sup>16</sup> E njëjta vepër, f. 93, 94.

<sup>17</sup> Po aty.

nizimi i autoritetit është mënyra e saj e të menduarit. Por në gjirin e saj spiritualizmi bëhet materializëm i trashë, materializëm i bindjes së verbër, i besimit në autoritetin, mekanizëm i veprimeve formale të fiksuara, i parimeve, i pikëpamjeve e i traditave të gatshme. Sa për burokatin e veçantë, qëllimi shtetëror bëhet qëllim i tij privat, *rendje pas posteve pas karrierës...* Shteti ekziston vetëm në trajtën e forcave burokratike të ndryshme, të lidhura midis tyre nëpërmjet subordinimit dhe bindjes së verbër». <sup>18</sup> Burokracia do të jetë veprimtare, do të vëre dorën e vet në çdo gjë, të fusë hundën gjithkund, do të shohë botën si një objekt të veprimtarisë së saj.

Edhe Hegeli, sikurse Veberi më vonë, flet për ndarjen e punës, për aftësimin për punë në administratë dhe dëshmimin e kësaj aftësie me shkollim e provime, për veprimtaritë shtetërore si mision jetësor të funksionarëve dhe, prandaj, për nevojën që të marrin rrogë për këto punë. Sipas Hegelit, natyrisht, i takon monarkut e drejta e zgjedhjes së individeve për detyra shtetërore. Ai kishte iluzionin se shteti dhe shtetasit janë të mbrojtur nga shpërdorimet e burckracisë, në saje të hierarkisë, domethënë të strukturës hierarkike të burokracisë, të përgjegjësisë që kanë funksionarët ndaj lart, ndaj instancave më të larta dhe për shkak të kompetencave të komunave e korporatave. Kishte Hegeli gjithashtu iluzionin se »humanizmi« i burokracisë qëndron në »kulturën morale dhe intelektuale« të saj. Sepse, Hegeli, në racionalizimet e burokracisë e të funksionit të saj, mendonte se funksionarët shtetëror formojnë »pjesën kryesore përbërëse të *rendit të mesëm* ku janë përqëndruar mendja e zhvilluar dhe vetëdija juridike«, »kultura më e shquar«, cilësi këto të cilat bëjnë që »panësia, ligishmëria dhe qëndrimi dashamirës të bëhen zakon«.<sup>19</sup> Por Marks nuk ua vë veshin ose i përqesh këto përcaktimes, i quan të padenja të konsiderohen analizë filozofike, mendon se shumë prej tyre »mund të figurojnë tekstuasilht në kodin civil prusian« dhe përfundon se »Hegeli na jep një përshkrim empirik, i cili i përgjigjet pjesërisht realitetit, ndërsa pjesërisht mendimit që ka vëtë burokracia për qenien e vet«.<sup>20</sup>

Marks ironizon, përqesh, shpotit »identitetet« e shtetit dhe të shoqërisë civile, që i gjen Hegeli, racionalizimin e burokracisë që e bën ai. Hegeli, p.sh., mendonte se identiteti i shtetit dhe i shoqërisë civile qëndron në përcaktimin e përzier të administratorëve, që është pjesërisht zgjedhje e tyre e pjesërisht emërim,

<sup>18</sup> K. Marks, *Vepra e cituar*, f. 95.

<sup>19</sup> E njëjta vepër, f. 90.

<sup>20</sup> E njëjta vepër, f. 92.

aprovim nga lart. Por Marks i thotë se kjo mënyrë e përcaktimit të administratorëve, të funksionarëve, jo vetëm nuk e zgjidh, por e dëshmon kundërtinë e pronës private e të interesave të veçanta, nga një anë dhe të shtetit ose të pseudo të përgjithshmes, nga ana tjeter. Hegeli përmendte që shteti, nëpërmjet të »të deleguarve«, d.m.th., administratës, policisë, gjyqit, futet brenda shoqërisë për të mbrojtur ligjin, interesin e përgjithshëm. Por edhe kjo dëshmon, thotë Marks, se shteti ekziston dhe vepron përkundër shoqërisë civile, jashtë saj dhe se administrata, policia, gjyqet janë jo organe të shoqërisë, nëpërmjet të të cilave do të mbronte ajo interesat e veta të përgjithshme, por organe shtetërore, përkundër shoqërisë civile.

Marks përqesh edhe *identitetin e dytë* të shtetit dhe të shoqërisë civile, të cilin Hegeli e shihte në mundësinë që secili qytetar të bëhet funksionar, pjesëtar i strukturës burokratike. Për Marksin jo vetëm që kjo mundësi është formale, por ajo nuk e heq dallimin e këtyre sferave. »Fakti që cilido ka mundësi të fitojë të drejtën e një sfere *tjetër* provon vetëm se sfera *e tij* nuk është realitet i kësaj të drejtë«. Provimet si kusht për t'u inkuadruar ose për t'u avancuar në strukturën burokratike Marks i tallë duke i quajtur si »pagëzim burokratik i dijes«, »vërtetim zyrtar i shndërrimit të dijes profane në dije të shenjtë« etj.

Vecanërisht energjikisht ngrihet Marks kundër po-himit të Hegelit se qytetarët janë të mbrojtur nga shpërdorimet burokratike, në sajë të hierarkisë, të përgjegjësisë së më të ultëve ndaj më të lartëve: »Sikur hierarkia të mos ishte *shpërdorimi kryesor* — ironizon Marks — dhe sikur disa mëkate personale të nëpunësve të mund të krahasoheshin me ato mëkate të tyre që rrjedhin *medoemos* nga kjo hierarki<sup>21</sup>.

Marks e quan gjë të bukur faktin që Hegeli, kulturën morale dhe intelektuale të nëpunësve ia kundërvë »karakterit mekanik të dijes e të punës burokratike«. Por është kundër iluzioneve të Hegelit se kjo kulturë do ta humanizojë atë dhe do ta bëjë të jetë i paanshëm, të respektojë ligjin, të jetë dashamirë etj. Përkundrazi, thotë Marks, »detyra« e burokratit përbën raportin e tij »substacial« dhe »bukën« e tij, ajo përbën fryshtë reale të burokratit dhe do të zotërojë mbi »kulturën« e tij morale e intelektuale.<sup>22</sup> Natyrisht, Marks e vlerëson lart një formulim të mëvonshëm të Hegelit, me të cilin fryma e vërtetë e burokracisë paraqitet si »routine administrative« dhe si »horizont i një sfere të kufizuar«.

<sup>21</sup> K. Marks, *E njëjta vepër*, f. 100.

<sup>22</sup> E njëjta vepër, 103.

<sup>23</sup> E njëjta vepër, f. 104.

<sup>24</sup> E njëjta vepër, f. 104.

Përkundër »identiteteve« të shtetit e të shoqërisë civile, të të përgjithshmes e të veçantës të Hegelit, në burokraci, sipas Marksit, identiteti i interesit shtetëror dhe i interesave të veçanta shprehet »në një formë të tillë që *interesi shtetëror* bëhet qëllim privat i *veçantës*. . ». Përkundrazi, burokracia mund të zhduket, mendon Marksia, vetëm po qe se interesi i përgjithshëm bëhet interes i *veçantës* në *realitet* dhe jo vetëm në mendim, në *abstraksion* — si te Hegeli. — Kjo, nga ana e vet, është e mundshme vetëm në qoftë se interesi i *veçantës* bëhet me të vërtetë i përgjithshëm».<sup>24</sup>

Në Dorëshkrimet ekonomiko-filosofike, Çështjen cijfute, Ideologjinë gjermane dhe në veprat e tjera të para Marksit e zhvillon dhe e thellon kritikën e shtetit dhe të politikës, argumenton tjetërsimin e tyre dhe, në këtë mënyrë, zgjeron dhe thellon konцепционин e tij të burokracisë, të qenies dhe të funksionit të saj shoqëror, të premisave dhe konsekuencave shoqërore të saj.

Në veprat e Marksit pas vitit 1848, në *Luftat klasseore* dhe në *Tetëmbëdhjetë brymerin e Lui Bonapartës*, për shembull, kur burokracia analizohet në trajta historikisht më konkrete, në bazë të analizave të begatshme sociologjiko-politikologjike të strukturës shoqërore-klasseore të shoqërisë franceze e të transformimeve të saj dhe në kuadër të një teorie të formuar për shtetin dhe luftërat klasore, përsëri i gjejmë mendimet mbi kontradiktën e shtetit e të shoqërisë, mbi alienimin politik etj., si faktorë që përcaktojnë qenien dhe funksionin e burokracisë si dhe vlerësimin e theksuar negativ të saj. Në *Tetëmbëdhjetë brymerin* Marks analizon burokracinë në formën më të shquar të pushtetit ekzekutiv, shqyrton dimensionet e saj, zgjerimin e ndërryrjes shtetërore, parazitizmin e burokracisë, bllokimin e shoqërisë civile e të opinionit publik nga burokracia, karakterin klasor të saj, interesat ekonomike dhe politike të borgjezisë për burokracinë. Marks e lidh zhvillimin e burokracisë me ndarjen e punës dhe kompleksësinë e jetës shoqërore, kurse thelbin e këtij fenomeni e sheh, si edhe në veprat e para, në shkëputjen e interesave të përbashkëta dhe konstituimin e tyre të *veçantës*, si interes i përgjithshëm, përkundër interesave të tjera të veçanta. Analizohen edhe kushtet e pavarësimit dhe të fuqizimit të jashtëzakonshëm të burokracisë dhe karakterizohet ajo si parazitore dhe si klasë artificiale.

Në Francën e mezit të shekullit të kaluar, pushteti ezekutiv, thotë Marks, »me organizimin e tij kolossal burokratik dhe ushtarak«, — »me organe të ndërtuara sipas parimit të ndarjes sistematike dhe hierarkike të

<sup>24</sup> E njëjta vepër, f. 96.

punës», — me makinën e tij shtetërore shumë të ndërlikuar dhe artificiale, me ushtrinë e nëpunësve prej një gjysmë milioni... ky organizëm — parazit i tmerrshëm... pështjell si një rrjetë tërë trupin e shoqërisë franceze dhe ia mbyll të gjitha poret...<sup>25</sup> Ky pushtet ekzekutiv mban në varësi një masë interesash dhe personash, »mbështjell, kontrollon, drejton mbikëqyr dhe mban nën tutelë shoqërinë civile«. Këtij stërfuqizimi të pushtetit ekzekutiv, të shtetit e të burokracisë i përgjigjet — thotë Marks, — »gjendja e varësisë së pafuqishme, shthuarja e mungesa e formës së organizimit të vërtetë shoqëror«, mungesa e mundësisë »së shoqërisë civile dhe e opinionit publik të krijojnë organet e tyre të pavarura nga pushteti qeveritar«.<sup>26</sup> Ndonëse kjo ide e »organizimit të vërtetë shoqëror«, e shoqërisë civile, e opinionit publik dhe e organeve të tyre, përkundër pushtetit shtetëror dhe burokracisë këtu, është dhënë, të thuash, në formë elementare, që të zhvillohet më tej në Luftën civile në Francë etj., na duket e rëndësishme jo vetëm pse dëshmon se Marks vazhdimisht e sheh burokracinë si rezultat të përçarjes së shtetit e të shoqërisë civile, por edhe pse Marks i kundërvën shtetit e burokracisë jo çorganizimin e mungesën e formës së organizimit, por organizimin e vërtetë shoqëror, aktivitetin e vërtetë të shoqërisë civile e të opinionit publik. Marks thekson interesat ekonomike të borgjezisë për forcimin e pushtetit shtetëror, por edhe interesat politike të saj, prej të cilave Marks përmend nevojën e borgjezisë që të shtojë shtypjen, »të bëjë luftë të vazhdueshme kundër opinionit publik« si dhe të sakatosë dhe të paralizojë organet e pavarura të lëvizjes shoqërore<sup>27</sup>.

Marks i lidh rritjen e aparatit shtetëror dhe të burokracisë me zhvillimin e ndarjes së punës, kurse bazën dhe thelbin e tyre e sheh në shkëputjen e interesave të përbashkëta si gjëja të përgjithshme dhe kundërvjenien e tyre ndaj interesave të individuale e të veçanta. »Ndarja e punës brenda shoqërisë borgjeze krijonte grupe të reja interesash — shkruan Marks — dhe, pra, edhe objekte të reja të administrimit të shtetit. Çdo interes i përbashlikët shkëputej menjëherë nga shoqëria, vihej përballe saj si interes i përgjithshëm, më i lartë, shkëputej nga sfera e veprimitarisë individuale të anëtarëve të shoqërisë dhe bëhej objekt i veprimitarisë së qeverisë«.<sup>28</sup> Marks thekson edhe faktin që, varësish nga raportet shoqërore-klasore e politike, ndryshon pozita dhe fu-

<sup>25</sup> K. Marks — F. Engels, *Vepra të zgjedhura*, I, Tiranë 1980, fq. 342.

<sup>26</sup> K. Marks, *Vepra të zgjedhura*, I, f. 292.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> K. Marks, *Vepra të zgjedhura*, I, 343.

qia e burokracisë. Gjatë kohës së Napoleonit, burokacia ishte vetëm një mjet për të përgatitur sundimin e borgjezisë, kurse gjatë restaurimit, përkundër përpjekjeve që të bëhet fuqi e pavarur, burokracia ishte vegël e klasës sunnduese. Por, në kushte të një raporti forcash si ishte gjatë Banapartit të Dytë, pushteti shtetëror forcohet dhe pavarësitet aq sa dominon mbi shoqërinë civile. Por, ky pushtet shtetëror, thotë Marks, nuk qëndron në erë, ai ka një bazë klasore dhe këtë bazë, në Francën e asaj kohe, e përbënte fshatarësia e vogël, parcellare. Dhe, në kushte e raporte të këtilla, mund të ndodhë që edhe një avanturier si Napoleoni i Dytë, një sharlata që mban emrin e Napoleonit vetëm pse ligji në fuqi ndalon kërkimin e atësise, thotë Marks, pas një vagabondazhi prej 20 vjetësh dhe pas një vargu avanturash të fëlliçura, të gjendet në krye të Francës, si perandori i saj!

Edhe pse u ngrit me përkrahjen e fshatarsisë parcelare, Lui Bonaparti me aparatin e tij burokratik i solloj asaj vetëm ngarkesa të reja. »Përveç borxhit hipotekar, me të cilin kapitali ngarkon parcele, mbi të rëndon edhe *tatimi*. Tatimi është burimi i jetës për burokracinë... Qeveri e fortë dhe tatim i lartë janë koncepte identike.<sup>29</sup> Burokracia, për Marks, është një klasë artificiale, pjesëtarët e saj kapen pas nëpunësive sipas një »lëmoshe të ndershme«, për ta ruajtja e regjimit është çështje e sigurimit të ekzistencës dhe, regjimi që nuk ka mbështetje, e mban këtë klasë me rroga të mira, me privilegje e sinekura.

Nuk përjashton Marks mundësinë që burokacia të kryejë edhe punë me interes të përbashkët shoqëror, por theksin e vë në anët negative të saj. Në artikullin »Sundimi britanik në Indi« Marks shkruante se në Azi, që nga lashtësia, ekziston tri degë administrimi: »Administrata e financave, ose e grabitjes së popullit të vet, administrata ushtarake, ose e grabitjes së popujve të tjere dhe, më në fund, administrata e punëve botore.<sup>30</sup> Kjo e fundit kujdesej për çështje si ujitjet, rruget e interesa të tjera të përbashkëta.

Shtetit dhe burokracisë së fuqizuar Marks, në *Luf-tën civile në Francë*, veprën në të cilën më së shumti e trajtoi idenë e vetëqeverimit, ia kundërvë Komunën. Komuna përbëhet nga këshilltare bashkiakë, të zgjedhur me votim të përgjithshëm. Këta, që janë kryesisht punëtorë, janë përgjegjës dhe mund të shkarkohen në çdo kohë. Komuna ishte jo një parlament, por një forum punë, legjislativ dhe ekzekutiv. Policia zhveshet nga fun-

<sup>29</sup> K. Marks, *Vepra të zgjedhura I*, 348.

<sup>30</sup> E njëjta vepër, 357.

ksionet politike dhe bëhet organ përgjegjës i komunës. Shërbimet publike, që nga anëtarët e komunës e poshtë kryhen për një pagë të barabartë me atë të punëtorit — Hiqen të gjithë funksionarët e lartë dhe privilegjet e tyre. Hiqet ushtria e përhershme, kisha shpronësohet dhe ndahet shteti. Funksionarët gjyqësorë humbën »pavarësinë fiktive« që ishte maskë pér të mbuluar »servilizmin e tyre të ulët përparrë të gjitha qeverive«. Sikur ky rend të ishte vendosur në Paris dhe në qendrat e tjera, thotë Marks, atëherë »qeveria e vjetër e centralizuar do t'ia kishte lëshuar vendin vetëqeverisjes së prodhuesve...«<sup>31</sup> Delegatët në komunë duhej t'u përbaheshin instrukSIONEVE, qëndrimeve të atyre që i zgjedhin (mandati imperativ).

Në këtë mënyrë, thotë Marks, nuk do të thyhej uniteti i kombit, por do të realizohej uniteti i vërtetë, duke u shkatërruar pushteti shtetëror që në mënyrë të rreme e simbolizonte këtë unitet, por që në fakt pavarësohej nga kombi dhe vihej mbi të. Pra, komuna donte të heqte »organet thjesht shtypëse« të shtetit të vjetër, kurse »funksionet e rregullta« t'u jepeshin »shërbëtorëve përgjegjës të shoqërisë«.

Komuna, forma politike e çlirimt ekonomik të punës, do t'ia kthente shoqërisë, shkruan Marks, »të gjitha ato forca që deri në këtë kohë i kishin qenë thithur nga ky mullë parazit, nga »shteti«, që ushqehet në kurri zë shoqërisë dhe pengonte lëvizjen e saj të lirë«.<sup>32</sup>

Shihet qartë se Marks, larg utopizmit që i atribuohet, lidhur me shuarjen e shtetit e të burokracisë, kërkon të hiqet pseudo e përgjithshmjë, simboli i rremë i unitetit, tjetërsimi i punëve drejtuese, në mënyrë që shoqërisë t'i kthehen forcat e saja, interesit i përgjithshëm të jetë vërtet, i përgjithshëm, funksioni shoqëror vërtet shoqëror. Pra, jo të shuhen funksionet e domosdoshme, të përgjithshme e të përbashkëta, edhe funksionet drejtuese, koordinuese etj., por të shuhen funksionet e tepërtë, funksionet shtypëse si dhe privilegjet e atyre që i kryejnë këto funksione, t'i kthehen këto funksione shoqërisë, që të mund të kryhen nga organe vërtetë shoqërore, të zgjedhura nga shoqëria, e përgjegjëse ndaj saj. Sështë Marks kundër punës së »burosë«, por kundër burokracisë, kundër shtresës dhe funksionit burokratik të tjetërsuar e të privilegjuar dhe të implikacioneve shoqërore, politike, kulturale, psikologjike etj. të këtij tjetërsimi dhe privilegjimi.

<sup>31</sup> K. Marks, *Vepra të zgjedhura*, I, 545.

<sup>32</sup> E njëjtë vepër, f. 547.

### III

Maks Veberi, njëri ndër mendimtarët më të shquar të shkencave shoqërore të të gjitha kohërave, renesanca e mendimit të të cilit, pak në mënyrë euforike, u proklamua më 1964, në njëqindvjetorin e lindjes së tij, nga Parsons i shkolla e Harvardit, një ndër përfaqësuesit kryesorë të të ashtuquajturit drejtim borgjez në sociologji, personi që konsiderohet themelues ose bashkëthemelues i disiplinave të tëra të veçanta sociologjike si janë sociologjia e religionit ose edhe sociologjia politike, »më i madhi nga të gjithë sociologët jomarksistë të marrëdhënieve politike«, si shkruan Jerzhi Vjatér, sociologu që »konstruktoi një sistem teorik, vërtet në shumë pika kryesore të papercaktuar deri në fund, por që më gjerësinë e horizontit, me origjinalitetin e pikëpamjeve, me gjithëanëshmérinë e analizës dhe, para së gjithash, me precizitetin rigoroz të mendimit dhe të argumentimit, ia kaloi çdogjeje që u krijuat në Gjermani, që nga koha e Marksit, në kuadër të kësaj fushe të shkencave shoqërore«, studioi intensivisht edhe burokracinë.

Për vendin e rëndësishëm që zë koncepcioni i Veberit për burokacionë në kuadër të sistemit të përgjilishëm sociologjik të tij dëshmojnë sociologë të shumtë, studiues të veprës së tij. »Nga të gjitha elementet konceptuale të teorisë së Veberit mbi pushtetin, ai për të cilin është më i famshëm është burokracia«,<sup>34</sup> shkruan Nisbeti, kurse Mihajlo Gjuriqi, në parathënien e vëllimit krestomatik për Veberin shkruan se që në veprat e tij të para »intonohet qartë njëra ndër temat qendrore të Veberit, tema për të cilën njihet më së shumti edhe në qarqet shkencore dhe jashtë tyre, dhe për të cilën mendohet në radhë të parë kur është fjala për pikëpamjen sociologjike të tij — problemi i burokracise«.<sup>35</sup>

Vlerësohet shumë lart, nganjëherë edhe tejçmohet, kontributi i Veberit në studimin e burokracisë. Për N. Bobion, teoria e Veberit për burokracinë është »një veprë vigane, deri më sot, në shumë pikëpamje, e patejkaluar«, e Nisbeti shkruan: »Analiza e burokracisë e Veberit, duke përfshire edhe rolin e saj në sferat joqevertare të shoqërisë e të kulturës, nuk është vetëm pikënisje e studimeve të sotme; ajo përbën, me përjashtime të rralla, pikërisht shumën (tërësine) e këtyre studimeve. Asnjëri nuk i shtoi ende teorisë (fjala vizion do të ishte më e përshtatshme) së Veberit për burokacionë asnjë element, që të mos gjendet implicitë në shkrimet e tij për këtë temë«.<sup>36</sup>

<sup>33</sup> Jerzy Wiatr, *Teoritë themelore të sociologjisë jomarksiste të marrëdh. politike*, »Marksizam u Svetu« 9/1977, 53.

<sup>34</sup> R. A. Nisbet, *The sociological tradition*, Londër 1971, f. 145.

<sup>35</sup> Mihajlo Gjuriq, *Sociologjia Maksa Vebera*, Zagreb 1964, 17.

<sup>36</sup> R. A. Nisbet, *Vepra e permendor*, f. 142.

Por, cila është kjo teori grandioze, çka e përbën, çka e shquan dhe çka e karakterizon atë?

Në studimet e tij sociologjiko-politike Veberi, duke i parë raportet shoqërore e ndërnjerëzore, kryesisht si raporte sundimi e varësie, eprore-deprore, kujdes të vëçantë u kushton kategorive të fuqisë e të pushtetit. Por, derisa fuqia, e cila definohet si gjasë që dikush të imponoje vullnetin vetjak, përkundër rezistencave evenuale, është një koncept »amorf«, pushtetin Veberi e definon si »gjasa që persona të caktuar t'i nënshtrohen urdhrit me përbajtje të caktuar«.<sup>37</sup> Pushteti realizohet në bazë urdhrash e dëgjesash dhe përbën preokupimin kryesor sociologjiko-politik të Veberit.

Në këtë kuadër për Veberin thelbësore është çështja e legjitimitetit — një koncept shumë aktual e i rendësishëm edhe në studimet sociologjiko-politike të sotme — të pushtetit, çështja se me ç'të drejtë, në bazë të çakat disa sundojnë, urdhërojnë, kanë pushtet dhe përsë, për ç'arsye të tjerët dëgjojnë, nënshtrohen, u përmban urdhrave, ligjeve, vendimeve.

Duke studiuar fenomenin e legjitimitetit të pushtetit, edhe pse me të drejtë potencon forcën, dhunën, detyrimin dhe — veçanërisht kur është fjala për grupet politike, për shtetin në radhë të parë — kërcënimi me përdorim të dhunës ose përdorimi i saj është miet specifik i tyre, ultima ratio e tyre, madje aq sa grupet politike definohen, mendon ai, jo aq për nga qëllimi dhe fusha e veprimit, por nga kjo specifikë e përdorimit të dhunës, prapë, mendon Veberi, dhuna s'është i vetmi mjet i pushtetit. Duhet të egzistonë momente të tjera, vlera, besime etj., të cilat përbëjnë bazën e legjitimitetit të pushtetit.

Veberi dallon tri baza të legjitimitetit ose tri *tipë të pushtetit*, pushtetin tradicional, harizmatik dhe pushtetin racional. Pushteti *tradicional* është tipi i pushtetit që bazohet në traditën, në bindjen e shtesave se pushteti dhe institucionet ekzistuese janë të shenjta, në besimin e tyre se pushteti, e drejta e sundimit është legitime, sepse — kështu ka qenë gjithmonë. Pushteti *harizmatik* mbështetet në bindjen se sundimtari ka cilësi, aftësi, talent të jashtëzakonshëm. Më në fund pushteti *racional*, karakteristikë dhe rezultat i botës perëndimore, studimit të të cilit Veberi i kushton kujdesin kryesor, është forma më e zhvilluar, racionale e pushtetit. Pushteti racional është sundim i ligjit apersonal, sundim me anë dhe në bazë të ligjit. Ligji është i përgjithshëm, i njëjtë për të gjithë dhe nënshtetasit, personalisht

<sup>37</sup> M. Veber, *Ekonomia dhe shoqëria* (serbokroatisht), Beograd 1976, I. f. 37.

të lirë, i nënshtrohen ligjit dhe jo personit që e zbaton atë. Natyrisht, tipet e pushtetit janë, sipas koncepcionit metodologjik Veberian, tipe ideale, që do të thotë konstrukcione abstrakte analitike, të cilat ndihmojnë të kuptohet realiteti politik. Në format konkrete të pushtetit nuk gjemjë pushtet që të përputhej plotësisht me tipet e përmendura të pushtetit, secila formë e pushtetit është një përzierje, kombinim i tipeve të përmendura me predominim më të madh ose më të vogël të ndonjërit prej tyre.

*Tipi racional i pushtetit është pushtet i burokracisë*. Veberi i kushton shumë kujdes organizimit dhe funksionimit të kësaj organizate, racionalitetit të saj. Burokracia është një sistem, një organizatë me ndarje sistematike të punëve, në kuadër të së cilës punët kryhen pandërprerë, sipas rregullave të përcaktuara. Parimi i kompetencës është një ndër parimet themelore të kësaj strukture. Secila gjymtyrë e kësaj organizate, secili zyrtar, ofiqar, vepron në bazë të autorizimeve, të kompetencës, e cila përfshin »sferën e obligimeve për kryerjen e funksioneve«, të përcaktuara në bazë të ndarjes precise të punës dhe mjetet »rigorozisht të përcaktuara« të dhunës eventuale si dhe kushtet e aplikimit të tyre. Parimi i kierarkisë është po kështu thelbësor për organizatën burokratike. Kjo do të thotë se kjo organizatë është e strukturuar kierarkisht, me poste të larta e të ulëta, me raporte urdhëruese e varësie, por edhe me sistemin e kontrollit e të mbikëqyrjes nga lart dhe me mundësinë e apelit e të ankesës nga poshtë, do të thoshë Veberi. Ofiqarët, zyrtarët, nëpunësit mund të kenë pushtet e të urdhërojnë vetëm si pjesëtarë të kësaj organizate hierarkike, nga kuadri i saj. Në organizatën burokratike punët e shërbimit kryhen me akte, dokumente të shkruara. Kryerja e detyrave bëhet sipas rregullave të qëndrueshme e detaje. Marrëdhëni brenda organizatës janë raporte zyrtare, të posteve, të rangjeve, raporte apersonale. *Objektiviteti* është karakteristikë e punës së burokracisë, sepse në organizatën burokratike puna kryhet sipas »rregullave racionale«, të përgjithshme e të njëjtë për të gjithë, burokracia punon si në iratet studio (pa urrejtje dhe anim), pra pavarësisht nga momentet si janë simpatia, antipatia, mëshira, animi etj. Në organizatën racionale parimi shët ekziston »ndarja e plotë« e aparatit administrativ nga mjetet e drejtimit e të furnizimit. Zyrtarët, nëpunësit nuk janë pronarë të mjeteve me të cilat punojnë, prona zyrtare dhe private janë të ndara. Po kështu posti që zë nëpunësi, vendi i tij në organizatën burokratike, nuk është pronë, monopol i tij, nuk mund të përvetësohet as të trashëgohet. Më në fund, burokracinë e karakterizon edhe sekreti zyrtar dhe ruajtja e tij. »Sekreti zyrtar« është zbulim specifik

i burokracisë, thotë Veberi dhe »ajo nuk mbron asgjë me aq fanatizëm sa e mbron këtë qëndrim«. Burokracia e përjashton publikun, opinionin dhe »interesi i fuqisë së burokracisë« vepron shumë më tepër se interesat objektive, për ruajtjen e sekretit zyrtar.<sup>38</sup>

Pra, sipas Veberit, pushteti burokratik është »sundim i apersonalitetit formalist«, nëpunësi ideal e kryen detyrën pa urrejtje e pasion, por edhe pa dashuri e entuziazëm, vetëm në bazë të detyrës, njëloj për secilin, pavarësisht nga personi dhe interesat e tij.

Pushteti racional realizohet nëpërmjet të aparatit administrativ burokratik. Ky aparat përbëhet nga nëpunës, zyrtarë që emërohen në bazë të kualifikimeve profesionale, të cilat dëshmohen me diplomë e verifikohen me provime. Këtë moment të caktimit të nëpunësve si pas kualifikimit profesional Veberi e konsideron si një element të rëndësishëm konstitutiv të aparatit burokratik. Këta nëpunës e ofiqarë, që personalisht janë të lirë, por u nënshtrohen »vetëm detyrave objektive zyrtare« emërohen në detyrë e nuk zgjidhen. Veberi mendon se në tipin e pastër të organizatës burokratike emërimi bëhet nga instanca më të larta, kurse aty ku bëhet zgjedhja e oficarëve, raporti s'është burokratik i pastër. Ai përmend edhe rastet — shumë të shpeshta në ditët tona — kur emërimi faktik i titullarëve fshehet me një zgjedhje formale. »Detyra« e nëpunësit, e ofiqarit shikohet jo si burim rente, as si këmbim shërbimesh. Përkundrazi, hyrja në detyrë shikohet si një »marrje specifike e obligimit për lojalitet ndaj shërbimit, me sigurimin e ekzistencës si kundërvlerë«. Lojalitet jo ndaj ndonjë personi, si vazali, shegërti etj., por ndaj qëllimit, i cili zbulohet ideologjikisht (shteti, bashkësia, partia, vlerat kulturore etj.). Për punën e bëre nëpunësit marrin rruga të përcaktuara *në para*, të përcjella të shumten me pensione, e të tjera. Veberi ndriçon përparësitet e sistemit të rrrogave *në para* dhe varësinë e madhe të nëpunësve dhe të oficarëve nga organizata burokratike pikërisht për shkak të kësaj mënyre të pagesës. Lartësia e rrrogës varet nga »rangu në sistemin hierarkik« e edhe nga »përgjegjësia që e kërkon pozita e caktuar«. Për nëpunësin »detyra« është profesion i vetëm ose kryesor. Në përpunthje me sistemin hierarkik të organizatës burokratike, nëpunësit janë të drejtuar kah »karriera«, d.m.th., synojnë »ngritjen në shërbim prej posteve më të ulëta, më të parëndësishme e më pak të paguara, kah më të lartat«. Natyrisht, thotë Veberi, nëpunësit mesatarë përpinqen që sa më mekanikisht të përcaktohen kushtet e për-

<sup>38</sup> M. Veber, *Vepra e cituar*, II, f. 87, 88.

parimit, së paku në klasët e rrrogave, sipas viteve të shërbimit ose ngjashëm. Në punën e tyre nëpunësit i nënshtrohen disiplinës zyrtare dhe kontrollit nga lart.<sup>39</sup>

Nëpunësi modern përpinqet t'i sigurojë vetes dhe shtresës së tij një respekt të veçantë. Këtë ia mundësojnë »dispozitat mbi rangun«, thotë Veberi dhe, kur është fjala për nëpunësin politik — »dispozitat penale-juridike« kundër »fyerjes së nëpunësit«, kundër »qëndrimit përbuzës ndaj shtetit«,<sup>40</sup> etj.

Duke përcaktuar natyrën e burokracisë dhe interesat e saja, të paraqitura kryesisht si interesa të përgjithshme, të maskuara si të tilla, Veberi shkruan se ylli kryesor prijës i sjelljes së ofiqarëve është — *raison d'Etat*, interesi shtetëror, si do të mund të thuhej. Por, »me kanonizimin e kësaj ideje abstrakte dhe »objektive« janë të lidhura pandaras instinktet e pagabueshme të burokracisë për kushtet e ruajtjes së fuqisë së saj në shtetin e vet«.<sup>41</sup>

Koncepcionin e Veberit për burokracinë fuqishëm e karakterizon mendimi mbi efikasitetin dhe racionalitetin e saj, mendim që është ndoshta tipari më dallues i këtij koncepcioni. Administrata burokratike është, nga aspekti teknik, ajo formë e pushtetit, »e cila mund të mbërrijë efikasitetin më të madh dhe që, në këtë kuptim, formalisht është më *racionale*. Ajo s'ka të barabartë për *nga preciziteti, qëndrueshmëria, disciplina, rigoroziteti* dhe *saktësia*, për nga mundësia e kalkulimit të rezultateve...; ajo formalisht mund të përdoret për të gjitha detyrat«.<sup>42</sup> Veberi thekson superioritetin teknik të organizatës burokratike». Aparati burokratik plotësisht i zhvilluar qëndron ndaj formave të tjera të organizimit si qëndron makina ndaj formave të tjera jomekanike të prodhimit». Si kualitete të kësaj organizate burokratike Veberi përmend precizitetin e punëve, shpejtësinë, njëtrajtësinë, kontinuitetin, diskrecionin, unitetin, zvogëlimin e konflikteve, kursimet në shpenzime materiale dhe personale etj.<sup>43</sup> Superioritetin e organizatës burokratike Veberi e sheh në strukturën dhe në mënyrën e veprimit të saj, por edhe në pozitën dhe motivimin e nëpunësve. Nëpunësit e Egjiptit ishin faktikisht skllavë të Faraonit. Por, mundësitet e mjeteve të dhunës e të detyrimit ishin të kufizuara, kurse gjasat për sukses optimal të aparatit burokratik mbështeten në »rrogen e siguruar në para, të lidhur me shpresën e karrierës, e cila të mos varet thjesht nga arbitrariteti,

<sup>39</sup> M. Veber, *Vepra e cituar*, I, f. 173, II, f. 60—63.

<sup>40</sup> M. Veberi, *Vepra e cituar*, II, 61.

<sup>41</sup> *E njëjtë vepër*, f. 77.

<sup>42</sup> M. Veber, *E njëjtë vepër*, I, 175.

<sup>43</sup> *E njëjtë vepër*, II, 72.

mandej në disiplinën e rreptë dhe kontrollin (i cili i ka në konsiderim ndjenjat e nderit të ofiqarit), zhvillimin e ndjenjes së prestigjit të shtresës (professionit)...«<sup>44</sup>

Veberi i jep përparësi organizatës burokratike dhe funksionimit të saj, jo vetëm krahasuar me format, t'i quajmë arkaikë, të organizimit në të kaluarën, por edhe me format »gjëja të kundërtë« të sotme, si janë format përfaqësuese kolegiale, këshillat e parlamentit, ofiqarët e nderit, me format demokratike e vetëqeverisëse, si do të mund të thoshim. »Puna kolegialisht e organizuar kushtëzon fërkime (grindje) dhe shtyrje, kompromise në mes interesave dhe mendimeve që janë në konflikt, prandaj është më joprecize, më e padëshiruar nga eprrorët, më pak unike dhe më e ngadalshme«. Dhe, sikur të donte të zbulojë sekretin e koncepcionit të vet, i cili ishte pjesërisht idealizim i strukturës dhe i funksionimit të burokracisë prusiane, vazhdon: »I tërë përparrimi i organizimit prusian të administratës ishte dhe do të jetë edhe në të ardhshmen përparrim i parimit burokratik, posaçërisht monokratik«.<sup>45</sup> Veberi madje thotë se, kur është fjala për detyrë kompleksë, »puna e paguar burokratike është jo vetëm më precize, por më rezultatin definitiv shpesh edhe më e lirë nga shërbimi formalisht i papagesë e nderit«.<sup>46</sup>

Sipas Veberit, organizata burokratike bazohet në një »nivelizim«, qoftë relativ, të dallimeve ekonomike dhe shoqërore, lidhur me zërien e funksioneve administrative. Do të thotë, pa prekur në dallimet e tyre reale, kur është fjala për zërien e këtyre funksioneve, por edhe për trajtimin administrativ të individëve përgjithësisht, i merr ata si të barabartë. Ky nivelizim është »rezultat i parimit të saj karakteristik: të rregullsisë abstrakte në kryerjen e pushtetit. Sepse kjo rregullsi rrjedh nga kërkesa e »barazisë para ligjit« në kuptimin personal dhe objektiv, pra, ajo rrjedh nga ndjenja e neverisë ndaj »privilegjës« dhe nga hedhja parimore e zgjidhjeve« nga rasti në rast«.<sup>47</sup> Duke shprehur qartë pikëpamjet dhe orientimet e veta klasore ideore dhe politike, Veberi thotë se disa shtresave ose klasave, proletariatit për shembull, nuk u përgjigjet ky nivelizim, barazia formale para ligjit. E drejta dhe administrata proletarëve duhet t'u shërbejë »për barazimin e gjasave të tyre jetësore, ekonomike dhe politike, me gjasat e të pasurve«. Prandaj proletarët duan një të drejtë e administratë joformale, si e drejta e kadisë, që i përshtatet personit apo grupit të caktuar, interesave të ty-

<sup>44</sup> E njëjtë vepër, II, 68.

<sup>45</sup> E njëjtë vepër, II, 73.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> E njëjtë vepër, II, f. 80.

re.<sup>48</sup> Në këtë kuadër Veberi mbron burokracinë edhe nga — si thotë ai — iluzioni i demokratizimit. Termi demokratizim mund të mashtrojë. »Demosi, në kuptim të një mase amorfë, asnjëherë nuk »drejton« vetë në grupet e mëdha të organizuara, por atë e drejtojnë...«<sup>49</sup>

Struktura burokratike është produkt i vonë i zhvillimit, thotë Veberi. Në shoqëritë e përparshme format e pushtetit nuk ishin burokratike ose në to gjemë elemente të pakta të marrëdhënieve burokratike. Zhvillimi i formave moderne të organizimit grupor, i shtetit, kishës, ushtrisë, partive, ndërmarrjeve, grupeve të interesit, shoqatave etj., përputhet me zhvillimin dhe me zgjerimin e organizatës burokratike.<sup>50</sup> Këtë administratë burokratike e krijoj kapitalizmi, thotë Veberi: »Jo vetëm ai, por sigurisht dhe padyshim, ai në radhë të parë, sepse ai pa të s'mund të ekzistojë«.<sup>51</sup>

Duke përmendur kushtet dhe premisat e lindjes e të forcimit të burokracisë, Veberi përmend zhvillimin e ekonomisë monetare si një ndër premisat thelbësore të saj. Në sferën e politikës, trolli klasik i burokratizimit janë shteti i madh dhe partia masive, thotë Veberi, prandaj burokracia zhvillohet me to. Zhvillimi »intensiv dhe cilësor« i detyrave të administratës është faktor i zgjerimit të burokracisë. Kompleksia e jetës shoqërore, shtimi i nevojave shoqërore dhe plotësimi i organizuar i tyre ndikon gjithashtu në zgjerimin e burokracisë. Nga momentet thjesht politike, mendon Veberi, në drejtim të burokratizimit vepron nevoja gjithnjë më e madhe e shoqërisë »për rend e mbrojtje«, mandej detyra sociopolitike, etj. Veberi përmend edhe faktorët teknikë të burokratizimit — mjetet moderne të komunikacionit dhe nevoja e drejtimit të tyre, faktorët si janë demokracia masive, mjetet moderne të informimit, nevojat e informimit e të reagimit të shpejtë etj.<sup>52</sup>

Për shkak të të gjitha këtyre, gjithnjë më e madhe bëhet nevoja për një administratë »të përhershme, rigozoze, intensive dhe të sigurtë«, shkruan Veberi. Në kushtet e shoqërisë së sotme, burokracia është e domosdoshme. Kjo përbën bazën e rëndësisë që ka e që po merr burokracia. Mandej, burokracia, pasi të realizohet njëherë, »u takon krijesave shoqërore që më së vështiri rrënohen«.<sup>53</sup> Aparati burokratik vazhdon të fun-

<sup>48</sup> E njëjta vepër, II, f. 77.

<sup>49</sup> E njëjta vepër, f. 81.

<sup>50</sup> E njëjta vepër, I, f. 175.

<sup>51</sup> E njëjta vepër, I, f. 176.

<sup>52</sup> E njëjta vepër, II, f. 69—71.

<sup>53</sup> E njëjta vepër, II, f. 83.

ksionojë, edhe po t'i ndërrohet sunduesi, bile edhe në duar të armikut. Revolucioni si krijim i formave krejtësisht të reja të pushtetit është i pamundshëm, mendon ai.

Më në fund, një ndër mendimet themelore të Veberit për burokacionë, mendim për të cilin shpesh përmendet e madhërohet sot, është mendimi i tij se *burokracia është e pashmangshme edhe në socializëm*, se socializmi, të cilin Veberi e sheh si socializëm shtetëror, do të ketë edhe më shumë nevojë për aparatin burokratik, prandaj do ta zgjerojë e fuqizojë edhe më tepër burokracinë.

#### IV.

Burokracia është një fenomen kompleks dhe shumë-dimensional, që vështirë mund të përcaktohet. Ajo është fenomen shoqëror-politik i rëndësishëm, prandaj në studimin e saj, në përcaktimin e thelbit dhe të formave të manifestimit, të karakterit dhe të karakteristikave të saj, angazhimet politike dhe ideologjike janë të pashmangshme. Më në fund, ndriçimin e fenomenit të burokracisë e vështirëson edhe mentaliteti i vetë burokracisë, me idealizimet e rendit, të kompetencës, të kierarkisë, ideologjia e vetë burokracisë, iluzionet që ajo përhap për veten e saj, paraqitja instrumentale e burokracisë, sikur ajo të ishte vetëm në shërbim të të tjerëve. Për shkak të të gjitha këtyre, natyrisht që do të paraqiten pikëpamje dhe teori të ndryshme, madje edhe të kundërtë, të burokracisë, të cilat do të ndriçojnë aspekte të ndryshme të ekzistimit dhe të funksionimit të saj dhe do ta vlerësojnë atë shpesh në mënyrë diametralisht të kundërtë. Dhe derisa disa theksojnë efikasitetin dhe racionalitetin e burokracisë, të tjerët theksojnë paaftësinë e ngurtësinë e saj, kurse të tretët — dominimin burokratik, rrezikun shoqëror të saj.

Në këtë kuader, natyrisht, imponohet dhe është i shpeshë krahasimi i Marksit dhe Veberit, i teorive të tyre për burokracinë.

Noberto Bobio, në artikullin e tij të përmendur (»*A ekziston doktrina marksiste mbi shtetin*«) u bën vë-rejtje marksistëve për një teprim të frysës kritike, për mendimin se, pasi Marksi ka gjithmonë të drejtë, kundershtarët e tij janë gjithmonë gabim. Bobio habitet me pohimin e Umberto Qerronit se Veberi është »studiu i zellshëm« i burokracisë, kurse Rajt Millsi »sociolog i madh«. Bobio habitet edhe sesi »disa faqe, padyshim të rrepta dhe aktuale, të Marksit të ri, të shkruara si kritikë e burokracisë, — që s'mund të ndahen nga konteksti në të cilin u shkruan, dhe ky është kritika e klasës universale të Hegelit — të ngrihen në

shkallë të një teorie të saktë e të vërtetë të burokracisë, e cila duhet t'i kundërvihet, dhe, qështë edhe më serioze, të ketë përparësi ndaj teorisë së Veberit». Sipas Bobios, në një anë kemi — »një veprer gjigante, deri më sot në shum pikëpamje të patejkaluar, të Veberit« dhe, në anën tjeter — »disa faqe të nxjerrura nga veprat e para të Marksit, të cilat ai ua kishte lënë brejtësive (minjve) të librit«.<sup>54</sup> Pasi ngrihet kundër gjëja përdorimit të veprës së Marksit — »për të mbyllë sytë« ose »për të shikuar vetëm në një anë«, Bobio kundërshton mendimin se burokracia lind nga ndarja e shoqërisë civile nga sfera politike dhe shkakun e lindjes së burokracisë e sheh vetëm në »forcimin, komplikimin dhe teknokratizimin e detyrave të shtetit«. Duke u ndalë në fenomenin e burokratizimit në vendet socialiste, Bobio ironizon: »A është vështirë të dihet se kush (Marksi apo Veberi) kishte të drejtë?«<sup>55</sup>

R. Nisbeti, pa e kufizuar mendimin e Marksit për burokracionë në »disa faqe« dhe duke pranuar mendjet hellësinë e tij në ndriçimin dhe vlerësimin e këtij fenomeni, dobësinë e kërkon në pikëpamjen mbi shuarjen e shtetit. Këtu qëndron arsyaja, mendon ai, përsë në vendet dhe në lëvizjet socialiste mbretëron një, të thuash, »indiferencë totale« për problemet e burokracisë. »Që socializmi mund të ketë probleme të veta me burokracinë, kjo duket se pak e trazonte mendjen e Marksit... (Per te) si do të humbë pushteti politik karakterin e vet politik, pasi të përblyset klasa kapitaliste, po kështu supozohet të humbë administrata shtetërore natyrën e vet burokratike«.<sup>56</sup> I cituam këta dy autore që të shihet se »mbyllja e syve« osc »shikimi vetëm në një anë« nuk është dobësi që mund t'u atribuohet vetëm — »marksistëve«. Përgjithësisht, kur është fjala për krahasimin e Marksit dhe Veberit, të konceptioneve të tyre teorike dhe jo vetëm të pikëpamjeve të tyre mbi burokracinë, qëndrimet jokritike e të paargumentuara nuk janë të rralla. Mihajlo Gjuriqi, për shembull, në monografinë e tij të botuar si parathënie të krestomacisë për Marks Veberin, shkruan se e tërë vepra e Veberit është »një përpjekje vigane« për tejkalimin e traditës idealiste të shkencave shoqërore gjermane dhe për »thellimin e zgjerimin e suazave analitike të pikëpamjes materialiste të Marksit«, kurse në *Etikën protestante* Veberi, »përkundër Marksit, tërheq vëmendjen për rëndësinë e faktorëve ideorë në zhvillimin shoqëror«.<sup>57</sup> Thua jse vepra e Veberit ishte kryesish

<sup>54</sup> N. Bobio,

<sup>55</sup> Po aty.

<sup>56</sup> R. Nisbet, »Sociological tradition«, f. 139.

<sup>57</sup> M. Gjuriq, *Sociologija Maksa Vebera*, f. 17, 19.

e ndryshme dhe e kundërt me të Marksit dhe thuajse Marks si nuk e kishte »tërhequr vëmendjen« për rëndësinë e faktorëve ideore në zhvillimin shoqëror, por është pritur që këtë ta bënte Veberi.

Krahasimi i teorive të Marksit dhe Veberit, e edhe i koncepcioneve të tyre për burokracinë, është një temë e gjerë, për të cilën u shkruan vëllime të shumta. Natyrisht, në këtë vështrim, nuk mund të ndalemi në mendimet e shprehura dhe në vlerësimet e dhëna për këtë raport, por do të kufizohemi në disa momente që duhet gjithsesi të merren parasysh, kur shqyrtohen konцепционet e Marksit dhe të Veberit për burokracinë.

Para së gjithash, Marks si dhe Veberi nuk kanë koncept të njëjtë për burokracinë. Derisa Marks si, në kuadër të koncepcionit të tij të përgjithshëm mbi shoqërinë, mbi strukturën dhe luftën klasore, shtetin dhe funksionin e tij klasor, mbi transformimin revolucionar drejt shoqërisë pa klasë etj., burokracinë e sheh në radhë të parë si shprehje dhe faktor të tjeterësimit të politikës dhe të funksioneve drejtuese, Veberi burokracinë e lidh kryesisht me momente si janë kompleksësia e shoqërisë, ndarja e punëve etj., dhe e sheh atë si administratë e punë zyre, si moment teknik dhe si shprehje të procesit të racionalizimit, që e karakterizon kohën e re. Ky fakt, që kemi të bëjmë me dy koncepte të burokracisë, me ndryshime të konsiderueshme, është i rëndësishëm jo vetëm për të parë shkallën e depërtimit të njërit dhe tjetrit mendimtar në thelbin e fenomenit të burokracisë, të karakterit dhe të funksionit të saj, por edhe për të evitar krahasime të paqëlluara dhe konkluzione të pavend. Kështu do të evitoj për shembull, që të proklamohej utopi mendimi për shuarjen e burokracisë, të mos shihet karakteri historik i saj.

Në koncepcionin e Marksit për burokracinë, veçanërisht në *Kritiken e filozofisë hegeliane* të së drejtës, ka elemente relativisht abstrakte, por ky koncepcion konkretizohet në veprat e mëvonshme, për t'u bërë në *Luftën civile* në Francë, të thuash, program i veprimit politik. Përkundrazi, koncepcioni i Veberit për burokracinë është formalist dhe i formalizuar. Duke dashur të krijojë *tipin ideal* të burokracisë e të raporteve burokratike, Veberi abstrakton shumë karakteristika thelbësore të saj. Kështu, p.sh., ai i zhvesh rapportet e organizatës burokratike nga interesat individuale e grupore të pjesëmarrësve në to, pretendon që njerëzit e administratës të punojnë vetëm sipas ligjit, normës, vetëm sipas detyrës, të jetë plotësisht e ndarëjeta e tyre private nga ajo zyrtare, të jenë në mes vete dhe me të tjerët në raporte të një racionaliteti apersonal. Mylla-sysh ignorohen arbitrariteti i pushtetmbajtësve, shpër-

dorimet e hierarkëve, korrupsiioni i administratës, interesat individuale dhe grupore të ofiqarëve, mandej vërsia e përcaktimit të kushteve dhe të mjeteve të veprimit të burokracisë nga raportet klasore, kombëtare, shoqërore-politike, etj. Ku shfaqen këto momente, aty rapportet nuk janë thjesht burokratike, thotë Veberi. Por këto momente, këto »deformitete« janë aq të shumta e të shpeshta sa e karakterizojnë esencialisht burokracinë dhe funksionimin e saj aq sa, do të mund të thuhet se pa to as nuk ka burokraci. Të shtojmë edhe se sipas Lukaqit, ky formalizëm sociologjik ka kushtëzim dhe funksion shoqëror. Problemi kryesor i sociologjisë gjermane në periudhën e imperializmit, para Luftës së Parë, shkruan Lukaqi, ishte të krijonte një teori mbi thelbin e kapitalizmit dhe të mundte teorinë shoqërore të marksizmit. Veberi e sheh thelbin e kapitalizmit në »racionalizmin e jetës ekonomiko-sociale« dhe në »mundësinë racionale të kalkulimit të të gjitha fenomeneve«. Veberi — vazhdon Lukaqi — »polemizon herë-herë kundër formalizmit të Zimelit, por sociologja e tij është plot analogji të tillë formaliste. Kështu, p.sh. në mënyrë formaliste barazohen burokracia e Egjiptit të vjetër me socializmin«. Me formalizëm të tillë nuk arrihet përtej konstruimit të tipeve të caktuara, »përcaktimit të tiplogjisë dhe mbërthimit të fenomeneve historike në këtë tipologji«.<sup>58</sup>

Cilësitë e burokracisë me qartësi e saktësi të pamohueshme i përcaktoi Veberi, shkruan V. Goati dhe këtë mendim e thonë edhe autorë të tjera që trajtojnë Veberin ose problemin e burokracisë. Dhe, vërtet, është meritë e pamohueshme e tij që depërtoi thelle në përcaktimin e organizimit, të strukturimit, të funksionimit të organizatës burokratike, të raporteve brenda saj. Por, po të merret ky kontribut në trajtë të kategorive të kompetencës, të hierarkisë, të kushteve dhe të mjeteve rigorozisht të përcaktuara të veprimit, të relacio-neve eprore-deprore, të kontrollit nga lart dhe të mundësisë së ankesës, të raporteve apersonale, të veprimit vetëm sipas ligjit e detyrës, të ndarjes së punëve zyrtare nga ato private, të shkollimit të zyrtarëve dhe të kualifikimit të tyre, të rrogës në para dhe të mundësisë së avansimit etj., dhe, përvèç këtyre, në formë të racionilitetit të burokracisë, vështirë të jetë kjo një »ve-për vigane« përballë kontributeve minore të mendimtarëve të tjere. Sepse, shumë nga këto përcaktime janë, të thuash, të nivelit empirik, të prekshme me dorë, kurse gati të gjitha këto kategori, jo vetëm që mund të thuhet se gjenden edhe të Marksi, por gjenden edhe te shumë autorë të tjere, janë të thuash kategori të kohës.

<sup>58</sup> Gjergj Lukaq, *Razaranje uma*, Beograd 1966, f. 479.

Eshtë meritë e Veberit që sistematikisht studioi organizimin burokratik edhe jashtë strukturës shtetërore, në ekonomi, në konfesione, në kulturë, etj., ndonëse as këtu nuk mund të thuhet se ishte i pari e i vërtmi. Të kujtojmë vetëm studime e Ostrogorskit dhe të Mihelsit për burokratizimin e partive, të Trelçit për hie-rarkinë kishtare, etj.

Një ndër çështjet e diferençimit më të madh të Marksit dhe të Veberit rrëth burokracisë është çështja e iracionalitetit apo racionalitetit, mosefikasitetit apo efikasitetit të saj. U tha se, për Marksin, burokacia është një strukturë shtypëse, një organizëm parazitar që mbyll poret e jetës shoqërore, që imponon interesat e saj si të përgjithshme dhe dëshiron të vihet mbi shoqërinë, se është e plogësht, joefikase, që trillon nevoja ireale dhe imponon probleme të paqena, etj. Përkundrazi, për Veberin, burokacia është racionale efi-kase, objektive, precize, sistematike, e shpejtë në vep-rim, etj.

Që të mos përsërisim konfrontimin e Marksit dhe të Veberit për këtë çështje, po përmendim se pas tyre, jo vetëm sociologjia e orientimit marksist, por as sociologjia borgjeze nuk pranoi pikëpamjen mbi racionalitetin dhe efikasitetin e burokracisë. Përkundrazi, shumica e autorëve theksojnë anët negative të burokracisë, burokacia përshtkuhet si »hibrid i neveritshëm«. Për të paraqitur negativitetet e burokracisë, Torsten Veberi krijoi shprehjen dhe konceptin *trained incapacity* (pa-aftësi e ushtruar) që shpreh paefikasitetin inherent të burokracisë dhe që ka përdorim të gjërë në sociologjinë e sotme. Ngjashëm u krijuan konceptet e »psikozës profesionale«, të »deformimit profesional« etj.

Konceptin e Veberit të racionalitetit funksional dhe të efikasitetit të burokracisë e kundërshton edhe Robert Mertoni, një ndër sociologët më të shquar të sotëm dhe, do të ndahemi te mendimi i tij, për të parë, sadopak, sesi trajtohet ky fenomen në sociologjinë boshkëkohore.

Përkundër Veberit, Mertoni flet për *disfunksionalitetin* e burokracisë. Veberi, në shqyrtimet e tij, theksoi vetëm të arriturat e burokracisë, precizitetin, sigurinë, etj. Por, sipas Mertonit, e njëjta strukturë (bu-rokracia) mund të shqyrtohet edhe nga aspekti i mos-sukseseve të saj. Dhe, shikuar nga ky aspekt, burokacia na del me shumë të meta. Paaftësia e ushtruar e administratës shfaqet shpeshherë si mungesë elasticiteti, adekuatësie, përshtatshmërie në situatat e reja, si veprim i njëlljojtë, pavarësisht nga situatat e krijuara. Por, disfunksionaliteti i burokracisë shfaqet edhe më fuqishëm në formë të shndërrimit të rutinës dhe të stilit burokratik në qëllim të saj. Struktura burokra-ti-

ke kërkon nga nëpunësit të jenë sistematikë e të disiplinuar, t'u përbahen gjithsesi rregullave, të krijojnë ndjenja të fuqishme të përpikmérise e të respektimit të rregullave. Kështu absolutizohen disiplina, përpikmëria, respektimi i rregullave dhe vendin e qëllimeve të organizatës e zë mënyra e veprimit. Respektimi rigoroz i rregullave, që do të duhej të ishte *njet*, bëhet qëllim për vete, spostohet qëllimi dhe »vlera instrumentale bëhet vlerë definitive, qëllimore«. Për këtë arsyе *administrata* është e ngathët, e paaftë përt 'u përshtatur, *formaliste*, ajo *ngul këmbë* në *procedure*, në *rregulla* edhe kur të jenë ato të *panevojshme* e të *tepërtë*. Mund të ndodhë edhe që ky formalizëm e ritualizëm, ky insistim në rregulla e në procedure të bëhet për realizimin e qëllimeve të organizatës, të paralizojë veprimin e saj. Virtuozi burokratik, që di çdo rregull, shpesh mund të jetë duarlidhur dhe fare i paaftë për veprim. Lidhja e administratorit për rregulla, përpikëria dhe disiplina e tij rrjedhin edhe nga varësia e tij nga organizata burokratike, nga lidhja e jetës së tij me rrogën, privilegjet, avansimet, karrierën. Këto bëjnë që ai të fetishizojë rregullën, urdhëresën, respektimin e tyre.

Gjithnjë duke trajtuar burokracinë si administratë, si edhe Veberi, Mertoni kritikon edhe apersonalitetin e raporteve burokratike, të cilin e shquante Veberi. Duke fetishizuar rregullën, veprimi i administratës është skematik, stereotip, nuk arrin të shohe e të vlerësojë të veçantën, specifikën, shndërrrohet në një qëndrim arrogant e të pashpirtë. Mandje, thotë Mertoni, burokrati, në rolin e tij zyrtar, ka pak pushtet. Por, në sjelljet e tij, në qëndrimin ndaj palëve, për shembull, pavareisht nga vendi që zë brenda hierarkisë, vepron si përfaqësues i fuqisë së tere strukturës, madje me një arrogancë që shpesh është në disproporcion me vendlindin që zë në hierarki. Por, përkundër apersonalitetit të shpeshtë ndaj të tjereve, brenda strukturës burokratike marrëdhëniet janë të personalizuara, prandaj burokracinë e karakterizojnë edhe korrupcioni, favorizmi, nepotizmi, servilizmi etj.<sup>59</sup>

Një pikë tjetër e dallimit qenësor të pikëpamjeve të Marksit dhe Veberit për burokracinë është çështja e perspektives së saj, vecanërisht e perspektivës së burokracisë në socializëm. Marks, si u tha, duke mos e parë burokracinë si administratë, por si pushtet të tjetësuar dhe përfaqësuesë të interesit pseudo të përgjithshëm, zhilloi pikëpamjen mbi shuarjen e shtetit dhe të burokracisë në shoqërinë pa klasë. Në *Luftën civile* në Francë, duke analizuar përvojat e Komunës së Parisit, Mar-

<sup>59</sup> Përbledhja: »Birokratija i tehnokratija«, I, Beograd, 1966, f. 239—248.

ksi paraqiti qartë pikëpamjen se shuarja e burokracisë do të thotë jo heqje e administratës dhe e funksioneve të koordinimit, drejtimit etj., por heqje e funksioneve të tjetërsuara nga shoqëria, e monopolit, e sundimit mbi shoqërinë dhe e privilegjeve. Përkundrazi, Veberi duke e parë burokracinë si administratë, mbron pikëpamjen se burokracia në të ardhshmen do të zgjerohet dhe do të fuqizohet. Edhe në socializëm, të cilin Veberi e shih-te vetëm si socializëm shtetëror. Për këtë arsy, për shkak të këtij pohimi, pikëpamja e Veberit u përqafua gjerësisht në sociologjinë borgjeze, »tematika veberiane mbi burokratizimin përvjetori sukses të jashtëzakonshëm«. Sepse, kur u shterren argumentet kundër socializmit nga arsenali i Bernshtjanit dhe i revizionizmit, argument kryesor mbetet burokratizimi në socializëm.<sup>60</sup> Por edhe këtu, sado që në fillim mund të duket se koha i dha të drejtë Veberit dhe përkundër »klithjeve triumfale« të disa »veberianëve«, nuk mund të thuhet se u dëshmua pikëpamja e Veberit dhe se triumfoi mendimi mbi përparrësitë teknike të strukturave burokratike krahasuar me format dhe me raportet demokratike.

Më në fund, Veberi, duke i konsideruar si racionale dhe efikase strukturat burokratike, nuk i konsideron ato edhe moralisht të dëshiruara, për arsyen humane e dënonë burokratizimin e shoqërisë, druante dhe shqetësohej për të dhe kjo përbën arsyen kryesore të pësimizmit të Veberit për të ardhshmen e shoqërisë njerëzore. Rryma demokratike në sociologjinë e sotme, si dëshmon rasti i Rajt Milsit, me sukses e shfrytëzon traditën veberiane, për të argumentuar arrogancën dhe papërgjegjësinë e elitës së pushtetit, të burokracisë së sotme. Përkundrazi, orientimi djathtist në sociologjinë e sotme, përkundër trajtimit të burokracisë si dhunë e forcë nga ana e Veberit, përpinqet të krijojë iluzione për burokracinë si gjë e përditshme, me të cilën mund dhe duhet të mësohem, kurse kritikën e drejton kundër shoqërive gjëja totalitare të Lindjes, shoqëri të dhunës dhe të mungesës së lirive individuale.

---

<sup>60</sup> J. M. Vincent, *Veberi apo Marks*, »Marksizam u svetu«, 9/1977, f. 24.

Fehmi Agani

## BUREAUCRACY, MARX AND WEBER

*This paper is a comparative essay on Marx' and Weber's theories on bureaucracy and on the place of their views on bureaucracy among their general sociological systems.*

After having stressed that bureaucracy is an old social phenomenon, which, in modern sense and dimensions, as an important element and structural political factor, is a product of these last centuries, it is also discussed the fact that theories interested in this phenomenon are also old, but the first modern theory on bureaucracy is Hegel's.

Marx's views on being, essence, manifestation forms, functions, place and social role and on socio-psychological characteristics of bureaucracy are presented; the negative character and the class function of bureaucracy are clearly distinguished. Different author's views on Marx' conception are discussed and it is concluded that even nowdays Marx's theory on bureaucracy is the central one.

Weber's conception on bureaucracy, and its features, on its organization, on the structuring and functioning of rationalisation of bureaucracy, takes a large part of the paper. Some of different evaluations of the Weber's conception on bureaucracy are critically discussed.

After comparing two theories, it is criticised especially the formalism of the Weber's conception and his view on bureaucratic rationality (efficiency). It is stressed that the latter sociology, having characterized bureaucracy with concepts like trained incapacity (Veblen), and stressing its dysfunctionality (Marton and others), in fact does not accept the idea of bureaucratic rationality.



**asllan  
pushka**

**NIVELI  
I KONCENTRIMIT  
EKONOMIK  
DHE POPULATIV  
NË KSA  
TË KOSOVËS**

**H Y R J E**

**M**e kalimin e shoqërisë prej nivelit të ulët të zhvillimit në atë më të lartë, vjen e rritet koncentrimi i parametrave ekonomikë e së bashku me të edhe popullsia. Koncentrimi ekonomik e populativ është ligji i zhvillimit prej shoqërisë agrare në atë industriale dhe postindustriale.

Ligji i koncentrimit del nga organizimi i punës në industri e veprimitari shërbyese si dhe nga ligji i zvogëlimit të popullsisë bujqësore, si rezultat i mekanizmit në bujqësi dhe zëvendësimit të fuqisë punëtore me mjetet bashkëkohore të punës në këtë veprimtarit.

Industria karakterizohet me koncentrim të mjeteve të punës dhe të fuqisë punëtore në hapësirë relativisht të vogël, sikurse edhe veprimtaritë shërbyese, kurse bujqësia, e cila për objekt të punës-prodhimit i ka sipërfaqet bujqësore, gjegjësisht ato të punueshme, ka shtrirje të gjërë sipërfaqësore.

Derisa bujqësia ishte dega kryesore ekonomike, me të merrej pjesa dërrmuese e popullsisë, e cila jetonte në fshatra për t'iu afruar sa më tepër sipërfaqeve bujqësore si objekt i punës. Veprimtarisë bujqësore, pra, i përgjigjej vendbanimi i fshatit, ngase këte e përcaktonte vendi i punës dhe i banimit, dy funckione shumë të rëndësishme jetësore. Objekti i punës, pra, e përcakton lokacionin ku kryhet funksioni i punës, e jo larg tij (afér tij) edhe lokacioni i banimit.

Me zhvillimin e mjeteve të punës, krijohen mundësitë përpunimin e lëndëve të para dhe prodhimin e të mirave të ndryshme materiale, në lokacione të zgjedhura, ku faktorët e vendosjes dhe të zhvillimit ndikojnë në mënyrë optimale.

Organizimi i punës, koncentrimi i mjeteve të punës, përdorimi i energjisë në lokacione të zgjedhura, në hapësirë relativisht të vogel, ka ndikuar dhe po ndikon në koncentrimin e fuqisë punëtore, të mjeteve, të mirave materiale, të ardhurës së krijuar etj. Me koncentrimin e fuqisë punëtore në qendrat e punës, objektet e ndryshme industriale e infrastrukturore, koncentrohet edhe popullsia në afersi të tyre. Numri i banorëve që vendoset në vendbanime të tilla është për 2—5 herë më i madh sesa numri i të punësuarëve, varësisht prej numrit të anëtarëve në familje, respektivisht prej rapportit të numrit të anëtarëve aktívë dhe të mbajtur.

### *Metodologja dhe metadat e punës*

Për të treguar në nivelin e koncentrimit ekonomik dhe popullativ kemi marrë në shqyrtim 7 parametra ekonomikë e demografikë:

1. Popullsia sipas komunave në vitin 1981,
2. Popullsia e punësuar gjithsej në vitin 1981,
3. Popullsia e ardhur (imigruar) në periudhën 1971/81,
4. Vlera e të ardhurave gjithsej në Komunë, viti 1980,
5. Vlera e mjeteve themelore sipas shënimeve të vitit 1980,
6. Produkti shoqëror i sektorit shoqëror në vitin 1980,
7. Shtimi natyror në periudhën 1971—1980, vlerat absolute.

Për ta llogaritur koeficientin e koncentrimit të Ginisit<sup>1</sup> dhe të asocimit<sup>2</sup>, është dashur të llogariten vlerat e pjesëmarrjes së çdo komune në vlerën e përgjithshme të Krahinës për parametrin e caktuar dhe pastaj vlerat relative t'i kumulojmë dhe pastaj t'i rangojmë komunat prej vlerës më të vogël deri në vlerën e fundit më të madhe.

<sup>1</sup> Koeficienti i koncentrimit të Ginisit llogaritet sipas formulës:  $Kg = \frac{\sum p(X_i) \cdot q(X_i - 1)}{\sum q(X_i) \cdot p(X_i - 1)} \cdot 100$ , shiko librin e Milosh Blazheviqit: Opšta statistika, Beograd, 1971, fq. 268/269.

<sup>2</sup> Koeficienti i asocimi llogaritet sipas formulës:  $Kas = 1 - \frac{(\sum d)}{100}$ , me ç'rast d është shuma e ndryshimit të vlerave të pjesëmarrjes së njerit dhe parametrit tjetër pa marrë parasysh shenjen.

Kësaj radhitje i përshtatet edhe renditja e komunave për parametrat e tjerë. Në këtë mënyrë e shohim lidhshmërinë e koncentrimit të popullsisë sipas komunave ndaj parametrave të tjerë të lartëpermendur.

Koeficienti i koncentrimit të Ginisit llogaritet me vlerat e kumuluara të dy parametrave çiftë, kurse ai i asociiimit me vlerat e pjesëmarrjes së parametrave çiftë.

Ndërmjet vlerave të koeficientit të koncentrimit dhe asociiimit kemi diktuar lidhje negative, sepse me rritjen e vlerave të koeficientit të koncentrimit (Ginisit), zvogëlohen vlerat e koeficientit të asociiimit.

Më tutje kemi llogaritur edhe vlerat e koeficientit të asociiimit të shtrirjes së popullsisë ndaj vlerave të shpërndarjes së të punësuarëve në disa veprimtari, si kurse edhe të punësuarve gjithsej dhe atyre në industri ndaj atyre në disa veprimtari.

### *Analiza e rezultateve*

Së pari do të cekim se koeficienti i koncentrimit të popullsisë në vitin 1981 (ndaj sipërfaqeve gjithsej) në Kosovë është i ulët, vetëm 15,3 në krahasim me vlerën në RF Gjermane, i cili në vitin 1971 ka qenë 78,6<sup>3</sup>. Indeksi i koncentrimit<sup>4</sup>) për RF Gjermane për vitin 1946 ka qenë 55,6, për vitin 1970 64,2 dhe për SHBA në vitin 1950 58,9. Për KSA të Kosovës vlerat e koeficientit të Ginisit në vitin 1948 dhe 1981 kanë qenë 33,4 dhe 42,4, ndërsa vlerat e indeksit të koncentrimit 28,3 dhe 37,5 (por për sipërfaqe sipas izohipsave).

Këto vlera tregojnë se koeficienti dhe indeksi i koncentrimit të popullsisë në KSAK është shumë më i vogël sesa në shtetet e cekura me shkallë të lartë të zhvillimit.

Në bazë të analizës së shpërndarjes së popullsisë bujqësore dhe sipërfaqeve bujqësore e atyre të punueshme, kemi konstatuar se sa më e ulët që është shkalla e zhvillimit ekonomiko-shoqëror, aq më e lartë është përputhja në mes shpërndarjes së popullsisë në përgjithësi dhe asaj bujqësore në veçanti me sipërfaqet bujqësore dhe të punueshme. Sa më larg që shkon niveli i zhvillimit ekonomik e shoqëror aq më e lartë është shkalla e koncentrimit të popullsisë dhe e fuqise punëtore, e në anën tjeter më e ulët është përputhja me sipërfaqet bujqësore e të punueshme. Kështu, në Kosovë koeficienti i korelacionit në mes pjesëmarrjes së

<sup>3</sup> Jürgen Bähr: Bevölkerungsgeographie, 1984, fq. 45.

<sup>4</sup> Ibid, faqe 45, Indeksi koncentrimit llogaritet sipas formu-

lës:  $I_k = \frac{1}{2} \sum (X_i - Y_i)$ .

popullsise bujqësore e sipërfaqeve bujqësore për vitin 1971 ishte 0,942, e në vitin 1981 0,929<sup>5</sup>. Koeficienti i asociimit po ashtu tregon trend të zvoglimit me kalimin e kohës prej 0,725 në vitin 1971 në 0,608 në vitin 1981.

Koeficienti i koncentrimit të Ginis-it në mes popullsise dhe punësimit është 28,2, ndërsa i sipërfaqeve dhe i popullsise punëuar 41,4 ose 2,7 herë më e lartë se vlera e koeficientit të Ginisit për sipërfaqe — popullsi, apo 1,47 herë më e lartë se vlera në mes popullsise dhe punësimit. Kështu, 10,5% e popullsise në 5 komunat më të vogla kanë pasur 5,6% të punëuarve, kurse në 15 komuna më pak të zhvilluara ku jetojnë 46,5% të popullsise janë të punëuar 22,9%. Në shtatë komuna të tjera, qendra rajonale, në 53,5% të popullsise është koncentruar 77,1% e të punëuarve. Vetëm në komunën e Prishtinës e cila në vitin 1981 merrte pjesë me 13,2% në numrin e banorëve të Kosovës, ka pasur 30,2% të të punëuarve të Krahinës.

Koncentrimi i tillë i të punëuarve në komunat qendra regionale është si rezultat i ndikimit të faktorit historik, gjeografik, i politikës ekonomike etj. Ekzistimi i qendrave urbane, në të cilat ka qenë edhe më parë e zhvilluar zejtaria, më pak industria, tregtia dhe disa veprimtari të tjera, me zhvillimin e industrisë dhe të funksioneve administrativo-politike, social-kulturore, shëndetësore etj., u krijuat mundsia për një punësim relativist më të madh sesa në komunat e tjera që nuk i kishin këto veçori. Faktori gjeografik ka ndikuar me prezencën e pasurive natyrore, të përparësive në pozitën gjeografike, të lidhjeve komunikative, të fuqisë punëtore dhe ekzistimin e traditës zejtare, etj.

Zhvillimi i shtatë qendrave rajonale ka mundësuar formimin e »poleve zhvilluese« të cilat është dashur të shërbejnë si qendra të lokacionit të aktiviteteve ekonomike dhe joekonomike, e të cilat më tutje do të ndikonin në rrëthinën e tyre duke ngritur objekte ekonomike e infrastrukturore.

Se a është dashur të veprohej kështu, është pyetje që kërkon përgjigje nga politika ekonomike dhe regionale e përcaktuar edhe në nivel të shtetit. Në politikën e zhvillimit regional të Kosovës, ka ndikuar, pamëdyshje, orientimi në shfrytëzimin e mineraleve me ngjyra dhe i thëngjillit në bazenin e Kosovës, në Mitrovicën e Titos dhe në Prishtinë (dhe rrëthinën e tyre), në kuadër të të cilave janë bërë investime të konsiderue-

<sup>5</sup> Asllan Pushka: Prirodni resursi i teritorijalna podela rada SAP Kosovo, Zbornik radova Jugoslovenskog simpozijuma »Geografski aspekt prirodnih i ljudskih resursa Jugoslavije«, Priština 1984, fq. 39.

shme. Prandaj, nuk është gjë e rastit se vetëm në komunën e Prishtinës në vitin 1980 ka qenë e koncentruar 40,5% e vlerës së mjeteve themelore, në atë të Mitrovicës së Titos 12,8% ose në të dy komunat 53,3% e vlerës së mjeteve themelore të Krahinës.

Në shtatë komunat qendra regionale në vitin 1980 ka qenë koncentruar 83% e vlerës së mjeteve themelore, kurse në vlerën e produktit shoqëror kanë marrë pjesë me 80,9%, pra diç më pak se vlera e mjeteve themelore.

Vlera e koeficientit të Ginisit në mes popullsisë dhe vlerës së mjeteve themelore për vitin 1980 ishte 37,5, kurse ai në mes popullsisë dhe produktit shoqëror 33,9. Ky koeficient për sipërfaqe dhe për vlerën e mjeteve themelore në vitin 1980 ka pasur vlerën 50,0, vlerë e cila tregon për një koncentrim të konsiderueshëm të mjeteve themelore ndaj hapësirës kosovare. Produkti shoqëror ndaj sipërfaqeve po ashtu tregon koncentrim të konsiderueshëm (46,9). Në mes mjeteve themelore dhe produktit shoqëror ekziston përputhje e lartë ( $Kas=0,84$ ), prandaj shpërndarja e tyre për banor dhe sipërfaqe tregon afërsi. Në 5 komuna me 10,5% të popullsisë (Leposaviq, Kaçanik, Dragash, Gllogovc e Deçan) është prodhuar 4,8% e vlerës së produktit shoqëror dhe në to gjendet 4,7% e vlerës së mjeteve themelore të Kosovës. Në 46,5% të popullsisë, në 15 komunat më pak të zhvilluara në 1980 kanë qenë vendosur vetëm 17% e vlerës së mjeteve themelore dhe 19,1% e produktit shoqëror, gjë që tregon për disproporcione të dukshëm në mes shpërndarjes së popullsisë, mjeteve themelore dhe produktit shoqëror.

Të ardhurat po ashtu janë produkt i shkallës së zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Shpërndarja e tyre ndaj popullsisë tregon një shkallë diçka më të ulët të koncentrimit ( $Kg=24,9$ ), sikurse edhe ndaj sipërfaqeve ( $Kg=38,6$ ), ngase shoqëria me instrumentet e sajë politike dhe ekonomike ndikon në zbutjen deri diku të diferençave ekonomike në kuadër të vetë Krahinës. Në 10,5% të popullsisë së 5 komunave janë realizuar 6,2% të të ardhurave e në 10 komuna, në të cilat në vitin 1981 jetonin 26,1% e popullsisë, në vitin 1980 u realizuan 14,1% të të ardhurave, kurse në 15 komunat më pak të zhvilluara u realizuan 26,3% e të ardhurave të Kosovës. Në 7 komunat relativisht më të zhvilluara, në të cilat në vitin 1981 jetonte 53,5% e popullsisë së Krahinës, në vitin 1980 ishte realizuar 73,7% e të ardhurave, e prej tyre vetëm në komunën e Prishtinës 28,5% (ndaj 13,2% të popullsisë së Kosovës), ndërsa në Mitrovicën e Titos 11,2% (ndaj 6,6% të popullsisë).

Në 6 komunat qendra regionale, përpos në komunën e Pejës, pjesëmarrja e të ardhurave të realizuara ishte më e lartë sesa pjesëmarrja e popullsisë së tyre.

Për të parë se a ndikon faktori ekonomik në lëvizjet e popullsise (imigrimin e saj) do të tregojmë në disa raporte të parametrave të marrë për këtë rast dhe popullsise së ardhur në periudhën 1971/80. Koeficienti i koncentrimit të Ginisit në mes popullsise dhe popullsise së ardhur është ndër më të ultit ( $Kg=12,8$ ), po ashtu edhe ndaj sipërfaqes ( $Kg=27,5$ ), ndërsa koeficienti i asociimit në mes popullsise së ardhur dhe të ardhurave është i konsiderueshëm ( $Kas=0,66$ ), e ai në mes popullsise së ardhur dhe produktit shoqëror pak më i vogël se ky ( $Kas=0,52$ ), por ende ka vlerë të konsiderueshme. Po ashtu, me rëndësi është vlera e konsiderueshme e koeficientit të asociimit në mes popullsise së ardhur dhe popullsise së punësuar ( $Kas=0,63$ ).

Këto vlera të koeficientit të asociimit na bëjnë të ditur se imigrimi varet dukshëm nga shkalla e zhvillimit ekonomiko-shoqëror (rreth 60%), mirëpo, në të ndikojnë edhe faktorë të tjera si: afërsia territoriale, kushtet natyrore, ndotja, mundësitet e shkollimit, klima shoqërore, situata ekonomike, çmimet dhe mundësitet për blerje të pronave të patundshme etj.

Te komunat më pak të zhvilluara, kryesisht më e lartë është pjesëmarrja e popullsise gjithsej, sesa e popullsise së ardhur, kurse të komunat relativisht më të zhvilluara, pjesëmarrja e popullsise së ardhur është më e lartë, përpos në komunën e Gjakovës e cila në popullsinë e Kosovës në vitin 1981 merrte pjesë me 5,8%, kurse në popullsinë e ardhur 4,3%. Një raport të tillë e hasim edhe në komunën e Pejës (7% popullsi të Krahinës ndaj 6,4% popullsi të ardhur në këtë komunë prej tërë popullsise së ardhur në Kosovë).

Në 13 komuna ekziston ndryshimi i vogël në pjesëmarrjën e popullsise së ardhur dhe të ardhurave të realizuara, kurse në 9 komuna ky ndryshim është diku më i lartë e diku më i ulët. Kështu, në Kamenicë më e lartë është pjesëmarija e popullsise së ardhur (3,1%) sesa e vlerës së të ardhurave (2,05%), sikurse edhe te Klina (3,3% ndaj 1,4%), pastaj te Vuçiterna (4,9% ndaj 1,8%) ose Podujeva (4,7% ndaj 1,8%). Këtij grupi i takon edhe Ferizaj me 8,7% të popullsise së ardhur dhe 4,5% të ardhurave krahinore. Këto komuna relativisht më pak të zhvilluara kanë pasur lëvizje pak më dinamike të popullsise brenda vetë komunës ose edhe nga jashtë, por këto kanë realizuar më pak të ardhura, ngase niveli i zhvillimit nuk ua mundëson vlerën më të lartë të të ardhurave.

Ndër komunat që kanë participim më të lartë të të ardhurave të realizuara sesa kishin popullsi të ardhur qoftë brenda komunës ose jashtë saj, janë komunat më të zhvilluara të Krahinës, (përpos Ferizajt, Pe-

jës, Gjilanit). Kështu, p.sh., Gjakova ka marrë pjesë 7,0% në të ardhurat e krijuara në Kosovë, Mitrovica e Titos 11,2% (ndaj 7,8% të popullsisë së ardhur), Prizreni 9,9% (ndaj 9,1%) dhe Prishtina 28,5% (ndaj 20,3% të popullsisë së ardhur).

Në 15 komuna më pak të zhvilluara në periudhën 1971/80 është vendosur 36,7% të popullsisë së ardhur ndaj gjithsej popullsisë së imigruar. Pjesa tjeter 63,3% e të ardhurave është vendosur në 7 komuna qendra regionale.

Ndaj shtimit natyror pjesëmarrja e popullsisë tregon koncentrim të ulët negativ ( $Kg = -3,1$ ), që do të thotë se komunat e pazhvilluara kanë realizuar shtim pak më të madh të popullsisë sësë e kanë popullsinë (49,9% shtim natyror ndaj 46,5% të popullsisë) kurse komunat relativisht më të zhvilluara kanë realizuar shtim më të vogël natyror sësë e kanë popullsi (50% shtim natyror ndaj 53,5% popullsi). Një dukuri e tillë është nòrmale, ngase komunat relativisht më të zhvilluara kanë normën më të ulët të shtimit natyror në krahasim me ato më pak të zhvilluara. Diferenca nuk është e theksuar, ngase norma e shtimit natyror të popullsisë edhe në komunat relativisht të zhvilluara të Kosovës, është relativisht e lartë. Koeficienti i koncentrimit të Ginisit në mes popullsisë së punësuar dhe shtimit natyror ka vlerën ( $Kg = -31,3$ ) që do të thotë se ky koeficient është 10 here më i lartë sësë ai mes popullsisë dhe shtimit natyror.

Në 5 komunat e para që kanë 5,6% të të punësuarve të Krahinës, kanë realizuar 10,9% të shtimit natyror të Kosovës (të vlerave absolute), ndërsa 10 komunat kryesisht më pak të zhvilluara (përpos Leposaviqit dhe Kaçanikut) që kanë pasur 12,4% të popullsisë, kanë dhënë 27,3% të shtimit natyror të ponullsisë, ose 2 herë më shumë kanë marrë pjesë në shtimin natyror sësë së punësim. Koeficienti i asociimit mes këtyre dy parametrate ka qenë ( $Kas=0,408$ ) në kufirin mes vlerës së konsiderueshme dhe asaj të ulët.

#### *Raporti mes popullsisë dhe pjesëmarries së popullsisë së punësuar në disa veprimtari*

Shpërndarja e popullsisë qëndron në përputhje të lartë me veprimtarinë e arsimit dhe të kulturës ( $Kas=0,70$ ), më që përhapja e shkollave, sidomos e atyre fillore dhe pjesërisht të mesme është e lidhur për shpërndarjen e popullsisë. Prej veprimtarive të tjera që kanë shpërndarje pak ma disperse është edhe tregtia, e cila në rastin tonë tregon asociim të konsiderueshëm ( $Kas=0,48$ ), por që në të ardhshmen duhet të

tregojë përhapje edhe ma dispërse sidomos për prodhimet që shpenzohen në kohë më të shkurtër (furnizimi ditor dhe favor).

Veprimtaria e administratës është diç më e koncentruar se arsimi e kultura por më dispërre se industria, ndërtimtaria ose se mbrojtja e shëndetësia. Në mes shpërndarjes së popullsisë dhe të punësuarëve në administratë kemi fituar koeficientin e asociimit ( $Kas=0,408$ ) në kufi të vlerës së konsiderueshme dhe të vogël.

Në 5 komunat e para më të vogla (10,5% të popullsisë) në arsim ishin të angazhuar 7,5% të të punësuarve dhe 5,5% në administratë. Në 10 komunat e para në arsim janë koncentruar 19,7% dhe në administratë 13,2% ose për gjysmë më pak sesa kanë popullsi.

Në 7 qendrat regionale është koncentruar 64,6% e të punësuarve në arsim e kulturë, kurse në administratë 77,8%.

Koeficienti më i ulët i asociimit në mes popullsisë dhe të punësuarve në industri dhe ndërtimtari, tregon për shkallën e lartë të koncentrimit të të punësuarve në industri, xehetari dhe ndërtimtari ( $Kas=0,369$  dhe  $Kas=0,304$ ). Kështu, në 15 komunat e zhvilluara në vitin 1981 në industri e miniera ishin të punësuar 20,2%, e në 7 komunat qendra regionale 79,8%, në ndërtimtari 86%. Vetëm komuna e Prishtinës në vitin 1980 kishte 28,6% të të punësuarve në industri e miniera, kurse në ndërtimtari 40,5%. Tri komunat me industri më të zhvilluara në Krahinë (Prishtina, Mitrovica e Titos dhe Gjakova) kishin 51,4% të të punësuarve në këtë veprimtari, kurse në ndërtimtari 55,3%.

#### *Raporti në mes industrisë dhe veprimtarive të tjera*

Se industria është veprimtaria kryesore ekonomike, që e nxit zhvillimin e veprimtarive të tjera, dihet qëmoti, mirépo, ne dëshironim ta vërtetonim këtë edhe në rastin e Kosovës. Kështu, në mes të punësuarve në industri e miniera dhe të punësuarve gjithsej ekziston koeficient i lartë i asociimit (përputhshmërisë  $Kas=0,827$ ). Përputhje të lartë punësimi në industri tregon me tregtinë ( $Kas=0,763$ ), mbrojtje e shëndetësia ( $Kas=0,714$ ) përputhje të konsiderueshme në hoteleri e turizëm ( $Kas=0,678$ ), administratë ( $Kas=0,669$ ), transport e lidhje ( $Kas=0,642$ ), ndërtimtari ( $Kas=0,637$ ) dhe arsim e kulturë ( $Kas=0,583$ ). Koeficient shumë të ulët associimi tregon vetëm me bujqësinë e peshkatarinë (sektori shoqëror,  $Kas=0,187$ ), që do të thotë se në zhvillimin e bujqësisë të sektorit shoqëror nuk ka ndikuar zhvillimi i industrisë, ose ka ndikuar më pak, ngase

kjo veprimtari në sektorinë shoqëror lidhet për sipërfaqet të cilat janë hapur në mes viteve 1950—1960 në pjesët e brendshme të Krahinës në sipërfaqet e dikurshme me shkurre, lëndina e pyje të ulëta.

Në 15 komunat më pak të zhvilluara të Kosovës, në të cilat në vitin 1981 ishin të punësuar 20,2% në industri e miniera, në bujqësi e peshkatari të sektorit shoqëror qenë punësuar 47,6%, në ndërtimtari 14,0%, transport e lidhje 18%, tregti 22%, hoteli i turizëm 16,8%, administratë 22,2%, arsim i kulturë 36,4% dhe mbrojtje e shëndetësi 18%.

Prej grupit të komunave më pak të zhvilluara; Kançaniku, Leposaviqi e Lipjani kanë pjesëmarrje pak sa më të lartë të të punësuarve në industri e miniera sesa është pjesëmarrja e tyre në popullsi dhe të punësuar gjithsej, ngase në këto komuna gjenden nga disa objekte xehtarie dhe të industrisë të bazuar në lëndën e tyre të parë.

Komuna të kosovare që kanë më shumë të punësuar në industri e miniera, i kanë më të zhvilluara edhe veprimtaritë e tjera ekonomike e shërbysese, mëqë zhvillimi i industrisë nxit zhvillimin e shumë veprimtarive të tjera me të cilat është e lidhur në mënyrë direkte e indirekte. Më tutje mund të konstatohet se me koncentrimin e industrisë, koncentrohen edhe veprimtaritë e tjera në hapësirë më të vogël, e kjo në kushtet e normës më të ulët të punësimit do të thotë diferencim i lartë regional, duke shkaktuar kështu varférin në zhvillim të disa territoreve dhe të popullsisë në to. Sipas këtyre vlerësimeve del se faktor i diferencimit apo i zhvillimit të barabartë territorial është industria, varësisht sësí lokalizohet ajo, në mënyrë të koncentruar apo dispërvizive.

Lokacioni dispërviziv i industrisë, por që në aspektin territorial e ekonomik është i lidhur mirë si në pikëpamje horizontale ashtu edhe vertikale, mund të pengojë paraqitjen e diferencave të dukshme regionale, që është edhe synim i zhvillimit në shoqërinë sociale.

Faktori i rëndësishëm që e mundson politikën e tillë regionale është zhvillimi i komunikacionit dhe i sistemeve komunikatave të tjera që i mundësojnë lidhjet e mira në të gjitha pjesët e regionit dhe të vendit.

Politika e »poleve ekonomike« praktikohet edhe te ne dhe ajo i ka përparrësitë e veta, mirëpo, »polet ekonomike« nuk duhet të kuptohen si lokacione të

vetme, por si bashkësi e lokacioneve në vendbanimet satelite për rreth qendrave e edhe më larg tyre, nëse ka kushte optimale për vendosjen e tyre.

Eshtë fakt i pamohueshëm se Kosova ka trashë-guar një strukturë joracionale të vendbanimeve, mëqë ka shumë vendbanime të vogla (nën 1000 banorë 73,1%, kurse në Vojvodinë 18,8%) me distancë mesatare në mes tyre rreth 3 km (në Vojvodinë rreth 8 km) në Serbinë Lindore 3,3 km).<sup>6</sup> Kjo strukturë joracionale e vendbanimeve ka kushtëzuar shpërndarjen joracionale të fuqisë punëtore dhe e pengon më tutje shpërndarjen e objekteve ekonomike dhe infrastrukturore.

Numri i madh i vendbanimeve të vogla nuk mund të bëhen »bërthama ekonomike« për ngritjen dhe zhvillimin e veprimtarive sekundare e terciare, ato mund të jasin fuqi punëtore për bujqësi dhe migrues ditor për veprimtaritë e tjera, që zakonisht vendosen në vendbanime më të mëdha. Zhvillimi bashkëkohor i ekonomisë së zhvilluar kërkon vendbanime relativisht më të mëdha, mbi 5000 e 10.000 banorë, ku mund të bëhet koncentrimi i fuqisë punëtore për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike e joekonomike. Përendryshe, vendbanimet e vogla, vetëm në raste të veçanta mund të janë atraktive për vendosjen e objekteve të ndryshme ekonomike, ngase nuk kanë as fuqi punëtore e as konsumues të nevojshëm — të mjaftueshëm.

Ekonomia bashkohore kërkon strukturë racionale të vendbanimeve, që në bujqësi ofrojnë sipërfaqe të mjaftueshme bujqësore e sidomos të punueshme për ekonomi me prona relativisht më të mëdha (në mes 5 e 10 ha për kushtet tona), kurse për industri e veprimtaritë tjera ofrojnë fuqi adekuate punëtore dhe konsumues të mjaftueshëm.

Mëqë kufiri i përparshëm i vendbanimeve fshatare është përcaktuar në bazë të komunikacionit primitiv (në këmbë, qe e kuaj) edhe distanca e tyre kryesisht ka qenë më e vogël, si në rastin e Kosovës rreth 3 km. Sot me përdorimin e traktorëve dhe të mjetave të tjera të transportit (kamiona, kombajna etj.) kufijtë e vendbanimeve do të ishin optimalë, së paku nëse në mes tyre ka 5 — 10 km distancë.

<sup>6</sup> Jovan Žikić: *Kvantitativne karakteristike prostornog rasporeda naselja u Istočnoj Srbiji, »Kërkime gjeografike«*, nr. 7, Prishtinë, 1986.

Në komunën e Borit distanca në mes vendbanimeve fqinje është 6,6 km.

Në vendet e zhvilluara hapësira agrare është »zbra zur« nga fuqia e tëpërt punëtore duke e mundësuar rritjen e pronave dhe të prodhimit me përdorimin e mekanizmit dhe të masave të tjera agroteknike. Kësh-  
tu, p.sh., në Amerikën Veriore bujqësia është organizuar në ferma, në shumicën e vendeve socialistë në prona kooperativiste dhe shtetërore që gjithnjë kanë tendencë të rritjes së sipërfaqeve, duke u zvogëluar numri i tyre.

Në vendin tonë me procesin e deagrarizimit shumi-  
ca e vendbanimeve të vogla e kanë »humbur« popull-  
sine e vet, mëqë ajo është vendosur në vendbanimet qendrore, ku janë vendosur objektet ekonomike dhe infrastrukturore.

Me zvogëlimin e numrit të vendbanimeve të vogla do të shkaktohej rritja e hapësirës agrare rrëth vendbanimeve, numerikisht më të vogla, por me numër më të madh të banorëve, të cilët do të mund të inkudrohen në disa veprimitari — funksione. Punësimi në veprimtaritë jobujqësore në vendbanimet e tillë do të mundësonte mbetjen në bujqësi të atyre që kanë kushte dhe do të jenë prodhues tregu.

Viset me strukturë ma racionale të vendbanimeve ma vështirë mbisin pa fuqi punëtore në bujqësi ose në degët e tjera, ngase transferi i popullsisë nga bujqësia në veprimtaritë e tjera do të ishte më i lehtë, pa humbje të konsiderueshme të popullsisë.

Në vendin tonë, në viset ku shtimi i popullsisë është më i ulët dhe ku ekonomia është zhvilluar me ritëm më të shpejtë është shkaktuar »erozioni social«, eksodusi rural dhe plakja e popullsisë, sidomos e asaj bujqësore, e cila nuk është në situatë ta intensifikojë prodhimtarinë bujqësore. Procesi i deagrarizimit i ka përfshirë sidomos vendbanimet në viset bregore e malore, mëqë zhvillimi bashkohor është përqëndruar kryesisht në viset e ulëta dhe në vendbanimet më të mëdha.

Deri te struktura racionale e vendbanimeve mund të arrihet gradualisht me ndihmën e politikës regjionale, gjegjësisht të lokacioneve dispërzive por të lidhura mirë, pastaj me politikën afatgjatë të rritjes së pronave dhe me ndërprerjen e fragmentimit të tyre dhe me lokalizimin e vendbanimeve në zonat morfologjike, në skajet e fushave, ku sipërfaqet e punueshme do të pëndoreshin për bujqësi e ato të tjerat për blegëtori, pylltari dhe degë të tjera.

*Niveli i koncentrimit territorial të parametrave  
demografiko-ekonomik në KSA të Kosovës  
Participimi i komunave në gjithë vlerën e Krahinës*

Komunat	Popullsia gjithsej e v. 1981		Popullsia e punësuar v. 1981		Shtimi natyror 1971/80		Popullsia ardhur 1971/81		Të ardhurat gjithsej v. 1980		Vlera e mjeteve themelore sekt. shoq. v. 1980		Vlera e produktit shoqëror sekt. shoqëror v. 1980	
	fr	fk	fr	fk	fr	fk	fr	fk	fr	fk	fr	fk	fr	fk
1. Leposaviqi	1,1	1,1	1,6	1,6	0,44	0,44	1,47	1,47	1,71	1,71	2,25	2,25	1,71	1,71
2. Kaçaniku	2,0	3,1	1,6	3,2	2,22	2,66	1,23	2,70	0,95	2,66	1,33	3,58	0,98	2,69
3. Dragashi	2,2	5,3	0,6	3,8	2,11	4,77	0,78	3,48	0,72	3,38	0,18	3,76	0,35	3,04
4. Glllogovci	2,6	7,9	0,8	4,6	3,26	8,03	1,7	5,18	1,51	4,89	0,36	4,12	0,99	4,03
5. Deçani	2,6	10,5	1,0	5,6	2,86	10,89	1,28	6,46	1,29	6,18	0,54	4,66	0,81	4,84
6. Sérbiça	3,0	13,5	1,3	6,9	3,46	14,35	1,94	8,40	1,12	7,30	0,62	5,28	0,71	5,55
7. Vitia	3,0	16,5	1,0	7,9	3,23	17,58	1,90	10,30	1,42	8,72	1,07	6,35	0,95	6,50
8. Kamenica	3,0	19,5	1,9	9,8	2,76	20,34	3,12	13,42	2,05	10,77	1,85	8,20	1,58	8,08
9. Istogu	3,2	22,7	1,3	11,1	3,09	23,43	2,35	15,77	1,75	12,52	0,75	8,95	1,24	9,32
10. Klina	3,4	26,1	1,3	12,4	3,83	27,26	3,29	19,06	1,44	13,96	0,60	9,55	0,77	10,09
11. Suhareka	3,8	29,9	2,4	14,8	4,52	31,78	2,74	21,80	3,20	17,16	1,89	11,44	2,68	12,77
12. Lipjanë	3,8	33,7	2,6	17,4	3,88	35,66	3,12	24,92	2,83	19,99	2,64	14,08	2,39	15,16
13. Rahoveci	3,9	37,6	2,0	19,4	4,83	40,49	2,11	27,03	2,70	22,69	1,69	15,77	1,76	16,92
14. Vuçiterna	4,1	41,7	1,9	21,3	4,25	44,74	4,90	31,93	1,84	24,53	0,74	16,51	1,26	18,18
15. Podujeva	4,8	46,5	1,6	22,9	5,13	49,87	4,73	36,66	1,81	26,34	0,48	16,99	0,92	19,10
16. Gjilani	5,3	51,8	5,5	28,4	4,94	54,81	6,80	43,46	5,69	32,03	4,38	21,37	5,70	24,80
17. Gjakova	5,8	57,6	7,7	36,1	6,16	60,97	4,28	47,74	7,04	39,07	7,18	28,55	7,05	31,85
18. Mitrovica e Titos	6,6	64,2	10,9	47,0	5,95	66,92	7,84	55,58	11,23	50,30	12,78	41,33	12,94	44,79
19. Peja	7,0	71,2	7,8	54,8	6,16	73,08	6,44	62,02	6,84	57,14	6,93	48,26	6,62	51,41
20. Ferizaj	7,2	78,4	5,4	60,2	6,99	80,07	8,66	70,68	4,45	61,59	2,53	50,79	3,70	55,11
21. Prizreni	8,4	86,8	9,4	69,6	8,28	88,35	9,10	79,78	9,87	71,46	8,70	59,49	10,13	65,24
22. Prishtina	13,2	100,0	30,2	99,8	11,67	100,00	20,26	100,00	28,53	100,00	40,51	100,00	34,74	99,98

**Burimi i shënimave:** Vlerat absolute janë marre nga Buletini i EKS, Komunitat e KSA të Kosovës më 1981, Prishtinë, 1982, ndërsa vlerat relative i përpunoj autorë.

KATALOGU I »THEMÈS«  
KATALOG »THEME«

---



*Peri Anderson*

## »RAZMATRANJA O ZAPADNOM MARKSIZMU«

*BIGZ, Beograd 1985; prevod: Ivica Starčević; predgovor: Branko Pribičević i Miloš Nikolić*

Pripadnost marksizmu trebalo bi, u stvari, smatrati pripadnošću najbitnijoj intenciji Marksovog teorijskog/praktičnog delovanja. A Marksova intencija (zbog koje je, uostalom, njegova misao postala epohalna) može se ukratko odrediti kao nastojanje da se svet shvati i prihvati kao ljudski svet, kao vlastito delo čovečanstva, čime je otvorena mogućnost za stalnu revolucionarno-praktičnu izmenu sveta. Stoga *biti marksista* znači biti na tragu te Marksove temeljne intencije, odnosno znači to da se mora permanentno revolucionarno-praktički misliti i delovati na izmeni i humanizaciji sveta. Da li je, kako je i u kojoj mjeri ova temeljna intencija (=marksizam), ako se tako može reći, praktikovana u određenom vremenskom periodu i na određenom geografskom prostoru, pokušao je da utvrdi i engleski marksistički

teoretičar Peri Anderson u svom eseju »Razmatranja o zapadnom marksizmu«.

Ova po obimu mala rasprava privukla je odmah pažnju (ne isključujući i polemička osporavanja) ako ništa drugo a onda zbog toga što je to bio prvi pokušaj da se promisli često rabljeni pojam »zapadni marksizam«, i da se, u onome što Anderson pod tim pojmom razumeva, nešto jasnije evidentiraju i osmisle glavne struje i teorijsko-praktične orijentacije. No, posred u ovakvim pregledima neophodnog istoriografskog inventarisanja, Andersonova rasprava je i sintetizovan pokušaj vrednovanja marksističkih strujanja na evropskom kontinentu. Knjiga stoga predstavlja neku vrstu informativnog i istovremeno kritičkog pregleda »zapadnog marksizma«.

I. Da bi razvio osnovnu temu, budući da je pred-

met njegovih razmatranja određeni period istorije marksizma Anderson je, morao izvršiti vlastitu (ili preuzeti tuđu) periodizaciju marksizma, kako bi se tako na videlo iznela *diferentia specifica* zapadnog marksizma. Shodno ovom zadatku Anderson se odlučio za vlastitu periodizaciju, pa u istoriji marksizma razlikuje tri perioda. Prvi traje od Marksovih i Engelsovih početaka pa do završetka oktobarske revolucije. Drugi, koji je istovremeno i glavna tema »Razmatranja...« zahvata razdoblje od dvadesetih do sedamdesetih godina našeg veka. Od sedamdesetih godina, tačnije od majske pobune 1968. godine u Francuskoj, postaje vidljiv jedan novi, po Andersonu, treći period u istoriji marksizma. Osnovni kriterijum Andersonove periodizacije je odnos marksističkih teoretičara prema političkoj praksi.

II. Drugi period (koga naziva »zapadnim marksizmom«), nasuprot prvom (»klasična tradicija«) i trećem, ima za osnovnu i najfundamentalniju karakteristiku »strukturalno razilaženje sa političkom praksom« str. (77). To »strukturalno razilaženje« se, prvenstveno, ispoljava kao izbegavanje neposrednjeg političkog angažovanja najpoznatijih marksističkih intelektualaca zapadne Evrope. Naj-

sažetiju ocenu razloga i rezultata pomenutog razilaženja, Anderson izražava na sledeći način: »Organiciranje prostora za teorijski rad na veoma uske alternative institucionalne poslušnosti ili individualne izolacije uništilo je svaku mogućnost dinamičkog odnosa između istorijskog materijalizma i socijalističke borbe i sprečilo svaki neposredan razvoj glavnih pitanja klasičnog marksizma«. (99)

U okviru spleta okolnosti koji su vodili ka razilaženju teorije i prakse, odnosno marksističke filozofije i komunističkih partija formirali su se i delovali zapadni marksisti: Lukac, Korš, Gramši, Adorno, Markuze, Sartr, Altiser, dela Volpe, Koleti... itd., čije teorijsko-praktično (ne) delovanje pretstavlja osnovni predmet analize. U kakvom je odnosu, prema radničkim partijama svojih zemalja, stajala većina pomenutih marksista, pokaže Anderson u slučajevima Altisera i Lukača kada piše: »vodeći intelektualci, duboko životno povezanosti sa komunističkim pokretom, odbijajući da ga napuste ili da s njim raskinu, sklapali su prečutni sporazum sa svojim partijama, prema koome oni ne bi raspravljali o zvaničnoj politici ako njihovi teorijski radovi (bez obzira na njihove u krajnjoj liniji praktične implikacije) ne bi bili na-

padnuti«. (91)) Mudrost življenja, koja se zasniva (saobrazno Marksovoj intenciji) na sposobnosti stalnog revolucionarnopraktičnog preokretanja/prilagođavanja sveta ličnim ali istovremeno i opšteljudskim interesima (jer su suštinski povezani), izgubila je potpuno svoj smisao pa se pretvorila u (malograđansku) taktiku koju onda Anderson vidi kao model u Lelevrovom slučaju, kada kaže da se on pridržavao principa: »... caru carevo, to jest politička lojalnost kombinovana sa intelektualnim radom, koji je dovoljno odvojen od glavnih problema revolucionarna strategije kako bi se izbegla direktna kontrola ili cenzura«. (87) Ovaj model, sigurno, nije karakterističan samo za zapadni marksizam. No, da li je on (što nije predmet Andersonovog razmatranja) manje ili više karakterističan i za socijalističke zemlje pitanje je koje se, čini nam se, nije postavljalo u dovoljno otvorenoj, pa time i kritičko-delatnoj formi.

Antipod ovakvom odnosu prema, da tako kažemo, zadacima epohe jeste Gramši. Zašto? »To je logično, nastavlja Anderson, jer je on jedini u svojoj ličnosti otelotvorio revolucionarno jedinstvo teorije i prakse onako kako to određuje klasno nasleđe«. (99) Gramši, po Andersonu, i inače zauzi-

ma izuzetno mesto u celoj tradiciji zapadnog marksizma, zato što nijedan mislilac posle njega »nikada nije ponovio isti redosled u stvaranju«. (99) »Iskustva iz pobune Italijanskih radnika 1919 — 1920. godine i organizacionog rukovodstva u Komunističkoj partiji Italije bila su, navodi pisac, za vreme dugog zatočenštva koje ga je zaštitilo od intelektualnih posledica staljinizacije van Italije... izvor kreativnosti njegovog uma«. (99)

Andersonovo shvatanje odnosa teorija-praksa, kako se ono (doduše nigde potpuno eksplikite) pokazuje u samom eseju, i koje ga dovodi i do neke vrste »sužene optike«, u mnogome je, čini se, potaknuto nekim Gramšijevim shvatanjima, pa otuda i posebno mesto poslednjeg. Jedno od takvih je i ono kad Gramši piše: »... da je čovek u svojoj suštini 'političar', jer on svoju 'čovječnost' i svoju 'ljudsku prirodu' ostvaruje svojim djelovanjem na svjesnom mijenjanju i upravljanju drugim ljudima«. (A. Gramši, *Historijski materijalizam i filozofija B. Crocea*, Zagreb, 1958, str. 55). Navedeni Gramšijevi stavovi otvaraju mogućnost takvom shvatanju po kom se revolucionarno može delovati, skoro isključivo, samo ako se deluje neposredno politički i teorijski, angažovano tema-

tizirajući aktuelna politička i ekonomiska pitanja. Podosta od pomenu-tog shvatanja prepoznatljivo je u Andersonovim »Razmatranjima« III. Jedna od glavnih karakteristika zapadnog marksizma, proizišla kao konsekvenca tolerancije između marksističkih teoretičara i radničkih organizacija njihovih zemalja, jeste usred-sređenost njegovog tematskog interesovanja na filozofiju. »Postepeno napuštanje ekonomskih i političkih struktura, kao osnovnih predmeta interesovanja, konstatiše autor, bilo je praćeno jednom temeljnom promenom — usredsređenost evropskog marksizma prema filozofiji«. (105) Ovo je pomeranje težišta interesovanja uslovljeno delimično i time što su svi odgovori na strateška pitanja proleterske borbe (gde prvenstveno spadaju ona iz domena ekonomiske i političke sfere) bili prisvojeni od birokratizovanih vrhova radničkih organizacija. Ostavljajući po strani navedenu »vanjsku« okolnost (koje je svestan, samo je u ovom kontekstu direktno ne pomije), Anderson upozorava i na jedan unutar-marksistički razlog ovom širokom tematiziranju filozofskih pitanja. Radi se o kasnom otkrivanju Marksovih takozvanih *Ranih radova*, u kojima je, kao što je poznato, prisutan pretežno filozofski način

razmišljanja. Ovi Marksovi radovi, obelodanjeni uprkos upravo na početku ovog perioda, bili su zastupljeni u tolikoj meri, da se čak i kod njihovog prvog otvorenog odbacivanja — u Altiservim esejima — njih ipak smatralo pretpostavkom za bilo kakvu raspravu o savremenom marksizmu.

Tako se stvorila, misli Anderson, paradoksalna situacija: »Dok se osnivač istorijskog materijalizma *progresivno* kretao od filozofije ka politici i, potom, ekonomiji, . . . sledbenici te tradicije, koji su se javili posle 1920. godine, sve više su se od ekonomije i politike vraćali filozofiji, napuštajući tako *neposrednu obavezu* da se bave onim što je Marks u zrelim godinama veoma mnogo interesovalo (podvukao Đ. D.).« (109) U ovom se bavljenju filozofijom, nastavlja dalje Anderson, zapadni marksizam spetljaо u dugu i iscrpljujuću raspravu u metodu. Pravi, »*progresivan*« put daljeg razvitka marksizma, kako to iz ovih stavova proizilazi, moguć je samo kroz dalje upotpunjavanje i razradu ekonomskih i političkih pitanja, pa je upravo to ona »*neposredna obaveza* koja se mora poštovati ako se želi ostati na Marksovom tragu. Ovakav stav ukazuje na izlišnost svakog preispitivanja osnovnih filozofskih pitanja marksiz-

zma, i s druge strane na svojevrstan način određuje, i Andersonov odnos prema pojmu marksizma.

Načelno neslaganje sa ovakvim odnosom prema marksizmu, to jest razvijanju Marksove intencije upotpunićemo i nekim konstatacijama, koje Anderson iznosi „sa kojima se slažemo. »Neuspех Treće internationale, — piše na primer autor u poglavlju *Kontrasti i zaključci*, — čak i u Lenjinovim najboljim danima, da napravi bilo kakav prodor na anglosaksonske zemlje... ukazuje na stepen nepotpunosti Istočanskog materijalizma u vreme njegovih vrhunskih ostvarenja kao žive revolucionarne teorije«. (177) Da li je marksizam nepotpun i zato što se u zapadnim, razvijenim kapitalističkim zemljama, i pored predviđanja klasika, nije dogodila socijalistička revolucija i što su »represivni birokratski režimi, tuto rišući proleterijat u Sovjetskom Savezu i Istočnoj Evropi, pretrpeli posle Staljinove smrti nekoliko uzastopnih kriza i preuređivanja, ali ne i fundamentalnu izmenu svoje strukture«? (72) Nije li, dakle, ovaj »povratak« na filozofska pitanja bio prouzrokovao temeljnim neuspehom ekonomskih i političkih programa? Da li se iz toga postavlja zahtev za novim preispitivanjima »filozofskog ute-

meljenja«, čime se neizbežno akutelizira i pitanje metodologije? Nije li (ne) opravdan rad marksista evropskog zapada na pretraživanju novih temelja ili bi trebali sizifovski graditi »čvrstu« zgradu na »nestabilnoj« podlozi? Načelno neslaganje nije eo ipso i potpuno odbacivanje. Anderson svojim tvrdnjama upozorava bar na jedan bitan problem — nepristupačnost filozofskog jezika širem krugu proleterijata, protiv koje su se klasici borili gde god je to bilo moguće, a što su marksisti ove orientacije, čini se, preterano zanemarili. Naravno, ovde se misli na jezik kao tehniku (način) pisanja i govorenja. Bitnije je, mislimo, ustanoviti, da li ovi mislioci govore jezikom proleterijata, to jest da li misle / deluju na procesu njegovog oslobođanja, a time i na revolucionarno-praktičnom preuzilaženju kapital-odnosa kao glavnog obeležja naše epohe. Da bi se konstatovalo kakav vrednosni predznak može nositi zapadni marksizam kada je u pitanju pomenuti problem, neophodno je bar delimično utvrditi stvarne teorijsko-praktične uslove, a time i zahteve vremena u kome je nastao i razvijao se. Iz te dimenzije tek postoje moguće promisliti pravu ulogu i značaj nepristupačnosti tehnike izražavanja.

IV. O odsustvu značajnijeg revolucionarnog gibanja masa, u tradiciji zapadnog marksizma došlo je do pomeranja interesovanja prema savremenoj buržoaskoj kulturi, piše Anderson i nastavlja zaključkom, da je tome »... više nego bilo što drugo... doprinelo uspešno obavljanje imperializma, povezano sa staljinizacijom komunističkog pokreta, koje je odredilo da najvažniji delovi buržoaske misli ponovo steknu relativnu vitalnost i superiornost prema socijalističkoj misli. (133) U ovom okretanju prema savremenoj buržoaskoj kulturi, može se prilično jasno prepoznati preovlađujuće kritičko intoniran odnos. Onda kada konkretna revolucionarna praksa izostane, jedini praktični odnos teorije jeste kritika stvarnosti. Anderson, čini nam se, neće ili ne želi da primeti otpor samog »materijala« mišljenja / delovanja i kriticnost kao jedino moguću formu revolucionarnog ispoljavanja mislilaca ovog »nerevolucionarnog« perioda. Taj »otpor materijala« mišljenja / delovanja, prvenstveno je izražen u kapitalizmu, koji se, naročito posle drugog svetskog rata, tako paraderski obnovio i povratio veru u sebe, predstavljajući se kao večni i jedino mogući opstanak ljudske zajednice, pa je upravo zato i bilo potrebno da

ga se razobličava kritičkim potenciranjem svega neljudskog što ga on kao poredak nosi u svojim, ipak neizmenjenim, temeljima. Taj zadatak, koji je pred njih postavljala epoha u kojoj su živeli, bar delimično su ispunili marksisti sa zapada kritikujući u svojim delima kako građansko društvo industrijski razvijenog zapada, tako i birokratizovani poredak postojećih socijalističkih zemalja. To, međutim, Anderson, shodno svom uopšteno negativnom stavu prema delatnosti zapadnog marksizma, skoro u potpunosti predviđa ili takvoj delatnosti ne pridaje veći značaj.

Ova nepristupačnost jezika, favorizovanje filozofije, kulture (naročito građanske) i umetnosti u teorijskim nastojanjima, koji, po Andersonu, predstavljaju glavne faktore razilaženja marksističkih teoretičara i radničkih masa, bili su izazvani pored potrebe za izbegavanjem cenzure i, nama se bar čini, potrebama teorijske prirode. Anderson., međutim, misli da je na to presudno delovao uticaj svih tipova »evropskog idealizma« (u koji svrstava većinu nemarksističkih teorijskih nastojanja). Obim međusobne povezanosti zapadnog marksizma i evropskog idealizma, kako to Anderson nastoji pokazati na slučajevima Lukača, Markuzea, Sar-

tra, Altisera..., »bio je uvek složen i uključivao je i asimilaciju i odbacivanje, pozajmice i kritike«. (114) Nisu, međutim, bitni sami po sebi: ni odbacivanja, ni asimilacije, ni pozajmice, ni kritika. Šta je zaista bitno u odnosima između savremenih teoretičara svih orijentacija, na primeren način iskazuje Gajo Petrović kada, tematizirajući I. tezu o Foerbahu, piše: »Savremena filozofija predstavlja dinamički splet najraznovrsnijih odnosa, a ne skup točno raspoređenih filozofa... Ali nije najvažnija ni šarolikost filozofa, ni složenost njihovih misaonih odnosa. Najvažnija je ona jedna misao koju neki iskazuju (a mnogi zatomljuju): da nešto nije u redu u svijetu i da bi ga trebalo (ne samo u misli) promeniti«. (G. Petrović, Suvremena filozofija, Zagreb, 1979, str. 17).

Osa podele među savremenim misliocima mogla bi se smisleno postaviti tako da se, na izvestan način, razlikuje ono što misao o potrebi ljudske izmene sveta »iskazuje« i ono što je »zatomljuje«. Zapadni marksizam se našao u prividnoj krizi produkcije ideja, stoga što se počeo kritički odnositi prema svojim zadacima i time iskazivati netrpeljivost prema naivnom prosvetiteljskom optimizmu što su ga plasirale institucionalizovane

i birokratizovane radničke avangarde. Kada su se neke od nade i očekivanja izjalonila zapadni marksizam počeo je stvarati nove vizije da bi delovanje preusmerio prema novim nadama. Za Andersona su, izgleda, sve nade i vizije već postavljene u prošlosti, sa Marksom, a što se »činjenice« ne »slažu« sa njima u toliko gore po njih. Ipak, Anderson s punim pravom kritikuje pesimistički nastrojenu hladnu racionalnost akademskog marksizma, ističući nasuprot tome »Gramšijevu revolucionarno raspoloženje... izraženo u maksimi 'pesimizam razuma, optimizam volje'.« (158) Ako je kod Hegela misao dubila na glavi, pa ju je, zato da bi je ospособio za stvarnu izmenu sveta, Marks morao okrenuti na noge, ovde je ona da nastavimo metaforu, u nedostatku optimizma (sto bi joj ga trebala uliti stvarna revolucionarna gibanja) koji bi je držao uspravno, i glavom i nogama bila čvrsto priljubljena za »realnost«, te tako suzila vidike i aspiracije.

U nedostatku stvarnog revolucionarnog gibanja, sa jedne strane, i optimizma u vidu smelijih zahteva teorije, s druge strane onemogućeno je delatno uzajamno ulivanje poverenja a time i motor napredovanja — suprotstavljanja. Mislioci

»klasične tradicije« stasali su u klimi revolucionarnog optimizma i jedinstva teorijskog delovanja i revolucionarnog gibanja, dok je na mislioce ovog perioda, pored staljinizma, izmenjene forme kapitalizma, »delovao« i nedostatak revolucionarnog talasanja. »Akademski marksizam« kritičke škole, strukturalizam i slične orientacije zapadnog marksizma, misli Anderson, proizvod *su poraza* vere u širenje revolucije u razvijenom kapitalističkom svetu. Umesto revolucionarnog suprotstavljanja ovakvom razvoju događaja, marksisti zapada odabrali su, prema Andersonu, »prečutno sporazumevanje«. Međutim, stvarni će se značaj i uloga teorijsko / praktične delatnosti misililaca ovog perioda moći bolje proceniti sa nešto veće istorijske distance. To svakako ne umanjuje ni Andersonov doprinos, ni druge pokušaje te vrste.

Andersonova »Razmatranja...« nemaju koherentnu, strogo logički vezanu, unutrašnju strukturu, pa zato više lice na sabrane prizore o pojedinim pitanjima vezanim za razmatrani period mark-

sizma. Svi su ovi prizori delovi jedinstvenog kolaza koji se odlikuje Andersonovim odricanjem značajnije svetsko-istorijske uloge zapadnom marksizmu, čak štaviše on mu pridaje dekadentan značaj. Doduše, Anderson u »pogовору« samokritički primećuje da tezama iz dela nedostaju neka bliža određenja i jasnost, bez čega i njihova logika postaje ograničena, pa je neophodno »aktivno« čitanje tih teza, jer bi u suprotnom moglo da budu »naučno neodržive a politički neodgovorne.« (184) Međutim, kroz »aktivno« čitanje / promišljanje zadobivena »bliža određenja« ne menjaju u suštini stav prema zapadnom marksizmu, koji i dalje ostaje određen i pored Andersonove težnje da izbegne ocenjivanje gde god je to moguće.

Smelo pokrećući mnoga značajna pitanja, koja bi mogla biti predmet zanimljive i produktivne analize, ova knjiga — esej zadire u mnoge bitne odrednice, kako marksizma uopšte, tako i savremenog sveta.

Drago Đurić

Hivzi Islami

## FSHATI I KOSOVËS

*Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural, »Rilindja«, Prishtinë 1985, fq. 277.*

Literatura shkencore mbi gjendjen dhe tendencat e zhvillimit social, ekonomik, demografik, kulturor, infrastrukturor etj. të fshatit e të fshatarësisë te ne, me gjithë përpjekjet e bëra në studimin e tyre në këto dy deceniet e fundit, nuk është e mjaftueshme, duke pasur parasysh problemet e shumënduarshme ekzistuese, të cilat gjithnjë po rriten dhe ash-përsohen; studime përfshatin, fshatarësinë dhe bujqësinë kanë munguar veçanërisht për disa territore të vendit, të cilat janë kryesish rurale e deri edhe agrare, siç është, për shembull rasti me KSA të Kosovës. Mirëpo, edhe këto njoħuri jo të mjaftueshme shkencore-hulumtuese — në mungesë të përkujdesjes së nevojshme shoqërore — shumë pak janë zbatuar në praktikë. Është koha e fundit që shkenca shoqërore t'i kthehet më seriozisht studimit të fshatit, të mënyrës së gjithmbarshme të jetës në të dhe të bujqësisë dhe rezulta-

tet e saj të vihen në shërbim të praktikës jetësore dhe shoqërore me qëllim që jo vetëm të njihen por edhe të zgjidhen çështjet e fsheht, të fshatarësisë dhe të bujqësisë.

Në Kosovë fshati ka nisur shumë vonë të studiohet dhe atë vetëm kalimthi, më tepër në kuadër të çështjeve të tjera. Një pasqyrë të plotë të gjendjes dhe të zhvillimit të fshatit tonë, veçanërisht në aspektin sociologjiko-demografik, deri sot nuk e kemi. Studimi i dr. Hivzi Islamit »Fshati i Kosovës — kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural«, është i pari i këtij lloji që i kushtohet studimit shkencor të fshatit, të strukturave dhe të jetës rurale. Ndonëse, ky autor kohëve të fundit, duke u marrë me lëvizjet, strukturat dhe asociacionet e tjera të zhvillimit demografik të Kosovës, ka botuar disa punime mbi aspekte të ndryshme të fshatit e të mënyrës së jetës në të, studimi në fjale është vepër e parë

shkencore ku në mënyrë të tërësishme trajtohen një varg problemesh të fshatit tonë, para së gjithash të atyre demografike dhe sociologjike. Të gjitha këtyre problemeve autor i qaset në mënyrë empiriko-teorike. Përfundimet shkencore deri te të cilat ka arritur autor i këtë studim janë origjinale, ndërsa veprat e shtë rezultat i punës shumëve të autorit.

Arsyet e studimit të fshatit tonë, qoftë në kompleksitetin e tij, qoftë në aspektet konkrete (sociologjike, demografike, ekonomike, etnologjike etj.), sipas autorit, qëndrojnë para së gjithash në faktin se Kosova hyri në periudhën e zhvillimit socialist kryesisht si territor fshatar (më se 80% të popullsisë rurale) dhe agrar (më se 80% të popullsisë bujqësore), vëçoria themelore e të cilit ishte autarkia dhe homogeniteti ekonomik, social, demografik dhe kulturor. Dhe kjo gjendje zgjati deri vonë pas luftës, kur popullata fshatare e Kosovës përpinqej ta siguronte minimumin jetësor, ekzistencën. Në anën tjeter, edhe sot në strukturën e popullimit të Kosovës dominon fshatarësia (popullsia rurale përbën rrëth 2/3 e popullsisë së gjithmbarshme të Krahinës; nga 1453 vendbanime 1419 janë fshatra), e cila, me gjithë transformimet që ka përjetuar dhe po për-

jeton në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, po balafaqohet ende me një varg problemesh sociale, ekonomike, infrastrukturore, shëndetësore, arsimore etj. Në territorin fshatar të Kosovës më shumë se çdo kund tjetër në Jugosllavi po manifestohet dendësia e madhe agrare, tepricat e fuqisë punëtore, papunësia dhe gjysmëpapunësia; këtu ende po hasen mbeturinat e strukturave klasicke sociale dhe të tipave tradicionale demografike, por edhe konflikti i ash-për midis të vjetrës dhe së resë.

Studimi e shtë konceptuar në atë mënyrë që, pas një parathënie të thukët (fq. 5—8), përfshin dy pjesë: 1. *Fshati dhe shoqëria tradicionale kosovare dhe karakteristikat e tyre* (fq. 9—52) dhe 2. *Çështje të transformimit shoqëror të fshatit kosovar* (fq. 53—222). Studimi përmban edhe një përfundim të ngjeshur mbi rrjetin, problemet dhe perspektivën e evolucionit rural të Kosovës (fq. 223—235), pastaj një listë të gjerë njësish bibliografiqe dhe një shtojcë statistike me indikatorë më të rëndësishëm të zhvillimit rural sipas komunave.

Në pjesën e parë, pasi që mbi bazën e argumenave shkencore i hedh poshtë tezat e antropogeografisë e të historiografisë tendencioze mbi mos-ekzistimin e populatës

shqiptare në Kosovë dhe në viset përreth para shek. XVII e XVIII, autor i bën fjale për përvijimin midis fshatit e shoqërisë tradicionale dhe fshatit e shoqërisë bashkëkohore, i cili përvijim është vetëm një supozim teorik, sepse në praktikë është vështirë të haset. Autori këtu shqyrton të gjitha problemet e struktures shoqëroro-ekonomike, tiparet e familjes e të raporteve të brendshme të saj dhe të pozitës së femrës në familje, në ekonominë shtëpiake dhe në fshat etj., karakteristike për periudhën paraindustriale. Karakteristikat kryesore të fshatit tonë të kësaj periudhe, sipas studimeve të autorit, janë: homogjeniteti për nga të gjitha determinantet e mënyrës së jetës, kur popullata fshatare i ruante të gjitha veçoritë e jetës klasike agrare dhe deri vonë në shekullin tonë përshkohej nga shumë mbeturina të marrëdhënieve gjysmëfeudale dhe feudale; dallimet sociale manifestoheshin vetëm në bazë pronësore (në fond të tokës, të kafshëve etj.); popullsia rurale, në mungesë të rrugëve, rrymës elektrike dhe elementeve të tjera të komunikimit gjeografik dhe shoqëror, ishte e izoluar dhe si e tillë ishte e ngulitur përvendin e lindjes, lëvizte vetëm në suaza lokale fshatare; brenda familjes realizoheshin të gjitha

funksionet kyçe (prodhuese, konsumuese, riprodhuese, socializuese, edukative, arsimore, mbrojtëse, shëndetsore etj.), ndërsa forma dhe institucioni më i rëndësishëm shoqëror në fshatin tradicional shqiptar ishte familja e madhe; tërë organizimi dhe jeta familjare dhe sociale e shqiptarëve rregullohej sipas normave e institucioneve të Kërnikunit të Lekë Dukagjinit; pozita e femrës në familje dhe shoqëri të tillë ishte shumë e rëndë, ku përvëç funksionit të saj riprodhues, si funksion primar, ajo kishte obligime të mëdha edhe në ekonominë shtëpiake dhe në ekonominë bujqësore, kështu që fondi i kohës së saj të lirë reduktohej në minimum; kompleksi demografik ishte shumë karakteristik, identik me atë të popullatare paraindustriale, përtërirja e populsisë shumë ioracionale, ngase ekuilibri midis lindjes dhe shuarjes së jetës arruhej me humbje të mëdha njerëzish (mortaliteti i përgjithshëm arrinte nivelin mbi 30 promila në vit, ndërsa ai i foshnjave sillej mesatarisht deri 200 promila në vit); ekonominë bujqësore ishte e imbyllur e natyrore, ndërsa gjendja e fshatarësise, sidomos e asaj shqiptare shumë e rëndë, e cila midis dy luftërave botërore sikur keqësohet edhe më tepër nga reforma agrare, kolonizimi dhe një varg

masash të tjera të presionit ekonomik e politik, ndërsa qëllimi kryesor ishte shpërngulja e shqiptarëve në Turqi dhe ndryshimi i përbërjes kombëtare të popullsisë në dëm të shqiptarëve.

Pjesa qendrore e studimit është pjesa e dyte, e cila i kushtohet problemi të transformimit shoqëror të fshatit kosovar. Kjo pjesë përmban pesë kaptinat: 1. *Zhvillimi i popullsisë fshatare të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore dhe procesi i transicionit demografik* (fq. 55—72); 2. *Lëvizja e popullsisë fshatare* (fq. 73—137); 3. *Struktura e popullsisë fshatare* (fq. 138—180); 4. *Familja, ekonomia familjare dhe ekonomia bujqësore* (fq. 181—198) dhe 5. *C'ështje të urbanizimit dhe të standardit të vendbaneve fshatare* (fq. 199—222). Në këto kaptina të studimit, siç po shihet, trajtohen të gjitha çështjet aktuale relevante demografike, sociologjike, infrastrukturore etj., duke u nisur nga procesi i transicionit demografik, komponentet vitale (nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror), migrimet e popullsisë të gjitha tipeve strukturat më të rëndësishme demografike dhe socialo-ekonomike të popullsisë e deri te familja, e cila po përjeton thyerje e çthurje të rëndësishme në të gjitha segmentet e saj, ekonomia shtëpiake

dhe ekonomia bujqësore, si dhe urbanizimi e standardi jetësor e shoqëror i vendbaneve rurale të Krahinës.

Ndaj të gjitha problemeve të fshatit e të fshatarësise kosovare autori merr qëndrim kritik. Përmes analizës së shumë indikatorëve, ai konklidon se në periudhën e pasluftës u bënë ndryshime të mëdha socialo-ekonomike, demografike, infrastrukturore e arsimore, duke u zbërtyer struktura klasike agrare e fshatit dhe duke i zgjeruar grupet e reja socialo-professionale e arsimore të popullsisë, pastaj elementet infrastrukturore, institucionet e standartit kulturor e jetësor, vlerat dhe pikëpamjet dhe kërkesat e nevojat e reja, por, në anën tjetër, konstaton autori, bujqësia u lë pas dore në krahasim me degët e tjera ekonomike, kurse fshati pas qytetit në çdo pikëpamje; në shumë fshatra nuk ka institucione elementare shoqërorokulturore e shëndetsore dhe sisteme infrastrukturore, siç janë postat, bibliotekat, shtëpitë e kulturës, ambulancat, objektet sportive, as shitore me artikuj të konsumit të përditshëm, madje as shkolla të plota fillore, të palidhura mirë me rrugë, deri më 1985 edhe pa drithë elektrike etj.

Lënia pas dore e fshatit dhe e bujqësisë ndikoi që të zvogëlohet interesimi i

popullsise fshatare për t'u marrë me prodhimtari agrare, prandaj edhe nisi ta braktisë bujqësinë dhe fshatin. Sipas autorit është vështirë sot të vihen në lëvizje të gjitha mekanizmat përmes mbetur njërit në fshat dhe përmes t'i u kthyer bujqësisë, sepse mungojnë iniciativat, organizimi dhe kujdesi shoqëror. Prandaj, në shqyrtime përfundimtare autorit propozon që të ndërmerrin një varg masash, siç janë forcimi i bazës materiale të ekonomive individuale bujqësore, sigurimi i bazës së gjere sociale (sigurimi shëndetësor, pensional e invalidor), specializimi dhe profesionalizimi i bujqve, kooperimi dhe integrimi i bujqësisë individuale me sektorin shoqëror, sigurimi i shërbimeve agrare, zgjerimi i sistemeve urbane infrastrukturore, ngrija e qendrave përmes shkollimin e bujqve të rinj, komasacioni i tokës etj. Masat e politikës agrare, sipas autorit, duhet të sinkronizohen me masat e politikës sociale dhe kulturore në fshat etj.

Ky studim i dr. Hivzi Islamit hedh dritë mbi rrugët kyçë të tendencave të zhvillimit socialo-demografik dhe vë në pah të gjitha të arriturat në fshatin tonë, por edhe problemet me të cilat fshatarësia po ballafaqohet dhe të cilat do ta përcjellin përmes një kohë relativisht të gjatë, u mor

vesh, në qoftë se nuk ndërmerr masa të duhura përmes zgjidhjen e tyre. Studimi si i tillë paraqet një kontribut të madh shkencor përmes sociologjinës dhe demografinës fshatit tonë. Rezultatet e nxjerra në këtë studim janë shumë të vlefshme dhe me relevancë shkencore, ndërsa prosedeja e aplikuar metodologjike në hulumtimin e evolucionit rural të Kosovës është origjinale dhe mund të shërbejë si bazë solide përmes parimin e mëtejshëm të metodologjisë në rrafshin e studimit të fshatit e të jetës në të. Në çdo sektor të shtjelli mit të proceseve dhe të problemeve rurale është fuqimisht e pranishme qasja teorike dhe zbatimi i suksesshëm i të arriturave të teorisë bashkëkohore marksiste demografike dhe ruralo-sociologjike.

Përmes hartimin e këtij studimi autorit ka shfrytëzuar literaturën të gjere historike, demografike, sociologjike, ekonomike etj. në gjuhë të ndryshme, pastaj burime të shumta të statistikës së regjistrimeve të popullsise, të asaj vitale etj. Duke shfrytëzuar një fond të madh të të dhënave, me mjeshtëri të rrallë ka bërë zgjedhjen, përpunimin, analizën, si dhe vlerësimin racional e objektiv shkencor të tyre. Rezultatet të cilat i ka arritur autorit në këtë studim, hapin një varg pro-

blemesh për studime të mëtutjeshme dhe shërbejnë për përcaktimin e qëllimeve të zhvillimit të ardhshëm të fshatit e të fshatarësise kosovare në tërë kompleksitetin e ty-

re, gjë që e vë studimin ndër veprat e rralla shkenccoro-kërkimore të këtij lloji te ne dhe më gjere.

*Sherif Maloku*

*Ernst Bloh*

## TEZAT E MARKSIT MBI FOJERBAHUN

*Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 117.  
(Përktheu Nexhat Kërnja)*

Në botim të »Rilindjes«, për herë të parë në gjuhën shqipe, u botua një veprë e Ernst Bllohot (Ernst Bloch), njërit ndër mendimtarët më të mëdhenj marksistë dhe jo vetëm marksistë, të këtij shekulli. Çështë e vërteta, ky botim është vetëm një kapitull i veprës më të rëndësishme, jetësore, të Bllohot *Parimi shpresë* (Das Prinzip Hoffnung).

Bllohu me mendjem prehtësi analizon pikëpamjet e Marksit të shfaquara në *Tezat mbi Fojerbahun*. Është fjala për njëmbëdhjetë teza, që i shkroi Marks i në Bruksel, më 1845, që i kishin mbetur në dorëshkrim dhe për herë të parë i botoi Engelsi më 1888, si shtojcë të veprës së tij *Ludvig Fojerbahu dhe fundi i filosofisë klasike gjermane*. Ndonëse, si shkruan edhe Engelsi në parathënie të kësaj vepre, ishin shënimë të shkruara shpejt e shpejt, më tepër për nevoja personale të Maksit

e që nuk ishin të destinuara për shtyp, *Tezat janë* »me vlerë të paçmueshme si dokumenti i parë që përmban embrionin gjenital të një botëkuptimi të ri«. Duke u pajtuar me një vlerësim të këtillë Bllohu shton se *Tezat* »paraqesin ndarjen kështu të formuluar nga Fojerbahu, bashkë me paraqitjen fare origjinale të trashigimisë... Fakti se mori qëndrimin e proletariatit, bëri që Marksit të bëhej në mënyrën shkakësore-konkrete, pra me të vërtetë (me themel), humanist« (fq. 13).

Ky botim i veprës së Bllohot përmban një vërejtje hyrëse (që është një shënim i shkurtër i redaktorit të botimit serbo-kroatish të këtij punimi), kapitullin *Ndryshimi i botës ose njëmbëdhjetë tezat e Marksit mbi Fojerbahun*, që në vete përmban këto pjesë: *Koha e të shkruarit, Çështja e grupimit, Grupi njohës-teorik: përceptimi dhe vëprimtaria* (tezat 5, 1, 3),

*Grupi antropologjiko-historik: vetëtjetërsimi dhe materializmi i vërtetë* (tezat 4, 6, 7, 9, 10), *Grupi teoria-praktika: prova dhe rivërtetimi* (tezat 2, 8), *Parulla dhe kuptimi i saj* (teza 11) dhe *Pika e Arkipedit: dija që ka të bëjë jo vetëm me ato që kanë kaluar, por thelbësish edhe me ato që vijnë*. Në shtojcë u botuan edhe *Tezat* në dy variantat e tyre (ai i Marksit dhe teksti i redaktuar i Engelsit), duke vënë përkrah tekstit origjinal (gjermainisht) edhe përkthimin shqip. U veprua kështu sigurisht me qëllim për të mbetur më afër tekstit burimor të Marksit dhe për të dëshmuar se nuk kanë bazë ato kritika qëllimkëqija të cilat variatant e Engelsit e shpallin si falsifikim të *Tezave* të Marksit. Blohu, me plot të drejtë, thotë se ndërrhyrjet e Engelsit janë stilistike dhe nuk e cënojnë fare përbajtjen e tyre.

Si mund të kuptohet edhe nga vetë titulli i pjesës *Koha e të shkruarit*, aty bëhet fjalë për kohën kur u shkruan *Tezat*, për veprat që i paraprijnë e në të cilat Marks i zhvilllon pikëpamjen e vet të mëvetësishme, por edhe për veprën *Ideologjia gjermane*, që është shkruar menjëherë pas tyre. Blohu këtu flet për ndikimin që pati Fojerbahu në Marksin, por edhe për dallimet thelbësore të pikëpamjeve të tyre.

Pjesa *Çështja e grupimit* bën fjalë për faktin e kompleksivitetit dhe të vështirësisë së madhe të grupimit të *Tezave*, meqë ashtu të renditura, më tepër për nevoja vetjake, »ato kryqëzohen shumëfish, sjellin edhe përbajtje të njëjtë në vend tjetër, nuk e lënë gjithkund të dukshme bazën e renditjes dhe të radhës« (fq. 16). Blohu ngrihet kundër renditjes sipas numrave, përkatesisht, mënyrës formale të grupimit të *Tezave*, duke kërkuar që ai të bëhet në mënyrë filozofike, në bazë të »temave dhe të përbajtjeve të tyre«.

Grupi i parë i *Tezave* është ai *n j o h ē s — t e o r i k*, që ka të bëjë me *pëceptimin dhe veprimtarinë* (tezat 5, 1, 3). Këto në thelb paraqesin qëndrimin kritik të Marksit ndaj pikëpamjeve të deriatëhershme filozofike (qofshin materialiste apo idealiste) mbi njëmendësinë dhe mundësinë e kuptimit të saj.

Fojerbahu, duke dashur t'i kundërvihet pikëpamjes idealiste-abstrakte, si pikënisje merr *njojjen ndijore*. Mirépo, kjo njoje në thelb është *pasive, soditëse* (vrojtuese). Blohu, në mënyrë spirituale, vëren se ai »dëshiron këmbët t'i shohë në truallin ndijor. Por teza 5, në rradhë të parë teza 1, shënojnë njëkohësisht se në ndieshmërinë e cila vrojton, çfarë Fojerbahu e

pranon si të vetmen, këmbët nuk mund të ecin ende, ndërsa vetë trualli imbetet i pakalueshëm« (fq. 18). Marks shpjegonte se përceptimi i kulluar natyrisht »ndijimin nuk e rrok si veprimitari praktike njerëzore-ndijore« (teza 5). Anën vepruese të njohjes, përkundër materializmit paramarksist, do ta zbulojë idealizmi, kuptohet vetëm në mënyrë abstrakte, meqë »veprimitarinë reale, ndijore, natyrisht se nuk e njeh si të tillë« (teza 1). Këtë anë vepruese e zbulon vetëm idealizmi që u zhvillua në shoqërinë borgjeze, meqë shoqëria në fjale, për dallim nga ajo skllavo-pronare e feudale, nuk ka qëndrim përbuzës ndaj punës, veprimitarisë, por e afirmon atë. Këtë moment e shpreh më së miri filozofia klasike gjermane, e në veçantë *Fenomenologja e frysës* e Hegelit. Sipas Marksit madhështia e kësaj vepre qëndron në faktin se ajo »kupton thelbin e punës, ndërsa njeriun veprues-njeriun e vërtetë, sepse është i njëmendtë — e kupton si rezultat të punës së tij vetjake« (fq. 21).

Pikënisje e materializmit të Marksit është praktika, përkatësisht raporti përherë lëkundës subjekt-objekti. Tezat në fjale, por edhe *Ideologja gjermane*, si vepër që vjen menjëherë pas tyre, trajognë për këtë fakt. Një

fragment, që e merr Blohu nga *Ideologja gjermane* dëshmon më përafërsisht se pa dimensionin e punës, jo vetëm që nuk mund ta kuptojmë botën, por nuk ka kuptim as ekzistenca njerëzore. »Kjo veprimitari, kjo punë dhe ky krijim i pandëprerë ndijor, ky prodhim është në këtë masë bazë e tërë botës ndijore, e së tillës siç ekziston tash, saqë Fojerbahu, sikur të ndërpritej ajo goftë edhe për një vit, do të shihte një ndryshim shumë të madh jo vetëm në botën e natyrës, por do të vërente shumë shpejt se nuk ka as botë të tërë njerëzish, as fuqi të tij (të Fojerbahut) vetjake të përceptimit, madje as ekzistencë të tij vetjake (fq. 23).

Materializmi i Marksit sigurisht nuk e harron epërsinë e natyrës së jashume, por thekson se nga ajo natyrë çfarë e has njeriu i parë ka mbetur fare pak. Fojerbahu nuk është në gjendje të kuptojë se natyra, duke iu falenderuar veprimitarisë, më nuk është e kulluar, »e virgjér«, por natyrë e ndryshuar, që në vete ka njerëz aktívë, përkatësisht natyrë e humanizuar. Njeriu duke vepruar e ndryshuar natyrën, ndryshon kushtet e jetës e të punës dhe me këtë ndryshon edhe vetveten. Duke e kuptuar këtë raport dialektik, të varësise së ndërsjellë të njeriut e të

natyrës, të subjektit e të objektit, mund të tejkalohet teza mekaniciste e materializmit paraprak, sipas së cilës njeriu është rezultat i ndryshimit të rrethanave dhe të edukimit (shih teza 3).

Tezat 4, 6, 7, 9 e 10 përbëjnë të ashtuquajturin *grup antropologjiko-historik*, ku trajtohet çështja e vetëjetërsimit dhe e materializmit të vërtete. Këtu Marks tregon se sa jokonsekuent ishte Fojerbahu, me materializmin e tij, në shpjegimin e thelbit të njeriut dhe të zhvillimit historik të tij. Çështë e vërteta, duhet të theksohet se te Fojerbahu materializmi dhe historia janë fare të ndara mes vete, për çka flasin *Tezat*, por edhe veprat e tjera të Marksit. Blohu e vëçon një fragment nga vepra *Ideologjia gjermane* në të cilin thuhet: »Po që se është materialist Fojerbahu, tek ai nuk përsëritet historia, ndërsa po që se merr parasysh historinë, ai nuk është materialist« (fq. 35). Shkurt e shqip të themi se Fojerbahu, ndonëse është materialist në shpjegimin e qenësise së botës dhe të njoftes së saj, në shpjegimin e njeriut dhe të historisë mbetet në pozita idealiste.

Teza baze e këtij grupi është teza e 4, e cila si çështje thlbësore ka tjetërsimin. Çështë e vërteta, Fojerbahu kishte zbuluar vetëjetërsimin në

trajtën e tij fetare, puna e të cilit qëndronte në faktin »që ta shpinte botën fetare në bazën e saj tokësore». Meqë në fe njeriu kishte tjetërsuar thelbën e vet dhe të natyrës, detyrën e filozofisë Fojerbahu e sheh në kërkesën që t'ua rikthente atë thelb atyre. Mirëpo, sipas Marksit, kjo nuk mjafton, pikërisht për faktin se Fojerbahu mbeti në gjysmë të rrugës, meqë u ndal te ky »njeri genus abstrakt«, te ky njeri që fare nuk është zërthyer »në aspektin klasor-historik«. Për Marksin thelb i njeriut nuk është kurrfarë përgjithësie, kurrfarë gjinie njerëzore abstrakte, por është »tëresi e marrëdhënieve shoqërore«. Fakti i vetëjetërsimit fetar duhet të shpjegohet »me vetëoptimin dhe me vetëkundërthënien vetjake të kësaj baze shekulllore (tokësore — Xh. Xh.). Vetë kjo pra, si vetë në vete, ashtu në kundërthënien e vet, duhet të kuptohet dhe të revolucionizohet praktikisht. Pra, p.sh., pasi që familja tokësore është zbuluar si e fshehta e familjes së shenjtë, tashti vetë ajo e para duhet të asgjësohet teorikisht dhe praktikisht« (teza 4).

Marks, përkundër njeriut abstrakt të Fojerbahut, i kthehet njeriut të thjeshtë, të njëmendtë, konkret-praktik. Njerëzit e dyzognë botën meqë kanë vetëdije të copëzuar,

ndërsa vetëdija e tillë burimin e ka në përçarjet shoqërore. Ç'është e vërteta, jeta shoqërore në thelbë është praktike, andaj Marksi duke analizuar marrëdhëniet borgjeze zbulon edhe trajta të tjerë të tjetërsimit, pos atij fetar, tregon në rrugët e shndërrimit revolucionar të shoqërisë dhe të sendërtimit të marrëdhënieve njëmend njerezore.

Tërësi të veçantë, sipas Bllohit, paraqesin *Tezat 2* dhe *8*. Këto përbëjnë *grupin teori-praktika*, që kanë të bëjnë me provën dhe rivërtetimin.

Marksi duke u nisur nga pikëpamja e njeriut si qenie e praktikës, të menduarit e kupton si trajtë të kësaj veprimtarie njerezore. Për të mendimi nuk është »i zbehtë dhe i pafuqishëm — thotë Bllohu. Teza e 2 e vë mbi përceptimin ndijor, me të cilin dhe mbi të cilin ai thejsht ngrihet« dhe se ai nuk synon »kah e përgjithshmjë e keqe, abstraktja, por anasjelltas :ai e zbërthen pikërisht lidhjen e ndërmjetësuar, thelbësore, të dukurisë si lidhje që është ende e mbyllur për ndijimësinë e thjeshtë në dukuri« (fq. 37). Ç'është e vërteta, Marksi arrin deri te rezultati i kundërt me Fojerbahun: mendimi i tij i kuptuar kështu është konkret dhe anasjelltas, ndijimi, duke qenë i ndarë nga mendimi, është ab-

stract. Së këndejmi, ndijimi dhe mendimi duhet të kuptohen si procese të lidhura ngushtë, që qëndrojnë në raport të ndërsjelle. Te Marksi mendimi duhet t'i kthehet përsëri përceptimit, për t'u provuar mbi të, si i gërshtuar, por ku përceptimi nuk është pasiv.

E vërteta nuk është vetëm raport teorie, por është absolutisht raport teori-praktikë. Në vend që praktika të kuptohet si e ngjitur pas teorisë apo edhe në provë teorie »të bëjë jetën e vet të mëvetësishme dhe që të mbetet edhe më tutje vetëm jaftueshmëri«, te Marksi që të dyjat »lëkunden alternativisht dhe duke u pleksur mes vete, praktika parakupton gjithashu teorinë, ashtu siç liron edhe vetë sérish dhe kërkon teori të re për zgjatjen e një praktike të re. Mendimit konkret nuk i është dhënë askund vlerë më e madhe sesa këtu, kur është bëre dritë për vepër, edhe ku është kurorë e së vërtetës« (fq. 44).

Grup të veçantë përbën teza 11, të cilën Bllohu e cilesón si »më të famshme«, »më të rendësishme« dhe »të formuluar më së thukti«. Kapitullin ku bën fjalë përkëtë tezë ai e titullon »*Parulla dhe kuptimi i saj*«.

Në tezën 11, sipas Bllohit, pranohet se »ajo, që është e ardhshme, është më e afërtë dhe më e rë-

ndëshishmja». Ndonëse jsh-te parajmëruar si folozofi e së ardhshmes, filozofia e Fojerbahut nuk mund të shpjerë përpara, pikërisht për shkak të karakterit të saj soditës, vrojtues, metafizik. Duke u ngritur kundër një filozofie të ketille e cila »shpjegon kulluar antikuarisht botën«, Marks i kërkon që filozofia të zbulojë lidhjet e njëmendësise, ligjësitë dialektike të saj. Filozofia duhet të jetë vepruese, që pashmangshmërisht të shpjerë në ndryshim. Ajo që është e re në filozofinë marksiste, që e cilëson nga çdo filozofi tjetër, është misioni i saj proletar-revolucionar.

Bllahu, pasi që bën fjalë për kuptimin e gabuar pragmatik dhe prakticist të tezës 11, do të tregojë në kuptimin e vërtetë të ndryshimit filozofik marksist. Në thelb ky është »ndryshim me njojjen e pandërrerë të lidhmërisë« dhe se ndodh »thelbesisht në horizontin e së ardhshmes«. Është karakteristik mendimi i Marks-it i shfaqur në veprën »Rreth kritikës së filozofisë hegeliane të së drejtës — Hyrje« ku thuhet: »Filozofia nuk mund të realizohet pa suprimimin e proletariatit, proletariati nuk mund të suprimohet pa realizimin e filozofisë«. Bllahu shpjegon se ky suprimim, që është proces i gjatë, nuk duhet të kuptohet vetëm si suprimim i proletariatit si

klasë, por i proletariatit edhe si »simptomi më i shprehshëm i vetëtjetërsimit të njeriut« dhe se suprimimi i plotë përpuneth vetëm me aktin e fundit të komunizmit.

Kapitulli përfundimtar, i këtij punimi, mban titullin *Pika e Arkimedit — dija që ka të bëjë jo vetëm me ato që kanë kaluar, porse thelbësisht edhe me ato që vijnë*. Edhe vetë titulli jep për të kuptuar se ç'është e re dhe e rëndësishme në pikëpamjen e Marks-it, të shfaqur edhe në këto *Teza*.

Marksizmi apo siç e cilëson Bllahu »shkenca e dialektike-historike me tendencë« paraqet fillimin e filozofisë së revolucionit. Ai nuk do »vetëm të ndërtojë një vetëdije të sakte për faktin ekzistues«, vetëm t'i kthehet së kaluarës dhe të jetë vrojtuese e saj, por do të jetë pikëpamje kritike-krijuese, që shpreh raport përherë lëkundës teori-praktikë, që në të kaluarën gjen themellet e së tashmës e në të tashmen horizontin e së ardhshmes. Marksizmi si pike Arkimedi, për historinë, merr punonjësin, me çka »zbulon jo vetëm çelësin e teorisë, porse edhe levën e praktikës« (fq. 66).

Bllahu me të drejtë vërejti se »Vetëm horizonti i së ardhshmes, i tillë, çfarë pushton marksizmi, me horizontin e së kaluarës si hapësirë paraprake,

i jep realitetit përmasai e tij reale» (fq. 64). Kjo është porosia e *Tezave* në tërësi, ndërsa porosia e tezës 10 në trajtë më të hapët e më të vendosur është se »Pikëpamja e materializmit të vjetër është shoqëria »civile«, pikëpamja e të riut shoqëria njerezore ose njerezimi i shoqërizuar«. Ndryshimi i botës ka kuptim vetëm atëherë kur ai kryhet në botën e ndryshueshmërisë, madje të ndryshueshmërisë cilësore dhe se nuk ka kurrfarë bote të ndryshuar »pa horizont të kuptuar të mundësise objektive reale në të«. Shpreza në dijen mbi jetën është bërë te Marksit ngjarje madje ngjarje e tillë që nuk ka përfunduar por është pah i vetëm përparrë në botën e ndryshueshme dhe si e tillë implikon lumturinë. Porosia e *Tezave* është: »Njerezimi i shoqërizuar në aleancë me natyrën, që i është ndërmjetësuar, është rindërtim i botës në vendlindje« (fq. 67) Të themi edhe këtë se me vendlindje Bllohu nënkupton situatën historike në të cilën hiqet tjetërsimi.

Në veprën *Tezat e Marksit mbi Fojerbahun Bllohu me mprehtësi, kulturë dhe vështrim të jashtëzakonshëm zbulon domethënien përherë filozofike në këtë tekst të thukët, zbulon vlerën e vërtetë të *Tezave*. Mund të themi me plot gojë se ai, deri më sot, ka dhënë një pa-*

raqitje ndër më të plotat dhe më të thellat, të *Tezave* në fjale. Analizat e tilla janë shumë të rralla në filozofinë marksiste dhe paraqesin kontribut të rëndësishëm për shpjegimin e mendimit burimor të Marksit.

Vepren në fjale e përktheu nga serbokroatishtja Nexhat Kërnja. Përkthimi, me disa përmirësime (që do të bëhen me rastin e ribotimit), do të bëhej më cilësor. Kështu do të bëhej korrigimi i gabimeve që janë përvjedhur në këtë botim si p.sh. në vend të fjales »Rrugës« duhet të shkruhet »Ruges« (fq. 11), »origjinar« = »gjinor« (fq. 12), »ndjenjës« = »kujtesë« (fq. 61), »praktika teknike« = »praktika teknike dhe politike« (fq. 39), mandej fjalën »njeriun« duhet zëvendësuar me »natyrën« (fq. 15, rreshti i tretë nga fundi), fjalën »materializmit« duhet zëvendësuar me »idealizmit« (fq. 15, rreshti 8—9). Ka edhe fjalë të tjera, por edhe konstrukte fjalish që nuk janë përkthyer si duhet. Moment me rëndësi është fakti se përkthyesi për shumë fjalë të huaja, që po përdoren dendur në shtyp e në literaturë, gjen fjalë nga gurra popullore, ndënëse edhe ky nuk është deri ndë fund këmbëngulës.

Në fund të këtij vështrimi do të thosha se botimi i kësaj vepre është shumë i qëlluar. Ajo ësh-

të literaturë e domosdoshme jo vetëm për ata që merren më drejtpërdrejt me studimin e mendimit marksist, por edhe për të tjerët, veçanërisht për studentët e degëve të

ndryshme që dëgjojnë Filozofinë marksiste, Bazat e shkencës mbi shoqërinë ose ndonjë lëndë tjeter të shkencave shoqërore.

*Xhafer Xhaferi*

Muhamedin Kullashi

## »KAH METAFILOZOFIA«

»Rilindja«, Prishtinë, 1985. fq. 172.

Kohë më parë në botim të »Rilindjes« (Redaksia e botimeve), doli libri i Muhamedin Kullashit »KAH METAFILOZOFIA«. Vepra në fjalë shënon njëfarë vazhdimësie të preokupimit të këtij autori me mendimin filozofik marksist të Anri Léfevrit (Henri Lefebvre). Përveç veprës së zënë ngoje, Kullashi, deri më tani, batoi veprën »FILOZOFEMA« (»Rilindja«, 1979.), por edhe shumë artikuj (studime) në revista të ndryshme e në periodikun tonë, ku krahas çështjeve të tjera dominon tema në fiale. Në këtë libër, sikundër edhe në punimet e tjera, shquhet rapporti përherë kritik e krijues marksist i këtij studiuesi ndaj mendimit filozofik të Léfevrit.

Në librin »KAH METAFILOZOFIA« Kullashi përqëndrohet në dy temat boshte të filozofisë së Léfevrit: në çështjen e suprimimit të filozofisë dhe në çështjen e të menduarit historik. Qështë e vërteta, autori do të tregojë në përpjekjet mendore të

Léfevrit që të formësojë një pikëpamje të mëvetësishme që nuk do të ishte më vetëm filozofike, por që do të ishte depërtim përmes suazave të filozofisë. Pikëpamjen e tillë Léfevri do ta quajë *mетода филозофи*. Me metafilozofji ai kuption »përpjekjet mendore që synojnë të dalin jashtë filozofisë tradicionale sistematike«. Mendimi metafilozofik në *thelb* është *mетод в практике* (pensée-action) që merr pjesë në ndryshimin e botës së tjetërsuar ekzistuese. »Përpjekjet e Léfevrit përtëjkalimin e trajtave tradicionale të të menduarit — thotë Kullashi — nuk nënkupton braktisjen ose hedhjen e filozofisë tradicionale, por aq më tepër përmban kërkësen përrimendimin e temave dhe të problemeve të saj themelore, duke u nisur me këtë rast prej një pozite të re mendore-praktike« (fq. 11).

Kullashi duke dashur ta elaborojë këtë tezë themelore të filozofisë së Léfevrit shtron shumë

pyetje, të cilave mundohet t'u japë përgjigje. Kështu një ndër pyetjet e para dhe më të rendësishme që shtron ai, është pyetja: Mos është pikëpamja metafilozofike e Léfevit vëtëm interpretim i filozofive të Hegelit, të Marksit dhe të Niçes, apo është një pikëpamje e mëvetësishme që i përvetëson momentet thelbësore të të menduarit të këtyre filozofive dhe përpinqet t'i zhvillojë më tutje disa nga temat e çështjet e tyre, duke i ballafaquar me botën bashkëkohore, me çështjet e ndryshme e sprovimet e saj? Autori do të përgjigjet në këtë dhe në shumë pyetje të tjera duke bërë shkoqitjen sistematike të mendimeve të Léfevit të paraqitura në vepra të shumta, duke i ballafaquar ato me traditën filozofike, para së gjithash me mendimin e Hegelit, të Marksit dhe të Niçes, por edhe me mendimin bashkëkohor filozofik — me pikëpamjen strukturaliste të filozofisë marksiste të *Lui Altyserit* (Louis Althusser).

Libri i Kullashit »KAH METAFILOZOFA«, me nëntitullin *Të menduarit historik dhe filozofia strukturore*, përbëhet prej dy pjesëve dhe përfundimit. *Pjesa e parë*, që mban titullin *Metamorfoza e filozofisë në metafilozofi* përmban një hyrje dhe kapitujt: *Kritika e filozofisë, Filozofia dhe bo-*

*ta dhe Konflikti ndërmjet dy interpretimeve: Léfevri — Altyseri*, ndërsa *pjesa e dytë*, që titullohet, *Historia dhe strukturat pëfshin këta kapituj: Kriza e vetëdijes historike, Historia totale si histori e praxisit, Parahistoria, historia, phistoria, Historia dhejeta e përditshme, Kriza e strukturalizmit dhe Mimesisi në modernitet*

Autori që në fillim analizon mendimin e Léfevit lidhur me »krizën e filozofisë« në botën bashkëkohore. Me »krizë« ai nuk kupton, si shumë menditarë të kohës, një gjendje vajtuese, që nënkupton lodi, shterjen dhe mungesën e perspektivës së të menduarit filozofik bashkëkohor, por dëshiron ta bëjë çështje filozofinë e cila vë në dyshim çdo gjë përvëç vëtës. Si pikënisje Léfevri merr të dhëna se njëmendësia dhe filozofia gërshtohen ndërmjet vete, ndonëse ai nuk bëhet në kuptimin e pikëpamjes së Marksit përendërtimin e filozofisë. Ai flet për shpërbërjen e filozofisë, por edhe për shpërbërjen e botës, përcopëtimin e tyre gjithnjë më të madh, përkatësisht përvëtësuar me vëtëm jaftueshmërinë e filozofisë por edhe për indiferencën e botës ndaj saj. Mirëpo, qëndrimi mos-përfillës i botës ndaj filozofisë nuk do të thotë se filozofia nuk është e pranishme në të. Përkundrazi filozofia e pushton

botën, përbotërohet. Ky përbotërim »shkon kras has përbotërimeve të »sistemeve« të tjera: shtetit, teknikës, artit», që në shkallë të fundit shpien deri te automatizimi, që në vete ngërthen edhe proceset e degradimit, të prishjes së tyre.

Kullashi në vazhdim tregon në të dhënë se Lëfevri duke dashur ta zgjidhë kundërthënien ndërmjet filozofisë dhe botës filozofike, si kundërthënie nie thelbësore e botës dhe të njeriut bashkëkohor, arrin deri te kritika e Marksit lidhur me filosofinë e Hegelit, kritikë e cila hap një horizont të ri në bazë të të cilit bëhet i mundshëm vështrimi i botës historike të njeriut. Sipas Lëfevrit *horizonti që e hapin Marksit dhe Niçë është i paevitueshëm jo vetëm për ndricimin e thelbit të botës bashkëkohore, por edhe për ndryshimin dhe kuptimësimin e saj.*

Në kapitullin e dyte »Filozofia dhe bota« Kullashi shqyrton në mënyrë kritike çështjet, që i shtron Lëfevri: *se në ç'mënyrë është sendërtuar filozofia në botën bashkëkohore dhe çdo të thotë për filozofinë e botën ky sendërtim; a ka pushuar me këtë bota të jetë indiferente ndaj filozofisë e filozofia të jetë vetëm »plotësim ideal« i saj dhe së fundit a është suprimuar nga kjo kundërthënia bazë ndërmjet filozofisë dhe*

*botës jofilosofike.* Autori do të përqëndrohet veçmas në ato shqyrtime të Lëfevrit, në të cilat bëhet çështje raporti i filozofisë së Hegelit, Marksit e Niçes ndaj botës bashkëkohore Kështu, për Lëfevrin bota bashkëkohore është edhe *hegeliane, edhe marksiste, edhe niçiane.* Çdo njëra nga këto filozofi është përbotëruar, shpreh »diçka« nga bota moderne, »diçka« që është në formim e sipër.

Lëfevri mendimin e tij metafilozofik e formon përmes një shtegtimi të gjatë nëpër traditën e tërësishme filozofike, veçmas i ndriçon me sukses dhe i asimilon në mënyrë kritike momentet thelbësore në mendimin e Hegelit, të Marksit e të Niçes, ndonëse, si konstanton me të drejtë Kullashi, ndonjëherë na befason me ca interpretime të qëndrimeve të tyre. Nga kjo traditë Lëfevri »mbledh atë që i jep gjallëri të menduarit kritik, i cili nuk dëshiron të jetë soditje e thjeshtë e botës, por mendim-veprim, që merr pjesë në humanizimin e botës« (fq. 53).

Në kapitullin vijues »Konflikti ndërmjet dy interpretimeve Lëfevri — Altyseri«, duke e ballafakuar pikëpamjet e Lëfevrit me pikëpamjen strukturaliste të filozofisë marksiste të Luj Aldyserit, autori do të tregojë në mëvetësinë e përparësinë e pikëpamjes së Lëfevrit,

tregon në të dhënën se kjo pikëpamje i afrohet mendimit burimor të Marksit. Ky përfundim do të dalë edhe më i dëshmuar në fund të librit, atëherë kur të elaborohet mendimi i Lëfevit si mendim historik, përkundër atij strukturalist.

Kullashi në *pjesën e dytë* të këtij libri, që titullohet »*Historia dhe struktura*«, analizon mendimin historik të Lëfevit. Mendimi në fjalë shpreh thelbin e mendimit metafilozofik dhe si i tillë, para së gjithash, do ta kuptojë historinë dhe proceset e formimit të saj. Mendimi metafilozofik nuk është ndonjë metaligjërim i filozofisë, sikundër edhe sugjeron termi, por është mendim që »mediton për mbarimin e një bote historike nga pozita e një bote të mundshme esencialisht të ndryshme nga e tashmja, nga pozita e revolucionit« (fq. 71). Qenesore për të menduarit historik është e dhëna se edhe kur ai është i preokupuar me të kaluarën, në thelb orientohet kah e *ardhshmja dhe e mundshmja*. Për Lëfevin e *ardhshmja dhe e mundshmja janë dimensione pa të cilat nuk mund të kenë kuptim të qenunit njerëzor dhe bo ta në tërësi.*

Në kapitullin »*Kriza e vetëdijes historike*«, sikundër sugjeron edhe titulli, shqyrtohet mendimi i Lëfevit për krizën e tash-

me të mendimit historik dhe të vetëdijes historike. Këtu bëhet fjalë edhe për praninë e tendencave, shembull strukturalizmi, që shpien »kah reduktimi dhe varfërimi i mëtejshëm i këtij dimensioni bazë të të menduarit evropian«. Lëfevri do të ripërtrojë të menduarit historik, për të treguar edhe në »*daljen nga historia*«, përkatesisht në tejkalimin e historisë së deritashme, tejkalimin e trajtave të ndryshme të tjetërsimit të njeriut.

»*Historia totale si histori e praxisit*« është titulli i kaptinës së dytë, të pjesës së dytë, të këtij libri, ku autori tregon në përpjekjet e Lëfevit lidhur me përtërirjen dhe zhvillimin e të menduarit historik në një »*skicë të historisë totale*«, e cila në thelb shpjegon formimin historik të njeriut dhe të botës së tij. Lëfevri, sikundër edhe Marksi, ishte për ndryshimin rrënjesor të shoqërisë borgjeze, si shoqëri e tjetërsimit të shumëfishtë të njeriut, duke kërkuar shtegdaljen jo në masa të pjesërishme (ekonomike apo politike) por në një »revolucion total«.

Pasi tregon se kategoria e praxisit është kategori bazë e refleksioneve të Lëfevit për »historinë totale«, Kullashi në vazhdim shpjegon se në çfarë kuptimi e përdor ai terminin e *praxisit*. Ai flet edhe për prirjen e

Lëfevit që shpesh »t'i partikularizojë, t'i specifikojë dhe t'i relativizojë« nocionet e rëndësishme, gjë që ndodh edhe me nocionin e praxisit. Ka raste kur Lëfevri praxisin e përdor në kuptim që e përdor edhe Marks, si veprimtari përmes së cilës njeriu krijon vetëm dhe botën e vet, madje në kuptim më të ngushëtë, ku përfshin veprimitarë njerëzore (duke e përjashtuar raportin e njëriut me natyrën), ndërkaq veprimitarë e njëriut si përvetësim të natyrës rrëth njeriut e brenda vetë njeriut do t'i përfshinte poesisi, por ka raste kur praxisi kuptohet si përsundim i natyrës e i proceseve shoqërore, e poesisi si përvetësim jashtë njeriut dhe brenda vetë njeriut. Ndodh që praxisin e poesisin t'i përfshijë brenda nocionit »produksion«, të kuptuar si vetëprodhim dhe vetëkrijim të njeriut, nocioni që mund të shërbejë për thellimin e mendimit historik, për »rishqyrtimin e historisë«, sepse »historia nuk është gjë tjeter veç se produksion i cili supozon se »qenia njerëzore« e merr mbi vete qenien e vet dhe nuk i shmanget luftës për vdekje (revolucionit) për të realizuar veten« (fq. 87).

Pasi në vazhdim tregon për dallimet por edhe për epërsinë e pikëpamjes së Lëfevit mbi praxisin nga disa pikëpamje të tjera

(shembull të Sarrit, empiristëve, e pragmatisteve, dogmatizmit stalinist), Kullashi shpjegon sesi Lëfevri në përpjekjet e tij për të shkoqitur kompleksitetin e këtij nocioni, brenda tij fut dallime të shumëfishhta, nivele si bie fjala *dallon praxisin tëressor revolucionar nga ai i pjesërishëm apo praxisin »repetitiv« nga ai krijues*. Kullashi heton edhe disa paqartësi e pasaktësi në shqyrtimet e Lëfevit mbi praxisin. Kështu ndodh që Lëfevri e kundërvë praxisin me poesisin e ndonjëherë i merr përnjë. Autori i librit, që e kemi në shqyrtim, shkakqet e kësaj moskëmbëngusie e kërkon në prirjen e Lëfevit për t'i partikularizuar e specifikuar nocionet. Përkundër këtyre të metave e dobësive, Kullashi përfundon me plot të drejtë se nuk mund të zvogëlohet kontributi i rëndësishëm i Lëfevit »në zhvillimin dhe thellimin e konceptit praxis, i cili paraqet njérën nga pikëmbështetjet kryesore të të menduarit marksist në ndricimin e mundësive të vërteta njerëzore« (fq. 92).

Në fund të këtij kapitulli tregohet edhe në të dhënën se Lëfevri, qysh në punimet e para të tij, kishte hetuar rëndësinë thelbësore të çështjes së tjetersimit dhe të shtjetërsimit. Ai »analizoi në mënyrë të shumanshmë« çështjen në fjale, »duke e begatuar teorinë e tje-

tërsimit me njohuri të reja, veçanërisht me ndriçimin e disa trajtave konkrete e specifike të tjetërsimit, karakteristike për njeriun modern dhe botën moderne» (fq. 93).

Në kapitullin »*Parahistoria, historia, posthistoria*« Kullashi do të ndalet te këto kategorji dhe te disa pikëpamje që i zhvillon Lëfevri kur trajton çështjen e historisë. Derisa Marksji përdor kategoritë parahistori (që përfshin historinë e deritashme të tjetërsuar) dhe histori, Lëfevri mendon se periudha e parahistorisë mund të ndahet në *parahistori* (që përfshin shoqëritet agrare) dhe *histori* (shoqëritet industriale), ndërsa shoqérinë e mundshme, të ardhshme, të vërtetë njerëzore (urbane) e shënon me termin *posthistori*. Mirëpo, këto dallime më tepër terminologjike nuk e bëjnë thelbësisht të ndryshme pikëpamjen e Lëfevrit mbi historinë nga ajo e Marksit.

Në këtë kapitull autor i vlerëson drejt përpjekjet e Lëfevrit në drejtim të thellimit dhe të zhvillimit të pikëpamjes së Marksit mbi historinë, duke treguar edhe në vërejtjet që mund t'i bëhen, qoftë kur flet për periodizimin e historisë, për rolin, rëndësinë dhe karakteristikat e industrisë në botën bashkëkohore apo për ndonjë çështje tjetër.

Tema qëndrore e të menduarit metafilozofik të Lëfevrit, në çka edhe qëndron pjesa më e rëndësishme e kontributit të tij specifik marksizmit bashkëkohor, është *kritika e jetës së përditshme*. Këtë temë Kullashi e paraqet në kuadër të kaptullit »*Historia dhejeta e përditshme*«. Ai përqëndrohet në *shkoqitjen e idesë bazë të kritikës së përditshmërisë*, pa u ndalur edhe në hollësitë e saj, meqë ajo, si e thotë edhe vetë autor, do të ishte objekt i një analize të vëçantë.

Lëfevri e bën çështje tèrësinë e botës bashkëkohore si tèrësi të përcarë, për të treguar edhe në mundësitë e ndryshimit të saj. Pasi që tregon në *kuptimet* që ia jep *përditshmërisë*, autor i do të ndalet te një moment i rëndësishëm i analizës së Lëfevrit, pikërisht në *zbulimin e dimensionit të dyfishitë të përditshmërisë*: në cektësinë dhe *thellësinë*, *banalitetin* dhe *dramacitetin*, *autenticitetin* dhe *joautenticitetin*. Dergat e kuptimi i saj mund të vihet vetëm përmes njohjes së tere shoqërisë, ndërsa njohja e njërisë dhe e tjetrës, sikundër edhe e veprimit të tyre të ndërsjellë, nuk është e mundshme pa »*kritikën radikale*« të tyre. Për tejkalinin e këtyre përcarjeve ai zgjidhjen e kërkon në *hapjen kahjeta politike*, në *pjesëmarrjen aktive* të je-

tës private në jetën shogërore e politike. Me këtë njeriu i përditshëm bëhet qenje historike, jo në kuptim të shpërbërjes së individuales brenda kolektives, të shpërbërjes së sferës private në sfere shoqëroro-politike, por në kuptim të ngritjes së individuales në nivel të shogërores dhe të historikes, në saje të vetëdijes dhe të veprimtarisë politike. Pasi *ngjarjet historike* të këtij shekulli, sikundër edhe tezat e Marksit, *flasin për thelbin e tjetërsuar të sferës politike*, Lëfevri *shtegdaljen*, për tejkalimin e kësaj përcarjeje dhe të tjetërsimeve ekzistuese e kërkon në *shuarjen e shtetit*, përkatesisht në *aktin revolucionar*, që jep mundësi për të hapur botën e vërtetë njerezore.

Në vazhdim të këtij kapitulli bëhet fjalë edhe për *qëndrimin e Lëfevrit ndaj pikëpamjes filozofike të Sartrit mbi përditshmërinë* (të përjetuarën). Lëfevri do ta kritikojë pikëpamjen e Sartrit, ndonëse në atë kritikë, si thotë Kullashi, »ka dhe nuk ka të drejtë«. Ka të drejtë kur kritikon pikëpamjen e Sartrit të paraqitur në veprën »*Qeniesimi dhe Hicë*«, por nuk ka të drejtë derisa nuk e merr përbazë pikëpamjen e zhvilluar, të paraqitur në veprat e mëvonshme të tij. Pasi që i ballafaqon këto pikëpamje Kullashi përfundon, me të drejtë, se

pikëpamja bazë dhe orientimi mendor i Sartrit »është i afërt« me atë të Lëfevrit, sado që »zhvillohen dhe artikulohen nëpërrrugë mendore të ndryshme«.

Në kapitullin »*Kritika e strukturalizmit*« tregohet sesi Lëfevri i jep një kritikë të themelte markiste strukturalizmit, kur në vitet e gjashtëdhjeta e të shtatëdhjeta në Francë shfaqet kontesti ndërmjet strukturalizmit dhe markisizmit.

Kullashi vë në pah se Lëfevri strukturalizmin e përcakton si të menduar johistorik apo kundërhistorik. Kështu ndodh që brenda pikëpamjeve të ndryshme strukturaliste historia ose të reduktohet thelbësishët ose të flaket plotësisht. Në kritikën e këtyre pikëpamjeve Lëfevri, para së gjithash, mbështetet në pikëpamjen e Marksit mbi historinë. Për Marks formimi, pra edhe ai historik, është i pashtershëm. Formimi historik nuk është as »kontinuitet i kulluar«, as »diskontinuitet i kulluar«, as sintezë mekanike e tyre, por një lëvizje më e thellë e më e ndërlikuar, »lëvizje dialektike e shoqërisë dhe e historisë«, në të cilën njeriu i sendërtzon fuqitë e veta thelbësore, duke e formësuar botën në të cilën jeton dhe duke i dhënë kuptim të qenunit të vet në të.

Në vazhdim vihet në pah se Altyseri, në dallim nga strukturalistët e tjerë, temën e historisë e kupton si qendrore në pikëpamjen e Marksit, shqyrtohet teza bazë e tij (pikëpamja e historisë si proces pa subjekt) dhe ballafaqohet me pikëpamjen e Lëfevrit mbi historinë.

Pavarësisht nga e dhëna se pikëpamja e Altyserit për historinë si proces pa subjekt nuk mund të merret si plotësisht arbitrarë ose e dështuar, ngase ka mbështetje në disa pohime të shfaqura në punimet e Marksit, Kullashi tregon se epërsinë e pikëpamjes së Lëfevrit ndaj saj.

Çështë e vërteta, Lëfevri *niset nga qëndrimi*, si pas të cilit *nocioni bazë i Marksit*, përmes të cilit e mendon historinë njerezore dhe botën borgjeze, është *tjetërsimi*. Ai kërkon mbështetje në një pozitë të re mendore-praktike, e cila në mënyrë kritike e shikon thelbin e botës borgjeze dhe të tërë historisë së deritanishme, e cila jo vetëm që nxjerr në shesh trajtat e ndryshme të tjetërsimit, por edhe që shpie kah ndryshimi rrënjosor i botës ekzistuese jonjerëzore në një botë të vërtetë njerezore. Duke e flakur *nocio-nin e tjetërsimit*, Altyseri ia mbyll vetes mundësinë që botën ekzistuese dhe marrëdhëniet ekzistuese t'i shohë ndryshe

veçse si »të natyrshme«, në thelb të pandryshueshme.

Lëfevri interpretimin e vet të Marksit e kupton si rrugë e cila shpie kah *praktika revolucionare*, përmes së cilës duhet të ndryshohet gjendja ekzistuese, ndërsa interpretimin e Altyserit si model të të menduarit i cili e shenjtëron gjendjen ekzistuese në emër të shkençës, i shenjtëron dhe i lejgitimon trajtat e tjetërsuara të ekzistencës njerezore si të natyrshme, të domosdoshme dhe të pazëvendësueshme. Ai zbulon karakterin ideologjik të ideologjisë strukturaliste, mendon se kritika e ideologjive nuk e zgjidh çështjen, por atë e zgjidh revolucioni »si lëvizje e cila do ta bartë në vete provën dhe të vërtetën e vet« (fq. 144).

Në kapitullin e fundit të librit »*Minezisi në modernitet*«, duke folur përkuptimin e Lëfevrit mbi minezisin, Kullashi shquan disa veçori të rëndësishme të modernitetit dhe të përditshmërisë, të këtyre »dy ftyrave të bashkëkohësisë«. Këtu zhvillohen disa teza interesante të Lëfevrit, por tregohet edhe në kufizimet e tyre. Kështu bie fjala tregohet se *moderniteti me pamjen e tij shumëngjyrëshe e shkëll-qyese* (përmes kulturës, artit, teknikës, reklamës) e mbulon dhe e fsheh zymtësinë, monotoninë e për-

*ditshmërisë. Ç'është e vërteta, ajo bën »fetishizimin e aktuales, informatives, të drejtëpërdrejtes«.*

Kullashi elaboron tezat e njohura të Lëfevit për jetën e përditshme si ve-për (veprimitari e cila e njeh dhe e përfytyron vetën, i riprodhon dhe i përvetëson kushtet e veta, e në aspektin shoqëror kupton grupin shoqëror që merr në duar të veta dhe në përgjegjësi të vet fatin e vet shoqëror-vetëqeversija), për »artin si instrument në transformimin e përditshmërisë« dhe për »fuzionin e artit e të përditshmërisë«, duke theksuar aspektet pozitive, por edhe dobësitë e tyre, që para së gjithash janë rrjedhojë e së dhënës se ato nuk janë përpunuar sa duhet dhe kështu lejojnë mundësinë e shpjegimeve të ndryshme, shpesh të kundërtë.

Libri »KAH METAFILOZOFIA« përcillet edhe me një fjalë përmbyllëse të autorit.

Në fund të këtij vështrimi do të thosh se *vlera më e madhe* dhe *momen-tet më të rëndësishme* të këtij studimi do të ishin:

— qëndrimi përherë *kritik, shquarja e aspekteve pozitive* por edhe e dobë-ive të pikëpamjes së Lëfevit;

— *njojja e veprimitarise së tërësishme, përpunimi i opusit të gjere krijues* të Lëfevit;

— *ballafaqimi i pikëpa-mjeve* të Lëfevit me pikë-

*pamjet e tjera filozofike bashkëkohore si dhe*

— *thellimi i analizave rreth disa çështjeve, të cilat ose nuk janë shqyrtuar ose nuk janë shkoqitur në masën e duhur nga studiues të mëparshëm.*

Mendoj se vetveti është e kuptueshme se asnjë studim, andaj as ky i Kullashit, nuk mund t'i përfshijë të gjitha çështjet e temat, aq më tepër në këtë rast kur autori shqyrton pikëpamjet e Lëfevit që zhvillohen brenda një opusi të gjere të krijimtarisë (me mbi pesëdhjetë vepra të botuara), veçanërisht kur kemi para sysht »karakterin fragmentar« të mendimit të Lëfevit, shprehinë që t'i përsërisë pikëpamjet e veta apo edhe t'i riformulojë idetë e qëndrimet, që idetë e njëjta t'i paraqesë në mënyra të ndryshme, shpesh pa i zhvilluar sa duhet. Për këtë është i vetëdijshëm edhe vetë Kullashi, gjë që do ta thotë në fjalën përmbyllëse të këtij libri.

Teksti komunikon lehtë me lexuesin, autori shkruan me një stil të përshtatshëm, përdor fjalë të qëlluara për nocionet e ndryshme filozofike. Megjithatë, duket se edhe ky, si-kundër disa autore të tjerë, madje edhe gjuhëtarë, nuk është aq këmbëngullës në përdorimin e fjalëve burimore shqipe në vend të fjalëve të huaja, si bie fjalë: *sasi për kuan-titet, cilësi (kualitet), thelb*

(esencë), thelbësore apo  
qenësore (esenciale), tërë-  
si (totalitet), risi (novum),

shndërrim (transformim)  
e ndonjë fjale të jetë.

Xhafer Xhaferi

## In memoriam

### VUJADIN JOKIQ

Nga fundi i nëntorit të v. 1986 vdiq në Beograd profesori shumëvjeçar i Universitetit të Prishtinës, filozofi dhe punëtori i shquar publik e kultural Vujadin Jokiq.

I lindur në Velikë, Mali i Zi më 1928, shkollën fillore e kreu V. Jokiq në vendlindje e të mesmen në Pejë. E ndërpree këtë shkollim gjatë luftës, në të cilën babai i ra dëshmor që më 13 korrik 1941, vellai iu vra në brigadat e para partizane kurse nëna ra viktima e terorit më 1944. Pas luftës shkollën e mesme e vijoi në Ivangrad dhe në Sarajevë. Shërbeu ca kohë si arsimtar në Vllasenicë, Zenicë, Podujevë e Pejë. Pasi kreu studimet e filofisë në Shkup, një kohë punoi në Bashkësinë e Universiteteve të Jugosllavisë, në Sekretariatin Republikan të Arsimit dhe në Entin për studimin e zhvillimit të kulturës në Beograd, ku udhëhoqi seksionin kërkimor.

Pas studimeve të shkallës së tretë zgjidhet docent në Fakultetin Filozofik të Prishtinës ku mban lëndën e Historisë së filozofisë dhe të Estetikës.

Vujadin Jokiqi ishte jo vetëm pedagog i shquar e i dashur për studentë dhe bashkëpunëtorë, por edhe punëtor i shquar shkencor e kultural. Interesimi dhe krijimtaria e tij përfshin fushën e filozofisë, të estetikës, të kulturologjisë dhe të kritikës letrare. Teza e doktoranturës së tij i kusqtohet gjenezës së krijimtarisë së Tin Ujeviqit. Botoi nëntë vëllime të veçanta dhe studime, ese, vështrime e shqyrtime të shumta në revistat filozofike, sociologjike, kulturologjike dhe kritike-letrare. Përveç tezës së përmendur të doktoranturës, batoi edhe këto vepra: Simbolizimi; Poezia e dashurisë e Tin Ujeviqit; Pozita shoqërore e artistëve të lirë; Shqyrtime filozofike dhe kritike-letrare; Udhëkryqet e filozofisë bashkëkohore; Shikimi i Marksit për artin; Hyrje në filozofi dhe Filozofia dhe poezia. Këto vepra si edhe punimet e shumta të V. Jokiqit të botuara në revista të ndryshme

dhe që u kushtohen kryesisht problemeve të filozofisë së marksizmit dhe të filozofisë bashkëkohore, të estetikës dhe të letërsisë i karakterizon serioziteti shkencor, fuga e theksuar e depërtimit në fenomenet që studion, një sensibilitet i shqar dhe ndjenjë e hollë e masës.

Vujadin Jokiqi qe ndër themeluesit dhe kryeredaktorët e revistave »Kultura«, që trajton kryesisht probleme të teorisë dhe të sociologjisë së kulturës dhe të revistës »Književna kritika«, revista këto me peshë të kon siderueshme në jetën kulturale të vendit.

Veprimtaria pedagogjike e Vujadin Jokiqit lichtet kryesisht me Universitetin e Prishtinës ku si docent, profesor inordinar e më vonë si profesor ordinar punoi rreth 15 vjet. Në Prishtinë botoi punime të tij të shumta. Një kohë ishte edhe kryetar i Shoqatës së filozofeve të Kosovës. Mësim mbajti edhe në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit »Velko Vllahoviq« të Titogradit e edhe në Fakultetin e Artit Dramaturgjik në Beograd, por bashkëpunimin me Fakultetin Filozofik të Prishtinës e kishte në radhë të parë. E edhe në vitet e fundit, në gjendje të vështirë shëndetësore dhe në situatat tjera të vështira, duke i përballuar dhe duke u ngritur mbi këto gjendje, me qëndrueshmëri dhe dinjitet të njeriut të nder shëm e të profesionit që ushtronte, ruajti kujtime, ndje nja dhe fjale të mira e të singerta për mesin dhe bashkëpunëtorët me të cilët bashkëpunoj gjatë.

Asnjë përkujtim i Vujadin Jokiqit nuk do të ishte as përafërsisht i plotë pa u përmendor cilësitë e rralla njerëzore të tij, sinqueriteti e modestia, nderi dhe dinjiteti që e karakterizonin.

*Fehmi Agani*



## NDËRRIME NË KËSHILLIN BOTUES DHE NË REDAKSINË E »THEMËS«

Në kuvendin e fundit të Shoqatës së Filozofeve dhe Sociologëve të KSA të Kosovës, të mbajtur më 5 qershor 1986, u bën disa ndërrime në përbërjen e redaksisë dhe të këshillit botues. Ramush Mavriqi kërkoi të lironhet nga detyra e anëtarit të redaksisë për shkak të disa obligimeve tjera. Isuf Berisha dha dorëheqje në detyrën e sekretarit të redaksisë pasiqë Shoqata nuk ndërmori asgjë lidhur me parashtresën që ia pat dërguar kohë më parë Kryesisë së shoqatës e ku shtrohej çështja e plagiave të Ali Didës. Anëtarë të rinj të redaksisë u zgjodhën Ibrahim Berisha e Enver Halilović, ndërsa sekretar i ri i redakesisë u zgjodhë Blerim Shala. Ali Dida kërkoi të lironhet nga detyra e kryetarit të këshillit botues të revistës. Shkëlzen Maliqi propozoi ta shkarkoi Ali Didën nga kjo detyrë e të mos e pranojë dorëheqjen e tij. Këtë propozim askush nuk e kontestoi. Kryetar i ri i këshillit botues u zgjodhë Ismail Berisha, ndërsa në vend të Rexhai Suroit, i cili kohë më parë shkoi në detyrë të ambasadorit të RSF të Jugosllavisë në Spanjë, anëtar i ri i Këshillit botues u zgjodh Ismail Hasani.

*Redaksi*



## THEMA

*Revistë e shoqatës së Filozofëve dhe Sociologëve të KSA të Kosovës  
Časopis Društva Filozofa i Sociologa SAP Kosova*

Numër 7 1986  
Broj

### *Redaksia — Redakcija*

Fehmi Agani  
Murteza Luzha  
Milenko Karan  
Gani Bobi  
Ibrahim Berisha  
Enver Halilović  
Dragoljub Zivković, zëvendës kryeredaktori — zamenik glavnog urednika  
Muhamedin Kullashi, kryeredaktor — glavni urednik  
Blerim Shala, sekretar

### *Këshilli botues — Izdavački savet*

Muslim Mulliqi  
Milan Šešlia  
Hajredin Hoxha  
Nehar Shishko  
Milovan Marković  
Nait Vranezi, zëvendës i kryetarit — zamenik predsednika  
Muhamedin Kullashi  
Ismail Hasani  
Ismail Berisha, kryetar — predsednik

### *Adresa e redaksisë — Adresa redakcije*

Fakulteti Filozofik, Dega Filozofi-Sociologji, 38000 Prishtinë  
Filozofski Fakultet, Odsek za Filozofiju i sociologiju, 38000  
Pristina

Llogaria rrjedhëse 68400-678-4062  
Ziro raçun

Shoqata e Filozofëve dhe Sociologëve të Kosovës (për revistën »Thema«)

Društvo Filozofa i Sociologa SAP Kosova (za časopis »Thema«)

Cmimi për një numër 300 din.

Cena pojedinoj broja 300 din.

Doreshkrimet nuk kthehen

Rukopisi se ne vraçaju

Redaksia pranon të mërkureve 10—12  
Redakcija prima sredom

Dizajni Nexhat Krasniqi — Nekra  
Dizajn

Lektor: Syle Osmanaj

Korrektor Beqir Sadiku  
Korektor

Redaktor teknik Jusuf Jusufi  
Tehnički urednik

Shtyp: OP për veprimtari grafike »Progres — S. Gjorgjeviç«  
Mitrovicë e Titos

Stampa: RO za grafičku delatnost »Progres — S. Đorđević«  
Titova Mitrovica

